XHEMAL BALLA

TRE ELEMENTET BAZË TË STRUKTURËS SË NDËRTIMIT TË FESË ISLAME

Tiranë, 2016

Autori : Xhemal Balla

Kompjuterizoi dhe redaktoi: Lira Musollari

Faqosi:

Kopertina:

Shtëpia botuese:

Shtypshkronja:

Hyrje

Falënderimi i takon Zotit të Lartësuar me begatitë e të Cilit vazhdojnë mirësitë me të cilat na udhëzon në rrugë të drejtë, udhëzim ky, të cilin nuk do të mundeshim ta arrijmë, po të mos na udhëzonte Ai.

Paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të Dërguarin, mëshirë për njerëzimin, Muhamedin a.s., familjen e tij, shokët dhe mbi ata të cilët ftuan në thirrjen e tij dhe pasuan sunetin e tij deri Ditën e Gjykimit.

Me lejen e Allahut, në këtë libër, do të paraqes strukturën bazë të ndërtimit të fesë islame. Kjo për faktin se besimtari mysliman duhet të jetë pasues i denjë i fesë islame, i mësimeve dhe parimeve të saj, për të mos dale nga natyra e tij e vërtetë dhe nga konteksti origjinal i saj.

Feja islame është universale, siç shprehet Zoti i Lartësuar në shumë citime kuranore duke iu drejtuar njerëzve me thirrjen: "O ju njerëz!" Për këtë arsye asnjë njeri nuk ka të drejtë ta konsiderojë fenë si monopol të tij duke i nënvlerësuar të tjerët, duke i fyer apo urryer ata.

Historikisht rrugët e interpretimit të fesë islame kanë qenë të ndryshme e vazhdojnë të jenë. Por duhet ditur se Islami në origjinën e tij është një fe e përhershme, e mbështetur në tekstin e Mesazhit Hyjnor, Kur'anit Famëlartë dhe e pandryshueshme në strukturën e ndërtimit të saj. Mbi këtë bazë në vendin tonë janë krijuar elemente të bashkëjetesës dhe të respektit ndërfetar, për të qenë të bashkuar në mbrojtjen e interesave të vendit. Një nga dijetarët e shquar myslimanë shqiptarë të shekullit të XX-të, Hafiz Ibrahim Dalliu, përkthyes dhe komentues i Kur'anit në gjuhën shqipe, shprehet: "Ne shqiptarët, prej çdo feje qofshim, jemi tanë vëllazën gjaku dhe vëllazën vatani. Do të shkojmë mbarë e mirë me shoq, si jemi tuj shkue, do të punojmë së bashku për lulëzimin e Atdheut tonë dhe do të mbrojmë atë me gjakun tonë".[1]

Liria e bindjes dhe besimit është e garantuar jo vetëm në Kur'anin Famëlartë, por edhe në kushtetutë. Në Kur'an thuhet: "Kush të dojë, le të besojë e kush të dojë, le të mohojë"[2]. "S'ka detyrim në fe"[3].

Çdo individ që pranon Islamin ka për detyrë të besojë edhe shpalljet e mëparshme hyjnore si Teurati Zeburi, Ungjilli, të cilët Allahu i përmblodhi në Kur'anin Famëlartë. Këta kanë pasur të dërguarit e tyre të veçantë e për këtë arsye besimi në pejgamberët, para të Dërguarit të Fundit, Muhamedit a.s., është një nga themelet bazë të besimit islam.

Në këto libra ndjenja e besimit në një fuqi absolute, që njihet me emrin "Allah" ose "Zot" ka qenë parësore. Pastaj njeriu nëpërmjet udhëzimeve është ftuar të jetojë në paqe e dashuri, në harmoni me familjen, farefisin, shoqërinë dhe tërë njerëzimin.

---

1. H. I. Dalliu, *Patriotizma në Tiranë.*
2. Kur'an, El-Kehf: 29.
3. Kur'an, El-Bekare: 256.

Me këtë libër synova që, nëpërmjet zbërthimit të elementeve bazë të strukturës së Islamit, te çdo besimtar të formohet bindja në ndërtimin e karakterit integrues në shoqëri e jodiferencues; që pranon bashkëjetesën dhe harmoninë me të tjerët. Kjo ishte edhe praktika e profetit Muhamed me besimtarët e Medinës që përmes kushtetutës së hartuar, u siguronte të drejta të plota banorëve jomyslimanë të shtetit. Për analogji, edhe sot, polemikat, dialogët e diskutimet për bindjet fetare duhen bërë me tolerancë e mirësjellje në përputhje me udhëzimet hyjnore.

Boshti kryesor që përshkon këtë libër është besimi dhe përkushtimi ndaj Zotit të Lartësuar. Këtu qëndron e tërë filozofia e Shpalljes Hyjnore, mbi të cilën do të mbështetet besimtari mysliman. Njëkohësisht sjellim argument edhe për ata që e harruan Zotin duke iu mbështetur teknologjisë së përparuar. Mirëpo Zoti i Lartësuar i drejtohet njeriut në Kur'anin Famëlartë me shprehjen: "O njeri! Ç'të mashtroi ty që nuk i besove Zotit tënd bujar, i Cili të krijoi ty, të dha përmasa të rregullta dhe të harmonizoi dhe, që të ka mbrujtur në çdo formë që ka dashur"[4]. Shpjegojmë më hollësisht që mohuesi të krijojë bindje të plotë. Dije se nga një qelizë e vetme, ke dalë nga bashkimi i prindërve babë-nënë. Por Zoti i Lartësuar hartoi dhe kontrolloi gjithë programin për të ndërtuar trupin e njeriut në mënyrë të përsosur. Prandaj ktheje edhe njëherë vëmendjen tek origjina jote qelizore dhe ule kokën përpara Atij Arkitekti Suprem që hartoi këtë program madhështor. Po të thellohesh më shumë në studimin e origjinës tënde, do të përballesh me një sekret akoma më të madh e të mahnitshëm, se nga qeliza mashkullore që i transmetohet vezës femërore, gjendet e shkruar e gjithë trashëgimia jote, që në gjuhën shkencore quhet ADN. Për këtë Allahu i Lartësuar thotë: "E pastaj e bëmë atë pikë fare dhe e vumë në një vend të sigurt (mitër)". Kjo pikë e farës ruan edhe gjininë e ardhshme të njeriut, mashkull ose femër. A ka mundësi që këto ndodhi të bëhen në mënyrë të rastësishme, pa pasur një arkitekt? Sigurisht për njeriun që arsyeton do të thotë se ka një Krijues. Ky është Allahu (Zoti) i Lartësuar i Cili në Kur'an thotë: "Në të vërtetë, Ne e krijuam njeriun nga një pikë fare e përzier, për ta sprovuar dhe e bëmë që të dëgjojë dhe të shohë"[5]. "Ai ju bën që të lindni si foshnje"[6]. Lindja sigurisht bëhet në një afat të caktuar. Kush e caktoi këtë afat? E caktoi Ai, i Cili organizoi tërë programin e zhvillimit e të rritjes së embrionit nga një qelizë e vetme, duke u shtuar dhe së cilës iu dha informacioni i caktuar në formën e organeve dhe gjymtyrëve me formën përfundimtare në një trup që është i gatshëm të përballojë jetën pas lindjes. A ka mundësi pas gjithë këtyre argumenteve logjika dhe arsyeja e njeriut të mohojë ekzistencën e Krijuesit, Zotit të Lartësuar? Sigurisht që jo. Prandaj për besimtarët që pranojnë dhe jetojnë me Islamin, me këtë libër, me lejen e Allahut, do të paraqes tre themelet bazë të fesë islame që janë: Islami, Imami, Ihsani, duke prekur në fund shkurtimisht edhe ligjet islame me të cilat duhet të ndërtojë jetën myslimani.

4. Kur'an, El-Infitar: 6-8.
5. Kur'an, El-Insan: 2.
6. Kuran, El-Gafir: 67.

1

Islami është ndërtuar në pesë shtylla

1. Dëshmia ose Shehadeti

Për të vërtetuar që je mysliman, së pari duhet të dëshmosh, të vërtetosh me gojë e me zemër, se ka vetëm Një Zot. Ky është akti themeltar i besimit prej të cilit varen të gjitha veprimtaritë e tij jetësore islame. Duke e njohur këtë realitet, dëshmon edhe profetësinë e Muhamedit a.s., nga i cili u përcoll Fjala Hyjnore, Mesazhi i Islamit, Kur'ani Famëlartë. Që në fillim të Kur'anit theksohet se myslimani duhet të besojë jo vetëm të dukshmen, por edhe të padukshmen (gajbin). Zoti i Madhërishëm i përfshin të dyja, të padukshmen dhe të dukshmen dhe është dëshmues e dëshmitar i çdo gjëje siç theksohet në Kur'an: "Ai është me ju kudo që të gjendeni"[7]; "dhe Allahu është dëshmitar për çfarë bëjnë ata."[8] dhe "A nuk të mjafton që Zoti yt është dëshmitar mbi çdo gjë".
Nga sa u tha më lart del se shehadeti apo dëshmia përbëhet nga dy fraza kryesore: "Nuk ka zot (të adhuruar) tjetër përveç Zotit", që do të thotë se Islami ka në themel të tij besimin në ekzistencën e Zotit të Lartësuar. Kjo vërtetohet nga argumentet e tij duke filluar me njeriun, nga natyra përreth, toka dhe gjithësia, si dhe gjithçka që ajo përmban brenda saj. Nuk mund të imagjinohet se gjithçka që shohim përreth është krijuar vetvetiu. Edhe objekti më i thjeshtë ka krijuesin e vet, ashtu siç ka edhe shtëpia ku ne jetojmë. Si mund të flitet për këtë gjithësi të pafund me këtë baraspeshë të mrekullueshme, tokën e detet ku jetojnë gjallesa pa fund, me një përsosmëri të ndërtimit të organizmit të tyre që nuk mund të krijohen nga mendja dhe dora e njeriut! Si nuk çuditet njeriu me vetveten?! Me organe të përsosura të trupit që janë formësuar nga një embrion qelizor. Sigurisht është një arkitekt suprem, njohës i të gjitha ligjeve në ndërtimin e organeve si për shembull: të syrit me ligjet e optikës, të veshit me ligjet e akustikës etj., të pafund. Në Kur'an thuhet: "Është Ai që i di gjërat e padukshme dhe të dukshme. Ai është i Plotfuqishmi dhe Mëshirëploti, i Cili ka përsosur çdo gjë që ka krijuar. Ai e ka filluar krijimin e njeriut prej baltës. Pastaj bëri që pasardhësit e tij të krijohen prej një pike të lëngut të shpërfillur, së cilës pastaj i dha trajtë dhe i fryu shpirtin e krijuar prej Tij. Ai ju ka dhënë dëgjimin, shikimin dhe zemrën, por pak prej jush janë mirënjohës"[9].

7. Kur'an, El-Hadid:4.
8. Kur'an, Junus:46.
9. Kur'an, Sexhde: 6-9.

Për njeriun e arsyeshëm ka prova të shumta e të padiskutueshme që e bindin se asgjë nuk krijohet vetvetiu, por ka një Krijues që, mbi bazën e ligjeve të caktuara, ka krijuar gjithçka në mënyrë të përsosur. Në Kur'an thuhet: "Në Tokë ka shenja për ata që besojnë me bindje, po edhe në vetet tuaja - a nuk e shihni vallë?"[10] Kjo është një tërheqje vëmendjeje për njeriun që mendon dhe analizon çdo gjë që shikon për të arritur në konkluzionin e vërtetë se gjithë bota nuk është krijuar vetvetiu e në mënyrë të rastësishme, por mbi bazën e një projektuesi superinteligjent e absolut, që është pa fillim e pa fund, i përhershëm në ekzistencën e tij, që shikon çdo gjë dhe sundon mbi to.
Karakteristikë themelore dalluese e myslimanit është besimi në Njëshmërinë e Allahut, Zotit të Plotfuqishëm, prej të Cilit varet fati i tërë njerëzimit. Ata që i drejtohen vetëm Allahut me falënderim, lutje e adhurim e njëkohësisht kërkojnë edhe mbrojtje prej Tij, konsiderohen besimtarë myslimanë. Në Kur'an thuhet: "në të vërtetë, Zoti juaj është Një, Zot i qiejve dhe i Tokës dhe çfarë gjendet mes tyre dhe Zot i lindjeve (të diellit)!"[11]. Kjo do të thotë që në gjithësi ka vetëm Një Zot krijues që mbikëqyr çdo gjë dhe i udhëheq mbi bazën e ligjeve të caktuara dhe sundon mbi to. Këtë e vërteton edhe ajeti kuranor: "Thuaj: Allahu është Krijues i çdo gjëje dhe Ai është i Vetmi, Ngadhënjimtari"[12]. Për shembull, bota ose universi përmban miliarda galaktika e yje të panumërt që janë në lëvizje të vazhdueshme. Toka në të cilën ne jetojmë është shumë e vogël si pjesë e këtij universi. Ashtu si të gjithë planetet e sistemit diellor, edhe Toka bën një lëvizje të vazhdueshme rreth vetes dhe rreth Diellit. Në rrotullimin rreth vetes kemi ndërrimin e vazhdueshëm të ditës dhe natës. Pozicioni i caktuar midis Tokës dhe Diellit bën të mundur jetën e gjallë në Tokë që nga organizmat njëqelizore tek ato shumëqelizore si bimë, kafshë e deri te njeriu. Të gjithë këta lëvizin e jetojnë në bazë të një plani të përcaktuar dhe shumë të saktë. Çdo gjë ekziston në harmoni të plotë. Për shembull, oksigjeni për frymëmarrje në atmosferë ka masën 21%, tejkalimi ose ulja e kësaj mase dëmton jetën derisa e bën atë të pamundur. Kjo tregon se është i njëjti Vullnet Hyjnor që ka vetëm një plan, projektues i të cilit është vetëm Një Zot, pa ortak dhe vetëm një sundues i kësaj gjithësie. Në Kur'an thuhet: "Allahu nuk ka zgjedhur për Vete ndonjë bir dhe përveç Atij s'ka asnjë zot tjetër, përndryshe çdo zot do të merrte atë që ka krijuar dhe do të ngriheshin njëri mbi tjetrin. Qoftë i lartësuar Ai nga shpifjet e tyre"[13]. Me këtë argument kuranor Islami hedh poshtë në mënyrë kategorike iluzionin se Zoti ka bir a bijë, apo rasti më ekstrem, që nuk ekziston dhe të gjitha gjërat kanë ardhur vetiu. Por ne themi: Po shtëpia ku jetoni është bërë vetë? Islami pohon e vërteton se çdo gjë që ekziston në gjithësi bashkë me njeriun, përveç Zotit, është krijesë e Tij dhe e varur prej Tij. Në Kur'an vuloset përfundimisht Njëshmëria e Allahut kur thuhet: "Thuaj: "Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm! Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim. Ai as nuk lind, as nuk është i lindur. Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë!""[14].

Njeriu që e mbush zemrën me këtë besim jeton i qetë, i mbrojtur, me kurajë për të përballuar jetën, një jetë plot dinjitet e shpresë, gjithmonë për një të ardhme të lumtur si në këtë botë, ashtu edhe në botën e pasosur.

---

10. Kur'an, Edh-Dharijat: 20-21.
11. Kur'an, Safat: 4-5.
12. Kur'an, Err-Rra'd: 16.
13. Kuran, sure "El-Mu'minun", ajeti 91.
14. Kuran, sure "El-Ihlas", ajetet 1-4.

1.1. Ç'është Islami?

Kur përdorim termin "fe" nuk përmbushet gjithë mesazhi që përfaqëson Islami. Ne nuk mund të jemi besimtarë nëse nuk jetojmë me Islamin dhe për Islamin, nëse Islami nuk bëhet program për jetën tonë, ndërsa Kur'ani rregull për shoqërinë tonë edhe nëse e drejta islame nuk gjykon në të gjitha çështjet tona.

Fjala "islam" do të thotë "t'i dorëzohesh, t'i nënshtrohesh vullnetit dhe kontrollit të Zotit të Lartësuar, si argument i padiskutueshëm për ekzistencën e Tij. Gjithësia dhe gjithçka ndodhet në të janë krijuar prej Tij, e lavdërojnë pa pushim Atë, kryejnë veprime sipas udhëzimeve të Tij dhe pranojnë kontrollin e Zotit. Në Kur'an thuhet: "A mos kërkojnë ata diçka tjetër përveç fesë së Allahut, ndërkohë që Atij i përulen të gjithë ata që gjenden në qiej dhe në Tokë, me hir a me pahir dhe tek Ai do të kthehen të gjithë?!"[15]. Pra është e domosdoshme që të besojmë Zotin Një dhe t'i përmbahemi angazhimit me shprehjen "Nuk ka zot tjetër veç Allahut dhe se Muhamedi është i dërtguari i Tij". Me këtë jemi të detyruar të angazhohemi për të vepruar sipas Islamit e të gjykojmë sipas tij, ashtu siç dëshiron Allahu i Lartësuar kur tha: "Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj."[16].

Të gjitha fetë me Shpallje Hyjnore nëpërmjet të dërguarve i kanë komunikuar njerëzimit se, nëpërmjet Islamit, bëhet takimi me Zotin e Lartësuar. Përpara profetit Muhamed, Zoti dërgoi profetë në periudha të ndryshme kohore, por që nuk kanë ndryshuar në shpallje. Në Kur'an thuhet: "Ai ka urdhëruar për ju atë Fe, të cilën ta zbuloi ty (o Muhamed) dhe që pati urdhëruar për Nuhun, Ibrahimin, Musain dhe Isain, duke thënë: "Qëndroni në fenë e drejtë dhe mos u përçani në të!""[17]. Do të thotë që të gjithë të dërguarit i kanë përçuar brezat e Islamit në mënyrë të barabartë. Këtë e vërteton përsëri Kur'ani Famëlartë ku shprehet: "Thuaj (o Muhamed): "Ne besojmë Allahun, atë që na është shpallur neve, atë që i është shpallur Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, Jakubit, Esbatëve (12 bijve të tij) dhe në atë që i është dhënë Musait, Isait dhe profetëve nga Zoti i tyre. Ne nuk bëjmë asnjë dallim midis tyre dhe Ne vetëm Atij (Allahut) i përulemi.""[18].

Zoti i Madhërishëm e krijoi njeriun me natyrë islame, sepse të gjitha organet e trupit nuk dalin jashtë ligjeve të krijuara prej Tij, ndryshe organizmi do të dëmtohet dhe më në fund edhe vdes. Por kjo natyrë e brendshme ka një komandë, që është zemra, e cila nuk kryen vetëm funksionin e qarkullimit të gjakut, por edhe atë që ajo rreh për Krijuesin e saj, Zotin e Lartësuar, sa organet e trupit u binden ligjeve të Krijuesit. Prandaj Allahu i Madhërishëm në Kur'an thotë: "Drejtohu me përkushtim në fenë e pastër monoteiste, natyrën fillestare, në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit. S'ka ndryshim të krijimit të Allahut. Kjo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë."[19]. Do të thotë që ilaçi për të mbrojtur zemrën, natyrën e brendshme të njeriut nga mikrobet e sëmundjeve të

---

15. Kur'an, Al Imran: 83.
16. Kur'an, El-Maide: 3.
17. Kur'an, Esh-Shura: 13.
18. Kur'an, Al Imran: 84.
19. Kur'an, Err-Rrum: 30.

veseve të këqija, është Islami që e ushqen njeriun me ushqime të pastra, për ta ruajtur trupin të shëndoshë ashtu si e krijoi i Plotfuqishmi, i Plotdijshmi, Sunduesi dhe Gjykatësi Suprem. Janë ligjet e fesë islame që e mbrojnë njeriun nga rreziqet e kësaj bote. Zbatimi i tyre në aktivitetin jetësor dhe falënderimi e adhurimi ndaj Krijuesit e bëjnë njeriun të nderuar e të respektuar jo vetëm në mjedisin familjar e shoqëror, por edhe tek Allahu i Madhërishëm, tek i Cili do të kthehet ballëhapur, për të fituar atë që Ai i ka premtuar, parajsën e amshuar. Ashtu siç thotë në Kur'an ku shprehet: "Kush i dorëzohet Allahut, me tërë qenien e tij, duke qenë punëmirë, ai është kapur për vegën më të fortë. Tek Allahu do të kthehet çdo gjë."[20] Për këtë arsye, çdo njeri duhet të përqafojë fenë islame e të zbatojë ligjet e saj,sepse Zoti na krijoi dhe tek Ai do të kthehemi.Kjo është logjika e besimit që po të gjykonim sipas tij, do t'u bindeshim plotësisht ligjeve të tij, adhurimit, moralit, marrëdhënieve ndërnjerëzore etj. Me Islamin do të bëjmë një jetë më të qetë, pasi jemi të angazhuar që të punojmë e jetojmë në bazë të një programi të caktuar në të gjitha fushat e jetës. Ndodh sot që besimtarët nuk i janë kthyer plotësisht në jetën e tyre Islamit, megjithëse e konsiderojnë veten myslimanë. Zbatojnë një ose disa aspekte të tij ose njërin nga parimet e tij. Pra, është kufizuar, ndërsa për sa u përket marrëdhënieve ekonomike, tregtare, qytetare, kushtetuese, zyrtare edhe kodit penal, Islamin do ta gjejmë larg vizionit të Shpalljes Hyjnore, Kur'anit Famëlartë dhe Sunetit të Profetit a.s.

Islami duhet të ndihet i lirë që të udhëheqë besimtarin në tërë aktivitetin jetësor të tij si individ, familjar dhe marrëdhëniet shoqërore. Zoti në Kur'an thotë: "Mos vallë, një pjesë të Librit (Teuratit) e besoni, kurse pjesën tjetër e mohoni?! Cilido prej jush që vepron kështu, do të ndëshkohet me poshtërim në këtë jetë, ndërsa në Ditën e Kiametit do të dërgohet në dënimin më të ashpër. Allahu nuk është i pavëmendshëm ndaj veprimeve tuaja."[21] Për këtë arsye duhen zbatuar të gjitha ligjet që burojnë nga Kur'ani Famëlartë (sheriati islam) që mund të përmblidhen në këto pika:

Së pari, në parimet e pandryshueshme të besimit në Një Zot dhe adhurimi ndaj Tij;

Së dyti, standardet e moralit në zbatimin e normave të lejuara e të ndaluara.

Së treti, në sistemin ligjor që përfshin tërë jetën e njeriut e marrëdhëniet me familjen dhe në ato ndërnjerëzore në tërë fushat e jetës.

Burimi i dytë i sheriatit (ligjit islam) pas Mesazhit Hyjnor, është suneti ose tradita e pastër profetike, që shpjegon Kur'anin dhe porosit norma e rregulla të caktuara në jetën e njeriut e të shoqërisë që nuk bien ndesh me Kur'anin.

Burimi i tretë është Ixhtihadi, që në rastet kur nuk i gjendet referim në Kur'an e Sunet, lejohet që nëpërmjet provave fetare, shkencore ndërtohet një legjislacion progresiv, por që nuk kundërshton Kur'anin dhe Sunetin.

Sipas dijetarit Hassan Hathaout "Synimet e sheriatit, në librin e parë përfshihen: pesë synimet e sheriatit që janë:

1. Ruajtja dhe mbrojtja e jetës - Në Islam nënvizohet me forcë ligji i lirisë dhe i të drejtave të njeriut e në veçanti mbrojtja e jetës dhe lirisë për të jetuar.

[20]. Kur'an, Lukman: 22.

[21]. Kur'an, El-Bekare: 85.

2. Ruajtja dhe mbrojtja e mendjes - Liria e fjalës dhe mendimit shihet me përparësi në liritë dhe të drejtat themelore të njeriut nga persekutimet që mund të vijnë nga çdo anë e deri te përdorimi i substancave që ndikojnë në humbjen e arsyes dhe logjikës.

3. Liria e besimit - Zoti në Kur'an thotë: "S'ka detyrim në fe"[22]. Secili ka të drejtë të zbatojë ritet e tij fetare e të mbrojë besimin e tij.

4. Mbrojtja e pronës private - E drejta e pronës është e paprekshme. Çdo njeri pa dallim gjinor mund të sigurojë pasuri me fitim të drejtë, hallall e jo me mjete të paligjshme.

5. Riprodhimi dhe ruajtja e llojit - Vetëm me martesë të ligjshme, të dokumentuar lejohet lindja e rritja e fëmijëve, të cilët kanë të drejta të plota mbi trashëgiminë e prindërve të tyre. Dënohen me ligj marrëdhëniet intime jashtë martese si për burrin edhe për gruan. Lejohet planifikimi familjar, por në asnjë rast me abort, me shkatërrimin e embrionit në mitrën e nënës.[23]

1.2. Njeriu lind me natyrë islame

Në Shpalljen Hyjnore, Allahu i Madhërishëm e lidh fenë që solli me natyrën e njerëzve dhe vetë njeriu e ka pranuar amanetin e dhënë para audiencës Hyjnore. Për këtë arsye, Zoti xh.sh.shprehet: "Drejtohu me përkushtim në fenë e pastër monoteiste, natyrën fillestare, në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit. S'ka ndryshim të krijimit të Allahut. Kjo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë. Drejtojuni Atij me pendesë, frikësojuni Atij dhe falni namazin e mos u bëni si ata, që i shoqërojnë Atij diçka tjetër (në adhurim)"[24]. Do të thotë që besimtari mysliman duhet të drejtojë vëmendjen tek Allahu i Madhërishëm dhe të respektojë udhëzimet e rregullat e shprehura në Kur'anin Famëlartë nga ku buron feja islame. Profeti a.s. shprehet: "Çdo fëmijë lind me fitrën e tij. Pastaj prindërit e tij e bëjnë të krishterë, çifut apo zoroastrian". Ky ishte interpretim i ajetit kur'anor cituar më lart nga i dërguari i Allahut të Lartësuar. Kjo vërteton se natyra njerëzore përputhet me Islamin, por janë prindërit si edukatorë të parë dhe pastaj shkolla e shoqëria që mund të ndikojnë në shtrembërimin e këtij besimi nga amaneti.

Thelbi i Islamit është që njerëzit të besojnë vetëm Një Zot se vetë natyra njerëzore kërkon këtë njohje, duke mos i shoqëruar Atij asnjë shok. Ai ka parim themelor formimin e myslimanëve me tipare dhe virtyte të larta etiko-morale dhe njerëzore duke e mbrojtur dhe ruajtur atë që të qëndrojë brenda natyrës së krijimit e të mos dalë jashtë saj gjatë gjithë jetës së tij. Një mysliman i tillë e ka të qartë se ka vetëm Një Zot, që është krijues i gjithësisë dhe gjithçka që përfshihet në të. Islami është vula e Mesazhit Hyjnor i shpallur njerëzimit nëpërmjet të dërguarit të Zotit, Muhamedit a.s., pas të cilit nuk do të ketë shpallje tjetër e të dërguar tjetër, sepse ai është edhe vula e profetëve.

Njeriu i lindur me natyrë islame ka prirjen për t'u afruar më shumë me Krijuesin e tij. Këtë ai e bën me tërë qenien e tij trupore e shpirtërore, kur edukohet nga prindërit e tij myslimanë. Udhëheqja më e mirë do të jetë shembulli i prindit në adhurim, në faljen e namazit, e bashkë me të e shoqëron fëmijën, mendja e shpirti i të cilit do të edukohet e përqendrohet në kërkim të Dritës

---

22. Kur'an, El-Bekare: 256.
23. *Leximi i mendjes së myslimanit*, botuar nga AIITC, viti 2011, f. 80.
24. Kur'an, Err-Rrum: 30-31.

Hyjnore. Në lutje e vepra lëviz e gjithë bota e brendshme shpirtërore dhe e jashtme, trupore,të cilat në unitet përbëjnë qenien njeri.
Te besimtari mysliman gradualisht do të farkëtohet dashuria ndaj Allahut dhe bindja ndaj Tij. Feja islame, e mbështetur në Kur'anin Famëlartë, e drejton individin në rrugën e drejtë e të vërtetë dhe i përsos aftësitë dhe potencialet që përfshin ai në veprimtarinë jetësore. Përfshirja në mësimin dhe leximin e Kur'anit Famëlartë, në zbatimin e urdhrave dhe porosive të tij e pastron zemrën e besimtarit nga ndotja e epsheve dhe pasioneve për të gjetur e ndërtuar një jetë në paqe e qetësi, ashtu siç thuhet në Kur'an: "Vërtet, kushdo që e pastron shpirtin, do të shpëtojë, ndërsa kushdo që e shtyp atë (me punë të këqija), do të dështojë."[25] Ky ajet u drejtohet gjithë besimtarëve pa dallim gjinie, race, ngjyre dhe shkallë intelekti, në mënyrë të tillë që secili të jetë i sinqertë me veprat që kryen, në marrëdhënie me ligjet e Zotit Famëlartë, vetëm për dashurinë dhe kënaqësinë e Tij.Të tillë përmendim Hafiz Dalliun, i cili me përkthimin dhe interpretimin e Kur'anit, u bë me veprat e tij mësuesi i së vërtetës për myslimanët shqiptarë. Ai e shpenzoi tërë jetën e tij në dobi të Atdheut dhe besimtarëve myslimanë, në zotërimin e publicistikës, të arsyes dhe gojëtarisë dhe iu përkushtua studimeve islame, në shkrimin dhe zbërthimin e tyre. Më në fund ai u zhyt thellë në ajetet e lavdishme të Kur'anit saqë zbërthimi dhe interpretimi i tyre u bë preokupimi më i rëndësishëm në gjithë veprimtarinë e tij. Me arsyetimin e thellë dhe nënshtrimin total të ligjeve të Krijuesit, kaloi një jetë të tërë duke studiuar, duke dhënë mësim, duke shkruar, hulumtuar dhe kërkuar mbi çështje që lidhen me Kur'anin Famëlartë. Zoti i dhashtë kënaqësinë e tij, siç thuhet në Kur'an ku shprehet: "Vërtet, Allahu është me ata që e kanë frikë dhe që janë punëmirë."[26].

1.3. Islami është fe universale

Çdo individ i lindur, pa dallim gjinor, racor e kombësie, e ka për detyrë të njohë ç'është Islami e ta përqafojë atë. Kjo për faktin se ai i përfshin të gjitha problemet me të cilat ndeshet njeriu në këtë botë, nga lindja deri në vdekje. Në të besimtari mysliman do të mësojë se si duhet të ndërtojë jetën e tij individuale, por edhe familjare e shoqërore. Do të njihet me ndërtimin e drejtë të marrëdhënieve ndërnjerëzore në fushën e ekonomisë, të tregut, shkëmbimeve etj. Do të thotë se njeriu me Islamin plotëson misionin e tij për të cilin është dërguar në këtë botë dhe e përgatit edhe për botën tjetër. Kjo është detyrë e çdo myslimani dhe realizohet nëpërmjet studimit të Kur'anit dhe gjithë literaturës që del nga origjina e Shpalljes Hyjnore dhe pastaj nga predikimet e Islamit. Një fjalë e urtë thotë: "Më thuaj ç'ka lexon, të të them se cili je". Pra duhet të dish se çfarë të lexosh e të dëgjosh dhe të marrësh prej tyre atë që është e vërtetë nga burimi Hyjnor dhe suneti i profetit a.s.. Pajisja me dituri islame e bën myslimanin të ndërgjegjshëm në besimin e tij te Zoti i Lartësuar. Dituria është detyrë e domosdoshme për çdo mysliman e myslimane. Thuhet: "Adhurimi pa dituri, më tepër prish se sa ndreq". Kjo për arsye se sot shumë individë marrin përsipër të japin mendime se cila përputhet me sunetin e profetit Muhamed e cila jo. Bëhen diskutime e debate të padobishme nga

[25]. Kur'an, Esh-Shems: 9-10.
[26]. Kur'an, En-Nahl:128.

njerëz që nuk kanë studiuar për fenë islame, por vetëm kanë dëgjuar gjëra të shkëputura. Akoma më keq kur japin mendime për veprimet e lejuara e të ndaluara, për mënyrën e paraqitjes, veshjes, ushqimit, veprimet etj. Të gjitha këto që u përmendën kërkojnë dituri të sakta, të cilat mund të merren nga studimi, kuptimi dhe interpretimi i drejtë i Shpalljes Hyjnore dhe hadithit të profetit Muhamed, paqja e bekimi i Zotit qofshin mbi të. Ibn Abasi transmeton se Pejgamberi a.s. ka thënë: "Ua tërheq vëmendjen që të mos e teproni në fe, sepse ata që ishin para jush shkatërruan pikërisht sepse i tejkaluan kufijtë në fe". Pra, është tepër e rrezikshme për shoqërinë teprimi dhe tejkalimi i masave dhe dalja nga mësimet e Kur'anit dhe suneti i Profetit a.s.. Prandaj duhet ndjekur shembulli i Profetit a.s. dhe i ndjekësve të tij, ndërsa sot të ndiqen imamët apo prijësit model në xhamia që predikojnë Islamin, por edhe janë model në jetën e tyre familjare e qytetare. Çdo mysliman sot në botë duhet të kuptojë detyrat prioritare të Islamit dhe të mos krijojë prioritete për probleme të dorës së dytë e të tretë. Kjo do të thotë që të mos krijohen konflikte në interpretimin e mendimeve për prioritete që nuk janë parësore. Duhet respektuar edhe mendimi i tjetrit, por secili mban qëndrimin e tij që e konsideron më të saktin. Zoti i Lartësuar në Kur'an thotë: "Thirr në rrugën e Zotit tënd me mençuri dhe këshillë të bukur dhe diskuto me ata në mënyrën më të mirë!"[27]

Myslimani, përveç diturisë mbi Islamin duhet të bashkëngjisë gjithë veprimtarinë e tij. Profetit Muhamed, shpallja e parë Hyjnore i erdhi për diturinë, ku Zoti i Lartësuar, nëpërmjet engjëllit Xhibril i thotë: "Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (gjithçka), e krijoi njeriun nga një droçkë gjaku! Lexo! Zoti yt është Bujari më i madh, i Cili, me anë të penës ia mësoi, ia mësoi njeriut ato që nuk i dinte."[28] Pra urdhri i parë i erdhi për leximin, pasi ai është çelësi për të arritur dituri në të gjitha fushat e shkencës duke përfshirë edhe Islamin. Por këtë dituri myslimani duhet ta vërë në përdorim në dobi të tij, të familjes, shoqërisë dhe Atdheut. Në rast se njeriu shpërdoron diturinë, atëherë ka bërë një ndarje të plotë në mes të saj dhe vullnetit të Zotit, në mes të mendjes dhe zemrës, dhe idesë me realitetin, gjë që është e ndaluar.

Sot shumë myslimanë njihen vetëm me emër, pasi veprimtaria e tyre në praktikë nuk është islame,nuk shndërrohet në sjellje dhe moral,por mbetet vetëm në fjalë.

Kalifi Omer r.a. i lutej Zotit që ta ruajë nga hipokriti i shkolluar duke thënë: "I ditur me fjalë dhe injorant me zemër". Që do të thotë se dituria e tij ka mbetur vetëm në fjalë e nuk ka depërtuar në zemër, që vullneti tij të lëvizë në vepra të mira.

Prandaj theksojmë se myslimanët duhet të demonstrojnë atë që përmban Islami në parimet e tij në veprime e sjellje ndaj vetes, familjes dhe të tjerëve, në farefis e shoqëri si ndaj myslimanëve edhe ndaj jo myslimanëve. Zoti në Kur'an thotë: "Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty (o Muhamed), veçse si mëshirë për botët."[29] Të ndjekim shembullin e Profetit a.s. që kjo mëshirë të shfaqet në sjelljet e çdo myslimani e myslimaneje.

---

[27]. Kur'an, En-Nahl: 125

[28]. Kur'an, El-Alak: 1-5.

[29]. Kur'an, El-Enbija: 107.

1.4. Edukimi i brezit të ri me Islamin

Familja është shkolla e parë e edukimit të brezit të ri me normat e një edukate të shëndoshë islame, që të bëhet në të ardhmen një njeri me vlerë për veten, familjen e shoqërinë. Zoti i Lartësuar në Kur'an urdhëron e thotë: "Allahu është ai që ju ka krijuar juve të dobët, pastaj, pas dobësisë, ju ka bërë të fuqishëm e, pas fuqisë, ju bën të dobët dhe të thinjur."[30] Do të thotë që në hapat e para fëmija merret për dore nga prindërit e tij, nga nëna që me qumështin e saj të bekuar e ushqen dhe bashkë me të i mëson edhe belbëzimet e para. Pastaj babai e merr për dore dhe i mëson normat e edukatës islame, e përgatit për në moshën më aktive, atë të rinisë, kur energjitë e tij shpërthejnë. Pikërisht për mënyrën si e kaloi këtë moshë, do të pyetet në ditën e llogarisë. Profeti Muhamed, paqja e bekimi i Zotit qofshin mbi të, ka thënë: "Nuk do të lëvizë njeri nga vendi pa mos u pyetur për katër gjëra: Për jetën ku e ka kaluar; rininë ku e ka harxhuar; për diturinë se çfarë ka bërë me të; për pasurinë se si e ka fituar dhe ku e ka harxhuar". Prandaj familja nuk ka detyrë vetëm ta ushqejë fëmijën, por edhe t'i mësojë Islamin, që të formojë personalitetin e tij të denjë për jetën, të jetojë me punën e tij, me diturinë e tij, të pajisur me një kulturë të gjerë, mundësisht e përsosur, të mbushë shpirtin me një adhurim të çiltër e të sinqertë për Krijuesin, të gëzojë një shëndet të plotë dhe të përsoset me virtytet me të larta të moralit islam. Duhet të edukojmë një brez të ri me shpresa për të ardhmen, për një shoqëri të shëndoshë nga ku do të ketë intelektualë e dijetarë,shkencëtarë për të gjitha fushat e jetës, sepse do të marrin në dorë fatet e vendit. Për këtë arsye brezi i ri nuk duhet të edukohet që të jetë i varur prej prindërve e të bëjë një jetë qejfi e hareje, një jetë pa preokupime, me zbavitje pa kufi në kafene e klube nate, të dehur nga pijet e muzika joshëse që i çon në degjenerim moral dhe seksin e shfrenuar e të ndaluar.

Është e domosdoshme që shoqëria të shqetësohet dhe të marrë masat e nevojshme, me mjetet që ka në përdorim, me aparate nga më të ndryshmet për përsosjen e edukatës në drejtim të brezit të ri. Objektivi parësor edukativ duhet të jetë ai shpirtëror, kulturor e fizik. Shkolla, mjedisi çlodhës e argëtues duhet të angazhojnë specialistë të fushës së edukimit e deri edhe fetare për të mbushur aspektin shpirtëror e material së bashku.

Profeti a.s. ka thënë: "Të gjithë ju jeni barinj dhe çdo njëri prej jush do të përgjigjet për kopenë e tij". Do të thotë që çdo njeri duhet të jetë përgjegjës para Allahut se si i ka kryer detyrat e tij, por edhe i riu që përgatitet do të pyetet në ditën e gjykimit se si e kaloi këtë pjesë të jetës. I dërguari i Allahut, Muhamedi, paqja e bekimi i Zotit qofshin mbi të, ka treguar kujdes të veçantë për edukimin e brezit të ri dhe një ndër këshillat e tij ishte: "Shfrytëzo pesë gjëra para se të vijnë pesë të tjera: shfrytëzoje rininë tënde para pleqërisë; shëndetin para sëmundjes; pasurinë para varfërisë; kohën e lirë para se të preokupohesh me probleme dhe jetën para vdekjes". Kuptohet qartë rëndësia që i kushtohet moshës së rinisë, që nuk duhet të jetë vetëm moshë e lojës dhe zbavitjes, por edhe moshë e edukimit, mësimit dhe punës për ndërtimin e jetës së tij. Vetëm bindja e ndërgjegjshme për Islamin dhe zbatimi në praktikë i udhëzimeve, rregullave dhe ligjeve të tij, bën të mundur përsosmërinë e tij si njeri. Ndryshe, zbrazëtia në besim do ta çojë rininë në varfëri shpirtërore, çrregullim familjar, degradim moral dhe pa shpresa për të ardhmen e jetës.

---

[30]. Kur'an, Er-Rrum: 54.

Çdo njeri duhet të ketë një vizion të qartë për jetën e tij e këtë mund ta gjejë të drejtë vetëm në Islam, i cili jo vetëm që i jep besim për jetën, por edhe nxitjen për të kërkuar diturinë në gjithë jetën e tij. I jep konceptin e qartë, adhurimin ndaj Krijuesit të tij e të gjithësisë dhe konceptin e drejtë për të shijuar në këtë botë çdo gjë të mirë e të dobishme për të, për të përcaktuar çka është e lejuar (hallall) dhe çka është e ndaluar (haram) etj.

1.5. Të ndjekim Islamin

Zoti i Madhëruar e pajisi njeriun me arsye e logjikë që të njohë Krijuesin e tij dhe të gjitha krijesat t'i përdori në dobi të tij në këtë botë tokësore provizore. Prandaj në shenjë respekti e falënderimi ne duhet të ndjekim Islamin, sepse vetëm ai do të na udhëheqë në rrugën e drejtë, do të na shpëtojë nga shqetësimet dhe vështirësitë që mund të na dalin përpara. Islami është feja e Allahut, është ligji i tij në zbatimin e të cilit do të gjejnë lumturi si në këtë botë edhe në botën tjetër. Por sot ka shumë myslimanë që e konsiderojnë veten të tillë, por në të vërtetë nuk bëjnë jetë islame si në mendime, në kulturë, në edukatë e në sjellje personale, familjare e shoqërore. Për këtë arsye duhet të ndjekim Islamin e të jetojmë si besimtarë të vërtetë, me moral e drejtësi islame. Zoti në Kur'an thotë: "Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj."[31]

Së pari, çdo besimtar që e konsideron veten mysliman, duhet të pohojë me vullnet të lirë dëshminë e sheriatit me shprehjen: "Nuk ka zot tjetër përveç Allahut" dhe se "Muhamedi është i dërguari i Tij". Pa këtë nuk mund të jesh besimtar. Kjo dëshmi do të vërtetojë edhe Shpalljen Hyjnore, Fjalën e Allahut, e cila do të bëhet program pune i jetës së besimtarit mysliman dhe e drejta islame do të gjykojë gjithçka nga jeta individuale, familjare e shoqërore. Zoti në Kur'an thotë: "Ndërsa përgjigjja e vetme e besimtarëve, kur thirren tek Allahu dhe i Dërguari i Tij, që ai të gjykojë midis tyre, është: "Dëgjojmë dhe bindemi". Pikërisht këta janë të shpëtuarit."[32] Prandaj duhet të ndjekim Islamin, sepse është program jete për çdo njeri, në çdo mjedis që të jetë, si në shtëpi, në shkollë, në xhami, në gjykatë, në rrugë e në çdo fushë të jetës. Ai e shoqëron njeriun nga lindja deri në vdekje.

Shoqëria sot përjeton disa shfaqje të amoralitetit, bixhozit, alkoolit, drogës, prostitucionit, përdhunimit, vrasjes e vetëvrasjes, dhunimit të gruas, shkatërrimit të familjes me divorce të shumta e akte të tjera kriminale që krijojnë shqetësime të rënda për shoqërinë. Për këtë arsye, shpëtimi i vetëm është ndjekja e Islamit, drejtësia islame, kthimi në rrugën e Zotit. Zoti në Kur'an thotë: "Kjo është rruga Ime e drejtë; prandaj ndiqeni e mos shkoni rrugëve të tjera që t'ju shmangin nga rruga e Tij. Kjo është ajo që ju porosit Ai për t'u ruajtur nga të këqijat."[33]

Vetëm feja islame mund ta shpëtojë shoqërinë nga veset negative, kur të pranojnë normat e rregullat e ligjit islam në çdo aspekt të jetës. Feja islame është i vetmi mjet që mund të krijojë në

---

31. Kur'an, El-Maide: 3.
32. Kur'an, En-Nur: 51.
33. Kur'an, El-En'am: 153.

familje e shoqëri harmoni e vëllazëri, që i bashkon zemrat e njerëzve, të duan e të ndihmojnë njëri-tjetrin. Gjithashtu Islami siguron të drejtën dhe lirinë e çdo personi dhe shoqërinë mbarë për të jetuar në paqe e qetësi.

Prandaj secili duhet të edukohet me frymën islame, të bëhen besimtarë të mirë, që zbatojnë të drejtën ndaj Zotit të Lartësuar, të drejtën ndaj vetes e të drejtën ndaj të tjerëve. Atëhere do të kemi një familje të shëndoshë, një shoqëri të shëndoshë pa konflikte. Zoti në Kur'an thotë: "Me të vërtetë, Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa ata të ndryshojnë ç'kanë në vetvete."[34] Për këtë arsye duhet të zbatojmë thirrjen e Allahut të Madhëruar në mënyrë që të jetojmë me nder e moral, i cili sot po cenohet e të ruajmë personalitetin tonë si qenie humane, të cilën Zoti i Lartësuar vetë e krijoi të përsosur dhe e nderoi mbi të gjitha krijesat.

2. Të falurit e namazit

Zoti i Lartësuar në Kur'an thotë: "Namazi është detyrë për besimtarët në kohë të caktuar"[35]. "Kryeje faljen për të më kujtuar Mua"[36]. Nga të dy citimet kuranore rezulton se namazi është bërë detyrë për rëndësinë që ka si burim hyjnor, por edhe për dobinë fizike, mendore e shpirtërore për parandalimin e sëmundjeve. Do të thotë që namazi jo vetëm tregon bindje ndaj ligjeve të Zotit të Lartësuar, por njëkohësisht forcon organizmin e njeriut, sepse vë në lëvizje të gjitha organet.
Adhurimi i Zotit të Lartësuar me namaz është i një rëndësie të veçantë, pasi nëpërmjet tij myslimani lidhet pa ndërmjetës me Allahun e Lartësuar. Jo vetëm kaq, por çdo krijesë e madhëron Zotin e saj, ashtu si thuhet në Kur'an: "A nuk e vëren ti, se Allahun e lavdëron çdo krijesë që ndodhet në qiej dhe në Tokë, madje edhe shpezët krahëhapur?!"[37]. Secili e di adhurimin e tij (namazin) dhe glorifikimin e tij. Njeriut iu mësua falja e namazit nga i dërguari i Allahut, Muhamedi a.s..

Besimtari në namaz i drejtohet i përqendruar Krijuesit të tij. I përkushtuar dhe me ndjenjë përulësie, në qëndrimin në këmbë, me leximin e Kur'anit, komunikon direkt me Zotin e Lartësuar dhe me përulje dhe me kokë në sexhde e falënderon Atë dhe se çdo lavdërim i takon vetëm Atij. Ky është momenti më i volitshëm kur mendja njerëzore gjen qetësi, duke lehtësuar trupin fizikisht e shpirtërisht dhe nga çdo stres të kësaj bote materiale. Doktoreshë Rose Haflerding, konsulente mjekësore në spitalin e Bostonit, thotë: "Me të vërtetë prej ilaçeve shëruese të stresit është të nxjerrësh ankesat dhe ngarkesat që të rëndojnë zemrën tek dikush që ti ke besim të fortë… dhe këtu ka shërim"[38]. Ndërsa doktor Alexis Carrel, fitues i çmimit "Nobel", në librin e tij "The unknown men" thotë: "Ndoshta namazi është energjia më e madhe për gjallërinë, që është njohur deri në ditët tona. Kam parë të sëmurë që kanë dështuar në mjekimin e sëmundjeve të tyre dhe mjekësia ka

34. Kur'an, Er-Rra'd: 11.
35. Kur'an, En-Nisa: 103.
36. Kur'an, Taha: 14.
37. Kur'an, 24:41.
38. Sajmir Bulku, Sekretet e mjekësisë në Kuran, f. 213, viti 2011.

ngritur duart. Kur ndërhyri namazi e shëroi atë nga sëmundja e tyre"[39]. Do të thotë që në namaz, kur besimtari i përqendruar vetëm te Zoti i Lartësuar e i kërkon falje e mëshirë për problemet që ka, Ai e ndihmon dhe i jep rezultatet e duhura.

Namazi është një adhurim i obligueshëm ndaj Allahut të Madhëruar nëpërmjet të cilit besimtari shpreh ndjenjën e thellë shpirtërore e trupore, që e ngre lart dhe fisnikëron personalitetin e tij. Namazi i paraprin një thirrjeje me zë kumbues, që shpreh thellë zemrën e njeriut dhe nxit arsyen për të vepruar sa më shpejt për t'u përgatitur me përkushtim para Zotit të Lartësuar. Së pari duhet të jetë i pastruar nga çdo papastërti trupore e veshje. Sipas transmetimit të Ebu Daudit, Profeti a.s. ka thënë: "Feja është ngritur mbi pastërtinë". Amri udhëtonte te Profeti a.s. në Mekë dhe e pyet për abdesin (pastërtinë) e ai përgjigjet: "Nëse ndokush prej jush e fillon pastrimin (abdesin) duke shpëlarë gojën e duke pastruar edhe hundën me ujë, gjynahet e fytyrës së tij bien të gjitha me ujin që pastron gojën dhe hundën. Kur ai lan fytyrën, gjynahet e fytyrës së tij bien bashkë me ujin që i kullon nga mjekra. Kur ai njom kokën e tij me duart e lagura, gjynahet e kokës bien bashkë me pikat që pikojnë nga flokët e tij. Kur lan këmbët, gjynahet e këmbëve të tij dalin bashkë me ujin që i kullon nga gishtërinjtë"[40].

Jo pa qëllim Allahu i Madhërishëm e ka vënë detyrë para namazit pastrimin (abdesin), sepse veç dobive fetare ka edhe shumë dobi shëndetësore. Uji që përdorim për pastrimin e gjymtyrëve trupore luan rol të rëndësishëm në freskimin e pastrimin e tyre, si dhe në procesin e uljes së temperaturës, veçanërisht gjatë stinës së nxehtë. Për këtë arsye, edhe njerëzve kur u bie të fikët, humbasin ndjenjat, spërkaten me ujë që të përmenden. Kjo për faktin se uji ndihmon zemrën që të gjallërohet dhe drejtohet drejt gjymtyrëve, në fytyrë, duar e këmbë. Profeti a.s. ka thënë: "Të marrim abdes kur të zemërohemi", sepse abdesi i ftoh nervat, trurin dhe trupin dhe normalizon rrahjet e zemrës, të cilat janë shpeshtuar nga zemërimi. Në të njëjtën kohë mbron ata që janë të sëmurë nga zemra, nga ndonjë atak kardiak për shkak të zemërimit të fortë ose nga frika e tepërt.

Me larjen e fytyrës, syve, veshëve, gjuhës gjallërohen shqisat dhe pastrohen nga papastërtitë, ndërsa me mes-hin (lagien e flokëve) e kokës qetësohet qarkullimi i gjakut në tru. Shkencëtarët rusë kanë zbuluar se fërkimi i fytyrës ka ndikim pozitiv dhe na mbron nga sëmundjet e lëkurës, sepse muskujt dhe damarët janë sipërfaqësorë në fytyrë. Nga ana tjetër fërkimi i fytyrës largon rrudhat dhe thatësirën e saj, për shkak të rritjes së qarkullimit të gjakut në fytyrë. Edhe larja e hundës të mbron nga rreziku i thithjes së pluhurit dhe mikrobeve në hundë"[41]. Kjo do të thotë që uji e bën trupin që të reagojë në momentin që lan gjymtyrët dhe njëkohësisht bashkë me ujin largohen edhe mëkatet nga këto gjymtyrë. Profeti a.s. ka thënë: "Zemërimi është nga shejtani dhe shejtani është krijuar nga zjarri e zjarri fiket me ujë. Kur të zemërohet ndonjëri prej jush, le të marrë abdes".

Namazi kryhet në kohë të caktuara sipas kalendarit islamik që janë: Agimi i mëngjesit, dreka, pasditja, rënia apo perëndimi i diellit dhe pasdarka. Ritet e caktuara të obligueshme të namazit në total përbëjnë 17 (shtatëmbëdhjetë) rekate përkulje nga qëndrimi në këmbë e rikthim në pozicionin fillestar. Ky nuk është një obligim i vështirë për njeriun që nga ditë-nata 24 orëshe të përkushtohet në adhurim ndaj Zotit të Lartësuar vetëm gjysmë ore. Myslimani duke kryer këto adhurime,tregon

---

[39]. Po aty.
[40]. Muhamed Gazali, Feja jonë, f. 115.
[41]. Sajmir Bulku, Sekretet e mjekësisë në Kuran, f. 210, viti 2011.

respekt të veçantë ndaj Krijuesit të tij. Në rast të kundërt, tregon mospërfillje, nga ku mund të marrë edhe ndëshkime për moskryerje të detyrave. Në një hadith të përcjellë nga Ubade bin Samit thuhet: "E dëgjova Profetin a.s. të shprehet: "Pesë janë faljet të përcaktuara nga Zoti. Ai që i kryen të pesta këto pa i nënvleftësuar, do të futet në parajsë. Ai që nuk i kryen këto falje, nuk do të ketë asnjë marrëveshje dhe Zoti do t'i dënojë ose falë sipas dëshirës së Tij"".[42] Prandaj myslimanët kështillohen që të kryejnë detyrën e faljes së namazit në mënyrë të rregullt. Zoti i Lartësuar i drejtohet njeriut në Kur'an ku thotë: "O njeri, ç'të mashtroi ty që nuk i besove Zotit tënd bujar, i Cili të krijoi ty, të dha përmasa të rregullta dhe të harmonizoi dhe që të ka mbrujtur në çfarëdo forme që ka dashur?!"[43]. Pra, Ai, superarkitekti është që hartoi e kontrolloi gjithë programin për të krijuar ty si qenien më të përsosur në botë. Për këtë duhet falënderuar e adhuruar pa pushim.

Myslimani, për të kryer ritualin e faljes së namazit, duhet të kryejë edhe lëvizje trupore që janë: drejtqëndrim në këmbë me drejtim nga (kibla) Meka dhe lexon në Kur'an, suren El-Fatiha, një ose disa ajete uranore, pastaj përkulet në ruku me madhërim për Allahun e Lartësuar, merr drejtqëndrim dhe bën përuljen me ballin në sexhde (në tokë) duke vazhduar me madhërimin e Zotit të Lartësuar. Pastaj përsërit të njëjtin ritual dhe mbasi bëhen dy, bëhet një pushim, ndenjur mbi gjunjë duke lexuar një përshëndetje(et-tehijatu dhe dëshmia shehadetin). Çohet përsëri dhe bën të njëjtat lëvizje, por mjafton vetëm një lexim i sures El-Fatiha dhe pasi mbaron dhe ky ritual, përfundon me qëndrim si në pushimin e parë duke përfunduar me përshëndetje (selam) djathtas e majtas. Vetëm sabahu (agimi i mëngjesit) ka dy rekate, cikle të lëvizjeve, në perëndim të diellit, aksham, kemi tre, ndërsa të tjerat kanë nga katër.

Specialistët dhe mjeshtrit e sporteve e shikojnë faljen e namazit më të lartë se sa ushtrimet që praktikohen në artin e sporteve. Ata e shikojnë si shumë të dobishëm për shëndetin e gjymtyrëve të trupit dhe procesin shumë aktiv të tij. Psikologët shikojnë një qetësi dhe çlodhje tek ai që falet dhe një stabilitet shpirtëror. Sipas të dhënave mjekësore rënia me kokë në sexhde e ul tensionin e gjakut dhe rregullon qarkullimin e tij, shkarkon ngarkesat elektrostatike nga atmosfera që merr gjatë ditës dhe kontakti me tokën i thith plotësisht ato. Në këtë pozicion rritet gjaku në tru dhe, për rrjedhojë, ushqehet më mirë me oksigjen e lëndë të tjera ushqyese, se sa kur nuk i kryejmë këto ushtrime. Dobitë trupore të namazit mund të përmblidhen në këtë formë:

- Përmirëson punën e zemrës;
- Gjallëron qelizat;
- Aktivizon aparatin tretës;
- Largon nervozizmin dhe pagjumësinë;
- Shton imunitetin ndaj sëmundjeve dhe pengon infeksionin në kyçe;
- Largon ankthin, forcon trupin, përqendron memorien dhe përfiton cilësi të larta morale[44].

Namazi pesë herë në ditë i dhuron trupit këto dobi mrekulluese, por kur i gërsheton me një seri leximesh nga Kur'ani bashkë me lutjet krijojmë njëkohësisht edhe lidhje direkte me Zotin e Lartësuar. Ai njëkohësisht merr edhe vlerën e namazit kur mediton me fjalët e Allahut në çdo ritual, të shprehur me zemër e gjuhë të pastër.

---

42. M. Gazali, Feja jonë, f. 116.
43. Kur'an, El-Infitar: 6-8.
44. Sajmir Bulku, Sekretet e mjekësisë në Kuran, f. 215.

I dërguari i Allahut, Muhamedi a.s., ka thënë: "Namazi është kulmi i lumturisë sime". Këtë e manifestonte kur i thoshte Bilalit (muezinit): "Na qetëso me të (namazin), o Bilal". Sipas profesorit Zija Ed-Din, për të liruar energjinë në mënyrë sa më të shëndoshë gjatë qëndrimit në sexhde, duhet të kthehemi në drejtim të Qabes. "Qabeja është qendra e Tokës dhe drejtimi i fytyrës nga qendra e Tokës është pozicioni më ideal për të liruar energjinë nga trupi"[45].

Namazin e kanë detyrë myslimanët e myslimanet që kanë mbushur moshën e pjekurisë. Ata mund të falen kudo që ndodhen. Mirë është frekuentimi i xhamive ku falja bëhet kolektive. Vetëm ditën e premte në vend të faljes së drekës, është bërë detyrë falja e namazit të xhumasë apo ditës së premte, në mënyrë kolektive në xhami që ka vetëm dy cikle(rekate), detyrë që i paraprin një predikimi me hytbe.

2.1. Ritet fetare - Adhurimi

Në kryerjen e riteve fetare myslimani adhuron Zotin e tij. Prandaj kushti kryesor është besimi në Zotin Një, krijues i gjithësisë, i gjithçkaje që ekziston në të, sundues dhe kontrollues dhe gjykatës suprem i ditës së gjykimit. Këtë e mësuan njerëzit nga mesazhi i Shpalljes Hyjnore nëpërmjet të dërguarve dhe i duhet përgjigjur thirrjes së tyre. Zoti në Kur'an thotë: "O besimtarë! Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit kur ju thërret drejt asaj që ju jep jetë!"[46] Jeta e njeriut nuk ka kuptim pa njohjen e Krijuesit. Pra interesat e tij duhet të jenë të lidhura ngushtë me Zotin e Lartësuar, i nënshtruar ndaj tij, me përulje në adhurim që të jep qetësi shpirtërore.

Myslimani në adhurim i përkushtohet plotësisht Zotit të Lartësuar, i përulur para Tij në shenjë respekti e falënderimi si dhe detyrimi që ka për të mirat që i ka dhuruar në këtë botë provizore dhe përgëzimet që premton për botën tjetër.

Në adhurim besimtari i lutet vetëm Zotit, që gjithçka në jetën e tij të drejtohet prej Tij, në shenjë mirënjohje për të mirat që i ka dhuruar. Zoti në Kur'an thotë: "O njerëz! Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju."[47] Në një citim tjetër kuranor shprehet: "O njerëz! Pa dyshim, premtimi i Allahut (Dita e Gjykimit) është i vërtetë, prandaj të mos ju mashtrojë kurrsesi jeta e kësaj bote"[48]. Për myslimanët këto porosi të Kur'anit janë shumë bindëse se adhurimi i drejtohet vetëm Një Zoti, që krijoi gjithësinë dhe qenien më të përsosur, njeriun si sundimtar në Tokë.

Në adhurim besimtari lidhet direkt, pa ndërmjetës, me Zotin e lartësuar, i kërkon falje Atij për mëkatet dhe lutet që të përfitojë nga mëshira e Tij. Zoti në Kur'an thotë: "se askush nuk do t'i

---

45. Po aty, f. 223.
46. Kur'an, El-Enfal: 24.
47. Kur'an, El-Fatir: 3.
48. Kur'an, El-Fatir: 5.

mbartë gjynahet e tjetrit dhe se njeriu do të ketë vetëm atë për të cilën ka punuar; se përpjekjet e tij do të shihen dhe se do të shpërblehet me shpërblim të plotë"[49].

Për këtë arsye besimtari në adhurim qëndron kokëulur, i përulur para Tij për falje e mëshirë.

Për besimtarin ka dy lloje adhurimi: njëri është caktuar si detyrë nga Allahu i Madhëruar në Kur'anin Famëlartë dhe tjetri përfshin tërë veprimtarinë e tij në përputhje me udhëzimet e Mesazhit Hyjnor. Adhurim i obliguar konsiderohet falja ose namazi për çdo mysliman e myslimane, që ka mbushur moshën e pjekurisë. Ky detyrim shoqërohet edhe me lehtësira sipas kushteve shëndetësore apo rrethanave të tjera në të cilat ndodhet besimtari. Zoti në Kur'an thotë: "Allahu e përcakton gjatësinë e ditës dhe të natës dhe e di se ju nuk mund ta llogarisni atë saktësisht, prandaj kthehet tek ju me mëshirë. Kështu që lexoni Kuran aq sa mundeni! Ai e di se disa prej jush do të jenë të sëmurë, disa do të udhëtojnë nëpër botë, duke kërkuar mirësitë e Tij (për jetesë) dhe disa të tjerë do të jenë duke luftuar në rrugën e Tij, prandaj lexoni sa keni mundësi nga Kurani!"[50].

Në llojin e dytë të adhurimit ku përfshihet tërë veprimtaria jetësore e njeriut, kërkohet që çdo akt i veprimtarisë të jetë në përputhje me udhëzimet e Zotit të lartësuar apo me ligjet e sheriatit (jurisprudencës) islame. Në qoftë se veprat nuk përputhen me këto ligje, konsiderohen mëkate (gjynahe) që i nënshtrohen gjykimit të Allahut të Madhërishëm e masa penalizuese, sipas transmetimit të Buhariut nga H. Ebu Behri, profeti a.s. ka thënë: "A doni t'ju tregoj se cilat janë gjynahet më të neveritshme? Shokët i thanë: Po, patjetër. Ai tha: T'i bësh shok Zotit; mosmirënjohja ndaj prindërve; vrasja, mashtrimi dhe dëshmia e rrejshme". Ndërsa në hadithin e përcjellë nga Ebu Daudi, profeti a.s. ka thënë: "Gjynahet më të neveritshme janë nëntë: Bërja shok Zotit; magjia; vrasja; kamata; harxhimi i pasurisë së jetimëve; dezertimi nga beteja; përgojimi i femrës së ndershme, mosmirënjohje ndaj prindërve; përdhosja e kohës"[51]. Akoma më keq dënohen ata njerëz që kryejnë këto mëkate kur janë njerëz të ditur e me pozitë të lartë.

2.2. Xhamitë - vende të shenjta adhurimi

Besimtarët myslimanë i kryejnë adhurimet e tyre në institucionet që kanë marrë emrin "Xhami", sepse adhurimi kryhet në mënyrë kolektive. Për rolin që kanë luajtur dhe kanë, konsiderohen si vende të shenjta ku janë të ndaluara veprat amorale. Xhamia është vend mbledhje për myslimanët që së bashku i luten dhe i falen Allahut të madhërishëm për nevojat që kanë. Ata e kanë të detyruar faljen kolektive vetëm një herë në javë, ditën e premte, kur falet namazi i xhumasë me dy rekate dhe një Hytbe (predikim) nga imami. Pastaj janë edhe dy festat e Bajrameve: i Ramazanit dhe i Kurbanit. Ndërsa kohët e tjera, kur myslimanët janë të angazhuar me punë, falen apo adhurojnë Zotin e Lartësuar kudo që ndodhen, në punë, në shtëpi, në rrugë etj.

Në fillimet e Islamit xhamitë kanë luajtur rol të rëndësishëm edhe si qendra mësimi dhe edukimi si dhe kryheshin edhe të gjitha aktivitetet social-kulturore. Sot janë krijuar institucione të veçanta që i kryejnë këto funksione.

---

[49]. Kur'an , En-Nexhm: 38-41.
[50]. Kur'an, El-Muzemil: 20.
[51]. Muhamed Gazali, *Feja jonë*, f. 112.

Në të gjithë botën ku ndodhen myslimanë, xhamitë janë ndërtuar me drejtimin nga Xhamia e Madhe e Shenjtë e Qabesë, që ndodhet në Mekë, pasi Profetit a.s. i është dhënë detyrë, kur ka emigruar nga Meka në Medinë, të drejtojë faljen nga Qabeja. Sot drejtimi i vetëm nga mund të falen myslimanët është Qabeja, e cila është edhe vend pelegrinazhi për mbarë myslimanët e botës. Faljet ditore për myslimanët janë pesë:

- Sabahu – falja e mëngjesit;
- Yleja – falja e drekës;
- Ikindia - falja e mesditës;
- Akshami – falja e mbrëmjes;
- Jacia – falja e darkës.

Thirrja për kohën e namazit – faljes bëhet nga një person që emërtohet "muezin", i cili u drejtohet myslimanëve: "Zoti është më i madhi, Muhamedi është i dërguari i Zotit, ejani në namaz, ejani në shpëtim …". Kjo thirrje dëgjohet në çdo vend të globit tokësor ku ka myslimanë. Profeti a.s. në Medinë ka pasur xhaminë e ndërtuar posaçërisht për të, ku i priu si imam në falje për myslimanët deri në fund të jetës së tij.

Xhamitë janë edhe simbol për myslimanët se janë vendmbledhje dhe adhurimi për ta.

2.3. Virtytet e namazit

Zoti i Lartësuar në Kur'anin Famëlartë thotë: "Ata që besojnë dhe kryejnë vepra të mira, falin namazin dhe japin zeqatin, do të kenë shpërblim te Zoti i tyre dhe nuk do të kenë pse të frikësohen apo pikëllohen."[52]

Nga komenti i këtij mesazhi kuranor në "Tefsiri Tibjan" thuhet se të gjithë ata që besojnë Allahun dhe të dërguarin e Tij, Muhamedin a.s., e dinë se feja islame, drita islame, është si një ndërtesë e bazuar mbi pesë shtylla. Nëse këtë ndërtesë e përngjasojmë me nje fanar, atëherë kemi një fanar të rrethuar nga të katër anët me xham. Njëra anë është namazi, ana tjetër është agjërimi, ana e tretë është zekati, dhe ana e fundit është haxhi. Kornizat që lidhin xhematin me njëri-tjetrin janë: besnikëria, mbajtja e fjalës, durimi dhe mirësia. Pjesa e sipërme është kënaqësia, ndërsa pjesa e poshtme është bujaria. Drita që ndriçon në mes është drita e Islamit dhe e besimit. Në këtë mënyrë ky fanar lëshon vetëm dritë dhe ndriçon përreth tij. Nëse një nga këto braktiset, xhamat nxihen dhe drita nuk ndriçon si më parë. Për ta shpjeguar më hollësisht marrim shembullin e një ndërtese që lëshon dritë nëpërmjet dritareve të saj. Do të thotë që ka energji dhe llambat janë ndezur dhe ndërtesa lëshon dritë që shihet nga larg. Po të mungojë drita, në errësirë nuk shihet asgjë dhe vetë ndërtesa është errësirë. Kjo ndërtesë ngjason me njeriun: kur në zemrën e tij ndizet llamba e besimit, do të shohim një njeri që reflekton mirësinë pamjen e tij dhe cilësi e virtyte të larta në personalitetin e tij si dashuri, bujari, humanizëm, i moralshëm në sjelljen e tij, respekton prindërit, ndihmon të varfrit, nevojtarët e të tjera cilësi të pëlqyeshme. Të gjitha këto na dhurohen nga falja e namazit, agjërimi i muajit të ramazanit, dhënia e zekatit dhe vizita në Qabe, në shtëpinë e shenjtë në Mekë dhe janë të pëlqyeshme tek Allahu i madhërishëm dhe i dërguari i Tij, Muhamedi a.s.. E kundërta ndodh

[52]. Kur'an, El-Bekare: 277.

me njeriun që nuk e ka ndezur llambën e besimit në zemrën e tij dhe nuk i kryen detyrimet ndaj krijuesit të tij, Zotit të Lartësuar dhe traditës profetike. Pra, kur në zemër ka errësirë, personaliteti i individit është i njollosur me cilësi e zakone të papëlqyeshme si egoizmi, smira, gënjeshtra, tradhtia, amoraliteti etj., me të cilat ai fiton mallkimin e Allahut të Lartësuar.

Namazi është adhurimi më i rëndësishëm që ndriçon zemrën e besimtarit dhe është më i dashur tek Allahu i Lartësuar, sepse nëpërmjet tij bëhet lidhja pa ndërmjetës. Prandaj ai është shkaku kryesor që Allahu të jetë i kënaqur me këtë besimtar, është shkaku që i pranohen lutjet, do të bëhet dritë në jetën e varrit dhe gëzim në ahiret, që do ta shoqërojë në ditën e gjykimit dhe do t'i bëhet mbrojtës dhe shpëtim në urën e Siratit.

Myslimani që kryen namazin e plotë me përkushtim dhe përulësi ndaj Zotit të lartësuar, do ta ketë çelësin për të zgjidhur të gjitha problemet e kësaj bote si dhuratë nga Krijuesi i tij. Prandaj namazi është shtyllë e fesë islame.

2.4. Veprimtari praktike:

2.4.1. Farzet e abdesit:

Abdesi ka katër farze:
- Larja e fytyrës;
- Larja e duarve dhe e krahëve deri mbi bërryla;
- Mes-hu i një pjese të kokës, domethënë përshkimi i saj me dorë të lagur;
- Larja e këmbëve deri përtej kyçeve.

Si merret abdesi?

1. Shpëlajmë gojën tre herë me dorën e djathtë;
2. Me dorën e majtë tri herë shpëlajmë hundën, pasi kemi futur ujë në të me dorën e djathtë;
3. E lajmë fytyrën prej ku kanë dalë flokët e deri nën mjekër e prej veshit në vesh tri herë;
4. Lajmë tri herë dorën e djathtë deri pas bërrylit, me dorën e majtë;
5. Lajmë tri herë dorën e majtë deri pas bërrylit me dorën e djathtë;
6. Me dorë të lagur i japim mes-h një pjese të kokës;
7. Pastaj, me duar të lagura, më drejt me gishtat tregues, lajmë brendësinë e veshëve, ndërsa me gishtat e mëdhenj lajmë pjesën e pasme të tyre dhe me tre gishtat e tjerë, me anën e jashtme të tyre, fërkojmë qafën;
8. Pasi t'i jepet mes-h qafës, lajmë këmbët duke filluar me larjen e këmbës së djathtë e më pas me këmbën e majtë deri mbi kyçe.

Si falet namazi?

Për namazin e mashkullit, që falet vetëm, po sjellim një shembull: Sunetin e namazit të Sabahut i cili falet kështu:

1. Së pari kthehemi nga Kibla. Këmbët i mbajmë paralelisht të ndara nga njëra-tjetra. Ngremë duart deri tek e buta e veshëve[53] dhe pëllëmbët të hapura i kthejmë nga kibla dhe me zemër e gojë shqiptojmë: "E bëra nijet (vendosa) për kënaqësi të Zotit, të fal sunetin e namazit të sabahut të sotëm, u ktheva nga kibla dhe u ujdisa (ndjek) Kur'anit" dhe e shqiptojmë tekbirin: Allahu Ekber, e pastaj i bashkojmë duart nën kërthizë duke vënë dorën e djathtë mbi të majtën.

2. Sytë i drejtojmë në vendin ku do të bëjmë sexhde dhe lexojmë:

a-Subhaneke;

b-Eudhu Besmelen pastaj Fatihanë;

c-Pas Fatihasë, pa lexuar besmelenë, lexojmë një sure të shkurtër.

3. Pas leximit të sures duke thënë Allahu Ekber, përkulemi në ruku. Me duar mbulojmë kupat e gjunjëve, belin e mbajmë drejt dhe, duke mos i ndarë sytë nga këmbët, themi: Subhane rabbije-l-adhim tri herë. Mund të thuhet edhe pesë ose shtatë herë.

4. Duke thënë SemiAllahu limen hamideh, drejtohemi dhe, kur qëndrojmë drejt, shqiptojmë: Rabbena leke-l-hamd.

5. Pa qëndruar shumë në këmbë duke thënë Allahu Ekber biem në sexhde. Duke rënë në sexhde në tokë, vëmë me radhë:

-gjunjët para duarve.

-gishtat e këmbëve mblidhen në drejtim të kibles;

-koka vihet në mes dy duarve;

-gishtat e duarve shtrihen përpara;

-së bashku me brendinë e pëllëmbëve shtrihen përtokë;

-duke qenë në këtë gjendje, themi së paku tri herë: Subhane rabbije-l-a'la.

6. Duke thënë Allahu Ekber ngrihemi nga sexhdja dhe këmba e majtë shtrihet në tokë, gishtat e këmbës së djathtë mblidhen në drejtim të kibles dhe ulemi në gjunjë, duart vihen mbi gjunjë me gishta të shtrirë.

7. Pa ndenjur ulur tepër në gjunjë, duke thënë Allahu Ekber, kthehemi prapë në sexhden e dytë.

8. Përsëri në sexhde dhe themi së paku tri herë Subhane rabbije-l-a'la dhe duke shqiptuar Allahu Ekber, ngrihemi në këmbë. Duke u ngritur nga sexhdja, së pari duhet ngritur koka, pastaj ngrihen gjunjët duke i mbajtur duart të mbështetura te kofshët.

9. Kur marrim pozicionin në këmbë, për të filluar rekatin e dytë, pas Besmelesë lexojmë Fatihanë e pastaj një sure të shkurtër dhe, duke shqiptuar Allahu Ekber, përkulemi në ruku.

10. Edhe rekati i dytë bëhet deri në fund në atë mënyrë siç është folur për rekatin e parë, veçse pas sexhdes së dytë, kur të themi Allahu Ekber, pa u ngritur në këmbë, ulemi në gjunjë dhe:

---

[53]. A preken veshët gjatë ngritjes së duarve? Uail ibn Huxhri thotë: "E kam parë të Dërguarin e Allahut (Paqja qoftë mbi të) duke ngritur duart dhe gishtat e mëdhenj i çoi deri te bulëzat e veshëve" (Ebu Daudi 737; Nesaiu në Muxhteba 882 dhe Ahmedi 4/316). Nga hadithi i lartpërmendur kuptohet se i Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të) i ka çuar gishtërinjtë e mëdhenj te bulëzat, mirëpo nuk mund të themi me siguri se i ka prekur apo nuk i ka prekur ato. Allahu e di më së miri; Rushit Musallari, Fikhu Praktik sipas Medhhebit Hanefi – Shtyllat e Islamit, f. 173.

a. Pasi të lexojmë lutjet (duatë): Ettehijjatu, Allahumme sal-li, Allahumme barik dhe Rabbena atina japim selam, së pari në anën e djathtë duke thënë: Esselamu alejkum ue rahmetull-llah e pastaj në të majtën Esselamu alejkum ue rahmetull-llah.

b. Pasi të japim selam, themi: Allahumme entes selamu ve minkes selam tebarekte ja dhel-xhelali uel-ikram dhe pa folur fare, ngrihemi të falim farzin e sabahut, sepse të flasësh ndërmjet sunetit dhe farzit, edhe se nuk e prish namazin, i pakëson sevapet.

Pas namazit, këndohen: tri herë Estagfirull-llah, pastaj Ajeti Kursij dhe tridhjetë e tre herë SubhanAllah, tridhjetë e tre herë Elhamdulil-lah dhe tridhjetë e tre herë Allahu Ekber. Këto duhen kënduar pa zë. Të këndosh me zë është bidat (shtesë).

Në fund bëhet duaja. Në dua, meshkujt i çojnë duart në lartësinë e gjoksit dhe hapen pëllëmbët në mënyrë që brendia e shuplakës të kthehet drejt qiellit, sepse ashtu siç është Qabeja, kibla e namazit, ashtu është qielli kibla e lutjeve. Pas duasë, duke lexuar ajetin "Subhane rabbike"…, i fërkojmë duart për fytyre.

Për rekatin e dytë në sunetet dhe farzet katër rekatëshe lexohet Ettehijatu dhe çohemi në këmbë. Në rekatet e treta e të katërta të suneteve, pas Fatihasë, këndohet një sure e shkurtër. Në rekatet e treta e të katërta të farzeve këndohet vetëm Fatihaja. Edhe farzi i akshamit falet kështu. Pra në rekatin e tretë të tij, nuk këndohet sureja. Kurse në namazin e vitrit në çdo rekat, pas Fatihasë, këndohet sure shtesë. Në rekatin e fundit, pas sures merret tekbir dhe duart ngrihen te veshët. Pastaj këndohet duaja e Kunutit. Edhe sunetet e para të ikindisë dhe jacisë që janë gajri muekkedeh (jo të forta), janë si sunetet e tjera, veçse në ndenjen pas rekatit të dytë, pas et-tehijatit, këndohen edhe salavatet.

Namazet e Bajramit

Dita e parë e muajit hënor (arab) Sheval është dita e parë e Fitër (ramazan) Bajramit, kurse dita e dhjetë e muajit hënor Dhul-hixhe, është dita e parë e Kurban Bajramit (Bajrami i vogël). Këto dy ditë, është vaxhib për meshkujt që, gjysmë ore pasi të lindë dielli, të falin dy rekate të namazit të bajramit.

Kushtet e namazeve të Bajramit janë si kushtet e namazit të xhumasë, por këtu hytbeja është sunet dhe lexohet pas namazit.

Në Bajramin e madh (të ramazanit) është mustehab (e pëlqyer) që para namazit të hash ëmbëlsirë (hurmë, karamele), të marrësh gusul, të përdorësh misvakun, të veshësh rrobat më të mira, të japësh fitrin dhe rrugës të këndosh ngadalë tekbir.

Në Bajramin e vogël (kurbanit) është mustehab që para namazit të mos hash gjë, pas namazit të hash së pari mish kurbani, duke shkuar në namaz të këndosh tekbir me zë dhe ai që është i penguar (me arsye), pa zë.

Namazet e Bajramit janë dyrekatëshe, falen në xhemat dhe nuk mund të falen vetëm.

Si falet namazi i Bajramit?

1. Së pari bëhet nijeti: "E bëra nijet në emër të Allahut të fal namazin e Fitër-Bajramit, u ktheva nga kibla, iu drejtova imamit dhe marrim tekbir pas imamit. Pastaj këndohet Subhaneke.

2. Pas Subhanekes, marrim tri tekbire duke ngritur duart te veshët. Në dy tekbiret e para duart i mbajmë të lëshuara anash e në të tretin lidhen nën kërthizë. Imami së pari lexon Fatihanë, pastaj një sure dhe bashkërisht përkulemi në ruku.

3. Në rekatin e dytë, imami së pari lexon Fatihanë dhe një sure. Pastaj duke marrë tre herë tekbire radhazi, duart ngrihen te veshët duke i lëshuar anash pas çdo tekbiri. Në tekbirin e katërt, pa i ngritur duart te veshët, përkulemi në ruku. Pastaj biem në sexhde dhe kryhet si farzi i xhumasë.

Tekbiret e Teshrikut

Nga namazi i Sabahut, natën e kurban bajramit e deri në namazin e ikindisë të ditës së katërt të bajramit, si për haxhinjtë edhe për ata që nuk kanë shkuar në haxh, mashkull apo femër qoftë, që falet me xhemat apo vetëm, pas namazeve farz, sapo të japë selam, është vaxhib të lexojë një herë tekbirin teshrik.

Pas namazit të xhenazes nuk lexohet. Pasi të dalësh nga xhamia dhe pasi të flasësh, nuk duhet të lexohet.

Nëse imami e harron tekbirin, xhemati nuk e braktis. Meshkujt mund ta këndojnë me zë të lartë, gratë e këndojnë ngadalë.

Si falet namazi i xhenazes?

Të katër tekbiret e namazit të xhenazes janë si një rekat. Prej këtyre katër tekbireve, vetëm në të parin ngrihen duart te veshët. Në tre tekbiret e tjerë, nuk ngrihen duart më.

1. Pasi të merret tekbiri i parë, lidhen duart dhe këndohet Subhaneke dhe para fjalëve "Ue la ilahe gajruke" shtohet fjalia "Ue xhel-le thenauke". Fatihaja nuk këndohet.

2. Pas tekbirit të dytë, pa i ngritur duart te veshët, këndohen salavatet.

3. Pas tekbirit të tretë, lexohet duaja e xhenazes. Në vend të duasë së xhenazes, mund të lexohet edhe "Rabbena atina…", ose vetëm të thuash "Allahumegfir lehu" ose me nijet duaje të lexosh Fatihanë.

4. Pas tekbirit të katërt, menjëherë jepet selam në të djathtë e në të majtë. Imami shqipton me zë të lartë vetëm katër tekbiret, të tjerat i lexon me vete.

Pasi falet namazi i xhenazes, nuk lejohet të bësh dua para arkivolit, sepse është mekruh.

Varri duhet të jetë i thellë sa gjysma e shtatit për meshkujt, ndërsa për femrat deri në lartësinë e gjoksit dhe ana e djathtë e kufomës në varr është e kthyer nga kibla.

Namazi i Teravisë

Namazi i teravive, për meshkujt e për femrat është sunet. Falet çdo natë të muajit të ramazanit. Falja e tij me xhemat është suneti kifaje (sunet i përbashkët). Falet pas sunetit të dytë të jacisë dhe para vitrit. Mund të falet edhe pas vitrit. Për shembull, ai që ka arritur një pjesë të teravive dhe e fal vitrin me imam, rekatet e teravive që nuk i ka arritur, i fal pas vitrit.

Ai që nuk e fal namazin teravi, nuk mund ta bëjë kaza. Nëse bëhet kaza, quhet nafile dhe jo teravi.

Namazi i teravisë ka njëzet rekate.

Si falen teravitë?

Namazi i teravisë falet vetëm në muajin e ramazanit. Është e pëlqyer që namazi i teravive të falet duke dhënë selam pas dy rekatesh apo pas katër rekatesh.

Namazi i teravisë zakonisht falet me xhemat në xhami, por edhe në vende të tjera. Mund të falet edhe vetëm, duke qenë në shtëpi, por nuk e ka sevapin e të falurit në xhemat dhe në xhami. Nëse falet në shtëpi me një apo disa persona xhemat, ka njëzet e shtatë herë më shumë sevap se sa të falet vetëm. Ata që nuk e kanë falur jacinë me xhemat, teravitë nuk mund t'i falin me xhemat. Një person që nuk e ka falur jacinë me xhemat, fal më parë farzet e jacisë vetëm e më pas mund të falë teravitë me xhemat.

Mund të falet me një nijet, kur i fillojmë teravitë me tekbirin e parë fillestar, por ta bësh nijet në çdo tekbir fillestar është më mirë. Nijeti bëhet kështu: "E bëra nijet në emër të Allahut, të fal namazin e teravive, u ktheva nga kibla, iu drejtova imamit".

3. Agjërimi i Ramazanit

Agjërimi është një adhurim tjetër që myslimanët pa dallim gjinor e kanë obligim nga Zoti i Lartësuar. Në Kur'an thuhet: "O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu si u ishte urdhëruar atyre para jush, që të mund të ruheni nga të këqijat. Agjërimi zgjat disa ditë, por, nëse ndonjëri prej jush është i sëmurë ose duke udhëtuar, le të agjërojë aq ditë sa i ka prishur në ditët e tjera pas. Ata që kanë vështirësi për të agjëruar, duhet të ushqejnë si shpagim nga një të varfër për çdo ditë agjërimi. E, nëse ndonjëri jep më shumë se kaq, kjo është edhe më mirë për të."[54]

Agjërimi, në ndryshim nga namazi, kërkon një vetëpërmbajtje të vullnetshme nga të ngrënët e të pirët e ujit dhe lëngjeve, nga agimi i hershëm i mëngjesit deri në perëndim të diellit sipas kalendarit islam. Ky angazhim përballon çdo pasion negativ që mund t'i serviret njeriut gjatë ditës. Shmangia nga veset negative që ofron agjërimi forcon karakterin e njeriut dhe e bën të aftë të përballojë epshet e pasionit që e ngarkojnë me mëkate. Profeti a.s. ka thënë: "Parajsa është e rrethuar me vështirësi, ndërsa zjarri me epshe". Prandaj agjërimi është edhe një nga adhurimet e veçanta, sepse e bën agjëruesin të heqë dorë me vullnet të lirë edhe nga ato gjëra që janë të lejuara në rrugë normale. Një hadith i përcjellë nga Ebu Hurejra tregon se Profeti a.s. ka thënë: "Zoti thotë: të gjitha veprat e njeriut janë për të, përveç agjërimit; agjërimi bëhet për Mua dhe Unë shpërblej për të".

Agjërimi i Ramazanit është detyrë një herë në vit sipas kalendarit islam. Kalendari hënor lëviz me njëmbëdhjetë ditë në vit. Kjo tregon se agjëruesit, pas çdo tridhjetetre vitesh, agjërojnë në sasi të barabartë kohe. Një nga shkencëtarët amerikanë, Mack Fotan, thotë se të gjithë njerëzit kanë nevojë të agjërojnë edhe nëse nuk janë të prekur nga ndonjë sëmundje, sepse helmet e ushqimeve mblidhen brenda trupit të njeriut duke e rënduar dhe reduktuar aktivitetin e tij. Kurse njeriut që agjëron i

[54]. Kur'an, El-Bekare: 183-184.

pakësohet pesha dhe helmet e grumbulluara prej ushqimeve në trupin e tij, i pastrohen duke u larguar plotësisht. Në të njëjtën kohë përtërihen qelizat e trupit 20 ditë pas iftarit, duke e ndjerë veten më aktiv dhe më të fortë se më parë"[55]. Ndërsa Profeti a.s. ka thënë: "Agjërimi është mbrojtje"; do të thotë që e mbron organizmin nga sëmundjet dhe i jep mundësi që të ripërtërijë qelizat.

Gjatë Ramazanit agjëruesi fiton cilësi të veçanta që e bëjnë të përballojë çdo vështirësi. Agjërimi e disiplinon agjëruesin, e bën të rregullt për kryerjen e detyrave për të përballuar nevojat e tij jetësore individuale e familjare, por njëkohësisht i shumëfishohen të mirat dhe bëhet më i afërt me Zotin e Lartësuar. Ai për çdo nevojë mund t'i lutet Zotit dhe lutja e tij do t'i pranohet. Për këtë Ibn Amri transmeton se Profeti a.s. ka thënë: "Lutja e agjëruesit nuk kthehet mbrapsht".

Zoti i Madhërishëm e bëri detyrë agjërimin për çdo mysliman e myslimane që ka mbushur moshën e pjekurisë me të vetmin qëllim për të pastruar zemrën nga çdo mëkat dhe për të rritur besimin te Krijuesi i tij e i gjithësisë në shkallë sa më të lartë.

Profesor Nikola Bihni nga Moska në librin e tij "Uria për hir të shëndetit" shkruan: "Çdo njeri duhet të praktikojë agjërimin duke ndaluar veten nga ushqimi për katër javë, çdo vit, në mënyrë që të gëzojë shëndet të plotë gjatë gjithë jetës"[56]. Do të thotë që agjërimi siguron një ekuilibër të plotë mendor e trupor, i siguron një motiv të qartë për të njohur të vërtetën, drejtësinë, vëllazërinë, dashurinë dhe mëshirën si dhe përmirësimin e moralit. Agjërimi përsos edhe moralin e agjëruesit, sepse e frenon nga veset negative. Profeti a.s. ka thënë: "Pesë gjëra e thyejnë agjërimin e agjëruesit: gënjeshtra, përgojimi, shpifja, betimi i gënjeshtër dhe shikimi i pasioneve".

Agjërimi që bën myslimani duhet të plotësohet me një namaz të natës, pas namazit të pasdarkës (Jacisë) që quhet namazi i teravisë, që shkon nga 8-20 rekate, namaz të cilin e ka praktikuar i dërguari i Allahut të Lartësuar. Profeti a.s. sipas transmetimit të Buhariut, ka thënë: "Ai që agjëron muajin e ramazanit me besim të plotë dhe duke synuar vetëm shpërblimin e Zotit, të gjitha gjynahet e tij të mëparshme, janë falur".

3.1. Muaji i agjërimit - faktor i rëndësishëm për përsosjen e moralit të agjëruesit

Muajin e agjërimit besimtarët myslimanë e kanë shndërruar në muajin e luftës kundër dobësive të tyre, të epsheve e të pasioneve si dhe kundër çdo gjynahu. Nuk mjafton vetëm agjërim me ndërprerjen e ushqimit, ujit dhe lëngjeve të tjera gjatë ditës. Këto aktivitete shoqërohen edhe me veprimet e gjymtyrëve dhe organet e shqisave e veçanërisht gjuha. Zoti xh.sh. në Kur'an thotë: "Mjerë për çdo përqeshës - shpifës"[57]. Në këtë ajet paraqitet skema aktuale e ditëve të hershme të thirrjes në Islam, por njëkohësisht, kjo skemë është shembull që përsëritet në çdo mjedis e shoqëri edhe në ditët tona. Është kjo skenë e njeriut të ulët, i cili luan me dinjitetin e tjetrit duke përgojuar e shpifur për të, që me gjuhën e vet i përflet të tjerët pas shpine, i përqesh në të gjitha mënyrat, duke prekur saktësinë e agjërimit. Kjo e zhvesh agjërimin nga vlerat e tij dhe ul personalitetin e agjëruesit. Për këtë në një hadith të Profetit a.s. që e transmeton Ibni Mesudi r.a. thuhet: "Asnjë nga shokët e

55. Sajmir Bulku, *Sekretet e mjekësisë në Kur'an*, viti 2011, f. 105.
56. Po aty, f. 106.
57. Kur'an, El-Humeze: 1.

mi të mos më tregojë asgjë për shokët. Unë vërtet dua të dal mes jush, dua të jem i sigurt nga të këqijat tuaja".

Kur'ani i shenjtë i cilëson këto veprime si neveritëse dhe na tërheq vëmendjen nëpërmjet këtij ajeti ku thuhet: "shpifaraku, që përhap thashetheme"[58]. "O ju që keni besuar! Mënjanoni shumë dyshime, se, vërtet, disa dyshime janë gjynah. Mos e spiunoni dhe mos e përgojoni njëri-tjetrin! Mos vallë dëshiron ndokush prej jush të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur?! Sigurisht që ju do ta urrenit këtë! Kijeni frikë Allahun! Me të vërtetë, Allahu është Pranues i pendimit dhe Mëshirëplotë."[59]

Agjërimi i Ramazanit e bën agjëruesin të kontrollojë vetveten nga të gjitha veset negative. Në rast të kundërt, agjëruesi i shuan vlerat e tij si për shembull, shoku i keq që fut ligësi në zemrën e shokut të vet, ashtu siç thuhet në Kur'an: "O besimtarë! Mos i çoni dëm lëmoshat tuaja duke ua kujtuar ato (atyre që ua keni dhënë) dhe duke fyer, siç vepron ai që e shpenzon pasurinë e vet për sy e faqe të botës dhe nuk beson në Allahun dhe Ditën e Fundit. Ai shëmbëllen me një gur të lëmuar të mbuluar me dhé, mbi të cilin bie shiu me rrebesh, duke e lënë të zhveshur. Ata nuk kanë kurrfarë dobie nga veprat që kanë bërë, se Allahu nuk e udhëzon në rrugë të drejtë popullin mohues."[60]

Ky muaj është periudhë stërvitore, për një ekzaminim ku të gjitha organet që na janë dhuruar nga Zoti, të disiplinohen e të vihen në shërbim të tij si mëkëmbës apo kalif në tokë. Për shembull, gjuha është një organ shumë i çmuar, për të cilën Muhamedi a.s. ka thënë: "Kur çohet njeriu në mëngjes, të gjitha gjymtyrët e tij përulen e i thonë: Kije frikë Zotin për ne, se ne jemi lidhur me ty. Në qoftë se ti shkon drejt, shkojmë edhe ne drejt, por nëse ti merr kot së koti, ashtu marrim edhe ne". Nga kjo porosi me vlerë të madhe kuptohet se gjuha duhet të mbahet e pastër, se ndryshe ajo dhunon shenjtërinë e agjërimit. Prandaj duhet përdorur me drejtësi e mirësi që t'i shtojë vlerën agjërimit. Pra është e njëjta gjuhë që mund të shkaktojë shumë të këqija, kur përdoret shtrembër dhe mund të japë shumë të mira dhe vëllazërim në mes njerëzve, kur përdoret me qëllime të mira. Po kështu edhe dora, me anë të së cilës mund të marrim padrejtësisht mallin e pasurinë e tjetrit dhe, njëkohësisht, mund t'i japë jetimit e të varfrit; këmba mund të na çojë në krime, por mund të na çojë edhe në vende shumë të mira si në xhami, për të vizituar prindërit apo të afërmit, të sëmurët dhe veprime të tjera të mira me të cilat përfiton pëlqimin e Zotit. Ndërsa me organet e shqisave nuk duhet abuzuar. Me sytë nuk duhet të shohim të keqen, me veshët nuk duhet të dëgjojmë thashethemet e fjalë të papëlqyeshme. Së fundi "mendja", që kujdeset për trupin dhe duhet të japë gjykime të pastra. Po kështu edhe me shqisat e tjera. Me këto bëhet një hap shumë i rëndësishëm për ngritjen e agjëruesit në shkallën më të lartë shpirtërore.

Miliona besimtarë së bashku korrin frytet e veprës së tyre në këtë muaj të bekuar, sepse zbatojnë detyrën e Zotit xh.sh., ashtu siç thuhet në Kur'an: "O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu si u ishte urdhëruar atyre para jush, që të mund të ruheni nga të këqijat"[61]. Pra agjërimi është disiplina më e drejtë e gjithë disiplinave shpirtërore që i imponohet çdo të rrituri mysliman, burrë apo grua qoftë.

---

58. Kur'an, El-Kalem: 11.
59. Kur'an, El-Huxhurat: 12.
60. Kur'an, El-Bekare: 264.
61. Kur'an, El-Bekare: 183.

Megjithatë, ka një perde midis njeriut dhe Zotit të Lartësuar dhe ajo perde është trupi i vdekshëm fizik. Ai e kupton se vetë është një krijesë e zhdukur, një ekzistencë e përkohshme e nuk mund të hyjë në kufijtë e amshueshëm të Krijuesit të pavdekshëm, pa pasur një mjet që të depërtojë perden dhe ky mjet është "mendja" e bindur ndaj Tij. Vetëm kjo "mendje" mund të ngjitet lart e t'i afrohet Qenies më të lartë. Që të dyja mund të takohen e të bisedojnë njëra me tjetrën. Njëra lutet, agjëron, lavdëron, madhëron e lyp, tjetra bekon. Ky afrim i të dyjave, domethënë bashkimi i të falurit midis tyre, në fenë islame, quhet adhurim.

Agjërimi i jep mundësi besimtarit që të angazhojë trupin e tij për vepra të mira e cilësi të pëlqyeshme. Për sasinë, moralin dhe përsosjen e personalitetit, agjërimi mund të paraprihet vetëm nga udhëheqësja kryesore e të gjitha cilësive dhe kjo është zemra e njeriut. Kjo zemër e pastër fiton mëshirën dhe përkrahjen e Zotit, sepse mbështetet në porositë e Kur'anit të Shenjtë duke zbatuar me përpikëri kërkesat e agjërimit, i cili është vendosur edhe për të vënë në provë e vështirësi besimin e myslimanit për një muaj, për shumë orë të ditës.

Efekti i agjërimit në personalitetin e agjëruesit është kapitali më i çmuar, i cili e bën të aftë t'u nënshtrohet urdhrave më të forta e ta sjellë atë në harmoni dhe ekuilibër të përkohshëm midis trupit dhe shpirtit dhe të dyja të jetojnë së bashku në bashkekzistencën paqësore.

Agjërimi është modeli i përmirësimit të karakterit moral dhe shpirtëror të agjëruesit. Qëllimi i tij është të ndihmojë në frenimin e veseve negative, në pastrimin e cilësive të këqija dhe në ngritjen e ndërgjegjes së besimit te Zoti i Lartësuar për të përfituar nga mëshira e Tij. Pra ai është një recetë hyjnore për çdo agjërues dhe është ndryshe nga receta e zakonshme që jep mjeku. Ai veç detyrës fetare, kontrollon komplet dëshirat trupore, është vetëpastrim i organizmit, i përkushtimit, bashkimit dhe vëllazërimit.

Dimensionet e moralit në fenë islame janë të shumta, të mirëfillta e të kuptueshme. Morali islam ka të bëjë me marrëdhëniet ndërmjet njeriut dhe Zotit, njeriut dhe njerëzve të tjerë, ndërmjet njeriut dhe elementeve dhe krijesave të tjera të gjithësisë dhe ndërmjet njeriut dhe brendësisë më të thellë të vetes së tij.

Myslimani duhet të kontrollojë sjelljen e vet të jashtme dhe manifestimin e veprave të tija si dhe ndjenjat dhe qëllimet e tij. Në kuptimin më specifik, marrëdhëniet e myslimanit me Zotin e Plotfuqishëm fshihen në dashurinë dhe dëgjimin, besimin e plotë dhe ndershmërinë, në rehati e qetësi dhe në shërbimin aktiv. Pa dyshim, ky moral i nivelit kaq të lartë, do të ushqejë dhe do ta forcojë moralin në nivel njerëzor. Marrëdhëniet e tij me besimtarin mysliman dhe me të tjerët që e rrethojnë pa dallim, duhet t'i karakterizojë përzemërsia. Zemra e tij duhet të rrahë në paqe e qetësi dhe këshilla e tij duhet të jetë e drejtë dhe e sinqertë. Për këtë profeti ynë, H. Muhamedi a.s. ka thënë: "Ruajuni nga mendimet e këqija, sepse mendimi i keq është gënjeshtra më e madhe. Mos e përgojoni, as mos spiunoni njëri-tjetrin, mos kini zili njëri-tjetrin, mos e urreni njëri-tjetrin, as mos ia ktheni shpinën njëri-tjetrit. O robërit e Allahut, bëhuni vëllezër, siç jeni urdhëruar. Myslimani për myslimanin është vëlla, prandaj nuk guxon t'i bëjë padrejtësi, ta lëshojë ose nënçmojë atë. Këtu është devotshmëria (duke treguar me dorë kraharorin e tij). Për njeriun është e keqe e mjaftueshme në qoftë se nënçmon vëllain e tij mysliman, është i pacenueshëm gjaku i tij, nderi i tij… Allahu nuk shikon në trupat tuaj as në pamjen tuaj, por shikon në zemrën tuaj". Kjo thënie e Profetit tonë është aktuale edhe në ditët tona. Është kjo skenë e njeriut të ulët, i cili luan me dinjitetin e tjetrit duke e

përgojuar dhe shpifur atë; smira dhe reagimi i keq i ziliqarit për asgjësimin e të mirave të shokut, apo vëllait të vet mysliman, që kanë çuar në krime si vjedhje, grabitje, vrasje etj.

Feja dhe mirësia nuk mund të zhduken. Ato lenë rrënjë të thella, por gënjeshtra, e keqja, krimi etj,pavarësisht se gjejnë terren e përhapen, përfundimisht mbarojnë në kotësi. Kriteret e vendosura nga Zoti janë të ndryshme nga kriteret e vendosura nga njeriu. Këta njerëz që kryejnë këto veprime mashtrohen kur besojnë se me mendimin e gjykimin e tyre të ligë mund të përcaktojnë kriteret që duhen zbatuar. Dinjiteti dhe personaliteti i këtyre njerëzve është shumë i ulët.

Njeriu, si mëkëmbësi i Zotit në tokë, duhet të jetë një besimtar i vetëdijshëm. Ai gjithmonë duhet të mendojë mirë për të tjerët, t'i ndihmojë ata që të kenë sukses në të ardhmen e jetës së tyre e të shoqërisë.

Pra, morali islam është mënyra më komplete e jetës, sepse na urdhëron jo vetëm të besojmë, por edhe të zbatojmë rregullat shoqërore të sjelljes.

I mbështetur në Kur'an, Islami nuk pranon që kjo jetë të jetë qëllim në vetvete e as beson se trupi nuk ka lidhje me shpirtin, por përkundrazi, na mëson se duhet të besojmë në jetën e përhershme. Si argument sjellim përgjigjen e H. Aliut r.a. i cili thotë se kur u pyet profeti ynë për sjelljen e tij të përgjithshme, ai u përgjigj: "Njohuria, mençuria është kapitali im, kurse mendja-arsyeja është themeli i besimit tim; dashuria është themeli im, dëshira është kali i shalës për mua; të kujtoj Zotin është detyrë e imja; besnikëria është pasuria ime; kujdesi është shoku im; dituria është arma ime; durimin e kam mbrojtje; modestia është fitim për mua; thjeshtësia është krenaria ime; të shmangem prej dëfrimeve është mjeshtëria ime; siguria është ushqimi im; e vërteta është bashkëbiseduesi im; dëgjueshmërinë e kam cilësi, kurse gëzimi i zemrës sime është në adhurim".

E falënderoj Zotin e Plotfuqishëm, i Cili ka ndriçuar zemrat e besimtarëve me dritën e së vërtetës, gjuhët e tyre i ka përgatitur për ta falënderuar Atë dhe trupat e tyre i ka krijuar që t'i shërbejnë Atij; Ai di për ata dhe ata e përmendin atë. Ai i do ata dhe ata e duan atë. Ai është i kënaqur me ata dhe ata janë të kënaqur më Atë. Pasuria e tyre është e varfër karshi Atij. Ata e ndiejnë nevojën për zbatimin e detyrave që ka urdhëruar Ai. Pra edhe agjërimi është detyrë e urdhëruar dhe një ndër kuptimet e tij është, ashtu siç thuhet në Kur'anin famëlartë, sure "Merjem", verseti 26, që domethënë: "Unë kam vendosur heshtje për hir të të gjithëmëshirshmit". Kjo është një fjalë që ndërpritet ose i bashkëngjitet agjërimit, sepse ata që kryejnë agjërim duhet ta frenojnë veten nga të gjitha veprimet e liga. Një bindje e thellë e agjërimit tregon:

Së pari, se ai kërkon ndihmë dhe udhëheqje nga një fuqi më e madhe se vetja e tij;

Së dyti, tregon frikën ndaj asaj fuqie dhe përuljen bindshëm para saj;

Së treti, tregon respektin e plotë ndaj asaj fuqie, e cila buron vetëm nga dashuria për të;

Së katërti, tregon shpresën e mëshirës tek Ai;

Së pesti, tregon ndjenjën e qortimit e të pendimit për të metat e neglizhencën që mund të ketë treguar në realizimin e detyrave.

Këto janë pjesët kryesore që përbëjnë sistemin e këtij adhurimi, qëllimi i të cilit është të përsosë personalitetin e agjëruesit e ta çojë atë sa më afër Krijuesit të tij.

Ai që triumfon nga kjo provë e vështirë, e parandalon veten nga të gjitha veset dhe sjelljet e liga dhe mendja e tij vepron kundër të këqijave për të arritur qëllimin final, rritjen e ndërgjegjes së tij dhe në afrimin shpirtëror me Krijuesin e tij.

Në fjalimin e tij të famshëm në haxhin e lamtumirës, Muhamedi a.s. deklaroi se në asnjë mënyrë nuk është e lejuar të shkelen të drejtat e njeriut në këto kategori të të drejtave:

1. Personaliteti.
2. Pasuria.
3. Nderi.

Këto porosi të profetit tonë të nderuar realizohen më së miri në këtë muaj të madhërishëm, sepse agjërimi i pastron zemrat e agjëruesve nga kujtimet e kota, pastron dashurinë nga të këqijat, shurdhon veshin nga fjalët e liga e thashethemet, mbron gjuhën nga fjalët e shtrembra, nuk e zgjat dorën në dëm dhe armiqësi të dikujt tjetër, nuk ecën në rrugën e keqe etj. Për të në këtë muaj, gjëja më e vlefshme është e vërteta, amaneti, ndërsa çështja më e urryer tek ai bëhet padrejtësia, gënjeshtra, shpifja dhe nuk pranon kurrë që ato të triumfojnë, sepse janë të dëmshme, ka frikë për dëmet që i shkaktojnë ato.

Nuk ka njeri më të dashur se myslimani i sinqertë në zemrat e njerëzve,sepse me agjërimin e tij, ai bëhet i drejtë në sjelljet me të tjerët, sillet mirë me ata, nuk u bën keq kurrë, mundohet për lumturinë e të tjerëve, duke mos pritur kurrfarë shpërblimi apo falënderimi.

Të gjitha këto mirësjellje të agjëruesit, përsosin moralin e tij, rrisin personalitetin e tij dhe tërheqin ndaj tij zemrat e dashamirësve të tjerë, i nxit ata që ta duan, nderojnë e respektojnë atë.

Agjëruesi nuk i shmanget kurrë të drejtës dhe amanetit edhe në çastet kur nuk e shikon askush e nuk e di kush prej njerëzve, sepse ai është i bindur se me të vërtetë e shikon Zoti i Madhërishëm.

I lutemi Zotit të Plotfuqishëm të bashkojë zemrat tona, të largojë djallin si armikun kryesor përçarës ndër ne, për hir të unitetit të fesë dhe dashurisë ndaj atdheut, që të bëhemi besimtarë të denjë për mëshirën e Tij.

Amin.

3.2. Kush nuk agjëron

Allahu i madhërishëm ka përcaktuar edhe lehtësira për njerëzit që, gjatë muajit të ramazanit, ndodhen në kushte të veçanta dhe e kanë të vështirë t'u përgjigjen kërkesave të agjërimit. Këto momente mund t'i përmbledhim si më poshtë:

1. Njeriu i sëmurë - Zoti i Lartësuar e ka përjashtuar nga agjërimi njeriun që është i sëmurë gjatë këtij muaji. Ky besimtar ditët e lëna mund t'i plotësojë gjatë vitit, para se ta arrijë muaji tjetër i agjërimit. Ndërsa ai që ka sëmundje të vazhdueshme ose të pashërueshme, nuk agjëron, por jep një shpërblim ose para në masën sa për të ushqyer çdo ditë një të varfër, duke e llogaritur për tërë muajin e agjërimit.

2. Njeriu i moshuar me pleqëri të rënduar - Nuk agjëron, por nëse i ka kushtet financiare, paguan për çdo ditë ushqimin e një të varfri.

3. Njeriu që ndodhet në udhëtim - Për t'ia lehtësuar udhëtimin agjëruesit, lejohet që ato ditë të mos agjërojë, por me kusht që t'i zëvendësojë në periudhën më të përshtatshme pas agjërimit.

Nuk është kusht i domosdoshëm prishja e agjërimit. Ai edhe mund të agjërojë dhe kjo është më e vlefshme tek Allahu i Lartësuar.

4. Gratë që kanë arsye të ndryshme - Nuk duhet të agjërojnë gratë që janë në ditët e përmuajshme, gratë lehona, shtatzëna dhe me fëmijë në gji. Ditët e mangëta ose tërë muajin duhet ta plotësojnë në periudhën më të përshtatshme gjatë vitit. Kjo kategori personash favorizohet duke e lejuar që të bëjë plotësimin e agjërimit edhe me shkëputje.

5. Fëmijët nuk e kanë detyrim agjërimin.

Agjërimi në fenë islame dhe aplikimi i tij në praktikë, mbi të gjitha është një adhurim që bëhet vetëm për hir të Zotit, duke nënkuptuar nënshtrimin ndaj Allahut dhe respektimin e ligjeve të tij. Çdo mysliman që agjëron duhet të njohë edhe rregullat dhe disiplinat që përmban një agjërues.

Çfarë nuk e prish agjërimin:

1. Nuk e prish agjërimin në qoftë se agjëruesi ha ose pi diçka me harresë, pa e ditur apo në mënyrë të detyruar.

2. Nuk e prish agjërimin nëse ha apo pi diçka duke menduar se dielli ka perënduar ose nuk ka ardhur akoma agimi i mëngjesit, në rastet kur agjëruesit i mungojnë mjetet e informacionit.

3. Nuk e prish agjërimin kur gjatë marrjes së abdesit i kalon pak ujë nga goja në brendësi.

Agjërimi prishet kur:

1. Kryhen marrëdhënie intime burrë-grua gjatë kohës së agjërimit, nga agimi i mëngjesit deri në perëndim të diellit

2. Ngrënia, pirja apo përdorimi i ilaçeve.

3. Pirja e duhanit dhe e tymrave të tjerë.

4. Përtypja e çamçakëzit.

5. Dalja e gjakut nga goja dhe gëlltitja e tij.

6. Kur merr serume apo gjilpëra ushqyese, ndërsa të tjera jo.

Në këto raste që u përmendën më sipër, agjëruesi duhet t'i kompensojë për aq ditë sa ka prishur.

Si për çdo adhurim, edhe për agjërimin e muajit të ramazanit, që mbahet një herë në vit, rregullat që i përmendëm më sipër duhet të respektohen nga çdo agjërues pa dallim gjinor.

3.3. Vlera e agjërimit në edukimin e vullnetit e të karakterit të njeriut

Një nga adhurimet më të rëndësishme ndaj Zotit të Plotfuqishëm, është edhe agjërimi i muajit të ramazanit, të cilin besimtarët e presin me kënaqësi, sepse është muaji që hap perspektivën për rregullimin e jetës të çdo individi dhe forcon vullnetin e karakterin e qëndrueshëm. Ky muaj është një periudhë stërvitore, për një ekzaminim, ku të gjitha organet e trupit të disiplinohen e të vihen në shërbim të tij. Zoti në Kur'an i drejtohet agjëruesit që të thotë: "Unë jam betuar në të

Gjithëmëshirshmin se do të agjëroj, prandaj sot nuk do të flas me askënd"[62]. Do të thotë që njeriu si krijesë e vetëdijshme dhe aktive, i plotësuar me proceset njohëse me anën e të cilave personaliteti pasqyron dhe njeh botën e jashtme dhe proceset emocionale, me anën e të cilave mban qëndrim pozitiv apo negativ për probleme të caktuara, agjërimi i vë nën kontroll të plotë, sepse me vullnetin e tij i vë qëllim vetes të sakrifikojë për një muaj urinë, etjen sikurse edhe epshet e pasionit etj.

Rol të rëndësishëm për kapërcimin e vështirësive të përkohshme që i dalin individit përpara në aktivitetin e tij të përditshëm luajnë besimi i tij i plotë në Zotin e Madhërishëm dhe kuptimi e vlerësimi i vetëdijshëm dhe i ndërgjegjshëm i qëllimit që ai ka për të arritur kënaqësinë e Allahut të lartësuar. Në Kur'an thuhet: "Agjërimi është për mua,vetëm unë kam për ta shpërblyer agjërimin".

Efekti i agjërimit në personalitetin e agjëruesit është kapitali më i çmuar, i cili e bën të aftë besimtarin t'u nënshtrohet urdhrave më të forta, e sjell atë në harmoni dhe ekuilibër të përkohshëm midis trupit dhe shpirtit dhe të dy jetojnë së bashku në bashkëjetesë paqësore.

Agjërimi është modeli i përmirësimit të karakterit moral dhe shpirtëror të agjëruesit. Qëllimi i tij është të ndihmojë në frenimin e veseve të këqija, në pastrimin e cilësive negative dhe në ngritjen e ndërgjegjes së besimtarit te Zoti i Lartësuar për të përfituar nga mëshira e Tij. Karakteri i besimtarit shprehet në tërësinë e cilësive të qenësishme dhe të qëndrueshme shpirtërore të personalitetit të tij në marrëdhënie me veten, familjen, shoqërinë dhe atdheun.

Një ndër cilësitë e karakterit të agjëruesit, që ka të bëjë me marrëdhëniet me të tjerët, është ndjenja humane, e cila i zbut zemrat e besimtarëve që agjërojnë dhe i bën ata të mendojnë për të afërmit, farefisin dhe njerëzit e tjerë. Është gatishmëria dhe kujdesi i vazhdueshëm për të ndarë me të tjerët gëzimet dhe hidhërimet e për të ndihmuar nevojtarët.

Çiltërsia ose sinqeriteti i agjëruesit është i hapur, pa asnjë të fshehtë, është gatishmëria për të ndjekur të vërtetën, larg individualizmit, egoizmit, dhunës, arrogancës etj. Tek agjëruesi vlerësohet shumë modestia, thjeshtësia në sjellje e në të folur, larg mendjemadhësisë. Me këtë ai kontrollon sjelljen e tij, manifestimin e veprave të tij si dhe ndjenjat dhe qëllimet e tij.

Me manifestim të veprave të agjëruesit kuptojmë dashurinë për Zotin e madhërishëm, dëgjimin e fjalës dhe urdhëresave të Tij, besimin e plotë në Zotin Një dhe ndershmërinë në gjithë aktivitetin e përditshëm të agjëruesit. Pa dyshim ky moral i nivelit kaq të lartë do të ushqejë e do të forcojë moralin në nivel njerëzor, sepse kemi të bëjmë me bindje të brendshme, të vetëdijshme të personalitetit të besimtarit për të vepruar në pajtim me udhëzimet e Shpalljes Hyjnore nga ku burojnë parimet e fesë islame. Prandaj themi se agjërimi forcon karakterin e besimit me dobi që i sjell atij gjatë këtij muaji si:

- I mëson agjëruesit se do të takojë Zotin e tij, i mëson vlerat pozitive të ekonomisë së familjes së tij, e mbron nga mëkatet dhe e bën të kënaqur me atë që ka, e bën të jetë i durueshëm në vështirësi, të jetë i sinqertë e besnik në marrëdhënie me të tjerët, e bën trupin të lehtë dhe të mbrojtur nga sëmundjet etj.

Së fundi, ky është një muaj i tillë agjërimi, ku fillimi është mëshirë, mesi është falje dhe fundi është shpëtim prej zjarrit të xhehenemit.

---

[62]. Kur'an, Merjem: 26.

3.4. Nata e Kadrit

3.4.1. Hyrje

Nata e Kadrit është njëra prej netëve të muajit të begatë të ramazanit. Ajetet kuranore dhe fjalët e të dërguarit Muhamed, paqja dhe bekimi i Zotit qofshin mbi të, që flasin për të, janë të shumta. Për rëndësinë dhe pozitën që kjo natë gëzon te zemrat e njerëzve, tregon edhe fakti që pothuajse i madh e i vogël, ditën që i paraprin Natës së Kadrit e agjërojnë. Për hir të së vërtetës, theksojmë se vetëm agjërimi i kësaj dite nuk e shlyen detyrimin që kemi për të agjëruar gjithë muajin e ramazanit.
Mjafton si nderim për këtë natë edhe fakti se i madhi Zot i ka kushtuar një sure të plotë me këtë emër në Kuran që quhet *Suretul Kadr*.

Pse quhet Nata e Kadrit? Ç'është Nata e Kadrit? Ç'vlera përmban dhe si mund të përfitojmë prej kësaj nate të madhe? Pikërisht pyetjeve të mësipërme do të përpiqemi tu japim një përgjigje të shkurtër.

3.4.2. Pse quhet Nata e Kadrit?

- Fjala "Kadr" ka disa kuptime,ku njëri prej të cilëve është edhe "nderim" ose "respektim",sepse ajo është natë që nderohet dhe ka një pozitë të veçantë tek Allahu për shkak të karakteristikave të saj. Po kështu edhe personi që qëndron zgjuar, duke iu lutur Zotit gjatë kësaj nate, pajiset me një nder të veçantë. Në një ajet kuranor Allahu e quan "Natë të begatshme", për mirësitë e shumta që u jep njerëzve.
- Kuptimi tjetër i kësaj fjale është"shtrëngim", "ngushtim" (i njohurive) në kuptimin që "dituria e saktë është e fshehur në dhjetë ditët e fundit", pra në atë dhjetëditësh të ramazanit kur fshihet edhe "nata e kadrit". Në lidhje me këtë kuptim të kësaj fjale (shtrëngim, ngushtim) El-Halil Ibën Ahmed, një dijetar i njohur, ka thënë: "Është quajtur "Nata e Kadrit", pasi bota shtrëngohet nga numri i madh i engjëjve që zbresin në këtë natë".
- Gjithashtu "kadr" ka kuptimin edhe "paracaktim", se në këtë natë paracaktohet se çfarë do të ndodhë për një vit (siç do ta shohim më poshtë).

Këtu kemi përmbledhur vetëm disa prej kuptimeve që përmban ky emër, kuptime që në tërësi shprehin vlerat e saj.

3.4.3. Ç'është Nata e Kadrit?

Allahu i Madhëruar thotë në suren "El Kadr":
1. Ne e kemi zbritur (Kuranin) në Natën e Kadrit.

2. E kush mund të ta shpjegojë ty se ç'është nata e Kadrit?

3. Nata e Kadrit është më e mirë se njëmijë muaj.

4. Engjëjt dhe Shpirti (Xhebraili), me lejen e Zotit të tyre, zbresin në këtë natë, me të gjitha vendimet.

5. Paqe është ajo deri në lindjen e agimit.[63]

Pra, sipas ajeteve kuranore të cituara më sipër, Nata e Kadrit është nata më e vlefshme dhe më e rëndësishme, sepse në atë natë ndodhi zbritja e Kuranit, drita nga Allahu për të zhdukur errësirën e mosbesimit dhe për të vendosur në vend dinjitetin njerëzor që ishte nëpërkëmbur. Kur'ani i tregoi njeriut se cili është ai në të vërtetë, e largoi njeriun nga adhurimi dhe përgjërimi ndaj çdo gjëje drejt adhurimit të Atij që e meriton këtë adhurim, ndaj Zotit, Krijuesit të tij. Kur'ani i rivendosi edhe një herë lidhjet mes Krijuesit dhe njerëzve, të cilët e kishin harruar Zotin e tyre. Kur'ani i tregoi njeriut se është i lirë dhe jo skllav i tekave njerëzore me pushtet dhe se ai i lutet dhe i mbështetet vetëm Zotit. Njerëzit e festojnë ditën kur çlirohen nga ndonjë pushtues i jashtëm, por të mos harrojmë se Kur'ani e çliroi njeriun nga "pushtuesi" i brendshëm që është egoja e tij dhe prirja e tij për vepra të ndaluara e të shëmtuara. E pra, a nuk e meriton kjo natë, nata e zbritjes së Kur'anit, që të jetë festë për mbarë njerëzimin?

Allahu në këtë natë e zbriti Kur'anin Famëlartë nga Leuhi Mahfudhi (pllaka e ruajtur mirë tek i madhi Zot) për në Bejtul Izeh, që është në qiellin e dynjasë. Kur'ani më pas iu zbrit Muhamedit a.s. përreth 23 vjet me radhë, sipas nevojave që dilnin. Për këtë shkak Nata e Kadrit paraqet ngjarjen më të rëndësishme dhe më madhështore në historinë e njerëzimit dhe si e tillë e ndryshoi rrjedhën e saj, sepse shpallja e Kur'anit në këtë natë madhështore lidhi qiellin me tokën, njeriun me Krijuesin e vet. Kur'ani hyri në historinë njerëzore ku nuk mbeti vetëm objekt pa përmbajtje dhe kuptim, por përkundrazi i dha zgjidhje njerëzisë dhe u bë fjalë e gjallë dhe ligj i jetës, sipas të cilit zhvillohej jeta.

Nata e Kadrit veç rëndësisë së madhe si ngjarje historike, në të njëjtën kohë paraqet natën mjaft të dobishme për çdo person që dëshiron t'i kthehet Allahut dhe ta pastrojë shpirtin e tij.

Kuptohet se vlera dhe dobia e kësaj nate është për atë që di ta shfrytëzojë. Kjo natë"është më e vlefshme se një mijë muaj", siç thotë Zoti në Kur'an. Nëse do ta marrim në konsideratë faktin se gjeneratat e mëparshme kanë qenë me jetëgjatësi më të madhe dhe rrjedhimisht e kanë adhuruar Zotin më shumë dhe kanë fituar më shumë shpërblim, në këtë thënie del në pah drejtësia e Zotit për t'u dhënë njerëzve mundësi të barabarta për të adhuruar Krijuesin e tyre. Në këtë natë zbresin engjëjt, në qiellin e dynjasë, në tokë rreth njerëzve, ashtu siç zbresin edhe kur njerëzit grumbullohen për të marrë dije të dobishme dhe për të lexuar Kur'anin.

Kjo natë karakterizohet nga një qartësi admiruese, njerëzit janë më të qetë dhe më të prirur për punë të mira.

Ç'ndodh në këtë natë?

- Në këtë natë vendoset fati i të gjitha krijesave për vitin e ardhshëm.
- Në këtë natë shkruhet se kush do të jetojë dhe kush do të vdesë.
- Shkruhet se kush do të nderohet e kush do të mallkohet.

---

63. Kur'an, El-Kadr: 1-5.

- Shkruhet se kush do të përcaktohet për në xhenet e kush do të përcaktohet për në xhehenem.
- Shkruhet se ku do të paraqitet thatësira dhe uria.
- Shkruhet se kush do ta kryejë haxhin atë vit dhe kush jo.
- Në këtë natë përcaktohen rrizqet.
- Çështjet e atij viti dërgohen nga Leuhi Mahfudh për tek engjëjt të cilët shënojnë urdhrat.

3.4.4. Disa Hadithe që flasin për vlerën e Natës së Kadrit:

- "Kush e kalon në namaz Natën e Kadrit me besim te premtimi i Allahut dhe shpresë tek Ai (për shpërblimin), i falen mëkatet që ka bërë më parë" (e trasmeton Buhariu).
- "Kërkojeni Natën e Kadrit në netët e dhjetë ditëve të fundit të ramazanit."[64]
- Në librin me hadithe të Buhariut përmendet se Ubadeh Ibën Samit ka thënë se i Dërguari a.s. doli të na tregonte se kur është Nata e Kadrit e në atë moment dy prej myslimanëve po grindeshin. Ai tha: "Dola t'ju tregoj se kur është Nata e Kadrit, ndërsa filani me filanin grindeshin, prandaj ajo (dija se kur është fiks) u mor prej meje. Ndoshta kjo është më mirë për ju. Prandaj kërkojeni në të nëntin, të shtatin dhe të pestin."[65] (në netët me numra tek pra 21, 23, 25, 27, 29 e ramazanit).
- Nata e Kadrit është më e mundshme të jetë në shtatë ditët e fundit. Ibën Umer (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) tregon se njëri prej shokëve të të Dërguarit a.s. ka parë natën e Kadrit në ëndërr dhe se ajo ka qenë njëra prej shtatë netëve të fundit. I dërguari i Allahut tha: "Si duket ëndrra jote është në përputhje të plotë me faktin se ajo është në njërën prej shtatë netëve të fundit, ndaj kush dëshiron ta kërkojë, le ta kërkojë në shtatë netët e fundit"[66].
- Allahu e ka fshehur këtë natë që robërit e Tij ta kërkojnë e të përpiqen në adhurimin e tyre. Për sa u përket thënieve se mund të jetë në natën e njëzetë e një, apo në natën e njëzetë e tre, në të njëzetepestën apo njëzeteshtatën, kjo nuk është aspak në kundërshtim me atë që thamë, se një herë mund të ketë qenë më njëzetenjë, më njëzetetre, e kështu me radhë, pra e sigurt është se gjendet brenda netëve të dhjetë ditëshit të fundit. Thelbësore është që besimtari të përpiqet të bëjë sa më shumë adhurim me këmbëngulje gjatë netëve të këtyre dhjetë ditëve të fundit.

Myslimanët e parë ia dinin mirë vlerën kësaj nate prandaj edhe pyesnin të dërguarin e Zotit, Muhamedin a.s. se si duhet ta kalonin atë.

Aishja, bashkëshortja e Muhamedit a.s., ka thënë: "O i dërguari i Allahut, nëse e përjetoj Natën e Kadrit, çfarë duaje të them? Ai tha: "Thuaj Allahume ineke afu-un Kerimun tuhibul afue fe' afu anni" (Zoti im, Ti je falës, bujar e do faljen, ndaj më fal mua)[67].

Pra, kërkohet që këto dhjetë net të mbetura prej ramazanit, t'i shfrytëzojmë me lutje, me kërkim faljeje për gjynahet tona, duke dhënë lëmoshë sa më shumë për ata persona që e meritojnë, duke lexuar Kur'anin, duke falur namaz dhe çdo gjë tjetër të mirë.

---

64. Buhariu, 4/259.
65. Buhariu, 1919.
66. Buhariu, 1911 dhe Muslimi, 1165.
67. Tirmidhiu, 3515.

4. Dhënia e Zekatit

Kur myslimani i kryen detyrat e tij ndaj Allahut, nuk duhet të harrojë se Ai ka urdhëruar edhe kujdesin ndaj myslimanëve të tjerë, të cilëve u nevojitet ndihmë. Islami kërkon nga ne që ta bëjmë ndarjen e paraparë të të mirave materiale, që Allahu na ka dhënë për t'u shërbyer. Kjo detyrë e jona shihet në zekatin. Me të, të pasurit ndihmojnë të varfrit dhe nevojtarët.

Ç'është zekati?

Vetë fjala *zekat* do të thotë "pastrim, pastërti, larje". Kjo fjalë do të thotë gjithashtu edhe "shtim, zmadhim".

Në bazë të domethënies së parë të saj, zekati do të nënkuptonte "pastrim nga mëkatet". Me të njeriu pastrohet dhe çlirohet nga shumë vese të shëmtuara e në radhë të parë nga rendja pas të mirave materiale të kësaj bote dhe grumbullimi i tyre. Zekati i largon dhe i mposht epshet, egoizmin dhe shumë dukuri të tjera të liga që janë të dënuara me fe. Me zekatin njeriu dëshmon dhe pranon që vullneti dhe kënaqësia e Zotit janë më me rëndësi për të se interesat e tij pesonale, para së gjithash ato materiale dhe se pasuria për të është vetëm një mjet me të cilën do të meritojë mëshirën, dashamirësinë dhe shpërblimin e Zotit në të dy botët.

Zekati ka rol shprehimisht edukues. Ai largon nga shpirti i njeriut kryeneçësinë që rrjedh kryesisht nga mirëqenia dhe pasuria materiale. Fjala "pastrim" do të thotë po ashtu edhe pastrim i pasurisë nga e drejta (hak) e huaj.

Fjala zekat do të thotë edhe "shtim". Në të vërtetë pasuria e myslimanit që ndan zekat shtohet me anë të bereqetit, mirtësisë së Zotit.

Kuptimet e përmendura të zekatit rrjedhin nga hadithi kudsij ku thuhet: "Zoti xh.sh. e ka urdhëruar zekatin vetëm për të zbukuruar tepricën nga pasuria juaj".

Pasuri e mirë për besimtarin e vërtetë është mirësia e Zotit, siç thotë Muhamedi a.s.: "Sa e mrekullueshme është pasuria në duart e njeriut të mirë".

Për zekatin, Allahu xh.sh. flet në Kur'an në shumë vende:

"Ata që shpenzojnë pasurinë e vet, për të kërkuar kënaqësinë e Allahut dhe që e forcojnë veten me punë të mira, shëmbëllejnë me një kopsht të mbjellë në rrafshnaltë, në të cilin bie shi i bollshëm, andaj jep fruta dyfish. Nëse nuk i bie shi i bollshëm, i bie shi i imët që i mjafton."[68]

"Ata që shpenzojnë pasurinë e vet në rrugë të Allahut, i shëmbëllejnë atij që mbjell një kokërr nga e cila dalin shtatë kallinj, ku secili kalli ka nga njëqind kokrra. Allahu ia shton (shpërblimin) edhe më tepër kujt të dëshirojë; Allahu është Mirëbërës i madh dhe i Gjithëdijshëm."[69]

"O besimtarë. Jepni pa u kursyer nga të mirat që keni fituar dhe nga ato që jua kemi nxjerrë Ne nga frytet e tokës. Mos dhuroni nga ato gjëra të pavlefshme të pasurisë suaj e të cilat ju nuk do t'i pranonit ndryshe veçse symbyllur."[70]

---

[68]. Kur'an, El-Bekare: 265.
[69]. Kur'an, El-Bekare: 261.
[70]. Kur'an, El-Bekare: 267.

4.1. Shpërblimi dhe dhënia llogari në lidhje me detyrën e zekatit

Allahu i Madhërishëm premton shpërblime të bollshme për ata që japin zekatin në emër të Tij dhe në mënyrën e përcaktuar. Ata do të jenë të lumtur në këtë botë, ndërsa në botën tjetër do të kënaqen me mëshirën e të Madhërishmit dhe do të kenë çfarëdo që të dëshirojnë dhe madje edhe më shumë se aq: "ndërsa mëshira Ime përfshin çdo gjë. Atë do t'ua jap atyre që ruhen nga gjynahet e japin zekatin"[71].

"Ata që besojnë dhe kryejnë vepra të mira, falin namazin dhe japin zekatin, do të kenë shpërblim te Zoti i tyre dhe nuk do të kenë pse të frikësohen apo pikëllohen"[72].

Për moskryerje të detyrimit të zekatit, të detyruarit do të japin llogari. Sikurse shpërblimi edhe dënimi mund të jetë i kësaj bote dhe i botës tjetër dënimet e kësaj bote shihen në pakënaqësinë e njeriut pavarësisht se sa pasuri zotëron. Atë e brejnë egoizmi dhe koprracia dhe shpesh i ndodhin edhe humbje të pasurisë.

"Ja, juve ju bëhet thirrje të shpenzoni në rrugën e Allahut, por disa prej jush janë koprracë. Kush tregohet koprrac, ta dijë se i bën dëm vetes, sepse Allahu është i Pasur (s'ka nevojë për asgjë), ndërsa ju jeni të varfër."[73]

Për të kuptuar këtë ajet mjafton të jepen shembuj nga historia. Kurdo që njerëzit i janë përmbajtur rrugës së Allahut, kanë arritur sukses e kurdo që i kanë kthyer shpinën, kanë vuajtur e janë shkatërruar. Sa për mësim mund të na shërbejnë shembujt nga koha e kalifit Omer bin Abdulazizit, kur myslimanët jetonin duke respektuar rregullat islame dhe arritën zhvillim të atillë ekonomik saqë askush nuk kishte nevojë për t'i dhënë zekatin. Në Spanjë, derisa aty sundonin myslimanët, tellalli udhëtonte dyzet ditë duke ofruar zekatin e dhënësit të tij, por nuk mund të gjente njeri të varfër që do ta pranonte atë. Nëse gjente ndonjë të varfër që do t'ia pranonte zekatin, tellalli shpërblehej në mënyrë të veçantë nga pronari i zekatit.

Kur'ani e përshkruan qartë vuajtjen e koprracit në botën tjetër. Lidhur me këtë, në Kur'an thuhet: "Ata që grumbullojnë ar dhe argjend dhe nuk e shpenzojnë për hir të Allahut, paralajmëroji me dënim të dhembshëm"[74].

Edhe Muhamedi a.s. e ka vërtetuar vuajtjen e atyre që nuk kanë dhënë zekatin nga pasuria e tyre duke u shprehur:

"Kush fal namaz e nuk ndan zekatin, ai nuk ka namaz!"

"Allahu xh.sh. nuk do ta pranojë as imanin as namazin pa zekat!"

"Mjerë pasanikët për shkak të të varfërve."

---

71. Kur'an, El-A'raf: 156.
72. Kur'an, El-Bekare: 277.
73. Kur'an, Muhamed: 38.
74. Kur'an, Et-Teube: 34.

4.2. Dispozitat e legjislacionit islam për zekatin

Zekati përcaktohet si detyrë rigoroze islame e myslimanëve më të pasur, që pa kompensim, t'u ndajnë myslimanëve të varfër një pjesë të caktuar nga pasuria e tyre që arrin ose tejkalon një sasi të caktuar (nisab) dhe që kalon një vit e nuk shfrytëzohet për nevojat personale.

Duke u mbështetur mbi këtë përcaktim, mund të nxjerrim këto përfundime:

- Zekati është një detyrë fetare e myslimanëve më të pasur e përcaktuar me përpikëri;
- Zekati jepet në emër të Zotit dhe me nijet (qëllim) të sinqertë;
- Zekati duhet ndarë fi sebilil-lah (në rrugën e Allahut) varfanjakëve myslimanë për zhvillimin e arsimit islam dhe për qëllime të tjera siç parashikon Kur'ani;
- Zekati përfshin edhe pasuri të caktuar që shtohet ose që është dedikuar për këtë dhe që e kalon një vit (në këtë rast merret si kriter viti hënor).
- Zekati ndahet nga teprica e pasurisë e i nënshtrohet zekatit, jashtë nevojave vjetore personale apo familjare, në qoftë se ajo tepricë arrin sasinë më të vogël të përcaktuar.

4.3. Qëllimi dhe kujt i takon zekati

Qëllimi (nijeti)

Sikurse për çdo ibadet, dhe për zukatin nevojitet nijeti (qëllimi), që sasia e caktuar nga pasuria të ndahet në emër të Zotit. Sikur dikush të ndajë një sasi të caktuar të pasurisë pa e konsideruar atë si zekat, ndarja e tillë do të konsiderohej lëmoshë e thjeshtë e jo zekat.

Kujt i takon zekati?

Në Kur'an janë përcaktuar kategoritë për të cilat jepet zekati.

Zekati u takon vetëm të varfërve dhe të ngratëve, atyre që e tubojnë, atyre që u duhen fituar zemrat dhe duhet dhënë edhe për lirim nga robëria, të mbyturve në borxhe dhe për qëllime në rrugën e Allahut dhe atij që ka mbetur në rrugë. Allahu e ka përcaktuar qartë këtë në Kur'an: "Vërtet, Allahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë"[75].

Siç e shohim nga ky ajet, kategoritë të cilave u takon zekati janë:

1. El-Fukara: Këta janë myslimanët e varfër në përgjithësi. Kjo kategori edhe mund të ketë diçka pasuri, por jo mjaftueshëm për të jetuar normalisht. Në këtë grup nevojtarësh bëjnë pjesë ata që nuk kanë asgjë apo që kanë, por më pak se nisabi.

2. El-Mesakin: Kjo është kategori e të mjerëve që nuk kanë asnjë lloj pasuri edhe që janë të detyruar të lypin.

3. El-'Amilin: Këta janë nëpunësit që janë marrë vetëm me mbledhjen (pagimin) e zekatit, për çka nuk kanë mundur të merreshin me ndonjë veprimtari tjetër për mbajtjen e vetvetes.

[75]. Kuran, Et-Teube: 60.

4. El-Muel-lefetu-l-kulub: Këta janë personat që me kalimin në Islam kanë humbur pasurinë e tyre. Kësaj kategorie u nevojitet mbështetje materiale në mënyrë që kjo humbje e tillë të mos i detyrojë të kthehen prapa.

5. Er-Rikab: Këta janë personat që kanë pasur statusin e robërve. Pa pasur parasysh se në atë kohë ka mbisunduar sistemi skllavopronar, Kur'ani thekson qartë se zekati u duhet dhënë edhe robërve me qëllim që ata të mund të shpaguajnë veten dhe të bëhen njerëz të lirë.

6. El-Garimin: Këta janë personat e mbytur në borxhe dhe nuk mund të çlirohen lehtë nga borxhi nëse nuk u jepet ndihmë.

7. Fi sebilil-lahi: Luftëtarët në rrugën e Zotit, janë personat që me armë, fjalë dhe penë luftojnë për fenë, atdheun, nderin dhe shtetin e myslimanëve.

4.4. Renditja e dhënies së zekatit

Zekati u duhet ndarë personave që u përkasin kategorive të sipërpërmendura duke filluar nga më i afërmi për nga farefisi deri te më të largëtit, përveç që dhënësi i zekatit është i detyruar t'i mbajë.

Duke i analizuar dispozitat te ndarja e zekatit juristët myslimanë përcaktojnë shkallën e farefisnisë dhe kanë vendosur rendin vijues: vëllezërit, motrat, fëmijët e tyre, pastaj farefisi anësor e më tej komshinjtë. Më tej zekati duhet të shpërndahet në vendin ku jetojmë. Ndarja e zekatit në ndonjë vend tjetër rekomandohet, por nëse atje jeton ndonjë farefis i varfër i dhënësit të zekatit.

4.5. Kujt nuk i takon zekati

Zekati nuk mund t'i jepet:

1. Jomyslimanit;
2. Atij që ka mjaft pasuri për t'u mbajtur;
3. Bashkëshortit/bashkëshortes;
4. Babait, gjyshit, nënës, gjyshes, (brezi përpjetë) dhe as fëmijëve dhe nipërve (brezi poshtë);
5. Personit mendërisht të çrregullt e as të marrit që nuk e kuptojnë dhënien e zekatit (kujdestarët e tyre mund ta pranojnë zekatin për ta dhe në emër të tyre);
6. Borxhmarrësit tonë me qëllim të larjes së borxhit;
7. Qiramarrësit të varfër nuk mund t'i hiqet nga zekati qiraja (kësaj kategorie duhet t'i jepet zekati në dorë dhe pastaj t'i kërkohet qiraja);
8. Nuk mund të ushqehet i varfri dhe pastaj ky ushqim t'i hiqet nga zekati, por ky ushqim mund t'i llogaritet në zekat pasi t'i jepet në dorë;
9. Meqenëse është rregull që zekati t'i dorëzohet drejtpërdrejt në dorë personit që i takon sipas përcaktimeve të Kur'anit, nuk mund t'u jepet institucioneve bamirëse të cilat nuk dihet si mund ta përdorin.

4.6. Përqindja dhe lloji i pasurisë që i nënshtrohet zekatit

Thamë tashmë se Kur'ani nuk e përcakton prerazi se cila pjesë dhe nga cili lloj i pasurisë duhet ndarë për zekat. Për këtë Kur'ani thotë: "Të pyesin se çfarë duhet të japin si lëmoshë. Thuaju: "Tepricën!""[76].

Interpretimin më të saktë të këtij ajeti e ka dhënë Muhamedi a.s. kur thotë: "Jepni çerekun nga një e dhjeta e pasurisë suaj".

Muhamedi a.s. e ka përcaktuar përqindjen kaq të ulët duke pasur parasysh disa arsye:

E para: është e pranueshme për të pasurit;

E dyta: mjafton si mjet plotësues për mbajtjen e personave të varfër dhe të paaftë për punë, si dhe të personave që janë të varfër, por të aftë për të punuar.

E treta: sikur të pasurit të duhej ta ndanin tërë tepricën, atëherë edhe shumë të varfër, madje edhe ata të aftë për punë, do ta linin punën dhe fitimin e ndershëm që, sipas parimeve fetare, konsiderohet si ibadet i veçantë dhe do t'i dorëzoheshin dembelisë dhe ngathtësisë, ndërsa më të shkathëtit do të mbartnin tërë barrën për mbajtjen e dembelëve.

Muhamedi a.s. e ndante gjithmonë atë që i tejkalonte nevojat familjare. Për më tepër ai, edhe nevojat e veta familjare, i reduktoi deri në masën më modeste dhe do të mund të thuhej se edhe vetë jetonte në modesti.

4.7. Ç'është Nisabi?

Nisabi shënon sasinë e pasurisë që mbetet pas nevojave vjetore, personale apo familjare, për të cilën myslimani është i detyruar të japë zekat. Nisabi është, në të vërtetë, vlera e sasisë së caktuar të arit ose argjendit. Duke pasur parasysh pasurinë, nisabi përcaktohet sipas: peshës, vlerës dhe numrit.

- Për ar dhe argjend nisabi përcaktohet sipas peshës;
- Për para, letra me vlerë dhe mall tregtar, nisabi përcaktohet sipas vlerës;
- Për bagëtinë, nisabi përcaktohet sipas numrit të krerëve dhe llojit të bagëtisë.

4.8. Objekti i zekatit

Thamë që si objekt i zekatit konsiderohet ajo pasuri që kalon vitin, respektivisht që gjendet në duart e pronarit një vit e që gjatë kësaj kohe nuk përdoret për nevojat personale apo familjare. Këtu duhet mbajtur parasysh që ari dhe argjendi i nënshtrohen zekatit pavarësisht nga dedikimi i tyre, vetëm në qoftë se posedohet sasia e përcaktuar me shariat-nisabi.

Pra objekt i zekatit është:

- Ari, argjendi, paratë dhe letrat me vlerë (aksionet, çeqet e të ngjashme me to);
- Mall tregtar;
- Lloj i caktuar i kafshëve shtëpiake;

[76]. Kur'an, El-Bekare: 219.

- Kërkesat, respektivisht mjete që ia kemi dhënë dikujt hua.

Sipas mënyrës së përllogaritjes së nisabit dhe sasisë apo vlerës që duhet dhënë si zekat, pasuria ndahet në dy grupe:

Në grupin e parë bëjnë pjesë paratë e gatshme, ari, argjendi, dhe gjërat e çmuara: stolitë, enët prej ari dhe argjendi ose përzierje të tyre, si dhe malli tregtar dhe kërkesat.

Në grupin e dytë bën pjesë: bagëtia e madhe dhe e imët, prodhimet bujqësore, frutat dhe mineralet.

4.9. Ari dhe argjendi

Për arin dhe argjendin përllogaritja bëhet me matjen e peshës së tyre. Masa ose pesha nismëtare për arin arrin 20 mithkalë, që i përgjigjet peshës prej 91.6 gram. Ky është nisabi për arin. Për këtë sasi jepet gjysmë mithkali që paraqet 1/40 (një të dyzetën) ose 2,5 %. Më tutje për çdo katër mithkalë të tjerë jepen edhe nga dy karate (nëntë gram e gjysmë) peshë respektivisht vlera përkatëse në para.

Sasia (pesha) nismëtare e nisabit për argjend është 651.5 gram. Për këtë sasi jepen 5 dramë ose 16 gram, që po ashtu përfaqëson pjesën e dyzet (2.5 %). Në 240 gram jepet edhe nga një dram më shumë, respektivisht dramë ose 19.20 gramë. Kështu në çdo 40 dramë ose 128 gramë më tepër jepet edhe nga një dram ose 3.2 gramë argjend.

4.10. Stolitë

Gjërat prej ari dhe argjendi: stolitë, enët e ngjashme, konsiderohen ar dhe argjend dhe me matje përcaktohet nisabi sipas shkallës së mësipërme, pra sipas peshës së metalit specifik në to. Nëse secila nga këto sende përdoret si mall tregtar, atëherë do të llogaritet vlera e tij dhe do të jepet 2.5% nga kjo vlerë. Nëse këto sende përmbajnë vetëm pjesërisht ar dhe argjend, atëherë, pas përcaktimit të vlerës së tyre, si zekat do të jepet 2.5% dhe kjo vetëm nëse përdoren si mall tregtar. Nëse këto janë sende amvisërie dhe nëse përmbajnë më pak se një nisab ari ose argjendi, atëherë nuk jepet zekat për to. Nëse në këto sende përmbajtja e arit ose argjendit arrin në një nisab dhe nëse këto sende nuk përdoren për amvisëri, zekati duhet dhënë. Është me rëndësi të përmendet që në raste të tilla bëhet matja ndaras e arit dhe argjendit dhe nisabet nuk bashkohen.

4.11. Malli tregtar

Nëse tregtari posedon në fillim dhe në fund të vitit hënor aq mall tregtar sa është nisabi i argjendit, pavarësisht nga lloji i tij dhe atë pas heqjes së borxheve të mundshme, është i detyruar të japë zekat. Sipas llogaritjes së vlerës, për zekat ndahen 2.5%. Nëse, nga ana tjetër, dikush posedon mall shtrirës (përveç arit dhe argjendit) si tepricë jashtë nevojave shtëpiake, por që ai mall nuk i kushtohet tregtisë dhe as shtimit të pasurisë, atëherë nuk është i detyruar që nga ai të ndajë për zekat.

4.12. Kërkesat

Zekati për kërkesat përfshin para, ar, argjend, mjete të kushtuara për tregti si dhe gjëra të ndryshme të çmuara.

Dijetari islam Ebu Hanife konsideron që detyrimi i dhënies së zekatit për kërkesat shfaqet në tre raste:

-për kërkesat tregtare, kur realizohet 1/5 (një e pesta) e nisabit;

-për kërkesat jo tregtare, kur paguhet (realizohet) i tërë nisabi;

-nëse kërkesat nuk dalin nga raportet tregtare dhe kontraktuese, por nga vetë ligji (si trashëgimi, amanet, mehr, aira etj.) duhet që i tërë borxhi të paguhet me kusht që të kalojë një vit nga skadimi i borxhit (e drejta për realizim, pagesë).

Këtu më në fund duhet të përmendet se zekati mund të jepet në natyrë ose në para ose një pjesë në njërën dhe pjesa tjetër në tjetrën.

4.13. Zekati për bagëtinë

Që dikush të jetë i detyruar të japë zekat për gjedhët duhet të ketë të paktën 30 krerë. Masa e zekatit për gjedhët është:

- Për pasurinë deri në 30 krerë jepet një gjedh 2-vjeçar si zekat;
- Për pasurinë 30-49 krerë jepet një gjedh 3-vjeçar si zekat.

Për kuajt nuk jepet zekat meqenëse shërbejnë për qëllime luftarake, bujqësi, transport etj.

Bagëtitë e imta. Me bagëti të imëta kuptohen dhitë dhe dhentë. Nëse posedohen 40-120 krerë, jepet si zekat një dele ose dhi; prej 121 deri 200 krerë jepet zekat dy dele ose dhi; për çdo njëqind të tjera shtohet edhe nga një bagëti si zekat.

4.14. Prodhimet bujqësore

Nga prodhimet e tokës bujqësore që ujitet nga shiu jepet zekat 10% e prodhimit, ndërsa për tokat bujqësore që vaditen me mjete teknike për të cilat pronari ka bërë shpenzime, masa e zekatit është 5% e prodhimit. Për prodhimet bujqësore zekati jepet ditën e korrjes. Sasia fillestare është pesë barrë anije, e barabartë me 600 kg.

4.15. Sadakatu-l-Fitri

Detyrë e çdo myslimani dhe myslimaneje të pasur është të japë sadekatu-l-fitr për vete dhe për fëmijët e vet të mitur.

Te ne është zakon që kjo sadaka të jepet me para myslimanëve të varfër. Jepet nga fundi i ramazanit, por para namazit të bajramit. Kësisoj u mundësohet edhe familjeve të varfra myslimane të përgatiten për të festuar bajramin. Nëse kemi kushërinj të varfër, duhet që në radhë të parë t'ua japim atyre sadakanë. Kjo sadaka nuk mund t'i jepet farefisit sipas vijës përpjetë-tëposhtë, domethënë prindërve dhe as prindërve të tyre, fëmijëve dhe as nipërve.

Për vlerën e sadekatu-l-fitrit mund të vendosë çdo njeri sipas mundësisë pasurore. Ajo është me vlerën e ushqimit një ditor për person. Në këtë drejtim nga ana e autoriteteve fetare jepet

informacion në kohën e duhur lidhur me kategoritë e sadekatu-l-fitrit. Në rast se këtë sadaka e japim pas namazit të bajramit, atëherë ajo nuk është sadekatu-l-fitr, por sadaka e zakonshme.

Kjo dhënie e detyrueshme është pranuar me shumë zemërgjerësi nga masa e popullit tonë, saqë ka edhe emër të veçantë "fitre".

Fitret jepen gjatë dhjetë ditëve të fundit të ramazanit. Zakonisht bëhet kujdes që kjo të jepet më herët në mënyrë që personit që i jepet, të ketë mundësi të marrë masa për të festuar ditën e bajramit.

Në disa vende sadekatu-l- fitri u jepet vashave të varfra, ndërsa në vende të tjera u jepet nënave vetëmbajtëse.

Myslimanët në viset tona, si duket, e kanë marrë shumë seriozisht këtë detyrim dhe kurrë nuk e kanë ngatërruar atë me lëmoshën. Gati çdo mysliman është i ndërgjegjshëm se ajo është e drejta e tyre që Allahu xh.sh. i ka bërë sprovë për myslimanët e tjerë.

Myslimanët që ndihmohen me dhënien e fitreve e pranojnë atë në mënyrë të natyrshme, të ndërgjegjshëm për të drejtën e tyre dhe i janë falënderues Allahut xh.sh.

"Nëse i pasuri e shtyn dhënien e asaj që është i detyruar të japë, kjo konsiderohet dhunë. Kur dikujt nga ju i sugjerohet t'i drejtohet të pasurit, le ta pranojë"(hadith).

5. Kryerja e haxhit një herë në jetë

Të kryerit e Haxhit një herë në jetë e ka detyrë - farz çdo mysliman e myslimane që është i saktë mendërisht, ia lejojnë mundësitë financiare dhe ka mbërritur në moshën e pjekurisë. Çdo njeri që merr udhëtimin për në Mekë (Qabe) e ka për detyrë - farz që të kryejë:

1. Të veshurit e ihramit duke u zhveshur tërësisht nga veshjet e tij;
2. Të qëndrojë në Arafat ditën e nëntë të Dhul Hixhes;
3. Të realizojë Tavafin-vizitën, që do të thotë të bëjë rrotullimin rreth Qabesë në ditën e kurban bajramit.

Haxhi konsiderohet kongres i madh islam që i përkushtohet thirrjes së Zotit të Lartësuar. Të gjithë myslimanët nga të katër anët e rruzullit tokësor bashkohen pranë shtëpisë së shenjtë si vëllezër të një nëne e babai dhe bashkëbisedojnë me njëri-tjetrin të përmalluar duke u ofruar ndihmën individëve që kanë nevojë. Të gjithë janë të barabartë dhe nuk dallohet pushtetari nga punëtori, sepse veshja është e njëjtë për të gjithë dhe para Zotit të gjithë janë të barabartë. Qëllimi për të cilin kanë ardhur është i njëjtë, përkushtim ndaj thirrjes së Zotit të Lartësuar për të arritur kënaqësinë e Tij.

Çdo mysliman e myslimane për të kryer vizitën në Qabe duhet paraprakisht të kenë plotësuar nevojat materiale për familjen, të mos u mungojë asgjë në ushqim familjarëve të tyre. Jo vetëm kaq, por duhet edhe të përshëndeten me të afërmit e farefisin dhe të mos u mbetet as detyrimi më i vogël ndaj tyre. Atëherë udhëtimi bëhet i qetë dhe me një objektiv të qartë, përkushtimi ndaj Zotit të Lartësuar, kërkesa për falje e mëshirë, në lutje të përvuajtur ndaj Tij.

Një detyrim tjetër gjatë pelegrinazhit në Mekë, është edhe therja e kurbanit. Kurbani është akt fetar që kryhet duke prerë një kafshë të caktuar në emër të Allahut të Madhërishëm. Me këtë akt myslimani tregon devotshmërinë dhe besnikërinë e H. Ibrahimit dhe të birit të tij, H. Ismailit. Kjo është simbolika më e madhe për myslimanin, për të treguar se sa i gatshëm është për të qenë besnik e i sinqertë ndaj fesë islame dhe i gatshëm për të shpenzuar apo flijuar nga pasuria për dëshirën e Zotit të Lartësuar.

Kurbani nuk është detyrë vetëm për ata që shkojnë në Qabe, por për të gjithë myslimanët e myslimanet që kanë mundësi financiare e pasurore, si në rastin e zekatit.

Për kurban zgjidhet kafsha më e mirë si dele, dhi, dash, cjap, ose kafshë të trasha si gjedhët që ndahen për shtatë persona, me kusht që secili ta bëjë nijet pjesën e tij për kurban.

Kurbani theret ditën e parë të Bajramit, pas faljes së namazit të Bajramit. Por mund të theret edhe ditën e dytë e të tretë, deri në namazin e ikindisë.

Mishi i kurbanit ndahet në tre pjesë: një pjesë u shpërndahet të varfërve si sadaka; një pjesë u dërgohet si dhuratë miqve; pjesa e tretë përdoret për nevojat familjare.

Myslimanët që shkojnë në Haxh, pa dallim gjinor, duhet ta konsiderojnë veten si të larguar nga problemet e kësaj bote dhe tërësisht të përqendruar te Zoti i Madhërishëm. Qabeja është Shtëpia e Zotit dhe këtu bëhet takimi me Zotin. Kur e kryen Haxhin dhe kthehet pranë familjes, besimtari mysliman ka rilindur. Për këtë arsye ata që kanë kryer Haxhin, marrin emrin "Haxhi" dhe janë njerëzit më të respektuar në shoqëri. Ata shihen si njerëz model, besimtarë të devotshëm, që kanë marrë përsipër përgjegjësinë për të ruajtur të pastër titullin e Haxhiut.

5.1. Domethënia e Haxhit

Në Mekë të Arabisë Saudite gjendet faltorja e parë e shenjtë që njihet me emrin "Qabe". Ajo është ngritur nga dy profetët e mëdhenj, atë e bir, H. Ibrahimi dhe H. Ismaili, që çrrënjosën besimin pagan dhe konfirmuan besimin monoteist, besimin në Një Zot të vetëm. Të dy këta profetë konfirmohen në Shpalljen Hyjnore, Kur'anin Famëlartë. Në Kur'an thuhet: "Unë e kthej fytyrën time nga Ai që i ka krijuar qiejt dhe Tokën, duke qenë besimtar i vërtetë, dhe nuk jam nga idhujtarët"! Dhe, kur populli i tij polemizoi me të, ai tha: "Doni të polemizoni me mua për Allahun, ndërkohë që Ai më ka udhëzuar në rrugën e drejtë?!""[77] Ndërsa për Hz. Ismailin në Kur'an thuhet: "Kur Ibrahimi dhe Ismaili ngritën themelet e Qabes, u lutën: "O Zoti ynë! Pranoje prej nesh (këtë vepër)! Me të vërtetë, Ti je Ai që dëgjon dhe di gjithçka!"[78] Që nga ajo ditë xhamia e shenjtë, Qabeja e lartësuar, kujtohet nga mbarë myslimanët e botës dhe e meriton pasi Zoti i madhërishëm e caktoi si kible (drejtim) i faljes nga myslimanët e botës në xhamitë e vendeve të tyre. Zoti i Madhërishëm në Kur'anin Famëlartë, që i dërgoi profetit Muhamed për t'ia përcjellë njerëzimit, thotë: "Nga cilido vend që të dalësh, ktheje fytyrën nga Xhamia e Shenjtë. Kjo është e vërteta që vjen nga Zoti yt. Allahu nuk është i pakujdesshëm ndaj veprave që ju bëni. Nga cilido vend që të dalësh, ktheje

[77]. Kur'an, El-En'am: 79-80.

[78]. Kur'an, El-Bekare: 127.

fytyrën nga Xhamia e Shenjtë. Kudo që të ndodheni, ktheni fytyrat tuaja nga ajo anë, që njerëzia të mos ketë ç'të thotë kundër jush, përveç keqbërësve"[79].

Zoti i Madhërishëm, vizitën në këtë xhami të shenjtë e bëri obligim për myslimanët një herë në jetën e tyre, kur i plotësojnë kushtet shëndetësore e financiare. Çdo vit mijëra besimtarë nga e gjithë bota bëjnë pelegrinazhin në Qabe dhe nëpërmjet riteve që kryejnë forcojnë akoma më shumë ndjenjat e besimit dhe përkushtimin ndaj Zotit të Lartësuar. Në ballafaqimin e parë me shtëpinë e shenjtë, myslimanët njëzëri thërrasin: Të përgjigjem Ty, o Zot! Të përgjigjem Ty. Nuk ka tjetër veç teje". Për këtë Profeti a.s. thotë: "Kur një pelegrin bën këtë thirrje (telbije) çdo gur, pemë apo guralec në të djathtë të tij, flet bashkë me të".

Ky udhëtim i shenjtë kryhet në muajin Dhul Hixhe dhe është quajtur "Haxh", i cili i grumbullon "haxhinjtë" në luginën e Arafatit në ditën e nëntë të këtij muaji dhe përfundon me rrotullimin rreth Qabesë.

Ritet kryesore që kryen myslimani në Haxh janë: Porsa mbërrin në Mekë bën rrotullimin në formë homazhi, kalon në Arafat, riti i goditjes me gurë dhe lëvizja me hap më të shpejtë në mes të kodrave Safa e Merve.

Në Haxh myslimani përjeton emocione të thella shpirtërore se grumbullohen besimtarë nga të gjitha anët e botës dhe bëjnë kongresin e myslimanëve.
Myslimani haxhi konsiderohet si shembull i përkushtimit ndaj fesë islame dhe ligjeve të saj në familje e shoqëri.

5.2. Vlerat shpirtërore të Haxhit

Pelegrinazhi është njëri nga aktet e adhurimit që Zoti ua ka urdhëruar njerëzve në mënyrë që të arrihet një këndvështrim i plotë mbi çështjen e njeriut dhe jetës së tij. Zoti e bëri pelegrinazhin një detyrim për gjithsecilin që është i aftë ta kryejë atë dhe shpërfilljen e tij e konsideroi një devijim nga rruga e bindjes ndaj Islamit, duke e konsideruar të dalë nga feja personin që e shpërfill këtë detyrim.

Pelegrinazhi është sot një detyrim për robërit e Zotit që nga koha e profetit Ibrahim. Megjithatë, Islami erdhi dhe i vendosi këtij rituali rregulla dhe qëllime të caktuara, duke e pajisur me korniza specifike që do t'i mundësonin Islamit të arrinte rolin e tij madhor në jetë, duke e bërë atë më me ndikim. Islami nuk e kufizoi pelegrinazhin vetëm në një aspekt të edukimit, por i përfshiu brenda tij të gjitha konotacionet e akteve të tjera të adhurimit. Zoti e "urdhëroi" Ibrahimin, duke radhitur një sërë gjërash që duheshin kryer detyrimisht ose që nuk duheshin bërë kurrsesi. Në këtë mënyrë, njeriu do t'i arrinte qëllimet që fshiheshin pas agjërimit në një mënyrë më të ndryshme dhe aktive, e cila nuk krijon uri dhe etje brenda njeriut, por u drejtohet disa aspekteve të tjera të tij, të cilat e disiplinojnë fuqinë brenda tij për ta kthyer atë në gjendje paqeje, disiplinojnë dëshirën për ta kthyer në një gjendje baraspeshe, e disiplinojnë luksin brenda tij për ta kthyer në një ndjesi bamirësie dhe disiplinojnë krenarinë njerëzore për ta kthyer në modesti. Për më tepër, ky ritual e mëson njeriun si të përdorë mendimin, kulturën dhe diturinë e tij në rrugën e të mirës dhe jo të së ligës, duke bërë që dituria të jetë qëllimi i vetëm i mendimeve dhe i fjalëve të tij. Po kështu Zoti ka urdhëruar që njeriu

[79]. Kur'an, El-Bekare: 149-150.

të rrotullohet rreth e përqark Qabesë dhe këtë rrotullim (tavaf) e ka konsideruar një lloj adhurimi, nëpërmjet të cilit njeriu e ndjen atmosferën e përshpirtshmërisë në vendin ku Zoti dëshiroi të ishte Qabeja. Ai e krijoi Qabenë që të ishte simbol i unitetit midis njerëzve, natyrisht në kontekstin e tij shpirtëror që është i ndërlidhur me Zotin dhe jo thjesht si një copë guri.

Me këtë urdhër të rrotullimit rreth Qabesë, Zoti deshi t'u shpallte njerëzve se jeta duhet të kthehej në një formë rrotullimi rreth e përqark vullnetit të Zotit, duke u mbështetur në ndjenjat e pastërtisë, qartësisë, të mirës, bekimit, mëshirës dhe dashurisë, të gjitha të mëshiruara në shtëpinë e Tij të shenjtë. Jeta, pra duhet të jetë një rrugëtim nëpër shtigjet dhe drejt qëllimeve të cilat Zoti i do dhe me të cilat Ai është i kënaqur.

Pastaj kemi detyrimin e "Sa'j-it "(ecjes) ndërmjet kodrave Safa dhe Merve, i cili i mundëson njeriut të ndërgjegjësohet në lidhje me faktin se çdo hap që hedh duhet të jetë për të mirën. Çdo veprim i tij gjatë këtij rituali duhet të jetë drejt asaj që është e mirë dhe larg të ligës,sepse gjatë këtij veprimi njeriu nuk kërkon tjetër veçse ta kryejë atë që ka urdhëruar Zoti, me qëllim afrimin me Të. Kjo na e bën të qartë se"sa'j-i"është njëra nga mënyrat e arritjes së kënaqësisë së Zotit duke e kryer atë që na urdhëron dhe duke qëndruar larg asaj që na ndalon, duhet që ky "sa'j" të zgjatet edhe drejt aspekteve të tjera të jetës, në gjithë dimensionet e saj shoqërore, politike dhe ekonomike, duke i mundësuar njeriut të fitojë kënaqësinë e Zotit në çdo veprim të tij.

Nga ana tjetër, qëndrimi (vukuf) në Arafat, el-Meshar dhe në Mina i dedikohet përsiatjes, vetëllogarisë, vëzhgimit të jetës dhe trajtësimit të saj, në mënyrë që njeriu të mund të ringjallë në jetën e tij principet që mund të humbasin dalëngadalë në përpjekjen që bën ai për ta fituar bukën e gojës ose për t'i përmbushur dëshirat e tij lakmitare, qofshin të lejuara ose të ndaluara… Nën ndikimin e prirjeve vetjake njeriu shpesh humbet shumë nga vlerat e tij dhe përballet me sfida që ngjallin reagime të ashpra tek ai vetë, duke bërë që të shpërfillë gjithçka që beson në jetë. Kjo gjë kërkon një gjendje përsiatjeje dhe vetëllogarie, e cila e udhëzon atë sërish drejt intelektit, besimit dhe rrugës së drejtë.

Përveç kësaj Zoti e ka bërë detyrim kurbanin gjatë pelegrinazhit duke e bërë atë një simbol të sakrificës dhe të dhurimit, duke iu referuar ngjarjes së Ibrahimit dhe Ismailit, të cilët iu nënshtruan Zotit dhe i tejkaluan brenda vetes ndjenjat që një baba ushqen ndaj të birit (në rastin e Ibrahimit) dhe dashurinë që njeri ka për tjetrin (në rastin e Ismailit). Më në fund Zoti ofroi një kurban tjetër në vend të Ismailit, duke e bërë një shembull për njeriun, qoftë edhe në kuptimin e thjeshtë shpirtëror dhe duke e kthyer në praktikë principin që jeta të mbështetet në sakrificë dhe dhurim.

Më pas, gjatë gjuajtjes me gurë të djallit, Zoti simbolizon gjendjen që dëshiron ta shohë në përditshmërinë e njeriut, i cili duhet t'i refuzojë të gjitha prirjet e liga në mendime, ndjenja, fjalë dhe vepra, si dhe në problemet e pronës dhe marrëdhënieve të tij private e shoqërore.

Akti i gjuajtjes me gurë djallit që simbolizon vendosmërinë në luftën kundër të keqes, nuk mund të kufizohet te një veprim i vetëm që kryhet një herë dhe pastaj lihen, por duhet të bëhet praktikë e zakonshme në jetën e përditshme. Pra, pelegrinazhi bashkë me simbolet dhe me atmosferën shpirtërore që krijon, duhet të ketë një rol aktiv në zhvillimin e karakterit njerëzor, në aspektin meditativ, praktik dhe shpirtëror. Me këtë nënkuptojmë se sikur njeriu ta ndërmarrë me vetëdije këtë detyrim, haxhi do të jetë shumë më tepër se një akt adhurimi nëpërmjet të cilit njeriu

arratiset nga realiteti për t'u fshehur në ndjenjat e tij vetjake të një atmosfere paqartësie, siç e përshkruajnë disa njerëz adhurimin.

Në këtë atmosferë të vetëdijshme shpirtërore që lëviz në vijën e përgjegjësisë, njeriu kthehet nga pelegrinazhi si një individ i ri në qëllimet e principet e tij, të cilat i fiton nëpërmjet mësimeve, mesazheve, qëndrimeve dhe përsiatjeve të përjetuara në atë vend ku mëshirohet pastërtia, e mira, dashuria dhe butësia. Mbase pikërisht këtë nënkuptojnë edhe hadithet e përcjella në këtë drejtim, që përpiqen të tregojnë se pas kryerjes së haxhit, njeriu kthehet si një person i sapolindur që ka mundësi të rifillojë me jetën. Për fat të keq, ka edhe shumë njerëz që e kryejnë haxhin pa kurrfarë ndjesie shpirtërore dhe e konsiderojnë atë thjesht një traditë, turizëm ose tregti, duke mëshiruar kështu atë që në hadithet e Ehl-i Bejtit përshkruhet me fjalët: "Sa shumë zhurmë e sa pak pelegrinë (të vërtetë)". Numri i madh i pelegrinëve nuk ka kurrfarë vlere, nëse ky numër nuk e reflekton edhe ndikimin dhe rëndësinë e madhe të pelegrinazhit në jetën e njeriut. Duhet pasur parasysh se një numër i vogël që i shton një vlerë humanizmit është shumë më i vlefshëm se një numër i madh që nuk i shton asgjë jetës njerëzore, përveç një rritjeje në numër e në sasi, duke mbetur vetëm në suazat e një mundësie që nuk shndërrohet në fuqi.

Nëse pelegrinazhi kryhet si një akt adhurimi në kontekstin e tij praktik dhe shpirtëror, duke i mundësuar njeriut të arrijë një lartësim në shpirtin e tij, atëherë ky ritual do të kishte një rol të rëndësishëm edhe në ndryshimin e realitetit, duke ndryshuar fillimisht vetë njeriun. Duke u mbështetur në idenë se njeriu është themeli i çdo ndryshimi, Kur'ani thotë: "Me të vërtetë, Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa ata të ndryshojnë ç'kanë në vetvete"[80].

Vetëm në këto rrethana adhurimi do të integrohet thellë në rrjedhën e jetës dhe nuk do të jetë më një gjendje e rastësishme. Në këtë mënyrë, ata që punojnë për hir të Islamit, duke i përdorur metodat e tyre praktike të edukimit, do të mund t'u japin njerëzve për ta kryer këtë detyrim në mënyrë që të mund të arrijnë një ndryshim të brendshëm dhe ta përdorin atë si një mjet të përparimit shpirtëror që do ta ndryshonte jetën edhe në aspektin e jashtëm. Potencialet e reja shpirtërore që njeriu i fiton gjatë haxhit janë bindshëm më të fuqishme se metodat retorike që njerëzit i përdorin rëndom gjatë procesit të edukimit.

Në të vërtetë, shumë njerëz që nuk e kanë përjetuar shpirtëroren në jetën e tyre, ndonëse i kanë respektuar deri diku rregullat e Islamit, kanë ndryshuar shumë pas kryerjes së haxhit në mënyrë të vetëdijshme, sepse kjo u ka mundësuar ta ndryshojnë mënyrën e të menduarit dhe ndjenjat e tyre kundrejt jetës, duke i kthyer personat e tillë në elementë aktivë dhe ndikues në lëvizjen islame, qoftë në ftesën drejt fesë, qoftë në punët praktike.

Por a thua se kjo është e gjitha që kërkohet gjatë kryerjes së këtij detyrimi? Përse atëherë gjithë ky insistim që të kryhet në të njëjtin vend dhe të mblidhen qindra e mijëra njerëz të gjinive, racave, kombësive e prapavijave gjuhësore nga më të ndryshmet?A është vallë thjesht ngaqë Islami i pranon të gjithë njerëzit? Përse edhe kjo gjë nuk është konsideruar njësoj si agjërimi ose namazi, të cilat njeriu mund t'i bëjë edhe individualisht edhe në grup? A ka ndonjë dobi të fshehtë që e tejkalon nivelin individual të edukimit dhe arrin te niveli shoqëror dhe politik? Këtë pikë do të përpiqemi ta shpjegojmë në vijim.

[80] Kur'an, Er-Rra'd:11.

Teksti i parë me të cilin përballemi në lidhje me haxhin është thirrja e profetit Ibrahim drejtuar njerëzve. Në Kur'an thuhet: "Thirri njerëzit për haxhillëk: ata do të vijnë në këmbë dhe me deve prej të gjitha viseve të largëta, që të dëshmojnë dobitë e tyre dhe të përmendin Emrin e Allahut në ditët e caktuara mbi kafshët (për kurban), të cilat ua ka dhuruar Ai. Hani nga ato (mishin) dhe ushqeni nevojtarin e varfër!"[81].

Kjo thirrje i fton njerëzit të kenë parasysh dobi të caktuara gjatë haxhit, pa i përmendur në hollësi këto dhe duke ftuar që ta ndërmarrin këtë rrugëtim për t'u ndeshur me dobitë që mund të fitojnë nëpërmjet tij në jetën e tyre private ose shoqërore, krahas shpirtit të adhurimit që përfaqësohet nga përmendja e Zotit në ditë të caktuara, nga falënderimi i Tij për bekimet që i fal njeriut dhe nga praktikimi i urdhrave të Tij për t'i kthyer këto bekime drejt njerëzve të mjeruar dhe nevojtarë.

Kur'ani, madje, edhe mund t'i lërë të mjegullta disa çështje që të mund të stimulojë njeriun të hulumtojë në shumë aspekte të saj, në mënyrë që njeriu të përpiqet t'i kuptojë të gjitha aspektet dhe të mos mbetet vetëm në njërin dimension të punës. Në këtë mënyrë urdhrat hyjnorë do të kthehen në një lëvizje që e ripërtërin veten gjithë kohës në aspektin e kreativitetit, përparimit e zhvillimit.

[81]. Kur'an, El-Haxh:27-28.

Kushtet e Imanit

1. Besimi në Zotin e madhërishëm

Çdo mysliman si bazë të besimit të tij ka besimin në Një Zot të vetëm, që është Krijuesi i gjithësisë. Mbi të gjitha nga Krijuesi është vlerësuar e nderuar njeriu, të cilit i është dhënë mundësia për të shfrytëzuar çdo gjë në dobi të tij për këtë botë provizore, por edhe materiale, si dhe për botën tjetër. Ai këtë do ta arrijë me cilësitë e karakterit të tij të dhuruara nga i Madhërishmi.

Së pari: Mendja, arsyeja, që e dallon njeriun nga gjithçka tjetër, që e orienton drejtë për të ndërtuar një jetë të qetë e të lumtur individuale, familjare e shoqërore. Pastaj vijnë gjithë organet e shqisave aq perfekte dhe të përsosura me të cilat është pajisur njeriu. Nëpërmjet tyre ai është në gjendje të perceptojë gjithë botën që na rrethon, ta shikojë, dëgjojë, prekë dhe shijojë atë në tërësinë e saj. Për këto dhurata të çmuara njeriu duhet të jetë mirënjohës ndaj Krijuesit, ta falënderojë dhe adhurojë Atë pa pushim. Por, nga ana tjetër, duhet edhe të zbatojë udhëzimet e porositë bashkë me urdhrat e ndalesat, për të ruajtur të pastër personalitetin e tij.

Myslimani nuk duhet të mjaftohet me një besim formal, duke pohuar besimin në Një Zot. Ai duhet të njohë cilësitë e Tij të panumërta si: Zoti ekziston, është Një i Vetëm, pa fillim e pa mbarim, i përhershëm, nuk ka mbarim, i pangjashëm me askënd etj. Zoti sheh, dëgjon, di gjithçka dhe me dëshirën e vet bën ç'të dojë. Ai me të folurit e Tij Hyjnor, si i Plotfuqishëm, shpik dhe zhduk çfarë të dojë. Zoti i Lartësuar cilësitë e Tij i ka sanksionuar në Kur'an kur thotë: "Thuaj: "Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm! Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim. Ai as nuk lind, as nuk është i lindur. Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë!""[82].

Pra me pushtetin e Tij të pakufizuar i drejtohet njeriut që të vrojtojë natyrën dhe gjithçka Ai ka krijuar, të njohë ligjet e krijimit dhe pastaj të argumentojë se gjithçka nuk është e rastësishme dhe e krijuar vetvetiu, por vepër e Krijuesit të plotditur dhe plotfuqishëm. Çdo gjë që sheh njeriu rrotull tij është krijuar për t'u vënë në shërbim të tij. Kjo do të arrihet me dituri e kulturë, të cilën Zoti i Lartësuar e bëri detyrë për çdo njeri. Profeti a.s. thotë: "Kërkimi i diturisë është detyrë për çdo mysliman e myslimane" dhe "Kërkojeni diturinë nga djepi deri në varr". Prandaj secili mysliman e myslimane duhet të niset në jetë me motivin: "Vrojto, zbulo, argumento, pastaj beso".

Këto argumente do ta çojnë çdo individ në përfundimin se "ekziston një fuqi superinteligjente" që krijoi, drejton dhe sundon, e cila njihet me emrin Allah ose Zot.

[82]. Kur'an, El-Ihlas: 1-4.

1.1 Zoti ekziston

Zoti e ka pajisur njeriun me katër tipare kryesore:

1. Njohja: Realizohet me anë të sistemit nervor që i jep mundësi njeriut të mësojë, të besojë, të studiojë e pastaj të vëzhgojë, të përfytyrojë, të arsyetojë, të analizojë gjërat me hollësi që të mund edhe të eksperimentojë për të argumentuar të vërtetën.

2. Vetëdija: Është e lindur me natyrën njerëzore nga Krijuesi, me anën e së cilës njeriu është në gjendje të dallojë të mirën dhe të keqen, të vërtetën nga e pavërteta, të dobishmen dhe të dëmshmen etj.

3. Liria për të zgjedhur: Zoti i Lartësuar i dha njeriut vullnetin e lirë për të zgjedhur rrugën e tij. Kjo liri nuk është absolute, pasi besimtari islam duhet t'i bindet Krijuesit për zbatimin e urdhrave të Tij, të përcaktuara në Mesazhin Hyjnor. Në qoftë se nuk i zbaton do të presë gjykimin dhe ndëshkimin. Në Kur'an thuhet: "S'ka detyrim në fe"[83].

4. Përgjegjshmëria: Myslimani nga liria për të zgjedhur do të marrë parasysh edhe përgjegjësinë e veprës që kryen. Pra, do t'i nënshtrohet gjykimit të Allahut të Lartësuar në ditën e llogarisë. Për veprat e mira do të shpërblehet, ndërsa për zgjedhjet e gabuara që e kanë shtyrë në vepra të liga do të ndëshkohet. Përgjegjësia është individuale. Në Kur'an thuhet: "Kush zgjedh rrugën e drejtë, e ka për veten e vet e kush i largohet asaj, i largohet në dëm të vetvetes dhe askush nuk e merr të keqen e tjetërkujt"[84]. Çdo individ, mashkull ose femër ka të drejtë t'i kërkojë falje Zotit pa ndërmjetës, sepse veç Tij askush nuk mund të japë falje për veprat e kryera. Besimtari duhet të jetë i sinqertë në lutjen që i drejton Zotit të Lartësuar dhe kusht që nuk do të përsëritet në të ardhmen. Prandaj besimtari duhet ta adhurojë Zotin dhe të lutet në vazhdimësi për t'u shmangur nga veprat e liga sepse në ditën e llogarisë do të përjetojë përgjegjësinë e tyre. Në Kur'an thuhet: "Qëndroni në fenë e drejtë dhe mos u përçani në të!"[85], "Pastaj të gjithë do të ktheheni te Zoti juaj dhe Ai do t'ju tregojë për kundërshtitë që kishit mes jush".[86]

1.2 Zoti është fuqiplotë

Zoti në Kur'an thotë: "Ne do t'u tregojmë atyre shenjat Tona në hapësirat tokësore e qiellore, si dhe në vetvete, derisa t'u bëhet plotësisht e qartë se ai (Kurani) është e vërteta. Vallë, a nuk të mjafton ty që, Zoti yt është Dëshmues i çdo gjëje?! Vërtet, ata dyshojnë në takimin me Zotin e tyre, por le ta dinë se Ai ka nën kontroll çdo gjë."[87]. Me këtë ajet Zoti u tërheq vëmendjen njerëzve

83. Kur'an, El-Bekare: 256.
84. Kur'an, El-Isra:15.
85. Kur'an, Esh-Shura:13.
86. Kur'an, El-En'am:164.
87. Kur'an, Fussilet:53-54.

që janë dhënë totalisht pas kësaj bote materiale, pas epsheve e pasioneve negative si bixhozi, alkooli, droga, prostitucioni e krimi etj., se këto e hedhin atë në humnerën e skëterrës. Në këtë rrugë merr goditje veçanërisht familja e fëmijët të cilët vihen nën presion, frikë e kërcënime të vazhdueshme dhe rrezikohen nga shpërbërja e familjes, nga krimi i gjakmarrjes etj.

Lidhur me këto shpëtimi i vetëm do të vijë nga kthimi në fenë islame, besimi te Zoti, i cili jep garanci e shpresë nga dora e dashurisë që i shtrin besimtarit. Zbatimi i ligjeve të Zotit e çliron njeriun nga turbullirat e torturat plot rreziqe të pjesëmarrjes në veprimtari antiligjore e kriminale. Ato e çlirojnë shpirtin e besimtarit nga ankthet e depresionet psikike që kanë çuar mjaft njerëz në vetëflijim.

Vetëm besimi te Zoti do të bëjë të mundur prekjen dhe qetësinë mendore dhe se mbështetja tek Allahu është shpëtimi i vetëm. Të dhënit krejtësisht pas kësaj bote materiale, joshja e nxitja e përfytyrimeve të egos çdo ditë e largojnë njeriun nga rruga e Zotit të Madhërishëm. Zbatimi i ligjeve të Zotit është rruga e sinqeritetit dhe të vërtetës, që myslimanin e bën të sigurt në punën e tij. Ai e ndan mendjen dhe me ndihmën e saj, gjatë ndërtimit të kësaj bote do të kapërceja çdo vështirësi dhe do të jetojë në paqe e qetësi si në këtë botë edhe në botën tjetër. Në Kur'an thuhet: "Çdo gjë që është në Tokë, do të zhduket, e do të mbetet vetëm Fytyra (Qenia) e Zotit Tënd, plot Madhëri dhe Nderim."[88]. Kjo do të thotë që Allahu i madhërishëm është i përjetshëm, ndërsa çdo gjë tjetër do të pësojë shkatërrim, për t'iu drejtuar vetëm Atij. Atëherë thirrja është t'i drejtohemi Kur'anit, Fjalës së Tij, i cili është burimi dhe mjeti i vetëm që luan rol të rëndësishëm për drejtimin e myslimanit në rrugën e Allahut. Kur këto shoqërohen me adhurim, me faljen e namazit, agjërimit etj., atëherë myslimani do të shijojë edhe shpërblimet e Allahut.

Në Kur'an thuhet: "ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me përkushtim të sinqertë"[89]. Do të thotë që besimtari si individ, në familje e shoqëri të udhëhiqet nga udhëzimet Hyjnore dhe aktivitetin e tij praktik duhet medoemos ta kryejë me sinqeritet e çiltërsi të plotë. Në veçanti, adhurimi si falja e namazit, agjërimit etj., duhen kryer me sinqeritet të plotë. Pra, myslimanit i kërkohet të jetë i sinqertë në fjalën e tij, në praninë e tij, në marrëdhëniet me të tjerët, për të arritur dashurinë e Krijuesit të tij.

Në Kur'an thuhet: "Tek Ai ngjiten fjalët e bukura, ndërsa veprën e mirë Ai e lartëson Vetë"[90]. Një besimtar i tillë nuk u bindet cytjeve të djallit të mallkuar, epshit e pasionit që të çojnë në degradim moral. Këta besimtarë do të shpërblehen ditën e gjykimit nga Allahu xh.sh. i cili në Kur'an thotë: "Dhe do të shpërbleheni vetëm sipas asaj që keni bërë, përveç robërve të sinqertë të Allahut"[91].

Por ndodh që njerëzit që e heqin veten për besimtarë, nuk janë të sinqertë në besim, veçse adhurojnë egon e nefsin e tyre duke kryer vepra të amoralshme. Në këtë rast ata largohen nga besimi dhe nefsin e kthejnë në objekt adhurimi duke plotësuar tekat e kapriçot e tij. Zoti në Kur'an thotë:

88. Kur'an, Er-Rrahman: 26-27.
89. Kur'an, El-Bejjine:5.
90. Kur'an, El-Fatir:10.
91. Kur'an, Es-Saffat:39-40.

"A e ke parë ti atë që epshin e vet e ka marrë për zot?"[92]. Për këtë arsye duhet braktisur egoja e tij për të qenë të sinqertë në veprimtarinë e tij si mysliman. Ai zbaton me sinqeritet ritualet dhe detyrat që parashtron jurisprudenca islame, nxjerrë nga Kur'ani Famëlartë. E këtë duhet ta bëjë për arsyen e përsosjes së personalitetit i pastruar nga mëkatet siç thotë Zoti në Kur'an: "për të t'i falur ty Allahu gabimet e mëparshme dhe të ardhshme"[93]. Do të thotë që myslimani është pastruar nga mëkatet dhe pret shpërblimin nga Zoti i madhërishëm siç thuhet në Kur'an: "Me të vërtetë vetëm tek Allahu është shpërblimi i madh"[94].

1.3 Ç'është imani?

Në Islam fjala "iman" vërteton një besim real, të vërtetë te Krijuesi i gjithësisë, Zoti i Lartësuar. Profeti a.s. e ka cilësuar fjalën "iman" si "besim me zemër, shqiptim me gjuhë dhe veprimtari me gjymtyrë". Do të thotë që, në besim përfshihet dituria, fjala dhe veprimtaria. Zoti i madhërishëm në Kur'an urdhëron e thotë: "Ata kanë zemra, por nuk kuptojnë me to"[95]. Do të thotë që një zemër me shëndet të plotë është e aftë të kuptojë të gjitha sendet që i dalin njeriut përpara; t'i diferencojë se cila është e mirë dhe jo e mirë. Në Kur'an thuhet: "Në të vërtetë, atyre nuk u janë verbuar sytë (në këto gjëra), por u janë verbuar zemrat e veta në kraharor"[96], "Vallë, a nuk përsiatin ata për Kur'anin apo i kanë zemrat të kyçura?!"[97]. Me zemër kuptojmë jo vetëm funksionin e saj si organ i qarkullimit të gjakut, por edhe si vendqëndrim i ndërgjegjes së njeriut. Pra, besimi me zemër konsiderohet vetëm ai që e pohon me ndërgjegje të pastër dhe jo formal. Për këtë arsye ky besim duhet shprehur edhe me gjuhë. Atë që del nga thellësia e zemrës, ta dëshmojë gjuha e besimtarit. Ndryshe, të shprehurit e besimit me gojë, por që nuk del nga zemra, është besim formal. Për këtë kategori besimtarësh Zoti i madhërishëm në Kur'an shprehet: "Në zemrat e tyre ka një sëmundje, të cilën Allahu ua shton. Ata i pret një dënim i dhembshëm, për shkak të hipokrizisë së tyre."[98], ose "Është shumë e urryer për Allahun të thoni atë që nuk e bëni"[99]. Kjo do të thotë se besimi duhet shoqëruar edhe me gjymtyrë. Në këtë mënyrë veprimtaria praktike e myslimanit është në përputhje të plotë me besimin, imanin, sepse u nënshtrohet urdhrave dhe udhëzimeve të Zotit të Lartësuar në Kur'anin Famëlartë.

Besimi në vetvete është një çështje që lidhet direkt midis besimtarit dhe Zotit të Lartësuar dhe nuk mund të gjykohet ky besim nga njerëzit. Në praktikën e përditshme besimtari mund të gjykohet vetëm nga veprat që kryen. Në Kur'an thuhet: "Allahu e di ç'ka në zemrat tuaja".[100]

---

92. Kur'an, El-Furkan:43.
93. Kur'an, El-Feth: 2.
94. Kur'an, Et-Teube: 22.
95. Kur'an, El-A'raf: 179.
96. Kur'an, El-Haxh: 46.
97. Kur'an, Muhammed: 24.
98. Kur'an, El-Bekare: 10.
99. Kur'an, Es-Saff: 3.
100. Kur'an, El-Ahzab: 51.

Pa dëshminë apo shehadetin nuk mund të jesh mysliman. Në të shprehen: Besimi ndaj Zotit dhe Muhamedit si i dërguar i Zotit. Ndalemi për të shpjeguar më qartë se ç'është shehadeti ose dëshmia.

Në dëshminë që bën myslimani vërteton dy pohime të rëndësishme:

Së pari: Ekzistencën e Zotit të madhërishëm ku shprehet: "Nuk ka Zot tjetër, përveç Zotit".

Së dyti: Vërteton se Muhamedi a.s. është i dërguari i tij e thotë: "Muhamedi është i dërguari i tij".

Kuptimi i parë ka përfshirje më të gjerë, sepse shpjegon çdo gjë që i nënshtrohet Allahut të madhërishëm dhe këtë e kanë predikuar të gjithë profetët paraardhës të Muhamedit, siç thuhet në Kur'an: "Ne nuk kemi nisur asnjë të dërguar para teje, që të mos i kemi shpallur se: "S'ka zot tjetër përveç Meje, andaj më adhuroni (vetëm) Mua!""[101]. "Zoti juaj është një Zot i vetëm, prandaj vetëm Atij përuljuni"[102]. Do të thotë se ka vetëm një të vërtetë që meriton të adhurohet dhe Ai është Zoti. Të bësh adhurim për dikë tjetër veç Zotit, është shirk, që domethënë t'i bësh Zotit ortak tjetër. Prandaj në Kur'an thuhet: "Adhuroni Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim)"[103]. Nga sa u tha vërtetohet se dëshmia me njësinë e Zotit është element bazë i Islamit. Ky element ekziston në natyrën origjinale humane (fitre) te njeriu, i cili e ka pranuar Zotin si krijues, kur është pyetur: A jam unë Zoti juaj? e ai e ka pohuar duke thënë: Po. Duke qenë i ditur për këtë, prej njeriut kërkohet që në këtë botë të sillet në pajtim me ligjet e Zotit të Lartësuar, në mënyrë që mendimet, kuptimet, qëndrimet dhe cilësitë morale të tij të mos e kundërshtojnë Atë. Se si duhet të veprojë myslimani e ka të përcaktuar qartë në Kur'anin Famëlartë që është Fjala e Zotit drejtuar njerëzimit. Këtë mesazh njerëzit duhet ta përkthejnë në vepra. Që do të thotë, të reagojnë drejt, sepse në çdo gjë që shohim e prekim janë vepra të Krijuesit, Zotit të Lartësuar.

Me një fjalë, Zoti i Lartësuar për ta udhëzuar njeriun, dërgoi një mesazh e ky është Kur'ani që iu kumtua profetit Muhamed për ta përcjellë qartë e kuptueshëm te njerëzit. Përmasat e këtij mesazhi i kapërcyen kontinentet dhe kanë ardhur deri në ditët tona. Ne e kemi për detyrë të lexojmë, të studiojmë dhe të zbatojmë udhëzimet e ligjet e tij. Në Kur'an thuhet: "Ne nuk kemi çuar asnjë të dërguar, përveçse në gjuhën e popullit të tij".[104] Do të thotë që mesazhet Hyjnore kanë ardhur për të gjithë popujt dhe u përshtaten rrethanave kulturore, historike e gjuhësore të çdo populli.

Pohimi se Kur'ani është Fjala e Zotit, tregon se gjithçka ka brenda tij, shpreh Zotin. Prandaj vërtetojmë se elementi i parë bazë i Islamit është dëshmia (shehadeti) që "nuk ka Zot përveç se Zoti". Ky Zot i madhërishëm është burimi jetës, i dijes, i mëshirës, i pushtetit, i fjalës, i së mirës dhe çdo gjë që gjendet në botë.

Cilësitë e Zotit të Lartësuar, janë ato cilësi të vetes së Tij, janë emrat e Tij, që ai ua zbulon krijesave të Tij. Veprat janë fenomenet e ngjarjet në univers që shfaqen nëpërmjet veprimtarisë së Zotit.

---

101. Kur'an, El-Enbija: 25.
102. Kur'an, El-Haxh: 34.
103. Kur'an, En-Nisa: 36.
104. Kur'an, Ibrahim: 4.

1.4 Besimi në dritën e Kur'anit

Kur'ani famëlartë, shpallja e fundit dërguar njerëzimit nëpërmjet engjëllit Xhibril, profetit Muhamed nga ana e Allahut të Lartësuar, është i vetmi burim prej të cilit kanë dalë të gjitha ligjet e fesë islame. Në Kur'an thuhet: "Ky është Libri në të cilin nuk ka dyshim. Ai është udhërrëfyes për të devotshmit"[105]. Pra është një vepër e mbinatyrshme që vërteton profetësinë e Muhamedit, i cili e përcolli Mesazhin Hyjnor me përsosmërinë më të madhe, jo vetëm për popullin arab, por për të gjithë popujt e botës dhe vazhdon e do të vazhdojë të përhapet deri në fund të kësaj bote.

Besimi islam ka zënë një vend të rëndësishëm në zemrat e njerëzve, duke njohur Krijuesin, Allahun e Lartësuar dhe mbi këtë bazë kanë ndërtuar sistemin jetësor. Ajo është mbështetja e njeriut në Zotin që sundon në mënyrë të pakufishme si dhe e mbikëqyr njeriun në veprat e tij. Islami është fe e përparimit dhe zhvillimit paqësor të njeriut mbi bazën e studimit dhe arsyetimit logjik e jo të verbër. Te besimtari i devotshëm reflekton një fuqi e brendshme e përqendruar thellë në shpirtin e tij, në zemrën e ndërgjegjen e tij dhe jo e ardhur nga jashtë. Kjo tregon bindjen me dëshirë ndaj besimit te Zoti, që njëkohësisht vërteton edhe detyrimin që ka mendja për të zgjedhur besimin me natyrën në të cilën lindi.

Të jesh besimtar do të thotë të besosh Zotin Një, që s'ka fillim e mbarim, krijoi gjithësinë me të gjitha qeniet e gjalla e jo të gjalla me vullnetin e tij të lirë dhe me ligje të përcaktuara për vazhdimësinë e jetës. Pastaj të dëshmosh se profeti Muhamed është i dërguari i Tij, i cili përçoi mesazhin Hyjnor. Ai tha: Besimi në Zotin Një, në engjëjt, në librat e Zotit, në profetët dhe në jetën e pasosur. Kush i pranon këto kushte konsiderohet besimtar mysliman; por në qoftë se nuk i shoqëron me vepra, mbetet mysliman i pamotivuar, besimi i tij nuk është i gjallë që të reflektojë në jetën dhe personalitetin e tij.

Besimi është ushqim shpirtëror, i domosdoshëm për organizmin e njeriut ashtu si ushqimi material, pa të cilin nuk ka jetë. Elementet e ushqimit shpirtëror janë:

- Të dëshmosh njësinë e Zotit;
- Të zbatosh detyrimet fetare si falja e namazit, agjërimi, zekati e Haxhi. (Dy të fundit i realizojnë ata që kanë mundësi financiare).

Pra besimtar i vërtetë dhe i sinqertë është ai që u përmbahet të gjitha detyrimeve të fesë islame, pa prishur ekuilibrin me përkushtimin e punës në ndërtimin e jetës së tij individuale e familjare.

Kur'ani përmban bazën e parimeve të besimit e të adhurimit. Këto parime së pari i kanë për detyrë fëmijët e lindur nga prindër myslimanë. Ata duhet të deklarojnë dëshminë se "Zoti është Një dhe Muhamedi i dërguari i Tij". Kjo dëshmi nuk është e mjaftueshme të pohohet vetëm me gojë, por duhet ta ndjejë edhe zemra, e cila reflekton te gjymtyrët e trupit për të vënë në zbatim parimet e adhurimit. Adhurimi është shije e besimit dhe morali i besimtarit që i jep gjallëri atij në jetën e përditshme për të grumbulluar kapital edhe për jetën e pasosur. Besimi me ndërgjegje të pastër përbën një nga elementet bazë të ekzistencës shpirtërore. Pra janë dy elemente të rëndësishme e të qenët mysliman. Ato janë: besimi në Zotin Një dhe adhurimi ndaj Tij. Për myslimanin adhurimi është tregues i besimit të tij, i cili i jep forcë për të zbatuar ligjet e Allahut në librin e tij Hyjnor,

[105]. Kur'an, El-Bekare: 2.

Kur'anin Fisnik. Pastaj me shembullin e tij e ka për detyrë të ndikojë tek të tjerët për t'u shmangur nga veprat negative. Profeti a.s. thotë: "Njeriu që e ka njohur me tërë ndjesitë Allahun për Zot, Islamin për fe dhe Muhamedin për pejgamber, ka shijuar kënaqësinë e besimit". Kjo do të thotë se ai zotëron vullnet dhe zgjedh sipas dëshirës të mirën apo të keqen. Besimtari që ka një besim të tillë nuk komandohet nga ndjenja e pasionit dhe gjykimeve sipas interesave personale, por qëndron në zbatimin me korrektësi të urdhrave dhe rregullave të fesë islame. Në Kur'an Zoti xh.sh. urdhëron e thotë: "Sikur e Vërteta të ishte sipas dëshirave të tyre, atëherë do të shkatërroheshin qiejt dhe Toka dhe gjithçka që gjendet në to"[106]. Kjo bëhet edhe për një arsye tjetër: ka besimtarë që përpiqen të shfrytëzojnë fenë sipas ndjenjave të tyre, për përfitime materiale, që çon në prishjen e rregullave dhe ligjeve të Islamit. Kjo do të thotë të tradhtosh idealet e islamit si fe Hyjnore e të sjellësh çoroditje te besimtarët për zbatimin e urdhrave Hyjnore si p.sh. alkooli që nga i ndaluar rreptësisht nga Kur'ani, bëhet i lejueshëm nga disa besimtarë me emër në Islam, por jo në përmbajtje. Këta besimtarë i shmangen udhëzimit Hyjnor duke preferuar më shumë ndjekjen e dëshirave dhe pasioneve të tyre. Profeti a.s. ka thënë: "Nuk ka dyshim se ky Kur'an është pranë Allahut një ndërmjetës për falje që i dëgjohet fjala dhe, në të njëjtën kohë, një paditës legal. Njeriun që ve përpara dhe e bën udhërrëfyes e çon në xhenet, kurse njeriun që e hedh pas shpine, e rrokullis këmbëpërpjetë për në xhehenem".

Këta besimtarë ngatërrojnë ligjet e fesë islame me traditat e zakonet të cilat janë edhe vese që bien ndesh me parimet e Islamit dhe ai nuk ka asgjë të përbashkët me këto. Besimi është një element që nuk i ndërron parimet e tij. Ato janë të qëndrueshme për çdo kohë e vend.

Në Islam i jepet përparësi mendjes, arsyetimit logjik, sepse kjo është dhurata më e madhe për njeriun që e shkëputi nga bota e kafshëve. Kush arrin moshën e pjekurisë, djalë apo vajzë, është i detyruar të besojë Allahun, engjëjt, librat e tij dhe pejgamberët, ditën e gjykimit, si dhe çdo gjë që ndodh sipas miratimit dhe dëshirës së Allahut. Por ndodh shpesh të dëgjohet nga persona të veçantë të thonë se janë myslimanë, sepse prindërit i kanë të tillë. Kjo do të thotë se ata besojnë formalisht, pa njohur ligjet themelore të besimit. Një besimtar i tillë është imitues dhe besimi i tij përpara Allahut është i varfër si në argument ashtu edhe në vepra. Në Kur'an thuhet: "Në Tokë ka shenja për ata që besojnë me bindje, po edhe në vetet tuaja - a nuk e shihni vallë?"[107].

Po ashtu dhe në veten tuaj keni argument. Ende nuk po i shihni? Në natyrë ka një numër të madh argumentash që bëjnë të ditur ekzistencën e Allahut. Besimtarët duhet të shprehin dashurinë dhe lidhjen me Allahun nëpërmjet dashurisë. Nuk ka Zot tjetër veç Allahut, Muhamedi është i dërguari i tij". Me përsëritjen e këtyre dy fjalive jo vetëm me gojë, por edhe me zemër, besimtari i nënshtrohet Allahut edhe me vepra.

Besimtar i devotshëm konsiderohet njeriu që adhuron Allahun, zbaton ligjet e Tij, fal me përkushtim namazin, që e mbron atë nga mëkatet dhe largohet nga çdo punë e keqe. Një besimtar i tillë i frikësohet Zotit xh.sh. dhe ruan nderin e tij të pastër duke frenuar ndjenjat e epshit e të pasionit e deri tek organet e shqisave. Gjithmonë në aktivitetin jetësor të tij kërkon kënaqësinë e Allahut.

---

[106]. Kur'an, El-Mu'minun: 71.
[107]. Kur'an, Edh-Dharijat: 20-21.

Besimtari i sinqertë në adhurim i mbështetet Allahut sepse mendon ditën e llogarisë përpara Tij. Pra cilësitë e besimtarëve shfaqen në kënaqësinë e tyre për jetën që bëjnë. Në Kur'an thuhet: "Ky është Allahu, Zoti juaj. S'ka zot tjetër të vërtetë përveç Tij, Krijuesit të çdo gjëje, andaj adhuroni vetëm Atë! Ai është Mbikëqyrës i çdo gjëje! Shikimet njerëzore nuk mund ta arrijnë Atë, ndërkohë që Ai i arrin shikimet e të gjithëve. Ai është Bamirës i pakufi dhe di çdo gjë. (Thuaju o Muhamed): "Tashmë ju kanë ardhur nga Zoti juaj prova të qarta. Ai që i sheh ato, i sjell dobi vetes, ndërsa ai që i mbyll sytë para tyre, i bën dëm vetes. Unë nuk jam rojtari juaj."[108] Profetit Muhamed iu shpall Kur'ani famëlartë, Fjala Hyjnore e do të mbesë i pandryshuar deri në Ditën e Kiametit. Pas Muhamedit a.s. nuk do të ketë më të dërguar dhe as shpallje Hyjnore nga Krijuesi dhe zotëruesi i qiejve dhe i tokës. Ai është i përjetshëm, është Një dhe i vetëm, zotëron cilësi të pastra dhe nuk i ngjan asnjë krijese, zotëron çdo gjë dhe krijon çfarë të dëshirojë, është i pari dhe i fundit që nuk ka nevojë për vend dhe kohë. Ai është sunduesi absolut dhe njeriu dhe çdo gjë është nën sundimin e tij.

Feja islame e bazuar në Kur'anin Famëlartë është e qëndrueshme dhe parimet e saj apo shtyllat bazë janë të tilla që nuk pranojnë zhvillime të mëtejshme, pasi vërtetojnë përsosmërinë e shpalljes kuranore. Me këtë i është dhënë mundësi njeriut të kuptojë, të mësojë dhe të arrijë njohuri të reja.

Njeriut i janë dhënë argumente nga Shpallja Hyjnore për njohjen e Krijuesit të gjithësisë. Nëpërmjet saj ai nxitet të shikojë e studiojë mjaft fakte bindëse në natyrën rreth tij, në tokë e në qiell. Në Kur'an thuhet: "Sikur në qiej dhe në Tokë të kishte zota të tjerë, përveç Allahut, si qiejt, ashtu edhe Toka do të shkatërroheshin."[109] Ky është një argument kuranor që vërteton se ekziston Zoti Një e nuk ka zot tjetër veç Tij. Njëshmëria e Tij është e domosdoshme dhe njihet me emrin Zot ose Allah. Me këtë emër nuk thirret asgjë në botë, sepse është i vetmi Krijues i çdo sendi dhe shkak i çdo gjëje. P.sh. njeriut i dha shpirtin që është i zhveshur nga materia, është i krijuar, nuk vdes me shkatërrimin e trupit, do të shpërblehet apo ndëshkohet bashkë me trupin në ditën e llogarisë për veprat e kryera gjatë jetës në këtë botë.

Nuk mohohet liria e zgjedhjes së njeriut në kryerjen e veprave. Mbi bazën e mendjes, e cila zgjedh rrugën për të vepruar, për mirë ose për keq, ai do të shpërblehet ose ndëshkohet. Sigurisht që në lirinë e veprimit ndikojnë edhe faktorë të jashtëm që i nënshtrohen ligjshmërisë së natyrës, por çdo gjë varet në kompetencën e tij, në analizën dhe arsyetimin e ligjit që u bën atyre veprave. Besimtari nuk duhet të ndikohet nga tjetri apo edhe mjedisi kur kryhen veprime që bien ndesh me ligjet islame. Islami kërkon nga besimtarët që të jenë të pajisur me moral të pastër për të krijuar një familje dhe shoqëri të pastër, të dashurisë dhe respektit reciprok. Filozofi islam, Ibn Sina, në lidhje me këtë shprehet: "Qëllimi i logjikës është që ajo të jetë armë në dorën e njeriut me qëllim që ta orientojë atë në rrugën e drejtë dhe të mos vijë deri te gabimet gjatë meditimeve të tij". Nëpërmjet Kur'anit mësojmë se Zoti nuk është bota, por ai është i Lartëmundësuari, i Cili e krijoi botën nga mosqenia dhe se është në gjendje që të ndryshojë krijimin në diçka që nuk është krijuar dhe përsëri ta kthejë.

---

[108]. Kur'an, El-En'am: 102-104.

[109]. Kur'an, El-Enbija: 22.

Meqenëse njeriu përbëhet nga shpirti dhe trupi duhet të krijojë barazpeshën ndërmjet tyre si në ushqimin material ashtu edhe atë shpirtëror. Shpirti nuk ka nevojë për bukë, ujë etj. si këto, por ka nevojë të falënderojë Zotin, ta adhurojë atë me faljen e namazit, agjërimin e ramazanit, kryerjen e Haxhit, dhënien e zekatit etj. Atëherë do të vihen në kontroll dëshirat e zjarrta drejt pasionit, epsheve shtazore, të lakmisë, egoizmit etj. Për këtë kërkohet nga besimtarët që t'i luten e falen Zotit e askujt tjetër dhe mbi çdo gjë të triumfojë urdhëri i Tij. Asnjë ligj nuk mund të mendojmë se nuk ka ligjvënësin e tij. Uniteti harmonik në natyrë si dhe fenomenet që ndodhin në të, na bindin për ligjvënësin suprem, Zotin e Lartësuar. Në Kur'an Allahu shprehet: "Thuaj: "Shikoni ç'ka në qiej dhe në Tokë!""[110], "A nuk vështruan ata mbretërinë e qiejve e të Tokës"[111]. Pavarësisht nga kjo ka edhe mohues që nuk pranojnë krijimin e gjithësisë nga ana e Zotit, sepse nuk e shohin atë, por ata harrojnë se ka edhe shumë gjëra që ne nuk i shohim dhe i besojmë. Ne i pyesim: A e shohin mendjen e tyre? Ata shohin manifestimet e mendjes në jetën e përditshme, gjë që do të thotë se mendja ekziston. Atëherë edhe në natyrë ngado që të hedhim sytë shohim manifestimet e supermendjes apo superarkitektit madhështor për gjërat e mrekullueshme që shohim. Kjo do të thotë se ekziston krijuesi i tyre superinteligjent, i pangjashëm me askënd, që e ka emrin Allah ose Zot. Ai është i përhershëm, pa fillim e pa mbarim që do të ekzistojë edhe pasi të marrë fund kjo botë. Pra, Ai nuk është një qenie që shihet me sy, nuk ka nevojë për vend, nuk mund të kufizohet në kohë dhe nuk ka as trup as formë. Është plotësisht i pavarur, ndërsa çdo krijesë është e varur prej Tij. Në Kur'an thuhet: "Allahu e di shikimin e përvjedhur të syrit dhe atë që fsheh zemra"[112]. Kjo do të thotë se Atij nuk mund t'i fshihet asgjë. Dituria e tij përfshin gjithçka, duke mos përjashtuar edhe të parët e të dëgjuarit. Siç shprehet Kur'ani: "Me të vërtetë Allahu dëgjon dhe sheh". Ai shikon dhe dëgjon me përsosmërinë e Tij të paarritshme nga logjika e njeriut. Jo vetëm kaq, por edhe flet ashtu siç shprehet në Kur'an: "S'ka ndryshim në fjalët e Allahut"[113].

Sigurisht, të flasësh për Kur'anin si bazë e besimit nuk mjaftojnë volume të tëra, por u ndalëm vetëm në disa argumente kuranore e shkencore, që e bëjnë të domosdoshëm besimin në Zotin dhe Kur'anin si shpallje e Tij, udhëheqës për besimtarët.

1.5 Besimi është themeli i jetës

Krijesa më e ndershme, njeriu, duhet të dijë synimin e ekzistencës së vet, duhet të pajiset me një metodologji të veprimit, duhet të dijë misionin e jetesës, ta kuptojë vlerën dhe domethënien e saj. Feja islame, përmes mënyrave dhe metodave të ndryshme, përpiqet që hyjnoren ta sjellë në shpirtin dhe jetën e çdo besimtari.

Personalitetin e njeriut në fillim e shoqërojnë proceset njohëse, me anën e të cilave ai njeh botën që e rrethon si dhe nga proceset emocionale me të cilat mban qëndrim pozitiv ose negativ ndaj fenomeneve jetësore. Nga ana tjetër ai bën përpjekje të ndërtojë jetën në përshtatje me kërkesat, nevojat dhe dëshirat e tij. Por besimi islam është besim Hyjnor, i bazuar në fjalën e Allahut, Kur'anin Famëlartë, i cili tregon shtyllat e tij dhe mbi sunetin autentik që e sqaron libri Hyjnor. Ligji islam si

110. Kur'an, Junus: 101.
111. Kur'an, El-A'raf: 185.
112. Kur'an, El-Gafir: 19.
113. Kur'an, Junus: 64.

në aspektin e jetës individuale, familjare e shoqërore, në saje të veprimeve dhe normave esenciale, ka ardhur që të rregullojë veprimtarinë e njeriut në përputhje me këto, për ta shmangur nga rruga e gabuar. Në Kur'an thuhet: "Të përkryera janë fjalët e Zotit tënd në vërtetësi dhe drejtësi; fjalët e Tij askush nuk mund t'i ndryshojë"[114]. Prandaj çdo besimtar mysliman, që e konsideron veten të tillë, duhet ta ndërtojë jetën si besimtar i vërtetë i kësaj feje e jo të bëjë një jetë jashtë Islamit. Ka shumë të tillë që pretendojnë se janë myslimanë, por në praktikë nuk bëjnë jetë sipas parimeve të Islamit. Atëherë ku është Islami në edukatën e myslimanit? Si reflektohet në kulturën dhe mendjen e tij, në sjelljen personale, familjare e shoqërore? Si mund të pretendojmë që të presim mirësitë nga ana e Zotit xh.sh? Në Kur'an Zoti urdhëron e thotë: "Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj"[115]. Ky ajet tërheq vërejtjen për secilin dhe kërkon një rikthim në praktikën e të vërtetave islame, ku do të drejtojë besimi islam, do të gjykojë e drejta islame në përsosjen e personalitetit të besimtarit, veçanërisht në përsosjen e moralit, për ta bërë qytetar të një shoqërie ku të dominojë parimi i tolerancës dhe vllazërimit. Islami të udhëzon në rrugë të drejtë, të shmang nga konfliktet, krimet, prostitucioni etj., të cilat nuk janë gjë tjetër veçse nxitje të djallit, i cili ka marrë përsipër të sjellë njeriun në konflikt me vetveten dhe të vërtetën. Dilema që i ka sjellë njeriut sot, është shtrirë më gjerë. Konfliktet në familje e shoqëri si dhe gjakmarrja janë bërë një fenomen i zakonshëm dhe i pashmangshëm, janë marrë padrejtësisht shumë jetë njerëzish, shumë familje janë ngujuar me fëmijët e tyre dhe kanë humbur shpresën për jetën etj. Në të tilla raste sundon zakoni i mallkuar që është vepër e djallit dhe ka mbushur boshllëkun që është krijuar në mes tij dhe krijuesit të tij, Zotit të madhërishëm. Megjithatë ilaçi i shërimit është, nuk përbën rrezik nëse menaxhohet drejt në një rikthim të vërtetë në besimin te Zoti.

Nuk konsiderohet besimtar i vërtetë ai që nuk jeton me Islamin dhe nuk e bën atë program të jetës së tij në familje e shoqëri. Dëshmia e njësisë së Zotit dhe Muhamedit si i dërguar i Tij, është domosdoshmëri që të bën të gjykosh sipas Islamit, të kthehesh me vepra konkrete në rrugën e tij duke u larguar nga aktet kriminale. Zoti në Kur'an urdhëron e thotë: "Nuk i takon asnjë besimtari apo besimtareje të vërtetë që, kur Allahu dhe i Dërguari i Tij vendosin për një çështje, ata të kenë të drejtë të zgjedhin në atë çështje të tyren"[116]. Pra, nuk ka dy zgjidhje, ka vetëm një, pranim ose refuzim. Ashtu si thuhet në Kur'an: "Ne dëgjojmë dhe bindemi. Faljen Tënde kërkojmë, o Zoti Ynë dhe te Ti do të kthehemi"[117]. Pra është feja islame që në misionin e saj ka si bazë parimin se "të gjithë myslimanët janë vëllezër". Nga ana tjetër, teologu i njohur shqiptar, H. Ibrahim Dalliu, i dalluar për ndjenjat e tij patriotike, e zgjeron më tej konceptin e vëllazërimit duke e shtrirë atë edhe në kombësinë, duke u shprehur: "… shqiptarët prej çdo feje qofshin, janë të tan vëllazën të një gjaku, të një gjuhe, të një vatani". Me këto ide duhet edukuar edhe brezi i ri me strategji dhe metoda që çojnë drejt zgjidhjeve efektive. Në Kur'an thuhet: "Thuaj: "Kërkoj mbështetje te Zoti i njerëzve, Sundimtari i njerëzve, i Adhuruari (i vetëm me të drejtë) i njerëzve, nga sherri i djallit cytës që fshihet (pasi cyt) e që hedh dyshime në gjokset e njerëzve, (qoftë ai djall) prej xhindeve apo njerëzve!""[118].

---

114. Kur'an, El-En'am: 115.
115. Kur'an, El-Maide: 3.
116. Kur'an, El-Ahzab: 36.
117. Kur'an, El-Bekare: 285.
118. Kur'an, Nas: 1-6.

Nga ajeti kuptohet se Zoti e ka paralajmëruar njeriun dhe i ka siguruar edhe mbrojtje. Besimtari i vërtetë me vullnet e vetëdije, duhet të bëhet faktor pozitiv për parandalimin e konflikteve që janë bërë problematike si ato për problem pronësie, sigurimin e mënyrës së jetesës, të lidhjeve bashkëshortore etj. duke dhënë gjithnjë zgjidhje paqësore. Sigurisht mbështetur në parimin bazë të fesë islame që është fe e paqes, pra paqe me Zotin, paqe me vetveten, paqe me të tjerët. Kjo e bën myslimanin të vendosur dhe jo hipokrit në trajtimin e problemeve jetësore. Duhet njohur ligji i Zotit, Kur'ani, kushtetuta e besimtarit nga ku burojnë ligjet e sheriatit islam mbi të cilat duhet reflektuar dhe që duhen zbatuar në praktikë.

Islami është themeli i jetës për besimtarin mysliman dhe sipas kësaj logjike duhet vënë në zbatim Kur'ani dhe suneti i profetit a.s. Por në shumicën e rasteve besimtarët islamë janë larg parimeve islame në të gjitha aspektet e jetës. Nuk mund të konsiderohet mysliman ai që mban vetëm emrin e tillë apo për traditë të familjes. Islami nuk pranon ndarjen e jetës së njeriut, sepse sipas tij jeta në tërësi është e Krijuesit të tij, Zotit xh.sh. Tani janë bërë më prezente konceptet e luftës që bëhen gjoja midis të resë e të vjetrës, dijes e padijes, të ndershmes dhe të pandershmes, të moralshmes dhe të pamoralshmes etj., deri edhe në vetë trajtimin e problemeve të fesë për këto drejtime qoftë konservatore apo liberale. Janë teologët e mirëfilltë ata që duhet të japin me kompetencë mendimet e tyre siç ka bërë Dr. Jusuf Kardavi në veprën e tij "Fetva Bashkëkohore" me të cilat duhet edukuar brezi i ri i besimtarëve islamë, vetëm me potenciale pozitive, pa tendenca e paragjykime, duke krijuar harmoni e unitet në çdo drejtim të jetës. Në Kur'an thuhet: "Mos vallë, një pjesë të Librit (Teuratit) e besoni, kurse pjesën tjetër e mohoni?!"[119]. Ky ajet është shumë domethënës, sepse na obligon t'i kthehemi Islamit të plotë, besimit të tij, ligjit, adhurimit, moralit, marrëdhënieve ndërnjerëzore sipas parimeve të tij. Islami është program jete, e rregullon atë si të tërë në çdo aspekt të saj, në shtëpi, në punë, në shoqëri e çdo aspekt tjetër. Ai është ligj për të dhe e udhëzon nga lindja deri në vdekje.

Feja islame kërkon paqen, stabilitetin, qetësinë larg krimit, drogës, prostitucionit, trafikimit të qenieve njerëzore etj. Janë pikërisht njerëzit mbartës të këtyre fenomeneve, midis të cilëve edhe shumë të ashtuquajtur myslimanë. Kur'ani tërheq vërejtjen: "Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin) dhe mos u përçani"[120]. Pra, Islami krijon një vizion të qartë për të ardhmen sepse besimi në Zot krijon më shumë siguri. Ai u mënjanon dhunën në zgjidhjen e problemeve dhe ndërgjegjëson për të krijuar marrëveshje mbi bazën e kompromisit sipas parimeve islame. Ashtu si thuhet në Kur'an ku shprehet: "Dhe tani, Ne të kemi vendosur ty në rrugën e drejtë të fesë, andaj ndiqe atë dhe mos shko pas dëshirave të atyre që nuk dinë!"[121]. Për këtë së pari duhet ndryshuar mentaliteti brenda familjes si modeli më i mirë për të rrezatuar kulturë në shoqëri. Në shumë familje mungon respekti i ndërsjellë midis prindërve e fëmijëve si dhe në mes të burrit dhe gruas, që shpesh përfundon me shkurorëzim duke lënë fëmijët jetimë. Kjo tregon se ndërtimi i këtyre marrëdhënieve nuk është i modelit të Islamit, nuk është qëllim i arritjes së kënaqësisë së Allahut xh.sh. Islami i vërtetë është ai që i bashkon njerëzit, i vëllazëron ata dhe ngjall në mes tyre shpresën për siguri e jetë më të lumtur. Megjithatë baza e edukatës në familje nuk ka arritur atë ndikim pozitiv në formimin

[119]. Kur'an, El-Bekare: 85.
[120]. Kur'an, Al 'Imran:103.
[121]. Kur'an, El-Xhathije: 18.

dhe edukimin e fëmijëve të tyre me parimet e Islamit, për të qenë model në shoqëri. Ka shumë familje të traumatizuara nga konfliktet midis dy prindërve që janë larguar nga besimi. Këto probleme janë me pasoja negative si për familjen edhe për shoqërinë. Çdo mysliman duhet ta ndjejë veten të pakënaqur nga vetja e tij, sepse nuk ka rrezatuar parimet e Islamit për këtë problem. Detyra e myslimanit është që të ndiejë veten e tij deri mëkatar për shumë probleme negative që ndodhin në shoqërinë tonë dhe kjo ndjenjë është rrjedhojë e besimit, duke e cilësuar të mirën të mirë dhe të keqen të keqe. Te myslimani nuk duhet të ndodhë fenomeni i nënshtrimit të fesë ndaj jetës, por e kundërta jeta ndaj fesë. Ai duhet të jetojë me Islamin e civilizimin e tij e jo i poshtëruar nga sundimi i epshit dhe pasionit të akteve të shëmtuara që e degjenerojnë atë. Mesazhi i Islamit duhet të ndiqet nga të gjithë besimtarët sepse ai nuk ndjek, drejton dhe nuk drejtohet. Njerëzit janë të lirë me dispozitat e krijimit të Zotit dhe me natyrshmërinë e lindjes së tyre. Ata janë të lirë dhe kanë të drejtë në liri. Imam Aliu r.a. ka thënë: "Mos u bëj rob i ndokujt pasi Allahu të ka krijuar të lirë". Sot në shoqërinë tonë demokratike Islami është i lirë, ka lirinë e bindjes, lirinë e të menduarit, të logjikës dhe nuk lejon që të mohojnë njerëzit bindjet e tyre ose bindjen e ndonjë feje. Ashtu si thuhet në Kur'an: "S'ka detyrim në fe, sepse tashmë është dalluar e drejta nga e shtrembra"[122]. Pra ky parim i lirisë ka ardhur si parim qiellor për njerëzit, që të jenë të lirë në zgjedhjen e fesë, por me kusht që ajo të mos bëhet lojë në duart e tyre. Ai që e konsideron veten mysliman duhet t'u përmbahet ligjeve islame, ndryshe ai do të gjykohet për veprat e tij.

Logjika është baza e argumenteve islame dhe njeh brenda saj lirinë e mendimit dhe të shkencës. Gjithashtu në Islam njihet liria e të shprehurit dhe kritikës për probleme që dëmtojnë etikën dhe moralin, madje kjo konsiderohet detyrë. Për hir të Allahut duhet thënë e vërteta, të urdhërosh për punë të mirë dhe të pengosh nga të këqijat. Natyrisht nuk ka liri pa detyra dhe të drejta, por këto duhen argumentuar pa paragjykime. Ndodh shpesh sot në praktikën tonë se ka disa që përkrahin ndonjë mendim të veçantë të medhhebit (doktrinës, ideologjisë) që simpatizojnë pa u mbështetur në argumente e fakte. Edhe se Zoti në Kur'an urdhëron e thotë: "Nëse është e vërtetë ajo që thoni, atëherë sillni provën tuaj!"[123]. Prandaj dituria në Islam, për parimet islame që janë themeli i jetës së njeriut duhet të mbështetet në Kur'an e sunet. Imam Aliu r.a. ka thënë: "E vërteta nuk njihet përmes njerëzve, por njihu me të vërtetën, do t'i njohësh edhe njerëzit e saj".

Sot më shumë se kurrë kërkohet dituri e kulturë, sepse shpirti i pastër që na është dhuruar po dhunohet, egoizmi po mposht dashurinë vëllazërore, degjenerimi po mposht vlerat morale etj. ku janë shtuar elemente tërheqës për të keqen dhe që vështirësojnë të mirën. Prandaj ne kemi nevojë t'i kthehemi besimit të vërtetë, sepse ai mund t'i japë qetësi jetës sonë, do të bashkojë mendjen me zemrën, shpirtin me materien, do të bashkojë detyrat ndaj vetes me detyrat ndaj Zotit të madhëruar dhe do të bashkojë këtë botë me botën tjetër.

---

[122]. Kur'an, El-Bekare: 256.
[123]. Kur'an, El-Bekare: 111.

1.6 Besimi pa veprim dhe praktikë e humbet gjallërinë dhe fuqinë motivuese të tij.

Të besosh se çdo gjë që shikon në natyrë është krijuar nga një fuqi absolute që e zotëron atë dhe vepron i pavarur në vullnetin e tij, është Një, pa fillim e pa fund, e ka emrin Allah ose Zot, do të thotë që të jesh besimtar. Jemi urdhëruar që të besojmë në pesë pika bazë që janë themeli i fesë islame si: besimi në Zotin Një, në engjëjt, në librat e Zotit, në pejgamberët apo të dërguarit dhe në jetën e pasosur - Ahiret. Kur myslimani i pranon këto pika hyn në Islam, por mbetet formal nëse nuk zbaton urdhrat e porositë e ardhura nga Zoti xh.sh. dhe H. Muhamedi a.s.

Besimi në vetvete duhet të shtyjë besimtarin islam në bindje ndaj asaj që beson dhe kjo vërteton atë që ka hyrë në fenë islame. Jeta dhe vepra e tij në përputhje me pëlqimin e besimit e bën besimtarin të devotshëm, ndërsa kur do të shikohen diferenca midis besimit dhe veprave, atëherë themi se besimi është me mangësi. Prandaj themi se besimi pa veprime dhe praktikë e humbet gjallërinë e tij, e humbet fuqinë motivuese dhe nuk jep atë ushqim shpirtëror që është i domosdoshëm për të. Po cilat janë ato principe themelore që e aftësojnë njeriun dhe i kënaqin nevojat shpirtërore të tij? Ato janë principet kryesore të besimit islam si domosdoshmëri e shehadetit, falja e namazit, agjërimi, zekati dhe haxhi. Zbatimi në praktikë i tyre përfshin të gjitha vitet e jetës së besimtarit pa shkëputur asnjë ditë prej tyre. Kështu, zbatimi në praktikë i jep myslimanit ushqimin shpirtëror, gjallëri dhe ripërtritje çdo ditë, sepse e inspiron atë të jetë i rregullt e korrekt në ndërtimin e marrëdhënieve me të tjerët. Ajo që është themelore ka të bëjë me lidhjet e vazhdueshme me Krijuesin e tij. Besimi dhe zbatimi i principeve themelore të tij në praktikë janë të lidhura ngushtë midis tyre. Njeriu që nuk i vë në jetë këto, është pa burim frymëzimi, është njeri pa principe të qarta e të sigurta në jetë. Ai jeton vetëm për ditët që ka në dispozicion, gënjen veten dhe ngjason me nje udhëtar kalimtar që ka humbur rrugën që e çon në destinacionin e caktuar. Besimtarin e devotshëm e udhëheq motivi, ashtu siç thuhet në Kur'an: "Vetëm ty të adhurojmë dhe vetëm prej teje ndihmë kërkojmë"[124]. Ky qëndrim ndikon shumë në ruajtjen e ekuilibrit midis trupit dhe shpirtit, disiplinimit të kërkesave të tyre, e bën njeriun besimtar që të afrohet më shumë te Zoti i tij".

Feja islame e orienton besimtarin drejt mirëqenies shpirtërore e materiale dhe e bën atë që t'i përjetojë të mirat e kësaj bote, që të lënë gjurmë të pashlyera edhe për botën tjetër, ato do të jenë kapitali që do ta çojë në lumturinë e pafund në jetën tjetër. Drita e besimit të tij ia ndriçon rrugën, i forcon më tej dashurinë ndaj Zotit dhe nuk e humbet dashurinë për Të, nuk humbet besimin ndaj Zotit edhe në momentet më të vështira të jetës së tij personale, familjare dhe në shoqëri. Zoti xh.sh. në Kur'an urdhëron e thotë: "Ditën kur të vijnë disa shenja të Zotit tënd, atëherë nuk do t'i bëjë dobi askujt besimi i tij, nëse nuk ka besuar më parë ose nuk ka bërë ndonjë të mirë me besimin e tij!"[125]. Edhe nga ajeti kuptohet lidhja në mes të besimit dhe jetës kuptimplote të tij që ta udhëheqë atë në të gjithë aktivitetin e tij në miratim me ligjet e Allahut, për të cilin është krijuar dhe vetë natyra njerëzore. Detyra e njeriut është që t'i ushqejë të dyja, si shpirtin ashtu edhe trupin duke respektuar të drejtat e njëri-tjetrit dhe në unitet i japin kuptim të plotë jetës. Puna e parë që duhet të bëjë myslimani është të aplikojë lutjet dhe ibadetet e tij që janë ushqim shpirtëror dhe e bëjnë atë të

[124]. Kur'an, El-Fatiha: 5.
[125]. Kur'an, El-En'am: 158.

ndërgjegjshëm në bindje e nënshtrim të plotë ndaj ligjeve të Zotit xh.sh. dhe për çdo gjë mbështetet në mbrojtjen e Tij. Besimtari i tillë largohet nga gënjeshtra, shpifja, trillimi, përgojimi dhe flet gjithmonë të drejtën, të vërtetën, përkrah të mirën e të tjera si këto. Të gjitha këto konsiderohen ibadete - adhurime, sepse janë në zbatim të porosive të Zotit xh.sh. Po kështu konsiderohen ibadete tregtia hallall edhe shitja, blerja dhe furnizimi hallall me mjete jetësore. Në çdo çast të jetës, kur myslimani bën veprime në pëlqim e miratim të ligjit Hyjnor deri te ngrënia, pirja, fjetja, ngritja, ndenja, qëndrimi, ecja, folja, heshtja etj,. janë nga llojet e ibadeteve. Ky është adhurimi apo lutja që është urdhëruar të bëjë njeriu për t'u aftësuar për ibadete më të mëdha që konsiderohen farze në Islam. Këto farze janë shtylla mbi të cilat ngrihet ndërtesa e fesë islame. Për shembull: namazi është një nga shtyllat e Islamit dhe konsiderohet themeli bazë pas dëshmisë së shehadetit.

Në namaz besimtari pohon përpara Zotit xh.sh. nënshtrimin e plotë të tij, kërkon ndihmë dhe udhëzim prej tij, kërkon mbështetje tek Ai, dëshmon për qenien e pejgamberit të tij, kujton ditën e gjykimit, për veprat që ka bërë do të marrë shpërblimin e merituar etj.

Namazi është një nga mjetet që forcon pesë herë në ditë rrënjën e besimit islam, duke i sjellë atij ndërmend në çdo namaz idetë që kufizohen në pastrimin e zemrës, në lartësimin e shpirtit, në sjelljet e mira dhe veprat e dobishme. Këtë e bën disiplina e ndërgjegjshme e kryerjes së namazit si abdesi, leximi i Kur'anit, mbështetja në Zotin Fuqiplotë, ndjekja e të dërguarit të Tij. Të gjitha këto veprime i bën edhe në fshehtësi kur nuk e shikon askush.

Kush e detyroi besimtarin të prishi gjumin e mëngjesit? Pse frikësohet në namaz që të mos gabojë në leximin e Kur'anit? Ai i bën të gjitha këto për bindjen e plotë dhe ndërgjegjen që ka ndaj Zotit xh.sh. Ai besimtar që nuk i kryen namazet e tij pa asnjë arsye, ka shkelur detyrën e ngarkuar nga ana e Zotit dhe konsiderohet mëkat si ndaj Zotit, edhe ndaj natyrës së tij të krijuar për këtë qëllim.

Duhet ditur mirë se Zoti xh.sh. nuk ka nevojë për adhurimin, faljen e lutjen e njeriut, por këto janë bërë detyrë me qëllim që të ndihmojmë atë, se çdo e mirë që bëhet është në dobi të tij. Në fenë islame namazi është forma që përmbledh në vetvete llojet e lutjeve, dorëzimeve dhe përgjërimeve të ndryshme. Prandaj është bërë detyrë (farz) në natën e Miraxhit me 621 e.r., ashtu siç thuhet: "namazi është detyrë për besimtarët në kohë të caktuar"[126] dhe si i tillë është shtyllë e fesë islame. Në Kur'an, namazi është shprehur me fjalën "salat", që është një lloj duaje, lutjeje e përcaktuar dhe përmendet në 99 vende, ndërsa fjala "dua" përmendet në 167 vende. Namazi dhe lutja janë ato që përshkruajnë më shumë Kur'anin. Mirësia, të cilën besimtari mund ta përfitojë nga namazi është e pakufishme sepse përforcon besimin në Zotin xh.sh. e gjallëron aktivitetin jetësor të tij, i ndihmon të kuptojë qëllimin për të cilin është krijuar, i pastron zemrën dhe i jep forcë shpirtit të tij për të përballuar çdo gjë. Namazi i bashkon të gjitha forcat të veprojnë në unitet për të përballuar të gjitha pasionet e ulëta që e poshtërojnë personalitetin e njeriut dhe e turpërojnë para Krijuesit të tij.

Mirëpo përgjithësisht sot shihet një mungesë vullneti e qëllimi te shumica e atyre që e konsiderojnë veten myslimanë për të falur namazin, madje tregojnë edhe një ndërgjegje të dobët përpara të tjerëve. Kemi dëgjuar shprehje të tilla: "unë jam mysliman, besoj Zotin, ndërgjegjen e kam të pastër, nuk bëj punë të këqija, por namazin nuk e bëj. Zoti do të më falë". Këto janë mendime të

[126]. Kur'an, En-Nisa: 103.

gabuara dhe të dëmshme, madje edhe të huazuara. Namazi, krahas vlerave që u përmendën, të bën të disiplinuar dhe me vullnet të palëkundur, një ushtrim fiziko-shpirtëror që realizon dashurinë ndaj Zotit dhe përkujdesjes që fiton nga Ai; i bën të duan njëri-tjetrin për hir të Zotit; i bën të jetojnë në harmoni me të gjithë si në jetën familjare ashtu edhe shoqërore e qytetare. Në Kur'an thuhet: "Lexo (o Muhamed) atë që të është zbritur ty prej Librit (Kuranit) dhe fale namazin! Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar"[127]. Përmendja e Allahut qëndron mbi çdo gjë tjetër, çfarëdo që të bëni apo të shprehni, nuk do t'i bënte drejtësi shtrirjes së fuqisë së Allahut xh.sh., lavdisë e madhështisë së Tij, si të dukshme ashtu edhe të padukshme. Prandaj duhet lavdëruar Allahu dhe për këtë Zoti xh.sh. Kur'anin, shpalljen e Tij e fillon me dy fjalë që kanë kuptimin e falënderimit dhe njëkohësisht është hymni i Allahut "El hamdu-lil-lahi rab-bil alemijn", që do të thotë "lavdëruar qoftë Allahu, frymëzuesi dhe mbështetësi i universit". Ne duhet të falënderojmë Allahun që krijoi jetën, që na dha mundësi të marrim frymë, që na dhuroi të folurit, e cila kontrollon gjuhën. Zoti xh.sh. në Kur'an, urdhëron e thotë: "Ai ju jep gjithçka që i kërkoni. Edhe nëse përpiqeni t'i numëroni dhuntitë e Allahut, nuk do të mund t'i numëroni dot. Njeriu është vërtet i padrejtë dhe mosmirënjohës"[128]. Të padobishme janë të gjitha veprat që nuk burojnë nga besimi i drejtë, ato nuk kanë peshë dhe nuk i shërbejnë njeriut. Prandaj njerëzit nuk duhet të jenë mendjelehtë e të nënshtrohen ndaj çdo kënaqësie të kësaj jete dhe të imitojnë ata që kryejnë akte të shëmtuara, në kundërshtim me ligjet e Zotit. Besimtari i devotshëm mbështetet tek Allahu me adhurim e falënderim, së pari me shprehjen ne arabisht e pastaj me "Hamd", "tesbih", "istigfar", "teube" dhe këshillon për në rrugë të drejtë. Adhurimi që del nga goja e besimtarit është një shprehje e bukur, e këndshme, personi i së cilës është si pema që nuk i ndërpret frutat asnjëherë dhe e qëndrueshme përpara çdo stuhie apo furtune. Ndërsa besimtari i zhveshur nga lutja dhe adhurimi është i dobët dhe i përngjan pemës me rrënjë të dobëta, që shkulet lehtë nga furtuna. Prandaj besimtari duke e njohur këtë realitet, përcakton qëndrimin e tij të drejtë, nuk shkëputet nga ibadeti-adhurimi, lutja e falja, që janë mburoja mbrotjeje ndaj nxitjes së pasioneve të shfrenuara, i qetëson ato sipas kërkesave e dëshirave të veta në përputhje me një program veprimi të shpallur nga Zotit xh.sh. Feja islame e harmonizon mirë kohën që shpenzon njeriu në dobi të ndërtimit të jetës materiale, individuale, familjare e shoqërore, me atë të përkushtimit të adhurimit direkt si falja e namazeve, lutje apo duave etj. Ajo nuk e bën njeriun nënshtrues të plotë të saj, por as edhe nuk i jep liri të plotë që ta çojë atë në humnerë të plotë, por përkundrazi realizon respektimin e tij të vërtetë si njeri.

Të gjitha qeniet e gjalla e jo të gjalla i thurin lavde Zotit xh.sh., ashtu si thuhet në Kur'an, ku shprehet: "A nuk e vëren ti, se Allahun e lavdëron çdo krijesë që ndodhet në qiej dhe në Tokë, madje edhe shpezët krahëhapur?! Çdokush e di se si t'i falet e ta lavdërojë. Allahu e di mirë çfarë bëjnë ata."[129]. "Atë e madhërojnë shtatë qiejt, Toka dhe gjithçka gjendet në to. Dhe nuk ka asgjë që nuk e madhëron Atë, duke e lavdëruar, por ju (o njerëz) nuk e kuptoni madhërimin që i bëjnë ata. Ai, me të vërtetë, është i Butë dhe Falës."[130].

---

127. Kur'an, El-Ankebut: 45.
128. Kur'an, Ibrahim: 34.
129. Kur'an, En-Nur: 41.
130. Kur'an, El-Isra: 44.

Nga të dy ajetet lind një pyetje shumë kuptimplotë: Si ka mundësi që një zog të këndojë lutje dhe t'i bëjë tesbih Zotit dhe njeriu si qenia më e përsosur të qëndrojë indiferent? Nga lindja në perëndim, nga Hëna drejt Diellit, Zoti xh.sh. i ka vënë në lëvizje, ka vendosur planetin e Tokës në ujë, që rrotullohet në atë mënyrë që ka krijuar florën dhe faunën (botën bimore e shtazore), aq të domosdoshme për jetën e njeriut e gjallërimin në të, duke e mbushur me ushqimet më të shijshme në dobi të tij. Për të mirën e njeriut çdo gjë është e mbikëqyrur dhe e nënshtruar, si ka mundësi që njeriu të neglizhojë në detyrat ndaj Tij, (falënderim, lutje e falje)?

Asnjë sasi falënderimesh nuk do t'i bënte drejtësi një shfaqe të mrekullueshme të kësaj gjithësie. Vetëm mjeshtëria e përsosur e Zotit ka ditur të errësojë natën për pushimin e njerëzve e ta ndriçojë ditën për angazhimin e tyre për të siguruar jetesën.

Jeta e njeriut i përngjan një fluture në relacion me nisjen e jetës së saj e deri në fund. Gjatë atij relacioni shënohet gjithçka dhe më vonë këto lexohen. Po kështu edhe gjatë gjithë jetës së njeriut mbahet shënim i veprave, që në ditën e gjykimit t'i lexojë ai vetë. Çdo njeri është përgjegjës i punës së vet. Askush nuk do të shpërblehet prej punës së tjetrit e as nuk do të ndëshkohet. Të dhënat e Zotit xh.sh. nuk janë të kufizuara vetëm për disa njerëz, por janë të dedikuara për të gjithë njëlloj. Duhet pasur kujdes në përgatitjen për botën tjetër, për jetën e pasosur, sepse të mirat e kësaj bote janë kalimtare dhe nuk bën të humbasë e përjetshmja për të përkohshmen.

Adhurimi, falja e lutja nuk duhet të shkëputen nga jeta dhe aktiviteti jetësor i njeriut, por të krijojnë një harmonizim të tillë që përcaktojnë Unin Njeri dhe përsosin personalitetin e tij në përputhje me ligjet hyjnore. Nga ana tjetër njerëzit që nuk janë inkuadruar në radhët tona, kur ne hyjmë në xhami, shohin me nënqeshje. Ata duhet t'i nënshtrohen arsyes së qetë dhe me objektivitet që të shkojnë drejt besimit të pashmangshëm. Kur të arrijë besimi i vërtetë te Zoti dhe H. Muhamedi si i dërguari i Tij, që janë baza të besimit, atëherë do të kalojnë natyrshëm, me ndërgjegje e bindje në adhurim, falje e lutje.

Gjatë zbatimit të ligjeve të Allahut që janë përsosmëria, dija dhe adhurimi, lutja dhe falja, besimtari arrin synimet e tij, qëllimin për të cilin është krijuar. Ashtu si thuhet në Kur'an ku shprehet: "Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar"[131]. Namazi është mjeti më i mirë që e largon njeriun prej punëve të këqija, natyrisht kur ai kryhet brenda të gjitha rregullave të parashikuara, kur ai falet me vëmendje, me përkushtim ndaj Allahut, me vështrim të domethënies së Kur'anit që lexohet gjatë faljes. Në të gjitha pjesët e namazit përkujtohet madhëria e Allahut e përkujtimi i madhërisë së Tij, është lutja më e madhe.

Në këtë mënyrë besimtari islam mbetet një personalitet që harmonizon besimin me adhurimin, që harmonizon besimin me veprat praktike të punës së përditshme. Besimi i tillë e tërheq myslimanin drejt lidhjes dhe disiplinimit me praktikën, me punën e përditshme, ku i paraprin gjithmonë qëllimi i sinqertë, i pastër në besimin ndaj Zotit xh.sh. Ashtu siç thuhet në Kur'an: "Kurse ata që besojnë e bëjnë vepra të mira, do të jenë banorë të Xhenetit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë"[132]. Edhe nga ky ajet kuptohet se besimi pa vepra humbet forcën dhe rezistencën ndaj mbrojtjes nga veprat e këqija dhe nuk do të sigurojë xhenetin. Ashtu si thuhet në Kur'an ku

[131]. Kur'an, El-Ankebut: 45.
[132]. Kur'an, El-Bekare: 82.

shprehet: "Pastaj përfundimi i atyre që punuan keq, ka qenë e keqja e madhe (Xhehenemi), ngase i mohonin shpalljet e Allahut dhe talleshin me to"[133].

Nga kuptimi i dy ajeteve del qartë se në qoftë se besimi do të ishte në harmoni me veprat konkrete, atëherë do të forconin njëri-tjetrin, do të ngrinte në një shkallë më të lartë shpirtin e besimtarit dhe do ta bënte atë të ndjeshëm për çdo gjë. Kjo do të realizonte qëllimin e njeriut në jetë. Myslimani i vërtetë dhe i sinqertë është ai që u përmbahet të gjitha detyrimeve të fesë islame, pa prishur ekuilibrin me përkushtimin ndaj punës në ndërtimin e jetës materiale. Në qoftë se zbatohet një pjesë e këtyre detyrimeve, atëherë besimtari i shmanget rrugës së drejtë. Nga kjo dallojmë dy qëndrime të njeriut në jetë: I pari u përmbahet të gjitha detyrimeve fetare, është njeri i qëndrueshëm, konstant gjatë gjithë jetës dhe i dyti që nuk i zbaton apo zbaton një pjesë të tyre dhe mban një pozicion të ndryshëm.

Sipas fesë islame, besimtari që mban një pozicion të qëndrueshëm në jetë, shpreh pandryshueshmërinë e rregullave të adhurimit, të faljes e lutjeve si dhe të ligjeve të fesë. Këto ligje kënaqin nevojat shpirtërore të njeriut dhe e bëjnë atë gjithmonë të gëzuar në jetën e tij, përsosin regjimin e tij, e bën të krijojë lidhje harmonike me njerëzit që e rrethojnë, duke mos shkelur në gabime apo vese negative. Për besimtarin që nuk i plotëson detyrimet fetare, krijohet një farë zbrazëtie tek ai, prandaj duhet të orientohet nga rregullat e përgjithshme të fesë islame, të përmbushë atë zbrazëti dhe të bëhet një njeri besimtar i qëndrueshëm në jetën e tij.

Kthesën besimtari e merr atëherë kur i lutet Zotit dhe bën pendesën për atë që ka bërë jo mirë. Lutja dhe pendesa e frymëzojnë besimtarin që të realizojë e konkretizojë veprimet e tij duke i izoluar të gjitha pengesat midis tij dhe Zotit xh.sh. që i lutet duke i kërkuar pendesën. Vetë lutja e edukon besimtarin dhe ia mëson të gjitha rregullat dhe ligjet Hyjnore nga të cilat do të udhëhiqet.

Thuhet se Zoti xh.sh., në qoftë se do të zemërohej nga ndonjë sjellje e keqe e njeriut apo mëkat i tij, Ai do ta fshinte atë mëkat nga libri i njeriut, sapo ky person të shprehte keqardhjen për atë që ka bërë. Prandaj besimtarët duhet të falënderojnë Zotin xh.sh. për fshirjen e mëkateve me anë të lutjeve penduese apo teube, siç e shprehin në arabisht.

Teube do të thotë "kthim në gjendjen e mëparshme, origjinale, të pastër". Kjo kërkon një pendesë e premtim se nuk do ta përsërisë gabimin, sepse në këtë rast është dëshmitar Zoti xh.sh. dhe nuk pranohet asnjë justifikim në rast të përsëritjes së gabimeve. Pendimi konsiderohet i plotë kur njeriun e vret ndërgjegjja për atë që ka bërë, lëshohet një mesazh i brendshëm nga ai që Zoti xh.sh. do ta marrë në konsideratë, sepse është falës dhe mëshirues. Ashtu si thuhet në Kur'an: "Vërtet, Unë jam Falës për atë që pendohet, beson e bën vepra të mira dhe pastaj qëndron në rrugë të drejtë"[134]. Pra, teubeja është një nga format e lutjeve, krahas të tjerave që u përmendën dhe e bën besimtarin të konkretizojë besimin e tij me vepra.

Si përfundim përmendim shkurtimisht format e zbatimit të besimit në praktikë në këto drejtime:

1. Adhurimi, falja e lutja në gjithë veprimtarinë jetësore të njeriut t'i drejtohet me sinqeritet e pastërti vetëm Zotit xh.sh.

---

133. Kur'an, Er-Rum: 10.

134. Kuran, Taha: 82

2. Besimtari gjatë adhurimit ndodhet më afër se kurrë me Zotin xh.sh. dhe realizon dy qëllime kryesore menjëherë, domethënë ai është i çliruar nga marrëdhëniet me këtë botë, veç Zotit xh.sh. dhe është përpara prezencës Hyjnore që e vëzhgon atë për përkushtimin që ka ndaj Tij.

3. Adhurimi e shmang nga instinktet e shfrenuara dhe ia kënaq nevojat shpirtërore duke përmbushur të gjitha kërkesat normale si njeri.

4. Adhurimi që plotëson të gjitha normat morale të njeriut sipas islamit, nuk e kufizon atë vetëm në faltore, xhami, por kudo që të jetë. Të gjitha cilësitë e tij pozitive deri te martesa e ndershme, konsiderohen adhurim.

5. Adhurimi synon të edukojë te njeriu ndjenjën e përgjegjësisë personale e shoqërore dhe secila prej tyre kontribuon në afrimin me Zotin, sepse bashkimi i këtyre interesave është rruga që na ka udhëzuar Zoti xh.sh. në Kur'an.

6. Adhurimi është mjeti që bashkon mendimin me veprimin në praktikën e jetës së përditshme.

7. Adhurimi e pajis njeriun me një edukatë të shëndoshë, që të kuptojë e përvetësojë edhe gjërat e fshehta që nuk i kupton mendja e njeriut, t'i nënshtrohet për çdo gjë Atij, pavarësisht nëse e kupton ose jo interesin që ka nga ky veprim. Me përmbajtjen e tij dhe me hollësirat dhe urtësitë që ka brenda, adhurimi edukon vetëm adhurim.

I lutemi Zotit xh.sh. që të na japë mbarësi për realizimin në praktikë të udhëzimeve Hyjnore dhe, me lejen dhe dashurinë e Tij, të na bëjë banorë të xhenetit.

Amin!

1.7. Trupi i njeriut, argument i ekzistencës së Krijuesit

Allahu i Lartësuar në Kur'anin Famëlartë, thotë: "po edhe në vetet tuaja - a nuk e shihni vallë?"[135]. Do të thotë që njeriu është krijuar me aftësi për të menduar, planifikuar, zbukuruar, për të ndërtuar mbi dituritë e mëparshme dhe për të përdorur gjuhë të ndërlikuar. Njerëzit i kanë të gjitha shenjat se janë krijuar të ndarë dhe dallohen nga bota shtazore. Njerëzit shumohen vetëm brenda llojit të tyre. Te njeriu është një nga mrekullitë më të mëdha që ekzistojnë sot në tokë. Cila është? Është truri i njeriut që për një sekondë merr afërsisht 100 milion njësi informimi që vijnë prej shqisave të ndryshme. Si ka mundësi që mendja e njeriut t'i administrojë këto miliona mesazhe njëkohësisht? Kjo përbën një mrekulli të veçantë. Nuk do të ndalemi në ndërtimin e trurit, në pjesët e tij dhe funksionet që kryen secila, sepse kërkon edhe nivelin e duhur për t'u kuptuar, por do të theksojmë mrekullinë e qendrës së kontrollit të miliona mesazheve që mbërrijnë në tru. Këto mesazhe seleksionohen dhe bllokohen ato që janë të parëndësishme, duke lejuar të kalojnë ato që kanë interes dhe i përvetëson në mënyrë të ndërgjegjshme. Në çdo sekondë në trurin tonë zhvillohet një aktivitet i jashtëzakonshëm.

---

[135]. Kur'an, Edh-Dharijat: 21.

Shkenca mjekësore ka realizuar studime të rëndësishme mbi trurin, por kjo nuk është asgjë në krahasim me ato që kanë mbetur pa u zbuluar. Truri përbën një univers më vete me shumë mistere. Ky mister fillon që në mitrën e nënës. Në krye të tre javëve fillojnë të dalin qelizat e para trunore që më vonë në vazhdimësi shtohen deri në 250 000 qeliza në minutë. Te njeriu i rritur, megjithëse truri përfaqëson vetëm 2% të peshës trupore, përmban mbi 100 miliard qeliza nervore. Njeriu zotëron shumë aftësi të lindura për të mësuar, por njëkohësisht edhe aftësinë e nevojshme për formimin e intelektit njerëzor. Me vullnet të lirë mund ta programojë atë, në bazë të njohurive, të vlerave dhe mundësive që kemi si dhe synimeve që i vëmë vetes. Kështu ndodh p.sh. me muzikantët. Një pianist i lëviz gishtat në tastierë me një precizion të saktë me notat e muzikës të regjistruara në trurin e njeriut.

Kurioziteti i trurit të njeriut shtrihet në shumë fusha të jetës. Tek ai shumë aftësi shfaqen në imagjinatë dhe konkretizohen në shpikje të reja. Kështu ai ndërton diçka të re mbi bazën e njohurive të mëparshme të lidhura me ato që fiton.

Truri i njeriut përfaqëson në vetvete kompjuterin më të përsosur në botë, me mbi 100 mijë programe në veprim të përhershëm, që, po të shtrihen, arrijnë një sipërfaqe prej 250 mijë km^2.

Njeriu lind me shumë aftësi të programuara, një nga të cilat është aftësia për të folur e programuar që në embrion, në kodin gjenetik. Truri i njeriut është i predispozuar për të mësuar shumë gjuhë me aftësinë e lindur. Kur ai jeton në vende të ndryshme dhe bie në kontakt me gjuhët e tyre, është në gjendje t'i mësojë këto gjuhë. Por shkenca e neurologjisë nuk ka mundur të depërtojë thellë në sekretet e mekanizmit të të folurit. Vetëm Krijuesi, Zoti i Lartësuar i njeh misteret në zonat e përcaktuara të trurit për përpunimin e të folurit.

Truri i njeriut është në gjendje të memorizojë çdo informacion që i jepet dhe kjo vazhdon të shumohet me miliarda herë gjatë jetës. Ai zotëron aftësinë e të menduarit abstrakt dhe me ndërgjegje bën plane për të arritur objektivat e tij në jetë. Sipas momenteve të jetës mund të shfaqë gëzime, por edhe hidhërime. Në këto raste përsëri ka aftësinë t'i përballojë me sukses dhe të ndjejë kënaqësi e lumturi në çastet më të bukura të jetës. Ndjenja e humanizmit tek ai është e lindur, por në jetë besimtari e manifeston më bukur në ndihmë të jetimëve, të varfërve, jo vetëm shpirtërisht, por edhe materialisht. Kështu ndodh edhe me moralin, i cili në saje të tij, dallon të mirën nga e liga, të moralshmen nga e pamoralshmja, të bukurën nga e neveritura etj.

Prandaj njeriu duhet të ndërtojë jetën në përputhje me ligjet e Zotit të Lartësuar, sepse tek Ai e kemi burimin e jetës dhe përsëri tek Ai do të kthehemi. Ne duhet të pranojmë faktin se të gjitha fenomenet negative që ndodhin sot në shoqërinë tonë, janë në shërbim të qëllimeve të djallit të mallkuar. Ai dëshiron që njerëzit të ndjekin rrugën e tij duke mohuar urdhrat e Krijuesit, Allahut të Lartësuar.

E ardhmja e njeriut nuk ndërtohet me drogë, prostitucion, kriminalitet, me vjedhje e grabitje të pronës së tjetrit. Çdo njeri e në veçanti besimtari, duhet t'i drejtojë pyetjen vetes: Ku qëndroj unë në lidhje me detyrat e dhëna nga Krijuesi? A dëshiroj të përfitoj parajsën e së nesërmes? Ai plotësoj kërkesat e Allahut të Lartësuar për të mbijetuar? Nëse duam një jetë të qetë, pa kriza familjare, pa divorce e fëmijë jetimë, të ndjekim ligjet e Allahut, të ndjekim shembullin e profetit Muhamed, të ndjekim shembullin e besimtarëve të devotshëm që respektojnë ligjet Hyjnore.

Në jetën e përditshme njeriu është në kontakt të vazhdueshëm me natyrën përreth, me botën bimore, pyje, male, kodrina, me botën e kafshëve tokësore e ujore, me pafundësinë e qiellit me yje etj. dhe sa i vogël duket përpara këtyre. Pyetjet dhe pse-të e shoqërojnë njeriun për gjërat e panjohura, të krijuara me përsosmëri nga Krijuesi, arkitekti suprem, që njihet me emrin Allah ose Zot.

Të kthehet te vetja e tij. A nuk është e habitshme që njeriu e ka fillin në vezën e vendosur në mitrën e nënës? Prej këtu nisin të zhvillohen organet si zemra, mushkëritë, stomaku, zorrët, veshkat, tëmthi etj. Prandaj rruga e mençur dhe urgjente është që njeriu me vetëdije t'i kthehet besimit në Zot.

Zoti në Kur'anin Famëlartë thotë: "Thuaju: "Është Ai që ju ka krijuar dhe ju ka dhënë dëgjimin, shikimin dhe zemrat, e megjithatë ju pak e falënderoni!"""[136]. Do të thotë që arkitektin që projektoi teknologjinë më absolute në organet e trupit tuaj, ju njerëz nuk keni mirësinë ta njihni e ta falënderoni pa pushim Krijuesin tuaj, Allahun e Lartësuar, që ju përsosi për të qenë krijesa më e zgjedhur në rruzullin tokësor. Nuk ka konstruktor që të projektojë organin e të parit në mënyrë të përkryer, veçse Një i vetëm, absolut, i plotdituri, i cili ka njohur mirë ligjet e okulistikës. Po ashtu edhe organin e të dëgjuarit, veshin. Struktura e veshit të jashtëm, të mesit dhe atij të brendshëm janë ndërtuar në mënyrë të tillë që të njohin zërat dhe të përcaktojnë vendin prej nga vijnë. Ai dallon edhe zërin me të ulët e deri fështërimën e krahëve të insekteve; duke arritur deri atje sa të njohë zërin që i intereson. Por jo vetëm kaq. Veshi funksionon edhe kur njeriu është në gjumë, sepse i merr sinjalet që përcjell truri. Mund të flejë në mes të zhurmave të makinave, por mund të zgjohet edhe nga një tingëllim i ziles së orës. Ai mund të dëgjojë e dallojë afro 400 mijë zëra, por ajo që është më e rëndësishmja në funksionimin e tij, është përgjegjës për të mbajtur trupin në ekuilibër, nëpërmjet dy sistemeve që janë vendosur në veshin e brendshëm. Cili konstruktor do të mund të ndërtonte një organ të tillë të përsosur prej mishi, që percepton tingullin e zërit të lidhur me mendimin abstrakt për të artikuluar fjalën e vënë në lëvizje gjuhën në komunikim me të tjerët. Jo vetëm veshi, por edhe të gjitha organet e trupit tregojnë ekzistencën e Allahut të Lartësuar. Pjesa tjetër e ajetit që bën fjalë për organet e shqisave, është syri, një organ kaq i saktë në identifikimin e sendeve saqë asnjë teknologji nuk mund të arrijë ta ndërtojë, me përjashtim të mjeshtrit absolut që ka njohur ligjet e optikës, ka projektuar një organ të tillë, mbi ngjasimin e të cilit janë ndërtuar aparatet fotografike, por jo prej mishi. Zoti në Kur'an thotë: "A nuk i kemi dhënë Ne atij dy sy, edhe gjuhë, edhe dy buzë, dhe ia kemi bërë të qarta të dyja rrugët?"[137].

Rrezet e diellit që janë dhunti e Allahut të Lartësuar përcillen në trurin e njeriut, pasi përpunohen, dërgojnë impulse në sy, ku japin pasqyrën e objektit (sigurisht këtu nuk ndalemi në hollësitë teknike të ndërtimit të syrit që kërkon specialist për ta kuptuar).

Pra është e qartë se organet e shqisave dhe pjesët e tjera të organizmit të njeriut, që quhen organe, vërtetojnë ekzistencën e Allahut, që ka fuqi dhe dituri absolute për çdo gjë. Në to ka vendosur ligje, ashtu si thuhet në Kur'anin Famëlartë ku shprehet: "Ti kurrsesi nuk do të gjesh ndryshim në ligjet e Allahut"[138]. Do të thotë që për çdo krijim janë vendosur ligje të veçanta, që me

[136]. Kur'an, El-Mulk: 23.
[137] Kur'an, El-Beled: 8-10.
[138] Kur'an, El-Ahzab: 62.

përsosmërinë më të madhe projektuese janë realizuar gjallesa, që janë në harmoni me natyrën përreth. Në veçanti organizmi i njeriut me organet speciale që kryejnë funksione jetësore në harmoni me njëra-tjetrën duke formuar në unitet organizmin e plotë të njeriut. Po si arrijnë që nga një pikë uji të kthehen në organe e deri në organizëm? Të gjitha këto janë shkruar në vezën e pllenuar në mitër, e cila përmban një program të brendshëm që përcakton kohën, afatin kur duhet të formohen me një renditje mahnitëse në momentin e shfaqjes. Sot shkenca ka arritur të zbulojë e vërtetojë se këtë program arkitekti suprem, Zoti e shkroi në kodin gjenetik. Vetëm mushkëria si organ frymëmarrje ka mbi 400 milion valvula që po të shtrihen arrijnë një sipërfaqe mbi 150 m^2. Ndërsa në mes kraharorit dhe barkut ndodhet një muskul që nuk i pushon lëvizjet. Afërsisht gjatë një ore bën 11 mijë lëvizje që ul dhe ngre kraharorin.

Njësia më e vogël e organizmit është qeliza nga ku fillon jeta. Por kjo në vetvete përbën një uzinë mikroskopike, që nga brenda është elektrizuar me ngarkesë negative, kurse nga jashtë me ngarkesë pozitive që prodhon energjinë e qelizës. Është për t'u habitur se si në muret e kësaj qelize ka rrahje të posaçme që kontrollojnë atë që hyn e del prej saj, që mbikëqyrin ndonjë shenjë rreziku që i vjen nga jashtë. Ato rrinë të gatshme të përleshen me armiqtë që duan t'i pushtojnë. A nuk është ky një projekt i përsosur i Krijuesit? Po madje, si arrin ajo të administrojë miliona mesazhe në të njëjtën kohë? Mënyra e vetme është mrekullia e Krijuesit, e një intelekti suprem, që është përgjegjës për projektimin dhe zhvillimin e lidhjes së pabesueshme tru-mendje.

Pra në trupin e njeriut ka argumente mahnitëse për të besuar në ekzistencën e një Krijuesi të padukshëm, cilësitë e të Cilit, fuqia dhe dituria e përjetshme, janë të dukshme në veprat e tij. E pajisi njeriun me mendje e gjykim të lirë, por liria e tij është relative e jo absolute. Njeriu nuk mund të vendoste vetë se cila është e drejtë dhe cila është e gabuar dhe prandaj Zoti dërgoi udhëzues dhe librat e shenjtë dhe së fundi Kur'anin për ta njohur Krijuesin, i cili i solli udhëzimet te njeriu për ta çuar atë tek e drejta dhe e vërteta.

Njerëzimi gjatë historisë ka krijuar pavarësi nga Krijuesi me zbulime e teknologji të reja, por nuk i ka zgjidhur problemet jetësore. Kjo tregon se nuk jemi të aftë të jetojmë të pavarur dhe të largohemi nga Krijuesi dhe ligjet e Tij. Megjithëse ka zotëruar atomin, ka udhëtuar në hapësire e deri në Hënë, përsëri nuk ka arritur të krijojë atë lumturi që ka nevojë shoqëria njerëzore. Njerëzimi ka përjetuar luftëra shkatërrimtare, por sot është shtuar kriminaliteti e deri brenda familjes, po përjetojmë kriza familjare etj. Këto tregojnë se njeriu nuk mundet të administrojë mirë punët e tija pa ndihmën e Krijuesit. Njerëzit sot kanë nevojë t'i drejtohen Allahut të Madhërishëm në drejtimin e punëve të tyre ashtu sikurse kanë nevojë për ushqimin e përditshëm.

Njeriu nuk mund të parashikojë me saktësi të ardhmen, sepse nuk është i pavarur. Kjo shkon përtej mundësive të tij, pasi Krijuesi i tij zotëron të gjitha faktet e nevojshme, që edhe mund të ndikojnë mbi ngjarjet që i ndodhin në jetë. Mënyra e zgjidhjes duhet bërë në emër të Krijuesit, ta falënderojë e adhurojë atë pa pushim. Pra, bindu ti njeri se është Krijuesi yt, Zotëruesi yt, pa të cilin ti as mund të jetoje, as mund të punoje, as mund të ndërtojë gjithë jetën tënde.

Është për të ardhur keq se sot ka intelektualë që e heqin veten të shkolluar dhe nuk e pranojnë arkitektin suprem të organizimit të përsosur të organizmit të njeriut duke u shprehur se "Zotin nuk e shohim". Me këtë ide ata justifikojnë mosbesimin e tyre. Ata harrojnë se në jetën e përditshme ndeshen me shumë gjëra që nuk i shohin, por i besojnë. A e shohin elektricitetin që ndez

llampën? A i shohin valët e radios? A e shohin mendjen e tyre? Shihen efektet e tyre. Edhe Krijuesi nuk shihet, por çdo gjë që shohim është argument i ekzistencës së Tij. Kështu universi është i organizuar në mënyrë të jashtëzakonshme me planetin e mrekullueshëm, Tokën, ku në mënyrë të çuditshme janë vendosur dhe jetojnë gjallesat si dhe me trupin mahnitës të njeriut. Janë të gjitha pasoja që duhet të kenë një shkak dhe ky shkak është ekzistenca e Krijuesit dhe arkitektit të gjithësisë, Zotit të Madhërishëm. Kjo do të thotë se Krijuesi, Zoti me cilësitë e Tija të padukshme, me fuqinë e Tij të përjetshme, bëhet i dukshëm nëpërmjet veprave të Tij. Këtu, duke u nisur nga veprat që janë pasojë e shkakut inteligjent të Zotit të Madhërishëm, vërtetohet plotësisht se asgjë nuk ka lindur në mënyrë të rastësishme me evolucion, por me krijim. Krijuesi e krijoi njeriun me mendje, që të gjykojë në mënyrë të lirë e jo në mënyrë instinktive si kafshët. Por kjo liri duhet ushtruar në mënyrë të ndërgjegjshme, me përgjegjësi, brenda kufijve të përcaktuar të Krijuesit, Zotit të madhërishëm që garanton jetën e mirë për të gjithë.

Duhet ditur se nuk ka liri absolute, ajo është relative. Kur kjo shfrytëzohet në mënyrë të papëlqyeshme dhe tejkalon në absolute, të çon në rreziqe përpara e deri në krime. Liria e plotë pa marrë parasysh përgjegjësinë para Zotit, e shkëput njeriun nga lidhjet me të dhe ai bëhet krejtësisht i pavarur dhe nuk është në gjendje të dallojë të mirën nga e keqja apo të vërtetën nga e pavërteta. Një nga krijesat e para frymore në qiell, që kërkoi mospranimin e udhëheqjes së Krijuesit, ishte djalli që me ambicien e tij e kundërshtoi autoritetin e Zotit, i Cili ia lejoi pavarësinë dhe është bërë armiku më i egër i njeriut që e shtyn në vepra të liga. Prandaj kërkohet udhëheqja Hyjnore për t'i treguar njeriut rrugën e drejtë e të vërtetë në jetë. Njeriu i lirë dhe i pavarur sot ka bërë gjëra të çuditshme që jo vetëm nuk i kanë sjellë lumturi, por përkundrazi ai i ka sjellë kriza familjare, ekonomike, varfëri e uri e deri kriminalitet. Pra, me gjithë sukseset e mrekullueshme në fushën e teknologjisë, njeriu akoma sot lufton me problemet më elementare për sigurimin e jetës. Zoti i Madhërishëm i drejtohet mendjes dhe i thotë: "O mendje, nuk kemi krijuar gjë më të dashur se ti tek Unë". Por kjo mendje si është përdorur dhe përdoret edhe sot? Zonja e nderuar, Aishe e pyet të dërguarin e Allahut: "Me se peshohen punët në dynja? Ai i përgjigjet: "Me mend". Po në ahiret? – e pyeti përsëri ajo. Ai i përgjigjet: "Me mend". Atëherë shohim tokën në të cilën jetojmë. Çfarë pasojash ka hequr ajo nga mendja e njeriut? Njeriu me pangopësinë e tij i ka katandisur disa zona në shkretëtira, me shkatërrimin e pyjeve, që mbrojnë njeriun nga sëmundjet e ndryshme. Substancat kimike dhe produktet e tjera nga mbetjet kanë ndotur tokën, ujërat dhe ajrin. Të gjitha kanë ndodhur sepse njeriu është larguar nga feja, nga ligjet e Krijuesit të tij. Mendja e dhuruar nga Krijuesi duhet ta falënderojë e respektojë atë në çdo moment të jetës. Imam Aliu r.a. ka thënë: "Feja është mendje dhe mendja është fe. Nuk është fe ajo që nuk e pranon mendjen dhe nuk është mendje ajo që nuk e pranon fenë". Prandaj duhet t'i kthehemi fesë me ndërgjegje, sepse njeriu ka nevojë për një udhëheqje në drejtimin e punëve të tij, sepse largimi nga kjo ka pasur pasoja shkatërrimtare. Njeriu ka nevojë për drejtimin e ligjeve Hyjnore të Allahut, ashtu si ka nevojë për ushqim, për ujë e për ajër. Mendja e njeriut duhet t'i analizojë gjërat gjithmonë nën dritën e mësimeve të Kur'anit Famëlartë. Edukimi me mësimet e normat Hyjnore dhe nënshtrimi ndaj ligjeve të Krijuesit, do t'i sigurojë njeriut paqe e lumturi në jetë. Truri i përsosur njerëzor, me potencialin e tij të madh për njohuri, i ushqyer me mësimet e fesë islame do të hapë gjithmonë perspektiva të reja për shoqërinë njerëzore.

2 Besimi në melekët (engjëjt) e Zotit

Ç'janë melekët?

Melekët janë krijesa të padukshme, të cilat Zoti i krijoi nga drita dhe i ka ngarkuar me detyra të veçanta. Ata i zbatojnë detyrat e caktuara me rregull e disiplinë të plotë, pa as kundërshtimin më të vogël. Janë qenie jo lëndore, që nuk hanë as nuk pinë dhe nuk bëjnë asnjë gabim në detyrat e caktuara si në tokë edhe në gjithësi.

Në Kur'anin Famëlartë janë dhënë njohuri për ekzistencën e tyre, disa prej të cilëve thirren edhe me emra e detyra si:

- Xhibrili, i cili u ka sjellë shpalljen Hyjnore të dërguarve të Zotit;
- Azraili është meleku i caktuar për ndarjen e shpirtit nga trupi i njeriut. Ndryshe quhet edhe meleku i vdekjes;
- Israfili është meleku që lajmëron ringjalljen e njeriut në jetën e pasosur;
- Kiramen Katibin janë melekët që e përcjellin njeriun, i sjellin mendime të mira dhe ata që i shkruajnë të gjitha veprat që kryen në këtë botë.
- Ka edhe një melek tjetër të cilin e mallkoi Allahu i lartësuar pasi bëri kryeneçësinë e tij. Ai është shejtani, qenie e padukshme që është i betuar për t'ia humbur mendjen njeriut dhe e shtyn në vepra të shëmtuara, që përbëjnë shkelje ndaj urdhrave dhe udhëzimeve të shpalljes hyjnore, të cilat konsiderohen mëkate ose gjynahe. Çdo person duhet ta dijë mirë se nxitja e njeriut për akte kriminale bëhet nga shejtani i mallkuar, prandaj duhet të mbrohet nga ai vetëm duke lexuar Kur'anin Famëlartë dhe duke rritur besimin e patundur te Zoti i Lartësuar, se vetëm tek Ai njeriu do të gjejë mbrojtje e qetësi shpirtërore.

Çdo njeri kur e sheh se e kap mërzitja, nxehja ose dëshpërimi dhe është i gatshëm të krijojë konflikte, menjëherë duhet të citojë shprehjen "Eudhu bil-lahi mine-shejtanirr-rra xhim", që do të thotë: "Lus Zotin që të më ruajë nga shejtani i mallkuar". Në çdo punë që kryen njeriu, kur hap derën e zyrës së punës ose të shtëpisë duhet të citojë fjalët: "Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim", që do të thotë: "Në (Me) emër të Allahut, Bamirësit të përgjithshëm, Mëshiruesit".

2.1 Engjëjt, lajmëtarë të padukshëm të Zotit të Lartësuar

Nuk ka kuptim besimi i njeriut pa besimin edhe tek engjëjt e Zotit. Ata janë të shumtë, me detyra të caktuara që përhapin mesazhet hyjnore të të dërguarit të Zotit. Këto mesazhe, udhëzime e urdhra përfundojnë në shkrime të shenjta që njerëzit duhet t'i marrin dhe me to të ndërtojnë jetën e tyre individuale e familjare. Ndodh që mesazhi i Zotit të vijë te njeriu edhe në formën e tij më konkrete, siç ndodh me Merjemen, kur e përgëzoi se do të lindë djalë. Në këtë rast ishte engjëlli Xhibril, i cili luajti rolin e ndërmjetësit duke dërguar fjalën e Zotit tek ajo se do të lindte djalë, Isain. Në Kur'an thuhet: "Ne dërguam tek ajo shpirtin tonë (Xhibrilin), i cili iu paraqit asaj si një njeri i plotë"[139] ose

[139]. Kur'an, Merjem: 17.

"Mesihu - Isai, i biri i Merjemes, është vetëm i Dërguar i Allahut dhe Fjala e Tij, të cilën ia ka dërguar Merjemes, si dhe shpirt (i krijuar) nga Ai."[140].

Nga kjo kuptohet qartë se mbrapa çdo krijese, qëndron një engjëll, që do të thotë se të gjitha krijesat janë mesazhe të dërguara nga Allahu i Lartësuar, të cilat na mësojnë për ekzistencën e Tij, të pa fillim e pa mbarim. Engjëjt luajnë rolin e ndërmjetësit në mes të Zotit të Lartësuar dhe krijesave të Tij në univers. Sigurisht ato janë të padukshme.

3 Besimi në Librat e Zotit

3.1 Librat e Zotit – Shpallje Hyjnore

Shpalljet Hyjnore të dërguara nga Zoti i Lartësuar, quhen "Libra të Zotit", sepse nëpërmjet melekut Xhibril, ua shpalli profetëve në kohë të ndryshme. Dallohen ndër librat më të vlerësuar si: Teurati, Zeburi, Inxhili dhe Kur'ani. Në këto libra ka udhëzime, këshilla, lutje dhe rregulla e ligje për jetën e njeriut.

I pari, Teurati i është shpallur Musait a.s., i dyti, Zeburi i është shpallur Davudit a.s., i treti, Inxhili i është shpallur Isait a.s. dhe i fundit, Kur'ani, i është shpallur të dërguarit të fundit, Muhamedit a.s.

Të dërguarit, nëpërmjet këtyre librave, kanë thirrur njerëzit në besimin monoteist, të Një Zoti të vetëm, t'i luten Atij dhe të zbatojmë udhëzimet dhe rregullat për ndërtimin e jetës. Janë këshilluar gjithmonë të kryejnë vepra të mira, në përputhje me udhëzimet e Zotit të Lartësuar. Veprat që kryhen në kundërshtim me këto udhëzime konsiderohen mëkate dhe në ditën e gjykimit, secili do të marrë shpërblimin ose ndëshkimin, sipas veprës së kryer.

Kur'ani, si libër i fundit, përmend librat e mëparshëm bashkë edhe me udhëzimet e pjesshme të të dërguarve të hershëm që nga i pari, Ademi a.s., deri më sot, duke iu përgjigjur zhvillimit në shkallët më të larta të tij. Dispozitat e Kur'anit i shërbejnë zhvillimit të shoqërisë njerëzore deri në ditën e fundit, kur bota do të përmbyset.

Muhamedi a.s. e ka marrë shpalljen nga Xhibrili a.s. për 23 vjet me radhë, nga të cilat 13 vjet në Mekë dhe 10 vjet në Medinë. Kur'ani përmban gjithsej 114 kaptina ose sure dhe 6638 ajete, të mësuara përmendësh nga i dërguari i Zotit dhe shokët e tij dhe janë regjistruar me porosinë e Muhamedit a.s. nga sekretarët e tij. Ai u botua si libër më vete në kohën e kalifit të tretë, H. Osmanit r.a.

3.2 Kur'ani, baza e besimit islam

Përse Kur'ani është baza e besimit islam?

Kur'ani është baza e vërtetë mbi të cilën qëndron e gjithë ndërtesa e fesë islame dhe, meqenëse është i vetmi autoritet në çdo diskutim që ka të bëjë me parimet islame, mund të themi me plot të drejtë se Kurani është i vetmi burim nga i cili dalin të gjitha mësimet e fesë islame.

[140]. Kur'an, 4:171.

Feja islame është një përmbledhje ligjesh e rrugësh, sistem i vendosur nga Zoti i Lartësuar që përmban rregullat dhe ligjet fetare, rregullat e etikës e të moralit, si dhe të gjitha dispozitat e marrëdhënieve të cilat Zoti xh.sh. ua komunikoi pejgamberëve për të udhëzuar njerëzit në rrugë të drejtë. Shpalljet e Allahut u quajtën libra të shenjtë dhe më të mëdhenjtë janë ata që përmenden në Kur'an, si: Teurati, Zeburi, Inxhili e Kur'ani. Në të gjitha librat e shpallur porositej besimi i vërtetë e i drejtë, besimi në Një Zot të vetëm. Në Kur'an thuhet: "Ky është Libri në të cilin nuk ka dyshim. Ai është udhërrëfyes për të devotshmit"[141]. Ai është një mrekulli hyjnore jo vepër e aftësisë mendore të H. Muhamedit a.s.

Ç'kuptojmë me mrekulli?

Mrekullia është vepër e Zotit, është një vepër e mbinatyrshme që vërteton misionin e të dërguarit të Tij dhe se fjalët dhe mësimet e të dërguarit nuk janë gjë tjetër veçse mësimet e Zotit të tij.

Kur'ani është mrekulli mendore dhe me përmbajtje kuptimplotë, efektive, e cila mbetet e përhershme, u përgjigjet të gjitha kohërave dhe të gjitha gjeneratave njerëzore që do të vijnë. Baza e fesë qëndron në mendjen e njeriut se, përndryshe, fakti i qenies hyjnore nuk do të kishte mundur të bindë asnjë njeri, po të mos e pranonte mendja.

Mendja është krijesa më e parë e Zotit xh.sh. që nga njëra anë është qiellore dhe nga ana tjetër shfaqet në vullnet e dije hyjnore në njeriun që është trup lëndor. Kjo është drita që mbulon krejtësisht faqen e dheut, mbi të cilën mbështetet plotësisht shkenca. Kjo dritë që ne e quajmë mendje, është fakulteti që transmeton në zemër të njeriut të vërtetat qiellore të frymëzuara prej veprave të Plotpushtetshmit, vepra nga i cili rrjedh edhe burimi i shkencës dhe i diturisë.

Kur'ani është ndërtuar me një stil të lartë, me vargjet e tij kuptimplotë me përmbledhjen e shkronjave në fjalë, të fjalëve në fjali e periudha e të gjitha këto janë të këndshme gjatë leximit. Vetë leximi krijon një harmoni të posaçme të melodisë e cila ka bërë që shumë jobesimtarë të pranojnë fenë islame nisur vetëm nga ky aspekt. Kur'ani i dha njerëzimit çelësat e çdo shkence dhe të çdo diturie tjetër, të cilat vërtetojnë faktet dhe ndodhitë historike.

A mund të themi se Kurani përmban të dhëna shkencore?

Pra, Kur'ani i shenjtë është njëkohësisht edhe shkencë, e cila është përfundim i një grumbulli të vërtetash, të cilat mendja e njeriut i i ka përshkuar nëpër objektivin e vet shqyrtues. Ai i mëson njerëzimit sistemet e jetës, që të jenë të sigurta e të dobishme, ta rregullojë njerëzimin si nga ana materiale, ashtu edhe shpirtërore në jetën e tij të dukshme e të padukshme, intelektuale e fizike, për ta bërë të lumtur këtë jetë si dhe jetën tjetër dhe të përgatisë mjetet që i sigurojnë atij qetësinë shpirtërore.

Kur'ani është ai, që i sjell këto njohuri të sistemeve nga një fuqi e plotpushtetshme, që është krijues i këtyre sistemeve, prandaj edhe ligjet e Tij kanë një shije qiellore e një ngjyrë shenjtërie. Mendja kërkon drejtimin e çdo sendi. Ajo shikon me të njëjtin sy si botën qiellore, ashtu edhe atë lëndore dhe u jep po të njëjtën shenjtëri ligjeve të natyrës, sepse ai që i ka vënë këto ligje është vetë i Madhi Zot.

---

141. Kur'an, El-Bekare: 2.

Kështu, ligjet e rregullat në natyrë janë të vendosura nga Ai Zot dhe vetë natyra është goja që flet e të madhit Zot. Ashtu si thuhet në Kur'an: "Ai është Krijuesi i qiejve dhe i Tokës, pa shembull të mëparshëm dhe, kur vendos për diçka, vetëm thotë për të: "Bëhu!" – dhe ajo bëhet."[142].

Kur'ani i ka çarë të gjitha perdet e kohës dhe ka depërtuar në thellësi duke zbuluar edhe sekretet që fshihen në zemrën e njeriut. Edhe sot janë aktuale mësimet e Kur'anit, i cili urdhëron për studimin dhe hulumtimin e sendeve, për vërtetësinë e tyre. Ai porosit që të hidhet vështrimi në studimin e vazhdueshëm në qiej e në tokë, të shikojë gjithësinë për të nxjerrë argumente të forta e për t'u bindur me të vërtetën, me qëllim që të arrihet bindja e plotë se krejt gjithësinë e ka krijuar Zoti xh.sh., i cili është pa fillim e pa mbarim.

Myslimanët gjejnë në Kur'anin e shenjtë argumente të plota për ekzistencën e Zotit të lartëmadhëruar, për gjithësinë e për njeriun. Ashtu si thuhet në Kur'an: "Dije se nuk ka zot tjetër të vërtetë përveç Allahut"[143]. Kështu feja islame zuri një vend të merituar në popujt e botës, sepse krijoi bindje në zemrat e besimtarëve, duke e njohur atë burim të shpalljes së Zotit xh.sh. nëpërmjet të dërguarit të tij. Pa marrë parasysh se Zoti i Lartësuar i dhuroi njeriut të menduarit, Ai zgjodhi në mesin e tyre disa përfaqësues që i kompletoi me dërgimin e shpalljes nëpërmjet melekëve për të udhëhequr njerëzimin në rrugë të drejtë. Këta, pra ishin pejgamberët e Zotit që e thirrën njerëzimin në besimin e Një Zoti të vetëm e pastaj i mësuan se si janë krijuar dhe qëllimin për të cilin u krijuan, si u krijua gjithësia etj.

Shtrohet pyetja: Ç'janë melekët?

Melekët janë qenie shpirtërore të padukshme që, me lejen e Allahut, mund të paraqiten në forma të ndryshme e deri në formën e njeriut, por të pagabueshëm dhe nuk bëjnë vepra të këqija. Profeti ynë a.s. thotë: "Melekët janë krijesa prej drite". Melekët në qenien e tyre kanë një natyrë, vetëm të bëjnë mirë, ndërsa njeriu ka dy pamje: për të bërë mirë e për të bërë keq, sipas vullnetit e lirisë së të menduarit për të cilën do të merret në përgjegjësi, do të shpërblehet ose do të ndëshkohet sipas veprave. Njeriu ka përparësi ndaj melekëve sepse Zoti xh.sh. atë e dërgoi mëkëmbës në tokë. Edhe këtë e realizoi nëpërmjet pejgamberëve, të cilët ishin të pajisur me cilësi të rralla. Ata dalloheshin në punën e tyre sepse ishin të pagabueshëm, besnikë e të ndershëm, të mprehtë në arsyetim, të drejtë e të sinqertë në veprimtarinë e tyre, si dhe të përpiktë në transmetimin e shpalljes hyjnore pa devijime.

Të gjithë të dërguarit kanë qenë burra e jo gra, kanë përballuar të gjitha vështirësitë dhe pengesat e ngritura kundër tyre. Ishin të zgjedhur nga familje fisnike, pa të meta trupore, me sjellje e moral shembullor. Dallohet nga të gjithë profeti ynë, H. Muhamedi a.s. sepse është dërguar për të gjithë njerëzimin e për xhindet. Ai është i fundit si pejgamber dhe me këtë kanë marrë fund të gjitha misionet e pejgamberëve të mëparshëm.

Feja islame është mbështetja e njeriut në një fuqi e cila sundon në mënyrë të pakufishme si dhe mbikëqyr njeriun dhe veprat e tij. Ajo e bazon besimin e saj në të menduar, studiuar e jo në mënyrë të verbër apo të trashëguar. Fuqia e bindjes islame qëndron në lirinë e plotë të njeriut për të besuar Zotin. Kjo është një fuqi e brendshme, e përqendruar thellë në shpirtin e tij, në zemrën e ndërgjegjen e tij e jo e ardhur nga jashtë.

---

142. Kur'an, El-Bekare: 117.
143. Kur'an, Muhammed: 19.

Bindja islame jo vetëm që është dëshirë e njeriut, por njëkohësisht është edhe një detyrim i mendjes së tij për të zgjedhur mësimin e tij.

Feja islame e bazuar në Kur'an është e qëndrueshme dhe parimet e saj nuk pranojnë zhvillim, gjë që vërteton përsosmërinë e shpalljes së ardhur nga Zoti xh.sh. Studimet filozofike dhe njohuritë e përgjithshme të njerëzve janë të natyrshme, ndërsa njohuritë e pejgamberëve nuk kanë mangësi, sepse janë nga Zoti xh.sh. dhe dija e Tij është e përkryer. Allahu i ka dhënë mundësi njeriut të kuptojë, të mësojë dhe të arrijë njohuri të reja.

Njohja dhe besimi i Zotit xh.sh. jo vetëm që është bërë detyrë nëpërmjet shpalljes, por njëkohësisht njeriu është urdhëruar që të shikojë e studiojë të gjitha ato fakte bindëse që janë në qiell e në tokë derisa të arrijë në bindje të pastër. Në Kur'an thuhet: "Sikur në qiej dhe në Tokë të kishte zota të tjerë, përveç Allahut, si qiejt, ashtu edhe Toka do të shkatërroheshin"[144]. Ky ajet argumenton se duhet besuar vetëm Një Zot, i cili është ekzistencë e domosdoshme në "Njëshmërinë" e Tij. Vërtetësia e Tij nuk varet nga dikush tjetër, nuk ka rivalë në mendimin e Tij, nuk pranon ndarje dhe nuk ka formë. Nuk mund të bëhen pyetje për Zotin xh.sh. Sa? Kur? Ku? etj. Nuk është trup, është një kuptim. Njësia e Tij nuk përbëhet nga diçka tjetër, por vetëm Njëshmëria e Tij është e domosdoshme në vetvete. Kjo Njëshmëri e domosdoshme e ka emrin "Allah" ose "Zot", që është Krijuesi i çdo sendi dhe shkak i çdo gjëje.

Çdo qenie e mundshme në ekzistencën e saj ka nevojë të domosdoshme për shkaktarin e saj. Çdo trup i gjallë ka shpirt, i cili është i zhveshur nga materiali, është i krijuar, është i përhershëm, nuk vdes me shkatërrimin e trupit, do të shpërblehet apo ndëshkohet bashkë me trupin në ditën e llogarisë për veprat që ka bërë njeriu në këtë botë.

A është njeriu i lirë në fushën e veprimit të tij?

Njeriu është i lirë në fushën e veprimit, por megjithatë ekzistojnë lidhje midis tij dhe Zotit, ndërlidhjes së veprimtarisë së tij me shkaqet e domosdoshme dhe pasojat. Nuk mohohet liria e zgjedhjes në kryerjen e detyrave, të veprave duke shfrytëzuar arsyetimin logjik, ku si pasojë do të vijë shpërblimi apo ndëshkimi. Njeriu posedon aftësinë e arritjes dhe morali i tij gjithmonë ka prirje nga vetë qenia e tij, e cila me vepra anon nga e mira. Por liria e tij varet edhe nga faktorë të jashtëm që i nënshtrohen ligjshmërisë së natyrës, ndërsa veprat kanë të bëjnë me të drejtpërsëdrejti, janë në kompetencën e tij.

Njerëzit janë krijuar të veprojnë mirë e drejtë, por tek ata ndikon edhe ambienti përreth dhe mund të marrin edukimin moral jo në pajtim me ligjet e shpalljes së Allahut, kur shoqërohet me të këqijat. Prandaj duhen kuptuar drejtë ligjet islame për një shoqëri të pastër, e cila do të ngrinte lart moralin e saj në bazë të parimeve themelore të Islamit, të dashurisë dhe respektit ndaj njëri-tjetrit. Këtyre fenomeneve u paraprin logjika. Ashtu siç thotë filozofi islam Ibnu Sina: "Qëllimi i logjikës është që të jetë armë në dorën e njeriut, me qëllim që ta orientojë në rrugën e drejtë dhe të mos vijë deri te gabimet gjatë meditimeve të tij".

Kur'ani shprehet qartë se Zoti nuk është bota, se Ai është i Lartëmadhëruar, se e krijoi botën nga mosqenia dhe se është në gjendje që të ndryshojë krijimin në diçka që nuk është krijuar dhe përsëri ta kthejë. Njeriu është qenie e përbërë nga shpirti dhe trupi, i cili ka nevojat e veta, plotësimi i të

[144]. Kur'an, El-Enbija: 22.

cilave është më se i nevojshëm, me qëllim që të vendoset harmonia e jetës dhe nga ana shpirtërore kërkesat e së cilës patjetër duhen plotësuar.

Veprimtaritë njerëzore që me shkaqet e veta i bashkohen njeriut mund të jenë të lavdërueshme ose të qortueshme. Këto veprimtari janë trupore ose shpirtërore. Shpirtëroret janë ato që e shkatërrojnë më shumë njeriun kur ai jepet pas tyre si dëshira e zjarrtë, pasioni, kënaqësia, lumturia, hidhërimi, frika, lakmia, ndjeshmëria e epshit e të ngjashme me këto. Ky njeri që u nënshtrohet epsheve, nuk është i lirë, por rob i tyre.

Si arrihet njohja e Zotit?

Puna më e vështirë në fenë islame është njohja e Zotit xh.sh., i Cili duhet të ngrihet në kuptimin e vërtetë të fjalës dhe jo me një fjalë goje. Në krye të parimeve praktike është që t'i falet e lutet vetëm Zotit dhe askujt tjetër dhe të përpiqet që të triumfojë urdhri i Zotit. Në krye të parimeve morale është ndihma e mëshira e të varfrit dhe përkrahja e të pafuqishmit.

Asnjë ligj njerëzor, sipas Kur'anit, nuk mund të mendohet pa ligjvënësin. Të gjitha fenomenet e natyrës na bindin për ekzistencën e qenies më të lartë, krijuesit dhe ligjvënësit. Shumë dijetarë islamë kanë theksuar se qëllimi i fesë dhe i filozofisë është një, e ajo është e vërteta dhe e drejta. Këtu përmendim filozofin arab, Kindiun, i cili shprehet për filozofinë dhe mësimet e saj se këto janë mësimet më të larta për njeriun kur thotë: "Qëllimi i filozofisë është interpretimi i drejtë i njohurive për të zbuluar të vërtetën".

A bie në kundërshtim filozofia me fenë?

Si filozofia edhe feja islame kanë një qëllim të përbashkët, sepse e para është një shkencë që merret me studimin e sendeve dhe vlerësimin e tyre nëpërmjet të menduarit logjik të njeriut, por edhe mësimet e Kur'anit e urdhërojnë një gjë të tillë. Mësimet e filozofisë islame vërtetojnë besimin në Zotin e vërtetë dhe e mbrojnë atë me argumente ashtu si thuhet në Kur'an: "Thuaj: "Shikoni ç'ka në qiej dhe në Tokë!"[145], "A nuk e shohin ata mbretërinë e qiejve e të Tokës dhe gjithçka që ka krijuar Allahu"[146]. Nëpërmjet Kur'anit njeriu mëson të vërtetën, por njëkohësisht mëson edhe detyrat, të cilat duhet të kryhen dhe nga ana tjetër edhe për llogarinë që duhet të japë për veprat e kryera.

Mohuesit këtë fakt e mohojnë dhe sjellin argumente për mosekzistencën e Zotit, sepse nuk e shohin dhe çdo gjë që nuk shihet, sipas tyre, nuk besohet. Shumë gjëra nuk i shohim, por nuk themi se nuk ekzistojnë. P.sh. mendjen tonë nuk e shikojmë, gravitacionin nuk e shikojmë etj. Por nuk do të thotë se ato nuk ekzistojnë. Ashtu si shohim manifestimet e mendjes sonë, ashtu shohim edhe manifestimet e mendjes më të lartë të Allahut xh.sh. që ekziston pa dyshim, sepse po të mos ekzistonte Ai, nuk do të ekzistonte askush. Ai është shkak i të gjitha shkaqeve. Nuk ka prodhim pa prodhuesin e vërtetë, asgjë nuk lind vetvetiu e rastësisht. As gjithësia, as Toka si pjesë e gjithësisë nuk mund të krijohet rastësisht apo vetvetiu, por patjetër duhet të kemi krijuesin dhe drejtuesin e Ai është Zoti xh.sh.

---

145. Kur'an, Junus: 101.
146. Kur'an, El-A'raf: 185.

Allahu i Lartëmadhëruar është i përhershëm, pa fillim e pa mbarim në ekzistencën, ashtu siç thuhet në Kur'an: "Ai është i pari dhe i fundit". Ai do të ekzistojë edhe pasi të marrë fund jeta në këtë botë, ashtu si ka ekzistuar para se të krijohej bota. Nuk mund t'i përngjajë asnjë sendi, ashtu si thuhet në Kur'an: "Atij nuk i përngjan askush". Ai nuk është qenie e dukshme, nuk ka nevojë për vend, nuk mund të kufizohet në kohë, nuk ka formë dhe nuk mund t'i japim trup. Ai është plotësisht i pavarur, ndërsa çdo krijesë është e varur prej Tij. Ai është i gjallë, ka krijuar jetën e të gjitha gjallesave, nuk ka as fillim as mbarim, është i përhershëm dhe nuk ka vdekje. Ashtu si thuhet në Kur'an: "Allahu! Nuk ka zot tjetër (që meriton adhurimin) përveç Tij, të Gjallit, të Përjetshmit, Mbajtësit të gjithçkaje."[147]. Jetën e Zotit xh.sh. nuk mund ta krahasojmë me jetën e krijesave të tjera, sepse këto janë të përkohshme, me të meta e mangësi, ndërsa Allahu është i përsosur, pa asnjë të metë. Ai është i gjithëdijshëm, ashtu si thuhet në Kur'an ku shprehet: "Allahu e di shikimin e përvjedhur të syrit dhe atë që fsheh zemra."[148]. Kjo do të thotë se Allahut nuk mund t'i fshihet asgjë. Ai ka dituri të plotë për atë që ekziston si dhe për atë që nuk ekziston. Dituria e Zotit përfshin gjithçka si në të kaluarën, të tashmen e të ardhmen, pa përjashtuar këtu të shikuarit e të dëgjuarit, ashtu si thuhet në Kur'an: "Vërtet, Allahu i dëgjon dhe i sheh të gjitha"[149]. Mbi këtë bazë Ai u dhuroi krijesave të Tij organet e shqisave si sytë për të parë dhe veshët për të dëgjuar, por të dy këto organe janë të kufizuara te njeriu, sepse janë të vendosur në trup të kufizuar dhe provizor, të krijuar nga i madhi Zot e për t'u kthyer përsëri pranë prezencës së Tij. Ndërsa Zoti xh.sh. nuk është trup e për rrjedhojë nuk është i pajisur me organe trupore. Ai sheh e dëgjon me përsosmërinë e Tij të paarritshme nga logjika e njeriut. Në Kur'an Zoti urdhëron e thotë: "fjalët e tij askush nuk mund t'i ndryshojë"[150]. Ai dëgjon dhe sheh shumë mirë. Krahas të parit dhe të dëgjuarit nga ky ajet kuptohet qartë se Zoti xh.sh. flet, por të folurit e Tij të përsosur nuk i përngjan të folurit të njerëzve, të cilët kanë organe për këtë. Ne e dimë se Zoti i ka folur H. Musait në malin Turi Sina, si dhe H. Muhamedit a.s. në Miraxh. Pastaj kuptohet qartë se përderisa njeriu u krijua me dhuntinë e të folurit e komunikimit, doemos Zoti xh.sh. i ka vetë cilësitë e të folurit që dëgjohet, shkruhet dhe lexohet. Shembull konkret kemi Kur'anin që Ai ia zbriti H. Muhamed nëpërmjet Xhibrilit. Ky libër memorizohet, studiohet e lexohet vazhdimisht nga miliona njerëz besimtarë dhe është udhërrëfyes në jetën e tyre.

Duhet të lexohet ky kod i plotë i udhëheqjes njerëzore që të ndihmojë besimtarët të pajisen me virtytet më të larta që inspiron ky libër i shenjtë, i cili është vetë Fjala e Allahut dhe si i tillë është shumë i vlefshëm për ndërtimin e jetës individuale, familjare e shoqërore dhe sjell lumturi në të dy jetët.

Lusim Zotin që ta kenë fatin të gjithë besimtarët të sigurojnë udhëheqjen e plotë në jetë nga Kur'ani i Shenjtë.

Amin !

3.3 Kur'ani - Mrekulli

147. Kur'an, Al Imran: 2.
148. Kur'an, El-Gafir: 19.
149. Kur'an, Lukman: 28.
150. Kur'an, El-En'am: 115.

Kur'ani, Libri Hyjnor sot është vërtetuar se i përgjigjet përparimit të teknologjisë moderne me mrekullitë shkencore në përmbajtjen e tij, të përcjella nga i dërguari i Allahut të Lartësuar, Muhamedi a.s., paqja e bekimi i Zotit qofshin mbi të. Në Kur'an thuhet: "Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty (o Muhamed), veçse si mëshirë për botët."[151]. Kjo mrekulli sot ndodhet në duart e myslimanëve, i përkthyer edhe në gjuhën shqipe, për të mësuar dijet shkencore që u kanë paraprirë zbulimeve shkencore në të gjitha fushat duke përshirë universin, gjithë botën e gjallë bimore e shtazore e në mënyrë të veçantë qenien njerëzore.

I Madhërishmi në Kur'an i drejtohet të dërguarit të tij, Muhamedit a.s. dhe i thotë: "Ky Kur'an më është shpallur, në mënyrë që nëpërmjet tij t'ju tërheq vërejtjen juve dhe kujtdo që i përcillet"[152]. Do të thotë që në të përmblidhen një seri mesazhesh mahnitëse që shërbejnë si udhërrëfyes në të gjitha dijet shkencore. Këto njëherësh tregojnë superarkitektin e të gjitha krijesave dhe të botës në tërësi. Kjo është madhështia që përmban Kur'ani, Fjala Hyjnore që i ka çarë perdet e errësirës në shekuj deri ditën e sotme e do të vazhdojë të nxjerrë në dritë sekrete të reja të pazbuluara që do të jenë në dobi të qenies njerëzore. Në Kur'an thuhet: "Allahun e përlëvdon gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë. Ai është Sunduesi, i Shenjti (i pastër nga çdo e metë), i Plotfuqishmi dhe i Urti."[153]. Prandaj duhet të marrim në dorë Kur'anin çdo ditë, të marrim mësim prej tij, të falenderojmë Zotin e Lartësuar që na bëri qenien më të përsosur të krijesave të Tij dhe t'i zbatojmë këshillat dhe porositë e Tij vetëm për të mirën tonë. Ai na krijoi pa qenë, me një trup të bukur e të hijshëm, ku të gjitha organet kanë një harmoni perfekte e të përsosur. Në Kur'an thuhet: "Ne ju kemi krijuar prej tokës, aty do t'ju kthejmë dhe nga ajo do t'ju nxjerrim edhe një herë tjetër."[154]. Prandaj besimi në Krijuesin, Zotin e Lartësuar, është detyra parësore e njeriut në këtë botë provizore.

3.4 Kur'ani, kushtetuta më e mirë e jetës

Në të ndodhen parimet, dispozitat dhe urdhrat fetarë, vlerat morale dhe rregullat e përgjithshme praktike. Në Kur'an thuhet: "Në të vërtetë, ky Kuran udhëzon drejt asaj që është më e mira"[155].

- Në Kur'an thuhet: "Ne ta zbritëm ty Librin, si shpjegim për çdo çështje"[156].
- Kur'ani përmban udhëzimet dhe parimet jetësore të njeriut:

1. Njeriu në jetën e vet synon lumturinë, kënaqësinë dhe plotësimin e kërkesave që dëshiron.
2. Veprat dhe aktet që dalin nga njeriu janë në kuadrin e ligjeve dhe dispozitave të Kur'anit.

---

151. Kur'an, El-Enbija: 107.
152. Kur'an, El-En'am: 19.
153. Kur'an, El-Xhumu'a: 1.
154. Kur'an, Taha: 55.
155. Kur'an, El-Isra: 9.
156. Kur'an, En-Nahl: 89.

" ... të cilët i kanë penguar të tjerët nga rruga e Allahut, duke dashur ta shtrembërojnë atë dhe nuk kanë besuar në jetën tjetër! "[157].

3. Zakonet dhe normat më të mira dhe më të qëndrueshme të denja që njeriu duhet të ndjekë, janë zakonet dhe normat që i jepen nga natyra e tij e drejtë dhe e shëndoshë e jo ato zakone që dalin nga ndjenjat dhe trillimet, qofshin edhe individuale apo shoqërore.

"Zoti ynë është Ai që çdo gjëje i ka dhënë trajtën e vet e pastaj e ka udhëzuar "[158].

"Drejtohu me përkushtim në fenë e pastër monoteiste, natyrën fillestare, në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit. S'ka ndryshim të krijimit të Allahut. Kjo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë"[159].

Prandaj njeriu në veprimet e tij duhet të zbatojë ligjet individuale e shoqërore, të cilat dalin nga natyra e tij e natyrshme. Ai nuk duhet të përfshihet në epshet e pasionet negative të ndaluara. Feja kërkon që e drejta natyrore e njeriut të mos anashkalojë mjetet e ruajtura në qenien e tij, por të shfrytëzojë çdo mjet në vetvete, ashtu siç është obliguar për të ekuilibruar fuqitë e fshehura në vetvete, që asnjëra të mos kalojë tjetrën.

Kur'ani përcakton rrugën dhe programin e jetës së njeriut.

Duhen pasur parasysh këto synime:

1. Që njeriu ka një qëllim të cilin duhet të arrijë në jetë.
2. Arritja e qëllimit në jetë realizohet në bazë të ndjekjes së zakoneve e traditave speciale.
3. Ligjet e jetës do t'i gjejë në Librin Hyjnor – Kur'anin Fisnik:

- Në ndjekjen e kësaj rruge duhet të mbështeten në njohjen e ekzistencës hyjnore dhe besimin ndaj saj. Pastaj mësimin në të dërguarit që sollën mesazhin hyjnor, si dhe në ekzistencën e botës tjetër.

Zoti në Kur'an thotë: "Tek Ai ngjiten fjalët e bukura, ndërsa veprën e mirë Ai e ngre Vetë."[160].

"Pastaj përfundimi i atyre që punuan keq, ka qenë e keqja e madhe (Xhehenemi), ngase i mohonin shpalljet e Allahut dhe talleshin me to."[161].

Kur'ani është libër universal

- Kur'ani në temat e tija nuk i drejtohet vetëm popullit arab, por gjithë popujve.
- Kur'ani nuk u drejtohet vetëm myslimanëve, por edhe jo myslimanëve.
- Kur'ani i fton gjithë njerëzit në besim.

"Ky Kuran më është shpallur, në mënyrë që nëpërmjet tij t'ju tërheq vërejtjen juve dhe kujtdo që i përcillet."[162].

"Ai është vetëm këshillë për të gjithë botët (njerëzit dhe xhindet)"[163].

---

157. Kur'an, El-A'raf: 45.
158. Kur'an, Taha: 50.
159. Kur'an, Er-Rrum: 30.
160. Kuran, El-Fatir: 10.
161. Kur'an, Er-Rrum: 10.
162. Kur'an, El-En'am: 19.
163. Kur'an, El-En'am: 90.

Kur'ani është libër i përsosur

Kur'ani përmban qëllimin më të lartë e të drejtë që njeriu synon të arrijë në jetë dhe e udhëzon me argumente të plota për arritjen e këtij qëllimi.

"O populli ynë! Ne dëgjuam një Libër të shpallur pas Musait, i cili vërteton shpalljet para tij, udhëzon nga e vërteta dhe tregon rrugën e drejtë."[164].

"Ne të kemi zbritur ty (o Muhamed) Librin me të vërtetën, si përmbushës të shkrimeve të mëparshme dhe mbrojtës të tyre. "[165].

"Ai ka urdhëruar për ju atë Fe, të cilën ta zbuloi ty (o Muhamed) dhe që pati urdhëruar për Nuhun, Ibrahimin, Musain dhe Isain"[166].

"Ne ta zbritëm ty Librin, si shpjegim për çdo çështje"[167].

Kur'ani është libër i amshuar, i pandryshueshëm, për të gjitha kohët. Dispozitat e tij i përfshijnë të gjithë njerëzit dhe i aplikueshëm për të kaluarën, të sotmen dhe të ardhmen.

3.5 Filozofia e Kur'anit

Në kuptimin filozofik të Kur'anit, shihen rrugë të reja reflektimi që kanë të bëjnë me një ritrajtim të traditës së mendimit negativ që i atribuohet Islamit. Ai i kundërvihet mendimit kundër hamendjeve njohëse të ekzistencës, me idenë e të vërtetës absolute, të arsyes së vetme e ligjvënëse në univers, ku me shpjegime të sigurta kushtëzon thellësisht mendimin të mbështetur në dije e kulturë. Në shumë vende në Kur'an Zoti tregon se Ai ka fakte të sigurta jo vetëm në sendet e krijuara në gjithësi, por edhe në vetë njeriun, si krijesën më të përsosur të Tij.

Paralelisht me argumentet, rëndësi i kushtohet të folurit të Allahut, gjuhës në të cilën Ai i është shprehur të dërguarit të Tij, Muhamedit a.s., nëpërmjet Xhibrilit. Ai shprehet në gjuhën arabe si model ideal i kuptimit, me strukturën logjike dhe të përsosur. Kjo është gjuha më e përsosur që zgjodhi Allahu i Madhërishëm, për të përçuar te besimtarët Kur'anin Famëlartë, pasi është gjuha më e përshtatshme për t'u interpretuar në të gjitha gjuhët e popujve apo racave të ndryshme njerëzore. Në përkthimin e Kur'anit në mbi 100 gjuhë të botës gjejmë të ngulitur, krahas mjaft problemeve edhe vetë kompleksitetin e jetës, rrugët për ndërtimin e saj dhe interpretime te reja për mjaft probleme që shkenca kohët e fundit po i vë në praktikë. Prandaj kërkohet një rivlerësim rrënjësor i Kur'anit si dimension përbërës i ekzistencës hyjnore, që i shtyn njerëzit të hulumtojnë proceset e kontrollit të jetës individuale, familjare e shoqërore e njëkohësisht për t'i orientuar gjithmonë nga veprat e mira. Në këtë kuptim kanë dalë ligje që rregullojnë sistemet e jetës, në të cilat dija dhe shoqëria paraqesin nivele të larta pluraliste, saqë ka vështirësi edhe te besimtarët myslimanë që të unifikohen e zbatohen në praktikë ligjet hyjnore të Kur'anit. Kjo problematikë kaq e gjerë në shoqërinë e sotme krijon mundësinë për një konceptim më të shtrirë të racionalitetit të këtyre ligjeve,

164. Kur'an, El-Ahkaf: 30.
165. Kur'an, El-Maide: 48.
166. Kur'an, Esh-Shura: 13.
167. Kur'an, En-Nahl: 89.

një interpretim të saktë nga intelektualët e dijetarët islamë në formimin e ideve, të sjelljeve e mentalitetit të njerëzve në veçanti të besimtarëve për problemet e jetës. Sot i duhet dhënë më shumë hapësirë arsyes në konceptimin e ligjeve të Kur'anit për të sendërtuar jetën në përputhje me këto ligje, larg fenomeneve negative që po e shoqërojnë sot si individin, familjen e shoqërinë. Ka një krizë të arsyes mbi konceptimin e familjes, e cila po shkon me shpejtësi drejt shpërbërjes së saj. Arsyet rrjedhin nga kuptimi jo i drejtë për shëndoshjen e familjes si nevojë e domosdoshme dhe absolute për mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve.

Fuqia e reflektimit të mësimeve të Kur'anit në këtë fushë ka të bëjë me botën e mendimit, që të bëhet transparente para ndërgjegjes së partnerëve bashkëshortorë. Bëhet fjalë për ligje sqaruese e detyruese për partnerët në bazë të të cilave do të ndërgjegjësohen, që asnjëri të mos shkelë mbi kurorëzimin e bërë në ndërtimin e familjes. Shthurjet që ndodhin në familje e shoqëri vijnë nga mungesa e njohjes së ligjeve të ekzistencës absolute, zbatimit konkret të tyre në çdo rrethanë, në të cilat format e dijes janë krijuar për të jetuar.

Veprimet intelektuale të njerëzve që janë lidhur ngushtë me Kur'anin dhe sistemin e praktikave dhe përpjekjeve në përputhje me të, duhet të shfaqen si të ndjeshme ndaj fenomeneve negative dhe të sigurojnë lirinë dhe hapjen drejt të së mirës, së bukurës e së vërtetës. Në dritën e këtyre konsideratave rriten reflektimet e ligjeve të Kur'anit, reflektojnë mbi papërshtatshmërinë e moralit të jetës individuale si të femrës edhe të mashkullit për t'iu përgjigjur vetëm nevojave të veçanta specifike të lirive të pakufizuara. Në Kur'an përfshihen ligje që përsosin personalitetin e njeriut, kanë një drejtim të vetëm e të pandryshuar, nuk tolerojnë në ato raste kur preken vlerat e tij. Vënia në qendër e njeriut mbështetet hapur në Kur'an, ku thuhet: "Në të vërtetë, Ne e krijuam njeriun në trajtën më të përkryer"[168]. Për këtë arsye në të gjithë aktivitetin jetësor të tij, Kur'ani shpall të gjitha arsyet ligjore të patjetërsueshme si dhe të përvojës dhe traditës profetike si bërthamë e pashmangshme për çdo besimtar islam, që ta ruajë atë përsosmëri. Askush nuk mund të zbehë porositë dhe urdhrat e Kur'anit për probleme të ndryshme, mbi kompleksin dinamik të tij dhe modelin e Profetit a.s. që duhet të shërbejë si mbështetje për myslimanët.

Vlera e Kur'anit ndihet në çdo kohë, sepse përfshin në të njëjtën kohë një front të dyfishtë. Nga njëra anë bën analizë të së kaluarës, që synon të nxjerrë në pah mangësitë e realitetit të popujve të kaluar dhe, nga ana tjetër, paraqet rrugët e mundshme për të ndryshuar të tashmen, ekzistuesen, duke i projektuar ato në mënyrë ideale larg nga çdo fenomen negativ. Sot ndihet nevoja dhe vullneti i besimtarëve myslimanë për ta sjellë atë në plan të parë, si kërkesë e domosdoshme për të kuruar sëmundjet e individit në familje e shoqëri. Ajo që duket qartë në çdo rast është se Kur'ani gjithnjë ka sjellë argumente për ndryshim nga e keqja, që duke i kundërvënë dëmet që i sjell njeriut, i ofron zgjidhje në planin praktik. Në këtë kuptim historia e popujve të kaluar me atë të tashmen dëshmojnë për një ndërthurje të madhe që gjithnjë ka mbajtur të lidhur dhe të pranishëm në duart e çdo studiuesi e veçanërisht studiuesve myslimanë. Kur'ani i jep mundësi njeriut të hyjë në epokën e ndryshimit, duke e lejuar të lëvizë lehtë mes marrëdhënieve shoqërore e kulturore, që përcaktojnë e kushtëzojnë procesin e edukimit, mbi bazën e ligjeve të tij. Kur'ani dhe edukimi përmes tij, krijojnë kushte teorike dhe praktike që nuk e lejojnë njeriun të dalë jashtë dimensioneve të tij, sepse në të gjen shpjegimin e plotë të mënyrës së ndërtimit të jetës. Përballë fenomeneve negative që përshkojnë

[168]. Kur'an, Et-Tijn: 3.

sot individin, familjen e shoqërinë jep modelin e drejtimit nga tradita profetike, zbatimi i së cilës paraqet një rikonfigurim të gjithë sistemit të ligjësisë islame. Mbi këtë bazë, çdo gjë do të marrë tipare të reja, duke fituar atë vlerë të fesë islame tërësisht emancipuese, të njeriut që e bën të jetë i lumtur në tërë jetën e tij si në këtë botë, ashtu edhe në botën e përtejme e të përhershme. Zoti i dhuroi njeriut arsyen, që i dikton dhe tregon të këqijat që shqetësojnë shoqërinë, në hapësirën në të cilën jeton e punon, duke interpretuar problemet mbi bazën e ligjeve të Kur'anit dhe zgjidhjen sipas tyre për ndryshimin konkret të realitetit. Toleranca fetare jep mundësinë për një kthesë rrënjësore në drejtim të një bashkëjetese paqësore ndaj problemeve të ndryshme jetësore. Në Kur'an, krahas pavarësisë intime, njohëse të lirive dhe të drejtave të tij që përcaktojnë të lejuarën dhe të ndaluarën, vijnë duke përcaktuar edhe lidhjet me pjesëtarët e tjerë të familjes, farefisit e më gjerë. Ligjet islame që burojnë nga Kur'ani, jo vetëm që zbulojnë e përcaktojnë kufijtë e të lejuarës dhe të ndaluarës, por nxjerrin në pah forcimin e karakterit të njeriut që u përmbahet këtyre kufijve duke bashkërenduar dimensionin e tij si njeri me dimensionin e praktikave të realitetit ku jeton.

Fryma humane që buron nga Kur'ani duhet të pushtojë kulturën dhe shpirtin e myslimanit, për t'i dhënë një kuptim të ri jetës. Një perspektivë e tillë e realizuar me vepra konkrete forcon vetëdijen dhe karakterin e besimtarit, i cili mund dhe duhet të bëhet pikë referimi për njerëzit që e rrethojnë. Në sjelljen e tij, kërkesa për një jetë më të mirë bashkohet nga njëra anë me kundërshtimin e shfaqjeve negative amorale të shoqërisë, ndërsa nga ana tjetër bashkohet me vëllezërit myslimanë, që e mbështesin atë, për mundësinë e ndryshimit të shoqërisë për të parandaluar fenomenet negative si alkooli, droga, prostitucioni etj. Bëhet fjalë për një lëvizje të lirshme që përfshin njerëzit dhe natyrën e tyre, të forcimit të karakterit në plotësimin e dëshirave, ëndrrave dhe shpresave në ato sende që janë të lejuara për njeriun e jo në ato të ndaluara. Kështu brenda proceseve të zhvillimit të shoqërisë veprat do të udhëhiqen e shoqërohen gjithmonë nga arsyeja dhe logjika e do të bashkëveprojnë në unitet, për të mbërritur në një shoqëri të drejtë, ku njeriu dhe shoqëria do të gjejnë një sintezë të kënaqshme e harmonike me natyrën përreth që u ka dhuruar Krijuesi. Ndryshe ndodh me ata që i konsiderojnë si abstrakte ligjet e Kur'anit, i shkëpusin ato nga vetja dhe shoqëria në të cilën veprojnë e jetojnë dhe nuk orientohen drejt së vërtetës. Detyra e besimtarëve të vetëdijshëm është që të çlirojnë njerëzit nga veprimet e djallit, i cili e çon njeriun drejt djallëzisë, nëpërmjet shembullit edukativ. Bëhet fjalë për një edukim institucional e jo informal, mbi të gjitha me një edukim që përshkohet nga tipare të qarta pozitive që përmban karakteri i njeriut. Atëherë do të bëjmë të mundur çlirimin e individit dhe shoqërisë për të ndërtuar një jetë të lumtur vetjake e shoqërore. Marrëdhëniet e besimtarit me realitetin duhet të përshkohen nga një frymë e shëndoshë e besimit në porositë e Kur'anit duke u bërë këshillues e kritikë ndaj shkeljes së normave në shoqëri dhe nevojën për të gjetur dhe ndjekur rrugën e vërtetë. Të rinjtë e të rejat me ngarkesën e tyre kulturore të emancipuar dhe imitimin që i bëjnë modës së huaj, larg traditës shqiptare, gjenden përballë një rrëmuje etike dhe shoqërore që nuk i japin zgjidhjen e duhur rrugës së jetës që duan të ndërtojnë. Edukimi me besimin te Zoti do të bëjë të mundur që ata të përballojnë me sukses dhe t'i thonë jo joshjes së tyre në përdorimin e pijeve dehëse, drogës si dhe jetës aktive seksuale jashtëmartesore. Të ndërgjegjshëm për rreziqet dhe pasojat e këtyre fenomeneve do t'u jepet mundësia që të ndërtojnë të ardhmen me synime të caktuara, jashtë çdo gjëje të ndaluar. Të udhëhequr nga mësimet e Kur'anit çdo njeri do të frenojë instinktet apo pasionet që janë të ndaluara,

duke krijuar një raport të caktuar midis vetes dhe botës përreth. Kur'ani ndalon çdo lloj dhune në edukimin e rinisë si në familje, edhe në shkollë e shoqëri. Po kështu në marrëdhëniet familjare midis burrit dhe gruas, për të cilat Kur'ani kërkon që të jenë korrekte, për të shmangur traumat familjare me pasoja të rënda, vuajtje e dhimbje që çojnë deri në shpërbërjen e familjes dhe lënien e fëmijëve rrugëve. Familja duhet t'u dalë zot detyrimeve të veta për të arritur objektivat e saj, të njohë jetën e përditshme dhe secili partner të marrë përgjegjësitë e duhura për të përballuar çdo vështirësi e tension të jetës në familje. Edukimi përbën kështu mundësinë konkrete për të jetuar së bashku, burrë e grua, duke arritur maksimalen në jetën e tyre dhe në edukimin e fëmijëve.

Studiuesit e Kur'anit do të mësojnë të vërtetën, të drejtën, të bukurën, të moralshmen etj. të cilat ndeshen me realitetin, që shpesh ngjallin mosbesim për të tashmen që po kalon shoqëria, por që sigurojnë garanci dhe hapje ndaj së ardhmes duke vënë në zbatim mësimet e Kur'anit. Në emër të vlerave që përmban ai si dhe autoritetin që mund të shfaqen, çdo besimtar do të mund të kapërcejë çdo vështirësi dhe kundërshtim që mund të vijë nga njerëz të papërgjegjshëm që nuk njohin e as zbatojnë jo vetëm ligjet fetare, por edhe ato shoqërore. Gjuha me të cilën e prezantoi i dërguari i Allahut, Muhamedi a.s. nuk është imagjinare, por një e vërtetë absolute që udhëzon për të ndërtuar çdo njeri një të ardhme të lumtur.

Profeti a.s. trajtoi hapur dhe drejtpërsëdrejti besimin te Një Zot. Në ajetet e zbritura të Kur'anit, ai nënvizoi praninë e ekzistencës hyjnore në të gjitha krijesat e botës dhe i lejon hapësirë njeriut si "zëvendës në tokë" të hartojë projekte, të procedojë me eksperimente për t'i shfrytëzuar në dobi të tij.

Mesazhi i Kur'anit i drejtohet njeriut, që të dijë ta kuptojnë, të arrijë të krijojë, të gjallërojë, të forcojë besimin në arritjet për të mos rënë pre e instinkteve shthurëse e të dhunshme, por të fitojë vetëdijen për t'i përballuar ato. Atëherë ai do të marrë vlera e mundësi të reja, në mënyrë që të bëhet protagonist i një qytetari të lirë, fisnik dhe të lumtur.

4 Besimi në të dërguarit e Zotit

4.1 Të dërguarit e Zotit

Të dërguarit e Zotit të Lartësuar ose pejgamberët, janë njerëzit më të zgjedhur të Tij, të cilëve, nëpërmjet melekut Xhibril u dërgoi shpallje për të thirrur njerëzit në besim, duke i udhëzuar të besojnë Një Zot të vetëm, ta falënderojnë e adhurojnë Atë për gjithçka të mirë që u ka dhuruar në këtë botë provizore dhe të kryejnë vepra të mira. Nga fillimi i historisë njerëzore e deri më sot, numri i të dërguarve është shumë i madh, por në librin e fundit, Kur'anin Famëlartë, janë theksuar me emra vetëm 25 prej tyre që fillojnë nga Ademi, Nuhu, Ibrahimi, Musai, Isai dhe Muhamedi që kanë bërë histori në shpalljen e Allahut të Madhëruar.

Sigurisht këta kanë qenë njerëz me cilësi dhe karakteristikat më të dallueshme nga masa për personalitetin e tyre. Ishin njerëzit më të besueshëm në shoqërinë ku jetonin sepse flisnin gjithmonë të drejtën, të vërtetën, dhe kanë shpjeguar me saktësi çdo gjë që u është shpallur. Dalloheshin për logjikën e shëndoshë në arsyetimin e problemeve, duke mos shkelur asnjë udhëzim e rregull që mund t'i çonte ata në gjynahe.

Pejgamberi i fundit që vulos një herë e përgjithmonë të dërguarit, është Muhamedi, paqja e bekimi i Zotit qoftë mbi të.

Muhamedi është përfaqësuesi i fundit i Allahut që i dërgoi njerëzimit mesazhin e Kur'anit. Në Kur'an thuhet: "Është Ai që e ka çuar të Dërguarin e Vet me Udhëzimin dhe fenë e vërtetë, për ta ngritur atë mbi të gjitha fetë. Allahu mjafton si dëshmitar"[169].

"Thuaj (o Muhamed): "O njerëz, unë jam i Dërguari i Allahut për të gjithë ju, i Atij që i përket sundimi i qiejve dhe i Tokës. Nuk ka zot tjetër të vërtetë veç Atij; Ai jep jetë dhe vdekje, prandaj besoni në Allahun dhe në të Dërguarin e Tij, Profetin që nuk di shkrim e lexim e që beson në Allahun dhe Fjalët e Tij! Shkoni pas Tij, që të jeni në rrugën e drejtë!""[170].

4.2. Besimi në pejgamberët

Dërgimi i shpalljes së Zotit njerëzimit nëpërmjet profetëve.

Allahu xh.sh. është Krijuesi i vetëm i gjithçkaje që ekziston dhe çdo gjë në gjithësi zhvillohet sipas ligjeve të Tij. Ai e dalloi njeriun nga të gjitha krijesat, e bëri qenien më të përsosur, e pajisi me arsye e logjikë, e bëri të aftë për të shfrytëzuar të gjitha mirësitë e kësaj bote e njëkohësisht për të justifikuar detyrën që iu ngarkua si mëkëmbës në tokë.

Të gjitha të mirat e kësaj bote u krijuan për njeriun si mjete për të arritur ai në njohjen e Krijuesit të tij e për të marrë udhëzime për ndërtimin e jetës. Është fakt i pamohueshëm që Zoti, qysh në krijimin e njeriut të parë e dërgoi njëkohësisht edhe si profet për t'u treguar pasardhësve të tij të vërtetën e kësaj bote dhe detyrat që ka ndaj saj. Krahas saj, nuk duhet lënë pas dore edhe bota tjetër, sepse kjo botë është provizore. Zoti xh.sh. njohjen dhe besimin në të dërguarit e Tij, e bëri kusht të besimit të myslimanëve. Ashtu si thuhet në Kur'an: "Thoni: "Ne besojmë në Allahun, në atë që na është shpallur neve (Kuranin), në atë që i është shpallur Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, Jakubit dhe Esbatëve (12 bijve të Jakubit), në atë që i është dhënë Musait e Isait dhe në atë që u është dhënë profetëve nga Zoti i tyre. Ne nuk bëjmë kurrfarë dallimi midis tyre dhe vetëm Allahut i përulemi""[171].

Profeti ynë, H. Muhamedi a.s. urdhëron e thotë: "Më ka ardhur Xhibrili a.s. në formën e njeriut dhe më pyeti për besimin se ç'është ai? Thotë: Unë u përgjigja "Të besosh Zotin, të besosh engjëjt, të besosh librat, të besosh të dërguarit, ditën e fundit dhe të caktuarat nga ana e Zotit të së mirës dhe së keqes."

Si nga ajeti i Kur'anit edhe nga hadithi i Profetit a.s. kuptohet qartë se njeriu duhet të besojë lajmëtarët e shpalljes së Allahut xh.sh. që janë njerëz të zgjedhur të Tij, por të dalluar me cilësi të veçanta, të cilët kanë pasur mundësi të pranojnë atë e t'i komunikojnë njerëzimit të vërtetën absolute dhe ligjet me të cilat njeriu duhet të ndërtojë jetën.

---

169. Kur'an, El-Fet'h: 28.
170. Kur'an, El-A'raf: 158.
171. Kur'an, El-Bekare: 136.

Nga ana tjetër, njeriu u lajmërua se, nëse vazhdon në kundërshtim me ato ligje, do të marrë ndëshkimin e merituar në botën tjetër. Feja islame, shpallur të dërguarit te fundit, H. Muhamedit a.s., arriti përsosmërinë e plotë, e pastroi fenë nga shtrembërimet dhe e vendosi mbi baza të shëndosha, duke forcuar besimin në Zotin xh.sh. dhe duke përcaktuar me saktësi ligjet hyjnore dhe kompetencat e shpikësit të këtyre ligjeve. Ashtu siç thuhet në Kur'an: "Ai i ka çelësat e së padukshmes dhe vetëm Ai i njeh ato."[172]. Ky ajet hedh poshtë pretendimet e shumë njerëzve që fshihen nën petkun e fesë se gjoja shpjegojnë gjëra të fshehta, shpjegojnë ëndrra, parashikojnë, hedhin fall etj.

Porositë që i jepen besimtarit nëpërmjet fesë islame janë nga burimi hyjnor dhe si të tilla janë të nevojshme e të domosdoshme për njeriun. Zoti xh.sh. kur e krijoi njeriun me një organizëm të përsosur, e bëri edhe të aftë që të krijojë një lidhje të ngushtë me botën që e rrethon, duke i dhuruar të gjitha elementet e nevojshme për jetesë. Ky njeri duhet të pyesë veten se kush ia dhuroi të gjitha këto të mira dhe aftësi për t'i përdorur në dobi të tij. Krahas të tjerave, ajo që i jep përgjigje të vërtetë e të saktë është feja islame me shpalljen e fundit, Kur'anin Famëlartë. Këtu i tregohet qartë njeriut se kush ia dhuroi të gjitha ato që ka sot dhe njëkohësisht i tregoi se kush është Krijuesi i tij dhe i gjithësisë. Ky është Zoti xh.sh., i Cili duhet falënderuar dhe adhuruar.

Në këtë mënyrë kuptohet se njeriut i janë shpallur gjëra të fshehta, për ta orientuar atë drejt në jetë e njëkohësisht për të praktikuar format e adhurimit ndaj Krijuesit të tij. Kjo është lidhja që krijoi njeriu me Zotin xh.sh. Pavarësisht se ka njerëz që e mohojnë këtë lidhje duke thënë se nuk e shohin me sy e as nuk e prekin, pohimi i tyre nuk e vërteton atë që duan të thonë se "nuk shihet apo eksperimentohet", pasi kjo është një e vërtetë që kuptohet. Njeriu nuk mundet të kundërshtojë diçka, për të cilën nuk është i aftë ta kuptojë apo ta shohë. Prandaj shpallja e Allahut të dërguarve të Tij, veçanërisht ajo e fundit, Kur'ani, dërguar H. Muhamedit, është e vërtetë, e përjeton njeriu dhe shihen pasojat e saj. Mendja e njeriut ka shumë gjëra që nuk ka mundur t'i kuptojë, por ka edhe nga ato që nuk kanë qenë të njohura e janë njohur. Kështu, shpallja nuk bie në kundërshtim me mendjen e njerëzve. Kjo po vërtetohet sot më shumë se kurrë nga filozofë e shkencëtarë që me vrojtimet e tyre kanë zbuluar ekzistencën e qenieve të gjalla jashtëtokësore, për të cilët mendohet se kanë një shkallë më të lartë të menduari. Ato kanë aftësi komunikimi me njerëzit dhe njëkohësisht mund të shndërrohen në forma materiale që shikohen me sy, flasin e të mbizotërojnë me dorë ose me gjuhë dikë tjetër. Ata mund të përcjellin edhe porositë, madje edhe me frymëzimin e ndonjë ndërmjetësi.

Shumica e dijetarëve mendojnë se këto janë qenie shpirtërore, që nuk mund të shihen me shqisat tona, por në situata të caktuara bisedojnë me njerëzit. Sipas Kur'anit këto qenie quhen engjëj, xhin etj.

Sot çështja e shpalljes nuk është çudi, sepse edhe shkenca i ka vërtetuar seancat e thirrjes së shpirtrave, hipnotizimi, leximi i mendimeve telepative etj., të cilat Kur'ani i ka vërtetuar përpara 14 shekujsh e gjysmë. Por e folura e Zotit xh.sh. është ndryshe nga ai i krijesave të Tij. Në këtë mënyrë është edhe të folurit e melekëve, të xhindeve, vetëm përjashtohen rastet kur ato janë paraqitur në formën e njeriut. Ashtu si thuhet në Kur'an: "Asnjë njeriu nuk i është dhënë t'i flasë Allahu, përveçse me anë të Frymëzimit ose pas perdes, ose me anën e një Kumtuesi (Engjëlli) të dërguar me lejen e Tij, për të shpallur vullnetin e Tij."[173].

---

[172]. Kur'an, El-En'am: 59.

[173]. Kur'an, Esh-Shura: 51.

Nga domethënia e këtij ajeti kuptohet qartë se Zoti xh.sh. u është drejtuar në këtë mënyrë të dërguarve të Tij, të cilët kanë qenë njerëz me cilësi të përsosura. Dallohet shpallja e fundit, Kur'ani që është përmbledhje e të gjitha shpalljeve të mëparshme dhe është i gjallë e aktual për çdo kohë.

Dërgimi i profetëve nga ana e Zotit xh.sh. ka një qëllim të caktuar nga të cilat mund të përmendim:

1. T'u bëjë të njohur njerëzve ekzistencën e Zotit të vërtetë, të plotfuqishëm e të përsosur me cilësitë e Tij;

2. Profetët nëpërmjet Fjalës Hyjnore kanë këshilluar të hartojnë ligje për mënyrën e jetesës individuale, familjare e shoqërore. Ata ligjet e tyre gjithmonë i kanë mbështetur në parimet bazë të fesë e të drejtësisë, sinqeritetit, të mirësisë e të dashurisë, të mëshirës e të ndihmës etj. Ashtu siç thuhet në Kur'an: "Në të vërtetë, Allahu urdhëron drejtësinë, mirësinë dhe ndihmën për të afërmit, si dhe ndalon imoralitetin, veprat e shëmtuara dhe dhunën. Ai ju këshillon, në mënyrë që ju t'ia vini veshin."[174].

3. Nëpërmjet profetëve i është bërë e ditur njeriut se Zotit nuk mund t'i fshihet asgjë nga aktiviteti i tij dhe se për këtë ai do të shpërblehet apo do të ndëshkohet sipas veprës së kryer, e dobishme apo e dëmshme është, e lejuar apo e ndaluar, sipas ligjeve të sheriatit islam. Ashtu si thuhet në Kur'an: "kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë."[175].

4. Profetët i kanë bërë të njohur njeriut qëllimin për të cilin Zoti i madhërishëm e ka krijuar njeriun si qenien e gjallë më të lartë, duke përcaktuar edhe normat bazë të mënyrës së jetesës, si dhe i kanë bërë të njohur edhe ekzistencën e botës tjetër, ahiretin dhe domosdoshmërinë e ringjalljes.

5. Profetët i mësuan njerëzimit se kjo botë kalimtare është e mbushur me gëzime e hidhërime, vështirësi, vdekje etj. Këto janë momente prove për njeriun në këtë botë. Ai duhet të pranojë me durim e arsye të fortë se këto janë nga Zoti xh.sh. për të cilat duhet të nxjerrë mësime në drejtim të aktivitetit jetësor të tij. Në Kur'an thuhet: "Sigurisht që Ne do t'ju provojmë me frikë dhe uri, me dëmtim të pasurisë, të njerëzve dhe të të lashtave! Prandaj, përgëzoji të duruarit"[176].

6. Profetët i mësuan njerëzimit rrugën e vërtetë e pa gabime, që nesër në ahiret, kur të japin llogari para Zotit xh.sh., të mos ankohen se gjoja nuk e dinin apo se nuk e kanë gjykuar drejt atë problem për të cilin do të ndëshkohen. Në Kur'an thuhet: "Ne të kemi dërguar ty me të Vërtetën, për të sjellë lajme të mira dhe për të paralajmëruar; nuk ka pasur asnjë popull që të mos i ketë ardhur paralajmërues."[177].

Nga sa u tha në ajetet e Kur'anit të përmendura më sipër, rezulton se Islami ka filozofinë e tij dhe shfaqet me një fe e cila e ka bazën në librin e zbritur nga qielli, libër i cili iu shpall të dërguarit dhe ky ia përcolli popullit të tij.

Të gjithë të dërguarit kanë pasur një përgjegjësi të përbashkët, librin e shenjtë, rregullat e jetës në këtë botë dhe përgjegjësia në botën tjetër. Detyra e parë dhe e fundit ka qenë të kuptuarit e domethënies së vërtetë të librit të shpallur. Natyrisht kjo ka qenë dhe është e vështirë, sepse varet

---

174. Kur'an, En-Nahl: 90.
175. Kur'an, Ez-Zelzele: 7-8.
176. Kur'an, El-Bekare: 155.
177. Kur'an, El-Fatir: 24.

nga mënyra e të kuptuarit të Kur'anit nga persona të ndryshëm e për rrjedhojë, edhe shkalla e besimit varet nga masa e kuptimit të librit të shenjtë.

Theksojmë se vetëdija islame nuk është përqendruar në një fakt historik, me zanafillën e njeriut të parë, H. Ademit, por ka një fakt tjetër zanafille, që i ka paraprirë kohës së historisë sonë empirike. Ajo është pyetja hyjnore e Zotit xh.sh. drejtuar shpirtrave të njerëzve që kanë ekzistuar para botës tokësore. Ashtu si thuhet në Kur'an: "'A nuk jam Unë Zoti juaj?" Ata u përgjigjën: "Po, dëshmojmë se Ti je." Kështu bëri Ai, në mënyrë që ju (o njerëz) të mos thoni në Ditën e Kiametit: "Këtë nuk e kishim ditur."'"[178].

Miratimi i shprehur me gëzim si përgjigje në këtë pyetje nga ana e Zotit xh.sh. ka lidhur kontratën e besnikërisë së shpirtrave ndaj njohjes e bindjes te Krijuesi i vërtetë. Kjo e ka shoqëruar njerëzimin nga epoka në epokë. Janë pikërisht profetët ata që e kanë mbajtur në kujtesë këtë te besimtarët e vërtetë.

Njohja e drejtë e Zotit xh.sh. bëhet vetëm atëherë kur besimtari beson në kelamin, fjalën e Allahut xh.sh., bazuar në të gjitha dispozitat fetare. Dhe është e vërtetë se Fjala e Zotit ka kaluar në artikulimin e vet njerëzor, veçanërisht tek i dërguari i fundit, H. Muhamedi a.s. me mënyrën e lidhshmërisë së tij me burimin e amshuar. Është Kur'ani, Fjala e Zotit, e cila vazhdon të rrojë me unin dhe është e pandarë prej Tij, pa fillim e pa mbarim në amshueshmëri.

Kur'ani është shpallur nëpërmjet engjëllit, që ka diktuar porositë e Zotit dhe H. Muhamedi e ka pranuar këtë shpallje dhe ia ka përcjellë gjithë njerëzimit. Vetë njeriu është dëshmia më kulmore me të cilën Zoti xh.sh. konfirmon krijimin e Tij. A është piramida e ndërtuar me urtësinë dhe mençurinë e pakufishme të të madhit Zot. Si i tillë, ai është i prirur të pranojë porositë e shpallura nga Ai nëpërmjet të dërguarve. I dërguari i fundit, H. Muhamedi a.s. lajmëroi ligjin e ri hyjnor, sheriatin islam, i cili abrogoi ligjet e tjera të mëparshme. Ky është vula e profecisë dhe pas tij nuk do të ketë të dërguar, të obliguar që njerëzve t'ua shpallë ligjin hyjnor. Kur'ani Famëlartë mbetet shpallja e fundit që është e do të jetë kodi i jetës morale e shoqërore deri në ditën e fundit të kësaj bote.

Natyrshëm lind pyetja: Në çfarë rrethanash pranohet shpallja nga i dërguari?

Në momentin e pranimit të shpalljes, profeti përjeton një gjendje të jashtëzakonshme, jo normale; shpirti zmadhon fuqinë dhe ndjeshmërinë dhe sundon trupin duke krijuar një lidhje të padukshme në mes tyre. Trupi i palëvizshëm nuk e ndjen shpirtin, i cili ka aftësi të shikojë përtej errësirës, të dëgjojë zëra e tinguj në distanca shumë të largëta, i përfshirë krejtësisht në dashurinë e Zotit. Pas kthimit në gjendje normale , kur ai e ka marrë shpalljen, është në gjendje që të përsëritë atë që ka dëgjuar që të mos e harrojë dhe pastaj jep porosi për ta shkruajtur.

Shpalljet kanë ardhur gjithmonë në gjuhën që ka folur profeti, me qëllim që ta kuptojë më mirë. Në Kur'an, në suren "Ibrahim, thuhet: "Ne nuk kemi çuar asnjë të dërguar, përveçse në gjuhën e popullit të tij, për t'u shpjeguar atyre (shpalljet e Zotit)."[179]. Në Kur'an thuhet: "Elif, Lâm, Râ. Këto janë versetet e Librit të qartë! Ne e zbritëm këtë Kuran në gjuhën arabe, për ta kuptuar ju."[180]. Sipas ajetit, kuptohet se fjala dhe kuptimi i saj shkojnë paralel dhe nuk mund të zëvendësohet fjala me përkthimin, apo zëvendësimin e lutjeve në faljen e namazit me përkthimin.

---

178. Kur'an, El-A'raf: 172.
179. Kur'an, Ibrahim: 4.
180. Kur'an, Jusuf: 1-2.

Fjala e Zotit xh.sh. apo Kur'ani paraqet mrekullinë që i manifeston të dyja njëherësh, fjalën me kuptimin e saj. Kur'ani është themeli i besimit islam e megjithatë nuk e mohon se Islami është feja e parë që ka ekzistuar që me krijimin e njeriut të parë në tokë, është e do të jetë e pandryshuar derisa të ekzistojë kjo botë.

Fe e vërtetë ekziston vetëm një, sepse ka vetëm Një Zot. Nuk mundet që nga Një Zot i vërtetë të dalin disa fe të vërteta. Kështu që e vetmja fe që iu shpall njerëzimit, e para dhe e fundit është Islami, besimi monoteist. Në Kur'an thuhet: "Feja e vërtetë tek Allahu është vetëm Islami."[181]. "Kush kërkon tjetër fe përveç Islamit, nuk do t'i pranohet dhe ai në botën tjetër do të jetë i humbur."[182]. E përbashkëta që kanë pasur të gjitha shpalljet e profetëve janë besimi në Një Zot të vetëm, besimi në ditën e gjykimit, adhurimi, lutjet, namazi, profetët, melekët e zekati. Meqenëse të gjitha shpalljet krijojnë një unitet midis tyre, besimtarët islamë vërtetojnë të gjitha shpalljet e mëparshme, të bindur në parimet themelore të fesë së vërtetë islame. Duhet theksuar se Ebu Hanife ka thënë: "Të dini se pa dyshim të gjithë profetët kanë predikuar një fe, por sheriatet e tyre kanë qenë të ndryshme, prandaj feja nuk ndryshon, ndërsa sheriati ndryshon". Në Kur'an thuhet: "Ne për secilin nga ju kemi sjellë një ligj dhe një rrugë të qartë."[183]. Feja islame është produkt i Zotit xh.sh. dhe për këtë arsye ajo është fe hyjnore, që e ka shoqëruar njeriun nga fillimi i historisë njerëzore e vazhdon ta shoqërojë deri ditën e fundit të ekzistencës së kësaj bote.

Pra është fe universale botërore, pa dallim race, kombi e gjuhe. Ajo u drejtohet të gjithë njerëzve pa dallim, myslimanë e jomyslimanë. Të parët për të forcuar besimin e tyre dhe për të kryer vepra të mira, ndërsa për të dytët iu bën thirrje të kthehen në Islam, sepse janë të gabuar në rrugën e tyre. Në Kur'an thuhet: "O njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëri-tjetrin. Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij."[184].

Feja islame është e vetmja rrugë për të përmbushur te njeriu si nevojat trupore, ashtu edhe ato shpirtërore, duke krijuar një ekuilibër midis tyre, të mos dëmtojë asnjërin nga këto dhe pastaj për të krijuar lidhjet e kësaj bote me botën tjetër.

Shpirti dhe trupi jetojnë në një unitet me organizmin e njeriut, por kanë detyra të posaçme, së pari në njohjen e Krijuesit e pastaj ndaj vetes e të tjerëve. Në Kur'an thuhet: "Por përpiqu me atë që të ka dhënë Allahu të fitosh jetën e botës së ardhshme, duke mos harruar pjesën tënde në këtë botë."[185].

Feja islame i shërben njeriut për të gjitha fushat. Krahas besimit ajo e udhëheq njeriun edhe për çështjet që kanë të bëjnë me rregullat e përgjithshme jetësore, kulturore, shkencore, sociale, ekonomike dhe shoqërore. Në Kur'an thuhet: "Ne nuk kemi harruar asgjë në Librin Tonë."[186], "Ne ta zbritëm ty Librin, si shpjegim për çdo çështje"[187].

---

181. Kur'an, Al 'Imran: 19.
182. Kur'an, Al 'Imran: 85.
183. Kur'an, El-Maide: 48.
184. Kur'an, El-Huxhuratë: 13.
185. Kur'an, El-Kasas: 77.
186. Kur'an, El-En'am: 38.
187. Kur'an, En-Nahl: 89.

Nga sa u tha kuptohet qartë se Islami është fe e gjallë që ka përfshirë paqësisht zemrat e besimtarëve në gjithë globin tokësor. Të gjithë trajtohen si anëtarë të një familje të madhe dhe urdhërohen të duan njëri-tjetrin, ta respektojnë njëri-tjetrin me ndjenja e bindje të ndërsjella. Muhamedi a.s. u bë shpëtimtar i qytetërimit botëror që me Kur'anin e shpallur nga Allahu vuri themelet e paqes botërore e të unitetit të racave njerëzore. Është feja islame ajo që i siguron shoqërisë njerëzore lumturinë e saj. Ky parim qytetërimi nuk është material, por shpirtëror. Ai e fton njerëzimin të kuptojë marrëdhëniet e tij me Krijuesin dhe pozitën e vet në mes të krijesave të ndryshme. Po të jetë se drita e kësaj vërtetësie dhe këtij qytetërimi do të depërtojë në shpirtin e kësaj bote, pa dyshim fati i njerëzimit do të ndryshojë shumë, sepse parimet e Islamit janë në gjendje të shërojnë plagët që manifestohen sot në shoqërinë njerëzore. Vetëm mbështetja në fenë islame, mbështetja në të Vërtetën Hyjnore, do t'i sjellë shoqërisë njerëzore prehjen e qetësinë, paqen e vëllazërimin.

Profeti a.s. ka thënë: "Dijetarët janë trashëgimtarë të profetëve". Këta u mësojnë besimtarëve madhështinë e Allahut xh.sh., si dhe dashurinë që duhet të kenë ndaj Tij. Kur'ani që i u zbrit të dashurit të Allahut me ndërmjetësimin e Xhibrilit, na urdhëron besimin në Një Zot. Besimtarët që kapen fort pas Kur'anit dhe e besojnë atë, janë si një organ i trupit të njeriut. Ashtu si çdo organ ka nevojë për organet e tjera të trupit, ashtu edhe besimtarët kanë nevojë për njëri-tjetrin. Shpirti i këtij trupi është Kur'ani dhe qendra e shpirtit është zemra. Kur shpirti ndahet nga trupi, ai trup nuk ka më vlerë, prishet dhe mbetet skeleti. Ashtu si ndihet dhembja e një organi të trupit kur i ndodh diçka, ashtu edhe trupi ndjen dhimbje për shkak të organit që është hequr nga ai trup. Madje na dhemb gjithë trupi kur dëmtojmë ndonjë organ. Nëse ti besimtar nuk e dëgjon dhimbjen e vëllait tënd kur e shqetëson atë, kjo do të thotë që ti je shkëputur nga ai trup. Nuk mund ta konsiderojmë jo besimtar njeriun që deklaron e thotë se është mysliman. Zoti në Kur'an thotë: "Mos i thoni atij që ju përshëndet me selam: "Nuk je besimtar""[188]. Kjo do të thotë se çdo njeri që dëshmon me gojë dhe e vërteton me zemër, është mysliman.

Në fenë islame nuk ka rëndësi kombi e ngjyra, raca dhe gjuha. Të gjithë myslimanët pa dallim janë vëllezër, ashtu siç thuhet në Kur'an: "Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër"[189]. Kjo do të thotë që asnjë nuk qëndron më lart se tjetri, veç se ai që është më bujari dhe i frikësohet Allahut. Konsiderohen miq të Allahut ata besimtarë që janë të devotshëm dhe i frikësohen Allahut. Prandaj besimtarët, për të lartësuar fenë islame, duhet të duan njëri-tjetrin për hir të Allahut dhe të dërguarit të Tij dhe të bashkohen me dëshminë e shehadetit.

Të mos ndahen nga kjo dëshmi e të jenë të qëndrueshëm në bindje e adhurim ndaj Allahut, të tregohen të kujdesshëm në zbatimin e urdhrave të Allahut si dhe të ndihmojnë njëri-tjetrin. Sipas Islamit, besimtarët nuk duhet t'i bëjnë padrejtësi njëri-tjetrit. Feja islame është një e tërë dhe ajo nuk mund të ndahet. Fjala është një kala e fortë e Allahut. Kush strehohet në këtë kala, është i shpëtuar nga dënimi në këtë botë dhe në ahiret. Ai është nën mbrojtjen e Allahut. Ai ka fituar lumturinë e kësaj bote dhe mëshirën e shpëtimin në ahiret. Për ta mbrojtur këtë kala dhe për të siguruar shpëtimin, Allahu në Kur'an urdhëron që të qëndrojmë gjithmonë bashkë. O besimtar! Sikur të jesh i vetëm në këtë botë, përsëri mos u ndaj nga Kur'ani, që është litari i Allahut dhe i të dërguarit të Tij.

---

188. Kur'an, En-Nisa: 94.
189. Kur'an, El-Huxhuratë: 10.

Kërko nga Allahu ditën dhe natën që të largohesh nga kjo botë si besimtar dhe mysliman. Konsideroji vëllezër të gjithë myslimanët. Le të jenë ata të sigurt ndaj gjuhës dhe dorës tënde. Mos e shenjtëro nefsin tënd. Lartësimi gjendet te Allahu dhe i dërguari i Tij. Le ta braktisim zilinë, smirën dhe zemërimin. Le të bëhemi vëllezër me njëri-tjetrin dhe të qëndrojmë në këtë vëllazëri.

Besimi në Zotin është një ndjenjë shpirtërore që mbush shpirtin e besimtarit me dritën hyjnore. Kur ky besim vendoset mbi themelin e jetës së tij, ai mendon e arsyeton me ligjin hyjnor i cili dominon mbi natyrën e tij dhe e bën ligj me rregull të veprimtarisë së tij.

Sa më shumë të përparojë dija e shkenca, aq më shumë duhen kthyer sytë tek fuqia e pakufizuar e të madhit Zot dhe do t'i gjejë të argumentuara të gjitha në Kur'anin e shenjtë. Kur'ani do të ndriçojë gjithnjë e më shumë të ardhmen. Ai do të jetë gurra e pashtershme për të gjitha nevojat e njerëzimit, për ta këshilluar e udhëhequr atë në rrugë të drejtë.

Lusim Allahun që të mos na ndajë nga Islami!

Amin!

4.3. Madhështia e Muhamedit a.s.

Lavdia i takon Allahut, Zotit të botëve, mëshira dhe paqja qofshin mbi të dërguarin e Tij besnik, Muhamedin, familjen dhe shokët e tij.

Sot myslimanët kanë një ditë të madhe, një ditë të lumtur, një ditë plot begati. Në këtë ditë çdo zemër që i ka kushtuar besimin fesë së vërtetë islame rreh me gëzim, çdo shpirt ndjen kënaqësi e çdo trup jeton në paqe e qetësi. Kjo pra ishte dita e madhe që me agimin e saj i dha gëzim e lumturi njeriut si krijesa më e lartë, pas mundimesh kaq të gjata morale e lëndore dhe kjo qe dita e dymbëdhjetë e Rebiul Evelit të vitit 571, e lindjes së profetit tonë të madh, Muhamedit a.s.

Po të hedhim një vështrim mbi historinë e zhvillimit të njerëzimit, do të zbulojmë se kanë ardhur shumë profetë në kohë, vende e popuj të ndryshëm. Lidhur me këtë lind pyetja: Cili nga këta yje të shkëlqyer ndriçon më tepër dhe mbi cilët supe ra barra kryesore e idealit të lartë, e besimit në Një Zot? Ai ishte Muhamedi, paqja e bekimi i Zotit qofshin mbi të, i cili dërgoi fjalën e Zotit te njerëzit, për t'i kthyer ata në rrugën e drejtë, në rrugën e shpëtimit. Ai ofroi zbulimin e një fuqie hyjnore, e cila mban në harmoni gjithçka ndodhet në gjithësi. Besimi ndaj kësaj fuqie te Një Zot i vetëm solli transformimin dhe shpëtimin e shoqërisë njerëzore nga degjenerimi moral e shpirtëror. Ai solli zgjidhjen e shumë problemeve morale si individuale, familjare e shoqërore. H. Muhamedi duke kuptuar veset e liga shoqërore e fetare që gërryenin zemrën dhe helmonin gjakun e pastër njerëzor, erdhi me një recetë shërimi, të perfeksionuar e të pavdekshme në efektin e saj.

Madhështia e këtij njeriu të madh u vërtetua me jetën e tij. Në të çdo fazë e moralit njerëzor gjeti zhvillimin e plotë e për këtë arsye ai u thirr "shembull i perfeksionuar i njerëzimit". Shfaqja e këtij njeriu të madh me mesazhin e Islamit, la gjurmë në zemrat e besimtarëve që një ditë lëshoi rrezet e shpëtimit në mbarë botën. Nga fillimet e shpalljes e deri në ditët e sotme madhështia e Muhamedit a.s. u bë një vepër universale për mbarë njerëzimin, e cila gjatë gjithë historisë mori vlera personale. Vetë uniteti i tij personal me të përgjithshmen e fesë islame u bënë objektivi kryesor që i

dhanë njerëzimit një pamje të re, një vizion të ri për familjen, për barazinë gjinore që solli shpëtimin e vajzave që varroseshin të gjalla.

Madhështia e këtij njeriu të madh nuk qëndron vetëm në faktin se predikoi fenë e logjikës e të arsyes, atë të adhurimit të Një Zoti të vetëm si dhe të shumë ngjarjeve që bënin mrekulli, por edhe në atë të të qenit e një personaliteti të pushtetshëm në të cilin janë përmbledhur shumë atribute të papërshkruara. Ai krijoi baza të reja për veprime më të mira të brezave që erdhën pas tij e që do të vazhdojnë të vijnë.

Sot, duke parë madhështinë e këtij profeti të madh, që la gjurmë në udhëheqjen e ligjeve islame, çdo besimtar zbulon veten. Sa më i ndërgjegjshëm me ligjet dhe kushtetutën hyjnore, aq më i vullnetshëm bëhet në zbatimin e tyre. Respekti për këtë njeri të madh, që, me thjeshtësinë e tij, e konsideroi veten "njeri" si gjithë të tjerët, bëri të mundur që të shihet madhështia e tij e mishëruar në botën myslimane. Shpallja Hyjnore e Kur'anit Fisnik e ngriti Muhamedin në personin më absolut që bëri kthesën në mënyrat e të menduarit psikik e psikologjik. Ai u bë garancia e së ardhmes dhe një kënaqësi e pakrahasueshme në vetvete.

Historikisht kanë ardhur njerëz të mëdhenj, profetë për popuj në epoka të ndryshme dhe janë konsideruar si të paarritshëm. Por profeti i fundit, Muhamedi a.s., paqja e bekimi i Zotit qofshin mbi të, u bë objekti më i madh i reflektimit. Interpretimi i mrekullueshëm i Mesazhit Hyjnor, madhështia e aftësisë së tij për të bindur njerëzit t'i kthehen të vërtetës, besimit te Një Zot i vetëm dëshmon për shkallën e lartë të inteligjencës që i është dhuruar atij nga Zoti i madhërishëm, i Cili e zgjodhi për këtë mision.

H. Muhamedi a.s. ishte dhe mbetet më i madhi, më i rralli, më i çmuari njeri që i përket racës njerëzore. Por nuk është kulti që i drejtohemi. Ai është i dërguari i Zotit dhe madhështinë e tij e shohim në realitetin jetësor të përditshëm. Që në rininë e tij kishte tërhequr vëmendjen si një individ i veçantë, personalitet me cilësi i etiketuar "i besueshëm". Cilësitë që e karakterizonin atë, ia ndryshuan mentalitetin për jetën e brendshme shpirtërore dhe atë të jashtme, veprimtarinë konkrete. Ky qëndrim e bëri Muhamedin si simbolin e të drejtës, që u forcua me Shpalljen Hyjnore, e vazhdon të mbijetojë deri në ditët tona. Muhamedi a.s. në misionin e tij, nuk e ka hyjnizuar kurrë veten. Në marrëdhënie me njerëzit e ka konsideruar veten "njeri i thjeshtë" që me personalitetin e tij ndikoi në përhapjen e Islamit në të katër anët e botës. E veçanta e tij ishte se vetë Zoti e zgjodhi si misionar me mendim të madh që përmes Kur'anit dhe interpretimit të tij, arriti te madhështia. Ai u bë simboli i mëshirës dhe vëllazërimit, drejtësisë dhe humanizmit, sinqeritetit dhe besnikërisë, moralit dhe pastërtisë. Muhamedi a.s. sot është portretizuar si njeriu më i madh reformator, që ndryshoi botën islame e vazhdon të mbetet i tillë me ligjet e Islamit. Ky është modeli që kanë ndjekur e do të ndiqet nga besimtarët, sepse është ai që përçoi Mesazhin Hyjnor. Me kushtetutën hyjnore u bë mendimtari, legjislatori, edukatori e burri i shtetit që realizoi gjithçka në zbatimin e ligjeve islame. Kuptimi dhe keqkuptimi që ka shoqëruar veprën e profetit Muhamed gjatë historisë, tregon se ka triumfuar e vërteta. Procesi i përhapjes së Islamit mbetet aktual, si i tillë ai konsiderohet si njeriu më i madh i së tashmes dhe të ardhmes.

Në personalitetin e Muhamedit a.s. mund të gjejmë të përmbledhura të gjitha virtytet njerëzore e hyjnore, virtyte këto që përballojnë e zhvillojnë njerëzimin në aspekte të ndryshme të jetës fizike, ndijore, shoqërore, mendore, morale e shpirtërore. Në karakterin e tij spikatin cilësi të

rralla si sinqeriteti, bujaria, mendjegjerësia, papërkulshmëria, gjakftohtësia në kundërshtime e armiqësi, përulja në lumturi, modestia, trimëria dhe guximi, shpirtmadhësia, dashuria e flaktë për fëmijët e mbi të gjitha për misionin e tij fisnik.

Madhështia e këtij profeti të Islamit tregon se ka jetuar në kohë dhe mbi kohën. Ai ka zbatuar ligjet e revelatës Hyjnore në një kohë dhe vend të caktuar, por ai nëpërmjet saj ka proklamuar përjetësinë, sepse Kur'ani, kodi hyjnor që shpalli, u flet të gjitha epokave dhe gjithë njerëzimit. Me përkushtim thirri e këshilloi njerëzit që të dëgjojnë mesazhin e tij ashtu si u dëgjua. Me krenarinë e ligjshme të Islamit, ai ishte unik për forcën e tij argumentuese në besimin e Një Zoti të vetëm dhe ndërgjegjësimin për këtë Ekzistencën Hyjnore dhe pasuesit e tij sot janë mbi një miliard. Mesazhi i tij u dëgjua, sepse mori vlerësimet më të mira në shoqërinë njerëzore si mik besnik, bashkëshort i devotshëm, mendimtar i thellë në misteret e jetës e të vdekjes dhe mbi përgjegjësinë e veprave njerëzore që është qëllimi i fundit i jetës së njeriut. Ai mori përgjegjësinë e reformimit të një kombi dhe më tej, për gjithë botën, me zemër që digjej për ta ngushëlluar e qetësuar atë. Ai u bë një sundimtar bamirës që përhap dritë e dashuri rreth tij. Muhamedi a.s. ishte një profet me qëllime të larta, një njeri me dëshirë të fortë dhe i vendosur në parimet e tij. Te ky njeri është përmbledhur gjithçka e mirë e fisnike dhe personaliteti i tij ka qenë i pajisur me të gjitha cilësitë që e bënin njeri të përsosur që të përjetonte madhështinë te njerëzit besimtarë e jo besimtarë.

Profeti Muhamed nuk i përket vetëm kohës së tij, pasi ai u flet njerëzve të të gjitha kohërave. Kjo është shenjë e madhështisë së të dërguarit të Zotit që arrin të bëhet bashkëkohor e shërben si pasqyrë për njerëzit, veçanërisht besimtarët i forcon e i shtyn të ecin përpara. Përmes veprës së tij krijuese e frymëzuese arriti të ketë aftësinë e mendimit origjinal për të vënë në lëvizje veten e të tjerët. Jo vetëm shpallja Hyjnore, por edhe qenia e tij i thjeshtë, rruga e jetës së tij, mjedisi ku jetoi, veprimet dhe karakteri i tij kanë lënë mbresa në zemrat e besimtarëve. Reformimi i botës shpirtërore e materiale me shpalljen Hyjnore bëri kthesën më të madhe në historinë njerëzore.

Prandaj profeti Muhamed është vendosur në histori dhe i lidhur ngushtë me epokat që kanë ardhur deri në ditët tona e do të vazhdojë deri në fund të kësaj bote.

Ai u ka rezistuar shekujve, sepse ka përçuar të vërtetën që nuk zhduket. Vetë Zoti i Madhërishëm është mbrojtës i saj. E vërteta e mesazhit bën pjesë në të vërtetën e këtij njeriu të madh në ndryshimin e realitetit që solli Islami si fe me ligjet më demokratike që ka parë shoqëria njerëzore.

4.4. Muhamedi, profet dhe reformator i kohërave

Në historinë e njerëzimit kanë kaluar shumë njerëz të famshëm, heronj apo figura të shquara të kulturës e shkencës, të dalluar në fusha të caktuara. H. Muhamedi vetëm për 23 vjet ndryshoi gjendjen e një popullit të vetëm, popullin mysliman, të një shteti të ri që i dha botës shembullin e vullnetit e të punës për të bërë çdo gjë. Ai njohu të gjithë profetët para tij, reformat që bënë ata në popujt e tyre dhe urdhëroi pasuesit e tyre që t'i besojnë ata. Ai tregoi se e vërteta është Një që nga profeti i parë dhe vërtetoi së është dërguar me parimet e tyre, por është plotësues i këtyre parimeve, krahas me përparimin e kohës e mentalitetin e saj, si dhe për të gjithë botën mbarë. Ai ndryshoi

mënyrën e të menduarit, zakonet e sjelljet e tyre morale. Nga një komb që nuk kishte nxjerrë njerëz me vlera kombëtare, prodhoi me mijëra elementë që u përhapën në të katër anët e botës për të predikuar mësimet e fesë, të moralit e të qytetërimit. Me sjelljen fisnike Muhamedi pushtoi zemrat e njerëzve e me simpatinë ndaj tij bëri edhe kundërshtarët më të egër. Ai ndërtoi shtet dhe u bë ligjvënës, por ishte edhe ushtarak i zoti, mësues dhe edukator i njerëzimit. Me udhëzimin hyjnor u bë udhëheqës shpirtëror që përçoi i vetëm nga fillimi mesazhin islam. Urdhrat dhe porositë e tij ishin që nga më të thjeshtat, në mënyrën e të jetuarit e deri te rregullimi i çështjeve të shtetit e marrëdhëniet me shtetet fqinje.

Profeti Muhamed a.s., në përcjelljen e mesazhit hyjnor, nuk u përkul në asnjë moment nga vështirësitë e pengesat që hasi gjatë rrugës së tij, por diti me durim të zgjedhë metodat më të përshtatshme, në kushtet e veçanta, që arriti të triumfojë feja e Allahut. Në Enciklopedinë Britanike theksohet: "Ndër personalitetet fetare që u dukën në këtë botë, vetëm Muhamedi arriti të sigurojë suksesin më të madh". Kjo është e vërtetë se Zoti në Kur'an i drejtohet Muhamedit e i thotë: "Ne të dërguam ty si mëshirë për të gjitha botët". Ai e mbarti dhe e realizoi këtë mision duke vendosur themelet e një feje për të gjithë botën mbi bazën e parimit të vëllazërimit e pa dallim ngjyre, race e kombësie.

H. Muhamedi solli qytetërimin në vendet arabe, edukoi njerëz me kulturë, të përkushtuar në besimin te Zoti Një, të drejtë në administratë e në shoqëri, njerëz fisnikë që në çdo moment i druheshin frikës së Zotit. Nga elita e këtyre njerëzve dolën misionarë që u përhapën në të katër anët e botës për të përçuar parimet e moralit të qytetërimit. Këto u arritën në saje të personalitetit të lartë të Muhamedit dhe ndjekësve të tij, me bindje e moral të lartë. Ai, edhe pse udhëheqës, bënte jetë të thjeshtë, merrte pjesë në gëzime e hidhërime bashkë me të tjerët pa dallim. Drejtësia dhe sinqeriteti ishin cilësi të personalitetit të tij dhe të gjithë e thërrisnin "El Emin", i besueshmi. Përpara drejtësisë të gjithë njerëzit pa dallim ishin të barabartë. Muhamedi zbatoi urdhrin kuranor ku thuhet: "O besimtarë! Bëhuni të qëndrueshëm në urdhrat e Allahut dhe bëhuni dëshmues me drejtësi! Le të mos ju nxisë urrejtja ndaj njerëzve për të bërë padrejtësi. Bëhuni të drejtë, se kjo është më afër devotshmërisë"[190]. Për drejtësi Muhamedi a.s. është përmendur edhe nga armiqtë e tij më të egër si Ebu Xhehli, Ebu Sufjani etj., të cilët e kanë vlerësuar besnikërinë, drejtësinë dhe moralin e lartë të tij. Në çastet më kritike të jetës së tij, asnjëherë nuk u tregua hakmarrës, përkundrazi, mëshirues dhe falës. Kur u plagos në luftën e Uhudit, kurrë nuk e mallkoi ushtrinë armike, por vetëm tha: "Unë nuk kam ardhur për të kërkuar mallkimin e Zotit mbi njerëzimin, por mëshirën. O Zot, fale popullin tim se ata nuk e dinë se ç'bëjnë". Kjo është një ngjarje unike në historinë njerëzore që tregon fisnikërinë e këtij profeti të madh të njerëzimit. Ai i bëri pasanikët që të ndihmojnë të varfrit për të zhdukur varfërinë. Vetë sakrifikonte dhe nuk nxirrte asnjë duarbosh. Veçanërisht u kujdes për jetimët që fati i kishte sjellë në gjendje të mjerueshme. Ai thoshte: "Ata janë afër meje se janë afër njëri-tjetrit si dy gishtat e dorës".

H. Muhamedi bëri reforma dhe përmirësoi plagët më të rënda të shoqërisë arabe si: imoraliteti, alkooli, bixhozi, kamata etj., fenomene këto që edhe sot po shkatërrojnë shoqërinë moderne. Ai shpalli pronën të shenjtë, nderin të shenjtë, barazinë gjinore të shenjtë, duke ngritur lart dinjitetin e femrës e deri në të drejtën e saj të trashëgimisë. Muhamedi a.s. bëri për popullin e tij

[190]. Kur'an, El-Maide: 8.

kushtetutën e parë mbi të drejtat e njeriut mbështetur në Fjalën Hyjnore, Kur'anin. Kjo më vonë gjeti mbështetje edhe jashtë territoreve arabe si në Spanjë, Kinë etj. Ai u shqua edhe si diplomat në marrëveshjet me fiset arabe pa dallim feje, për të sjellë paqen e qetësinë midis shtetasve në shtetin e parë islam. Nga ana tjetër krijoi ura komunikimi edhe me sundimtarët e huaj si dhe me mbretër duke i ftuar në fenë islame. Në delegacione që përcillnin mesazhin e tij dërgoi njerëzit më të zotë si oratorë të devotshëm, madje edhe jo myslimanë. Profeti kishte një aktivitet të gjerë politik. Nënshkrimi i paqes së Hudejbijes ku me konsensusin e arritur bëri që të realizojë fitoren më të madhe për myslimanët, që hynë fitimtarë në Shtëpinë e Shenjtë, Qabenë, e cila vazhdon të jetë qendër pelegrinazhi për mbarë myslimanët e botës. Kjo ishte aftësia diplomatike e Muhamedit me stafin e tij këshillues, që asnjëherë nuk e ndau nga vendimmarrjet e rëndësishme politike. Megjithëse i zgjedhur i Zotit, ai asnjëherë nuk u shkëput nga këshillat e shokëve.

Muhamedi është vula e profetëve. Ai udhëhoqi njerëzit në rrugën e logjikës dhe arsyes, bashkoi vlerat shpirtërore me ato materiale, harmonizoi fenë me diturinë, teorinë dhe praktikën. Të gjithë demonstronin dashuri dhe respekt për të, pasi ai bëri një revolucion të madh brenda sistemit shoqëror, moral e fetar të kombit të tij. Brenda një kohe të shkurtër, bota islame mori një zhvillim të madh në fushat e kulturës, shkencave, mjekësisë etj. Në këtë kohë Evropa dërgonte bijtë e saj nëpër universitetet islame, sepse këto universitete ishin në kulmin e suksesit. Këtë revolucion kulturor e ideologjik e bëri pikërisht H. Muhamedi, që konsiderohet një nga reformatorët më të mëdhenj të kohës, mesazhet e të cilit në këto fusha janë aktuale edhe në ditët e sotme.

Megjithëse i rritur jetim, i pashkolluar, në një mjedis ku sundonte injoranca dhe errësira, korrupsioni dhe imoraliteti, ai, i frymëzuar nga Zoti i Madhërishëm, mori përsipër të shpëtojë popullin arab e pastaj gjithë njerëzimin. Muhamedi a.s. mori guxim sepse Zoti e urdhëroi: "Thuaj (o Muhamed): "O njerëz, unë jam i Dërguari i Allahut për të gjithë ju, i Atij që i përket sundimi i qiejve dhe i Tokës. Nuk ka zot tjetër të vërtetë veç Atij"[191]. Me porosinë e Allahut e ftoi njerëzimin të bashkohet në formulën e besimit: "Nuk ka Zot tjetër, veç Allahut". Profeti Muhamed, me sjelljen e qëndrimin e tij, u bë zbatues i fjalës së Allahut, Kur'anit. Si i tillë ai u shpreh: "Unë kam ardhur për të plotësuar e realizuar sjelljet dhe moralin më të mirë tek njerëzit". Prandaj të gjithë besimtarët duhet të ndërtojnë jetën e tyre individuale, familjare e shoqërore sipas dy burimeve kryesore bazë të Islamit: Kur'anit dhe traditës profetike. Zoti në Kur'an thotë: "Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun."[192].

H. Muhamedi a.s. me personalitetin e tij të lartë u bë shpëtimtar i qytetërimit dhe me librin e shenjtë, Kur'anin, vendosi themelet e paqes botërore e të unitetit të racave njerëzore, pa të cilën nuk mund të ketë qytetërim. Zoti është Një për të gjitha kombet dhe i trajton ata si anëtarë të një familje të madhe njerëzore, urdhëron të duan njëri-tjetrin e të respektojnë ndjenjat e bindjet e ndërsjella për të shmangur konfliktet dhe luftërat shkatërrimtare. Ai me Islamin që përcolli, i solli njerëzimit fenë e vërtetë e bazuar në logjikë, ashtu si shprehet: "Të gjitha punët peshohen me logjikë". Me parimet islame u bë transformimi moral, shpirtëror e material jo vetëm i arabëve, por edhe i shteteve perëndimore. Ai i fton njerëzit të kuptojnë marrëdhëniet e tyre me Krijuesin dhe pozitën e tyre në

[191]. Kur'an, El-A'raf: 158.
[192]. Kur'an, El-Ahzab: 21.

mes krijesave. Në qoftë se sot drita e kësaj vërtetësie dhe këtij qytetërimi do të depërtojë në shpirtrat e njerëzve, pa dyshim fati i njerëzimit do të ndryshonte shumë dhe do ta shmangte atë nga konfliktet dhe krizat që përjeton sot.

Prandaj figura e tij do të mbetet shembull nga shekulli në shekull, fjala e tij do të tingëllojë ëmbël në përparimet e shkencës në të gjitha fushat, sepse do të gjejë porositë e tij të vëna në jetë. Sa më shumë të përparojë dija e kultura ajo do të zbulojë mrekullitë kuranore që transmetoi ky zotëri që i solli shërbime të mëdha njerëzimit. Prandaj e meriton të kujtohet me nderim të veçantë nga i gjithë njerëzimi e veçanërisht nga bota islame.

5. Besimi në Ditën e Gjykimit

Në Ditën e Gjykimit të gjithë njerëzit do të dalin para Sunduesit dhe gjykatësit absolut, Allahut të Lartësuar për të dhënë llogari se si e kanë kaluar jetën në botën tokësore, veprat që kanë kryer dhe sa ato kanë qenë në përputhje me udhëzimet hyjnore të lejuara apo të ndaluara. Për çdo gjë që ka kryer njeriu në këtë botë në përputhje me kushtetutën e vendit ku jeton, merr vlerësimet nga shoqëria, familja e deri edhe organet shtetërore. Por kur ai shkel ligjet, dënohet penalisht. Në botën tokësore mund t'i shpëtohet dënimit edhe me mashtrime e ryshfete. Kjo do të thotë se në këtë botë drejtësia gjithmonë është relative. Ndërsa nesër në ditën e gjykimit përpara Zotit të lartësuar, njeriu ndodhet para gjykatësit absolut, që nuk ka asnjë devijim në peshën që mban me veprat që ka kryer. Për veprat e mira besimtari do të shpërblehet me parajsën, jetën e lumtur, ndërsa për veprat e këqija do të ndëshkohet me ferrin e xhehenemin.

Njeriu në këtë botë duhet të jetë falënderues e mirënjohës ndaj Zotit të Lartësuar për atë që i ka dhuruar dhe të zbatojë udhëzimet e ligjet e shpalljes hyjnore, që të fitojë xhenetin. Në të kundërt, ai do të përjetojë xhehenemin, një vend ku ndëshkimi do të jetë sipas shkallës së mëkateve që ka bërë. Zoti i Lartësuar i njeh njeriut që gabon pendimin para se të vdesë. Pendimi me sinqeritet dhe lutja për faljen e mëkateve, i jep shpresë njeriut që Zoti t'ia falë mëkatin dhe të kalojë një jetë të lumtur në parajsë.

Gjurmët që lë Dita e Gjykimit mbi myslimanët.

Në Kur'an thuhet: "Ajo është Dita e Vërtetë, prandaj kush të dojë, le të kthehet te Zoti i vet (që në këtë jetë)."[193].

Dita e Gjykimit është çasti më i ndjeshëm dhe më i rrezikshëm për njeriun. Ajo ditë tregon se çfarë i ndodh njeriut nga çasti i vdekjes deri në saktësimin e vendqëndrimit të tij në ferr (xhehenem) apo në parajsë (xhenet).

Këtu ne po paraqesim një përshkrim të shkurtër të etapave të Ditës së Gjykimit në mënyrë që të zgjohemi nga pakujdesia jonë e deritanishme dhe të përgatitemi për këtë ditë të rëndësishme me vepra të mira. Të përpiqemi të shtojmë punët e pëlqyeshme në këtë jetë që ato të na mbrojnë në ditën më të vështirë, ditën e gjykimit. Po ashtu duhet të shikojmë në veten tonë nëse ekziston apo jo

[193]. Kur'an, En-Nebe': 39.

besimi në ditën e gjykimit. Nëse ekziston, falënderojmë Allahun, nëse jo, le të shpejtojmë për ta fituar këtë besim.

5.1 Ç'është vdekja?

Vdekja është çasti që ndan njeriun nga kjo jetë dhe pikënisja e tij për në jetën tjetër. Vdekja është e pashmangshme për çdo njeri dhe e ndan atë nga familja, fëmijët, të afërmit dhe gjithçka ka në këtë jetë.

Kur njeriu vdes shikon engjëjt që vijnë për ta përgëzuar nëse ka qenë besimtar, në të kundërt atë e hidhërojnë. Në çastet e fundit të jetës, kur njeriu dorëzon shpirtin, nuk ka vlerë asnjë lloj pendimi dhe çdo gjë që ka kaluar në jetën e tij, mbahet e pandryshuar. Prandaj njeriu duhet të kujtojë gjithmonë vdekjen, sepse kjo nuk e lejon të kryejë vepra të këqija, por gjithmonë është i prirur të bëjë vepra të mira. Profeti Muhamed, paqja e bekimi i Zotit qofshin mbi të, ka thënë: "Kujtoni shpesh atë që jua prish kënaqësitë, ajo është vdekja".

Zoti në Kur'an urdhëron e thotë: "Çdo shpirt do ta shijojë vdekjen"[194]. Njeriu vdekjen e konsideron si diçka shumë të frikshme, saqë kur zë në gojë njeriun e vdekur, thotë: "larg nesh", për të krijuar një mur ndarës ndërmjet njeriut që dëgjon dhe vdekjes.

Ta dimë se vdekja nuk është mbarim i çdo gjëje, por është edhe fillimi i një pike të re të pafund, prandaj nuk duhet të kemi frikë, madje duhet ti nderojmë ata që shkojnë me dinjitet e fisnikëri. Njeriu duhet të jetë i ndërgjegjshëm se shkon drejt qëllimeve të mëdha e të madhërishme.

Kjo botë është një kullotë për botën e ardhshme ose një fushë që duhet mbjellë e pastaj duhet korrur jeta e përhershme. Bota tokësore është gjithësia ku ne duhet të mësojmë dhe të përgatitemi për jetën tjetër në një betejë të përjetshme. Bota është një urë që duhet kaluar dhe jeta e kësaj bote nuk do të na duket absurd dhe pa vlerë, përkundrazi, ajo do të jetë fillimi për një jetë të përhershme, pavarësisht se përpjekjet tona janë të pakta.

Besimi në ringjallje i jep kuptim jetës, e çliron njeriun nga ankthi e shqetësimet dhe më tej besimi në ekzistencën e gjyqit të ditës së gjykimit, ndikon shumë në jetën tonë të përditshme. Zoti në Kur'an urdhëron e thotë: "Sigurisht, Ne i ringjallim të vdekurit dhe shënojmë veprat që kanë bërë dhe gjurmët e (punëve të) tyre. Ne e kemi llogaritur çdo gjë në një Libër të qartë."[195].

Shtrohet pyetja: Si është gjyqi?

1. Gjyqi është i drejtë. Në të nuk mund të ndryshohet fare vendimi.
2. Është një gjyq që bëhet menjëherë. Vendimet janë të shpejta.
3. Është një gjyq ku njerëzit do të njihen nga veprat që kanë bërë.
4. Dëshmitarë janë organet e trupit që i kanë kryer ato vepra. Ky gjyq ka për gjykatës Zotin e Plotfuqishëm, i Cili i di të gjitha dhe nuk ka nevojë për asgjë.

---

194. Kur'an, El-Ankebut: 57.
195. Kur'an, Jasin: 12.

Allahu i di të gjitha veprat e njeriut, ndjenjat e tij, mendimet e tij, të mira apo të liga qofshin ato, si dhe përfundimin që do të ketë njeriu nga këto vepra.

Njeriu, sado i lumtur që të jetë në këtë jetë, sado i pasur që të jetë, vjen vdekja dhe ia prish humorin e kësaj bote. Kjo tregon se njeriu është krijuar për të qenë i lumtur, por kulmin e lumturisë do ta arrijë në jetën pas vdekjes, në jetën e pasosur ku nuk ka më vdekje.

Kjo jetë është një udhëtim ku stacioni i parë është vdekja dhe pastaj nis një jetë të pasosur. Për të shkuar në këtë udhëtim, njeriu duhet të jetë i plotë, i përgatitur mirë. Kur bëjmë një udhëtim, marrim ushqim me vete, por për këtë udhëtim të gjatë, çfarë duhet të marrim? Këtu duhet ushqim për shpirtin, sepse ky u nda nga trupi, u largua, shkoi pranë prezencës Hyjnore. Ky është i padukshëm dhe ushqim i tij janë vetëm veprat e tij. Zoti na e ka falur shpirtin, na e ka dhënë amanet, edhe të kthehet tek Ai, por do të pyetet:

- Si e harxhoi jetën?
- Si e shfrytëzoi trupin e tij?
- Si e harxhoi dijen e tij?
- Si e fitoi dhe harxhoi pasurinë e tij?

Zoti xh.sh. në Kur'an thotë: "Ai ju ka krijuar për herë të parë dhe tek Ai do të ktheheni".[196] Pra ekziston ringjallja. Shpirti qëndron në një nivel më të lartë në kohën e ringjalljes dhe trupi do të shndërrohet, rikrijohet e bëhet i pastruar nga mangësitë e kësaj bote. Pra bashkohet me shpirtin e fillon një jetë të re. Kjo është ringjallja fizike se shpirti është i siguruar.

Zoti na nxjerrtë faqebardhë!

Amin!

5.2 Varri

Pasi njeriu vdes dhe vendoset në varr, atëherë të afërmit e tij kthehen në shtëpitë e tyre dhe pasuria e tij nuk i bën më dobi. Në këtë moment për të fillon jeta shpirtërore, në të cilën nuk mund të veprojë më asgjë. Aty ka provim dhe pas tij, kënaqësi ose dëshpërim. Dy engjëj fillojnë ta pyesin:

- Kush është Zoti yt?
- Cila është feja jote?
- Kush është profeti yt?

Nëse ai ka qenë besimtar, Allahu e siguron (e frymëzon) për të dhënë përgjigje të sakta dhe nëse ka qenë jo besimtar, ai nuk mund të përgjigjet, megjithëse mund t'i ketë ditur përgjigjet në këtë jetë. Besimtari do të jetë i lumtur në varr dhe do të shikojë vendin e tij në parajsë, ndërsa jobesimtari do të shikojë vendin e tij në zjarr, atij do t'i ngushtohet varri deri sa t'i kërcasin kockat dhe varri i tij do të jetë një gropë me zjarr për të.

[196]. Kur'an, Fussilet: 21.

5.3 Ringjallja

Kur të fryjë suri (fyelli) për herë të parë, atëherë do të vdesë çdo gjë në tokë. Më pas do të fryjë për herë të dytë, që është për ringjalljen e atëherë do të ngrihen njerëzit nga varri, këmbëzbathur e pa rroba në trup, duke mos shikuar njëri-tjetrin nga tmerri i furishëm. Pastaj do të shkojnë në sheshin e hapur dhe secili do të ketë frikë për veten e tij dhe nuk do të shikojë askënd. Allahu i madhërishëm në Kur'an thotë: "atë Ditë njeriu do të ikë nga i vëllai, nga e ëma dhe nga i ati, nga e shoqja dhe nga fëmijët e vet. Atë Ditë, secili prej tyre do të ketë aq shqetësim për veten, sa do t'i mjaftojë."[197]. Atë ditë dielli do të afrohet mbi ta dhe prej tyre do të rrjedhë djersë, ata do të përjetojnë plot brenga e mërzi. Vetëm besimtarët e vërtetë dhe të sinqertë do të jenë të qetë nën hijen e Mëshirëbërësit dhe do të pinë ujë nga burimi i të dërguarit Muhamed. Allahu na bëftë edhe ne ju prej atyre njerëzve!

Amin!

5.4 Dita e llogarisë

Pas qëndrimit të gjatë në sheshin e hapur dhe ndërmjetësimit të Muhamedit a.s., Allahu do të urdhërojë për fillimin e dhënies së llogarisë. Çdo njeri do të shikojë të gjitha punët dhe veprat që ka kryer në këtë jetë, sido që të kenë qenë ato, të vogla apo të mëdha, nuk mund t'i fshihen Allahut të madhëruar. Në Kur'an Allahu thotë: "… dhe do të thonë: "Të mjerët ne! Çfarë është ky libër që nuk paska lënë asnjë vepër të madhe apo të vogël pa e shënuar atë". Aty do të gjejnë të shënuar gjithçka që kanë punuar. Zoti yt nuk i bën padrejtësi askujt. "[198].

Në këtë ditë ne do të shikojmë punët që kemi kryer dhe për ato do të gjykohemi. Atë ditë do të shikojmë mungesat tona në të falur, në agjërim, mosdhënien e lëmoshës, do të shohim mëkatet apo krimet tona, do të gjykohemi për pasurinë tonë se si e fituam, ku e fituam dhe ku e shpenzuam, do të gjykohemi për vitet e jetës sonë, si i kaluam ato, si e kaluam rininë, do të gjykohemi për diturinë tonë, a e shfrytëzuam atë për të mirë apo për të keq.

Për të gjitha këto do të pyetemi, pra le të punojmë që të japim përgjigje të sakta!

Në ditën e llogarisë fytyrat e besimtarëve do të jenë të bardha, të shndritshme si hëna, ndërsa fytyrat e jobesimtarëve do të jenë shumë të zeza, të errësuara si nata e errët. Allahu i madhërishëm në Kur'an thotë: "Atë Ditë do të ketë fytyra rrëzëllore, të qeshura e të gëzuara. Atë Ditë do të ketë (edhe) fytyra të pluhurosura, që do t'i mbulojë errësira. Këta janë jobesimtarët, gjynahqarët. "[199].

5.5 Xheneti - Parajsa

Pasi të mbarojë llogaria do të vendoset ura e kalimit mbi xhehenem (skëterrë) për të kaluar njerëzit.

---

197. Kur'an, Abese: 34-37.
198. Kur'an, El-Kehf: 49.
199. Kur'an, Abese: 38-42.

Njerëzit që e kalojnë atë me shpejtësi, të sigurt e të qetë drejtohen për në parajsë, ku engjëjt i presin duke u hapur dyert e parajsës. Kështu ata futen në parajsë.

A e dini se ç'është parajsa?

Parajsa është begati e vërtetë dhe e përhershme. Besimtarët shikojnë aty çdo gjë të këndshme e të mirë që ne nuk mund ta përfytyrojmë dot. Përfytyrimi ynë nuk mund t'i afrohet fare vërtetësisë së saj. Për këtë na mjafton thënia e të dërguarit, Muhamedit a.s., i cili shprehet: "Në të (parajsë) ka gjëra që nuk ka sy që mund t'i ketë parë, as vesh që të ketë dëgjuar për të dhe as që i përfytyron dot njeriu". Ndodh që njeriu mund të ketë jetuar mirë në këtë jetë dhe atij mund t'i duket si parajsë, por, kur kujton jetën tjetër, menjëherë kjo begati i duket e pavlefshme, sepse parajsa (xheneti) është më se e përkryer, ajo është e përhershme, në të nuk ka vdekje. Njeriu shpesh mërzitet në këtë jetë edhe nga të mirat dhe kërkon që t'i ndërrojë këto të mira, por në parajsë ai nuk mërzitet kurrë. Allahu i madhërishëm thotë: "... për këta do të ketë si shpërblim falje madhështore (të gjynaheve) nga ana e Zotit të tyre dhe kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj dhe ku do të qëndrojnë përherë. Sa shpërblim i bukur është ky për ata që punojnë (vepra të bukura)!"[200].

Shpejto vëlla i dashur mysliman për në parajsë. Allahu i madhëruar në Kur'an thotë: "Prandaj rrekuni me njëri-tjetrin, duke kërkuar falje prej Zotit tuaj dhe një kopsht të gjerë sa qielli dhe Toka, që është e përgatitur për ata që i kanë besuar Allahut dhe të dërguarve të Tij. "[201].

5.6 Xhehenemi – Ferri

Pasi të përfundojë gjykimi i jo besimtarëve, edhe ata do të dëshirojnë të kalojnë urën njësoj si besimtarët, por engjëjt nuk do t'i lejojnë. Engjëjt do t'i tërheqin jobesimtarët dhe do t'i hedhin në skëterrë (xhehenem).

A e dini se ç'është xhehenemi (skëterra)?

Xhehenemi është vendi i tmerrit, i ndëshkimit, në të nuk ka asnjë ndihmë. Atje ka vetëm dhimbje, rënkime e dënime të shumta. Disa prej ndëshkimeve të jobesimtarëve në xhehenem janë: zjarri përvëlues, gjarpërinjtë e akrepat e mëdhenj, pirja e ujit të nxehtë që këput zorrët, pirja e pijeve të qelbura. I lutemi Allahut të madhëruar të na mbrojë prej xhehenemit, prej këtij ndëshkimi të papërshkrueshëm, që trupi yt i dobët, vëlla i dashur, kurrsesi nuk mund ta përballojë, qoftë edhe formën më të lehtë të tij. I dërguari i Allahut, Muhamedi a.s., ka thënë: "Ndëshkimi më i lehtë për një njeri në xhehenem do të jetë zjarri poshtë këmbëve të tij dhe nga ai zjarr do të vlojnë trutë e tij".

Pra, i dashur vëlla, a nuk duhet të shpëtojmë nga ky ndëshkim? Natyrisht po, por ky shpëtim nuk vjen veçse me largimin nga mëkatet dhe bindjen ndaj Allahut dhe të dërguarit të Tij. Allahu na ndihmoftë ne dhe ju për këtë!

I lutemi Allahut të madhëruar të na drejtojë ne dhe ju e të gjithë myslimanët në botë për në atë rrugë që Allahu ka kënaqësi, për në Xhenet.

I lutemi Atij të na shpëtojë ne, ju dhe të gjithë myslimanët në botë nga influenca e shejtanit dhe e të gjithë atyre që na thërrasin në të këqija.

---

[200]. Kur'an, Al Imran: 136.

[201]. Kur'an, El-Hadid: 21.

Së fundi: Falënderimi i qoftë Allahut, Krijuesit të gjithësisë, paqja dhe shpëtimi qofshin mbi të dërguarin e Tij, Muhamedin, familjen dhe shokët e tij!

5.7 Jeta e pasosur

Mohuesit pyesin: Si ka mundësi që njeriu i vdekur, i shkatërruar përfundimisht e i bërë pluhur, të ringjallet?

Ne i bëjmë pyetje të kundërt: Si u krijua trupi i njeriut nga një pikë lëngu dhe pastaj të trashëgojë deri edhe tiparet e stërgjyshërve të tij? Cila është ajo fuqi që vendosi në harmoni të plotë organet e gjymtyrët? Atëherë kuptohet se sekreti i tyre qëndron në fshehtësinë absolute, Zotin krijues.

Në qoftë se do të vështrojmë gjithësinë me gjallesat e jogjallesat që ndodhen në të, do të shohim se kudo ekziston harmonia, gjë që tregon qartë qenien e një të plotfuqishmi që rregullon gjithçka me ligjet e tij. Këto ligje mbizotërojnë në të gjitha krijesat e Tij. Atëherë nuk mund të themi se vdekja është zhdukja e përgjithshme e njeriut, kur shohim në çdo drejtim kujdesin e Zotit. Vdekja nuk është asgjësim i organizmit të njeriut, por përgatitja e shpirtit për një jetë të re.

Vdekja është si një gjumë i thellë e i gjatë. Qëllimi ynë duhet të jetë që këtë gjumë ta kalojmë në qetësi dhe kur të zgjohemi të jemi gati për dhënien e llogarisë me ballë të pastër dhe ndërgjegje të kulluar.

Njeriun duhet ta shtyjë kureshtja e tij sa është gjallë për të njohur vetveten, nga ka ardhur, ku do të shkojë, sendet që e rrethojnë, ndryshimet që ndodhin para syve të tij, madje edhe fatkeqësitë, pse ndodhin, pse çdo gjë në jetë do të njohë shkatërrimin dhe fundin. Edhe vetë njeriu është një nga ata që do t'i vijë fundi i jetës e do të lërë çdo gjë. Shpirti largohet nga ai, megjithëse do të jetojë bashkë me trupin e tij përgjithmonë.

Njeriu udhëtimin e kësaj jete e mbaroi dhe u nis për një jetë tjetër, udhëtimin e pasosur dhe të amshuar. Për të shkuar në këtë udhëtim, njeriu duhet të jetë i plotë dhe i përgatitur mirë. Ne kur bëjmë një udhëtim, marrim ushqim me vete. Po për këtë udhëtim të gjatë çfarë duhet të marrim? Këtu si ushqim për shpirtin shërbejnë veprat dhe punët që vetë njeriu ka bërë në jetë.

Kur trupi ndahet nga shpirti shoqërohet me mundime. Ka sëmundje të ndryshme që e dobësojnë trupin dhe e përgatisin për të prerë marrëdhëniet me shpirtin. Në momentin e fundit, shejtani i përgatit njeriut prita të rrezikshme. Ai i paraqitet njeriut me fytyrën e prindërve të tij dhe e provokon duke i thënë: Po deshe të shpëtosh, thuaj "nuk ka Zot". Myslimani i devotshëm dhe besimtari i vërtetë nuk bie në grackën e djallit të mallkuar e duhet të përgjigjet me dëshminë e shehadetit: Në këtë moment, njerëzit që janë përreth tij duhet të bien në shehadet në mënyrë që i sëmuri t'i dëgjojë e të kujtohet.

Në ndarje shpirti largohet nga trupi, por duhet të dimë se shpirtin na e ka falur Zoti, mendjen na e ka falur Zoti dhe gjithçka tjetër që kemi na e ka falur Zoti. Pra të gjitha këto janë dhurata të Zotit dhe në jetë njeriu duhet t'i përdorë e t'i shfrytëzojë në përputhje me ligjet e Allahut, pasi në ahiret ai do të pyetet:

- Si e konsumoi jetën?
- Si e shfrytëzoi trupin?
- Si i përdori dijet?
- Si e fitoi dhe e përdori pasurinë?

Pra njeriu duhet të jetë i përgatitur për të folur për gjithçka që ka bërë në jetë dhe këtë duhet ta bëjë me qartësi dhe sinqeritet të plotë, pasi Zoti i Madhëruar di gjithçka. Këtu duhet të kuptojmë se Zoti nuk ka regjistra lëndorë për të shkruar sjelljet dhe veprat njerëzore, as nuk ka sekretar, por dija e Tij është aq e madhe sa përfshin të gjitha sjelljet e njeriut dhe çdo gjë tjetër në botë. Këtë dituri e ka të pafund, si me e pas të shkruar në libër.

Pra Allahu i di të gjitha veprat e njeriut, ndjenjat, mendimet e tij, të mira apo të liga qofshin, si dhe përfundimin e njeriut me këto vepra. Allahu xh.sh. në Kur'an thotë: "A nuk e di ti, se Allahu di çdo gjë, që është në qiej e në Tokë? Të gjitha këto janë (shënuar) në Libër. Me të vërtetë, kjo është e lehtë për Allahun."[202]. Pra njeriu sado i lumtur të jetë në këtë botë, sado i pasur që të jetë, kur vjen vdekja prishet dhe shkatërrohet gjithë lumturia e kësaj bote. Kjo tregon se njeriu është krijuar për të qenë i lumtur, por kulmi i kësaj lumturie nuk do të jetë në këtë botë, të cilën çdo ditë e shkatërron vdekja. Lumturia për të cilën është destinuar njeriu do të realizohet në jetën pas vdekjes, në jetën e pasosur kur nuk ka vdekje.

Lumturia e jetës së pasosur do të jetë shpëtim i veprave të mira që njeriu ka bërë në këtë botë ose mëshira e të madhit Zot. Mjerë kush bën vepra të liga se e liga ka ndëshkim. Mjerë kush dëmton të tjerët, se ai ka shkelur urdhrat e Zotit.

5.8 Ç'është shpirti i njeriut?

Shpirti është një qenie pa lëndë që edhe shkenca fizike ka arritur t'i japë vërtetime reale duke caktuar vijën dalluese midis parimit jetik të trupit të njeriut dhe shpirtit të tij. Këto të dyja nuk duhet të ngatërrohen. E para është e përbashkët për të gjitha qeniet bimore, shtazore e njerëzore dhe mbaron me vdekje; ndërsa shpirti është vetëm karakteristikë ekskluzive e jetës njerëzore. Dy janë karakteristikat e shpirtit: ndërgjegjja dhe vullneti i lirë. Shpirti zotëron trupin me anë të qelizave të trurit të njeriut. Në kohën e gjumit, kur qelizat e trurit nuk janë në veprim, shpirti mund të shkëputet disa çaste, pra vetëm përkohësisht. Në zgjim e sipër, kur trupi vihet në lëvizje të plotë, shpirti shkëlqen. Në vdekje shpirti shkëputet përfundimisht nga trupi.

Pra, për të argumentuar vërtetësinë e shpirtit duhet të nisemi nga teoria e zbulimeve moderne të Kur'anit e të shkencës, që konceptuan dy parime të kundërta dhe paralele si shkak për të gjitha krijesat. Domethënë "kombinimi" i të kundërtave mund të japë lindjen e një sendi tjetër. Në Kur'an thuhet: "Dhe nga çdo gjë, Ne kemi krijuar dy palë, në mënyrë që ju të vini veshin!"[203]. Për të shpjeguar këtë le t'i hedhim një vështrim evolucionit gradual të botës materiale, e cila zë fill nga

[202]. Kur'an, El-Haxh: 70.
[203]. Kur'an, Edh-Dharijat: 49.

grimca e vogël, mjegullnaja, nga e cila dalin pa pushim shkëndija të errëta që janë dy llojesh, pozitive e negative (çifti që përmendet në Kur'an). Duke u ngjitur lart në shkallët e evolucionit, këto shkëndija bëhen elektrone, të cilat kanë gjithashtu dy natyra të kundërta, pozitive e negative dhe elektronet bëhen atome. Po të marrim formimin e botës bimore e shtazore, përsëri na paraqiten dy qeliza të kundërta: mashkullore e femërore. Në qoftë se nuk bashkohen këto dy të kundërta, nuk kemi vazhdimësi. Ky është ligji i përgjithshëm që "sendet janë krijuar në çift" ose të kundërta, prandaj kuptohet vetvetiu se duhet një sferë drite që t'i korrespondojë sferës së errët (mjegullës), ashtu sikurse dalin vazhdimisht shkëndijat e errëta prej mjegullës, kështu edhe prej sferës së dytë duhet të dalin shkëndija drite apo nuri. Secila nga këto shkëndija me dritë përmban shpirtin e njeriut. Shkëndija me dritë përmbledh në një gjendje embrionale gjithë virtytet e larta të drejtësisë, të dashurisë, të mëshirës etj. Natyrisht këto virtyte mund të fillojnë të zhvillohen e të përmblidhen, por është e nevojshme që të bashkohen imtësisht me të "kundërtën" e tyre, me pasionet e ulëta vetëkërkuese të mishit.

Në organizmin e njeriut bashkohen dy të "kundërtat", pasionet e ulëta, që janë trajta evolucionare e shkëndijave të errëta dhe virtytet e larta, të përmbledhura në shkëndijat e shndritshme, që burojnë prej sferës me dritë. Ashtu si materiali i mashkullit që duhet të përzihet me atë të femrës, po në këtë mënyrë edhe virtytet e larta, që të fillojnë e të zhvillohen, duhet të bashkohen me pasionet më të ulëta, që është gruaja pritëse e këtij materiali të burrit. Kështu është organizmi i njeriut për këto dy tendenca të kundërta.

Pra bashkimi është fillimi dhe formimi i shpirtit të njeriut, gjithë bota materiale, duke filluar me origjinën nga shkëndijat e errëta dhe duke kaluar nëpërmjet periudhave të panumërta të evolucionit, më në fund, pasionet mikroskopike materiale të njeriut, siguruan të kundërtën e nevojshme, shkëndijat e dritës, pa të cilat fillimi dhe zhvillimi i tyre nuk do të ishte i mundur.

Fëmija i njomë në barkun e nënës duhet të marrë disa lloj ushqimesh prej organizmit të saj në formë gjaku.

Po ushqimi shpirtëror cili është?

Ky ushqim jo material për të cilin ka nevojë foshnja e njomë, gjithashtu është jo material. Ky përbëhet prej dijes dhe veprës. Me këto ushqehet shpirti i fëmijës. Në qoftë se zjarri i pasionit mbizotëron në këto momente në trupin e nënës, atëherë fëmija që do të lindë do të ketë elemente të zjarrtë dhe këto elemente përbëjnë zjarrin e xhehenemit që përmendet në Kur'an. Në të kundërt, nëse në këto momente mbizotëron shpirti i veprave të mira, trupi i fëmijës ushqehet me ujin e veprave të mira, fuqitë shpirtërore të saj ripërtërihen dhe pasurohen dhe ky përcaktohet në Kur'an si parajsa në të cilën rrjedhin lumenj.

6. Besimi në caktimin e Zotit

Allahu i madhërishëm është Krijuesi i gjithçkaje që ndodhet në univers. Me ligje të qarta e të sakta të gjithë elementet e universit i ka vendosur në vendin e vet dhe në harmoni me njëri-tjetrin. Asgjë nuk del jashtë kontrollit dhe vullnetit të Tij të lirë. Ai është në dijeni të plotë për çdo gjë që u ndodh krijesave të Tij. Zoti i lartësuar i dhuroi njeriut gjënë më të çmuar, mendjen, me anë të së cilës ai duhet të dallojë të mirën nga e keqja, të dobishmen nga e padobishmja, të lejuarën nga e ndaluara. Veç kësaj, Allahu i lartësuar ka dërguar profetë lajmëtarë me udhëzime hyjnore për ta drejtuar njeriun gjithmonë në rrugë të drejtë, duke e njoftuar për gjërat e ndaluara nga Krijuesi i tij. Në fund njeriu është lënë i lirë të vendosë me vullnetin e tij për rrugën që do të marrë në ndërtimin e jetës së tij dhe veprat që do të kryejë për arritjen e të mirave materiale. Kjo do të thotë që dituria e Zotit nuk ndikon te njeriu për veprat që kryen, të mira apo të liga qofshin. Kjo u ngjason studimeve që bën një astronom mbi fenomenet e natyrës, apo eklipseve: studimet nuk ndikojnë në ndodhitë apo dukuritë e ndryshme, sepse, edhe nëse këto studime nuk do të kryheshin, fenomenet në natyrë do të ndodhnin.

Në Kur'an thuhet: "E si të mos dijë Ai që ka krijuar gjithçka, kur Ai njeh çdo gjë me imtësi dhe është i Gjithëinformuari?!"[204]. Do të thotë që Zoti i lartësuar ka njohuri të plota për të kaluarën e tyre, të tashmen e të ardhmen, kudo që ndodhen ato. Këtë e vërteton ajeti kuranor: "Thuaju: "Po, për Zotin tim! Me siguri që ajo do t'ju vijë"! Ai i di të gjitha të fshehtat. Atij nuk mund t'i fshihet asnjë grimë as në qiej, as në Tokë e nuk ka asgjë më të vogël apo më të madhe se ajo, që të mos jetë shënuar në Librin e qartë."[205]. Pra, Zoti i lartësuar jo vetëm që është Krijuesi i çdo sendi, por Ai ka njohuri të plota mbi të, gjykon mbi veprimtarinë e njeriut duke vlerësuar veprat e mira ose të liga dhe sipas këtij vlerësimi dënimin ose shpërblimin. Po ashtu gjithçka është regjistruar me saktësi në librin e qartë në "Leuhi Mahfudh", siç thuhet në Kur'an: "Ai e di ç'ka në tokë dhe në det; asnjë gjeth nuk bie, pa e ditur Ai dhe nuk ekziston asnjë kokërr në errësirën e tokës, as e njomë, as e thatë, që të mos jetë shënuar në Librin e qartë (Leuhi Mahfudh)."[206]. Në ajetin pasardhës shpjegohet qartë tema për të cilën po flasim, ku thuhet: "S'ka fatkeqësi që godet tokën dhe ju, që të mos jetë e shënuar në Libër (Leuhi Mahfudh) më parë se ta krijojmë atë. Kjo për Allahun është vërtet e lehtë!"[207]. Kjo do të thotë që dituria e Zotit të lartësuar nuk ndikon në kryerjen e veprave të njeriut si të mira ashtu edhe të liga. Çdo gjë kryhet me vullnetin e lirë të njeriut dhe jo se i është caktuar të veprojë në atë mënyrë. Vetëm liria e zgjedhjes që i është dhuruar njeriut është e paracaktuar. Këtë njeriu me logjikë e arsye mund ta ndryshojë me vullnetin e tij të lirë. Mbi këtë bazë ai do të marrë atë që meriton. Në Kur'an thuhet: " Në të vërtetë, Ne e krijuam njeriun nga një pikë farë e përzier, për ta sprovuar dhe e bëmë që të dëgjojë dhe të shohë. Natyrisht që Ne i treguam atij rrugën e drejtë, që ai të jetë ose mirënjohës, ose mosmirënjohës."[208]. Besimtari i devotshëm beson në paracaktimin dhe fatin që domosdoshmërisht e çon atë në njohjen e cilësive absolute të Zotit të lartësuar.

---

[204]. Kur'an, El-Mulk: 14.
[205]. Kur'an, Es-Sebe': 3.
[206]. Kur'an, El-En'am: 59.
[207]. Kur'an, El-Hadid: 22.
[208]. Kur'an, Insan: 2-3.

3

Ihsani

1. Ihsani, praktikimi i asaj që është e bukur

Në dy kapitujt e parë u fol për Islamin dhe Imanin, që janë elemente bazë në strukturën e ndërtimit të fesë islame dhe i treti është Ihsani. Në dy të parët u fokusuam më shumë te veprimtaria e njeriut dhe të kuptuarit e kësaj veprimtarie. Tani i vjen radha motivit dhe qëllimit për të cilin i kryejmë këto aktivitete. Me një fjalë, Islami u tregoi njerëzve se çfarë duhet të bëjnë, ndërsa imani i bën të kuptojnë përse duhen bërë ato që bëjnë, ndërsa ihsani merret me faktin se si mund të sillen motivet dhe cilësitë psikologjike të njeriut në harmoni me dy të parat. Profeti ynë, Muhamedi a.s., thotë: "Ihsani është të adhurosh Zotin sikur ta shikonit Atë, sepse nëse nuk e shikoni ju Atë, ju shikon Ai juve".

Origjina e fjalës "ihsan" vjen nga fjala "husn", që tregon cilësinë e të qenët "i mirë", "i bukur". Pra tregon çdo cilësi pozitive të njeriut si i virtytshëm, mirëbërës, human, etj., por tregon njëkohësisht edhe pamjen e tij si i hijshëm, i bukur, i mirë etj. Në Kur'anin Famëlartë kjo fjalë vjen për të treguar një vepër të mirë ose të bukur, siç shprehet: "Çdo e mirë që të gjen ty o njeri, prej Allahut është, kurse e keqja që të godet, është prej vetes sate."[209] ose "Kush bën një të mirë, do të ketë shpërblim më të mirë se ajo. Ndërsa ai që bën një të keqe, do të dënohet vetëm aq sa e meriton vepra e tij."[210]. Nga ajetet e cituara më sipër kuptohet së pari se është Zoti i Lartësuar bërës i së bukurës, me krijimin e gjithësisë dhe veçanërisht të njeriut. Për këtë lavdi njeriu duhet të bëjë vetëm vepra të mira në këtë botë që do t'i shërbejnë atij për të pasur një jetë të qetë e të lumtur. Zoti në Kur'an urdhëron e thotë: "Allahu është Ai që jua ka bërë Tokën vendbanim e qiellin kulm, ju ka dhënë formë e jua ka përsosur atë dhe ju ka furnizuar me ushqime të mira."[211]. Për këtë arsye njeriu e ka për detyrë të bëjë atë që është e bukur në marrëdhënie me krijuesin e Tij dhe gjithë krijesat. Kjo do të thotë që njeriu duhet të bëjë punë e aktivitete të tjera që janë në pajtim me natyrën fillestare "Fitren", që vendosi Allahu i Lartësuar brenda tij. Në Kur'an thuhet: "Bëju mirë të tjerëve, ashtu si të ka bërë mirë ty Allahu."[212].

Për këtë arsye themi se njeriu është i detyruar të besojë me ndërgjegje të pastër Krijuesin e tij, Zotin e Lartësuar e mbi këtë bazë të bëjë çdo gjë të bukur për vëllain e tij, për prindërit, për farefisin

[209]. Kur'an, En-Nisa:79.
[210]. Kur'an, El-Kasas:84.
[211]. Kur'an, El-Gafir:64.
[212]. Kur'an, El-Kasas:77.

dhe shoqërinë që e rrethon. Atëherë ai do të radhitet ndër njerëzit e mirë, i vlefshëm për familjen e shoqërinë. Ai do të zbatojë udhëzimet që jepen në Kur'anin Famëlartë, ku Zoti thotë: "Njeriun e kemi porositur të jetë i sjellshëm ndaj prindërve të vet. Nëna e mbart atë me mund dhe me mund e lind. Ai mbartet dhe ushqehet me gji për tridhjetë muaj dhe, kur arrin në moshën e burrërisë e i mbush dyzet vjet, ai thotë: "O Zoti im! Më frymëzo që të të falënderoj për begatitë që Ti më ke dhënë mua dhe prindërve të mi dhe që të bëj vepra të mira, me të cilat Ti do të jesh i kënaqur! Më dhuro pasardhës të mirë!"[213]. Allahu i Lartësuar i bëri të bukura të gjitha gjërat dhe veprimtaria njerëzore duhet bërë me nismën e Tij, me emrin e Zotit "Bismilah", që ta ndihmojë atë të bëjë të bukurën. Bekimi dhe mëshira e Tij e bën karakterin e myslimanit me cilësi të bukura, që të kryejë vepra të bukura.

Profeti Muhamed, paqja e bekimi i Zotit qofshin mbi të, ka thënë: "Po nuk pate turp, bëj çfarë të duash". Në këtë thënie profetike kemi një urdhër "bëj", që e kanë porositur të gjithë të dërguarit e Allahut të Madhërishëm pa dallim. Ky urdhër merr dy kuptime: urdhër vullneti dhe urdhër frikësimi. Me "urdhër vullneti" duhet të kuptojmë se motivi që ndikon te njeriu për zbatimin e urdhrit të Allahut është vullneti i lirë i tij, ndërsa me "urdhër frikësimi" kuptojmë ato raste kur njeriu e zbaton urdhrin e Allahut ose e kryen një vepër të mirë i detyruar nga frika e Allahut. Kur urdhri i lihet në dorë vullnetit të lirë të njeriut thënia profetike "po nuk pate turp, bëj çfarë të duash", merr kuptimin "je i lirë të bësh çfarë të duash, që nuk të turpëron para njerëzve", domethënë të bësh më të bukurën. Kur urdhri jepet për ta frikësuar njeriun në kryerjen e një pune, atëherë kuptimi ndryshon dhe thuhet: "Po nuk pate turp bëj çfarë të duash, por mos harro se ke përgjegjësi". Prandaj thënia e Profetit a.s. merr këtë kuptim: "Bëj çdo gjë që nuk të turpëron para njerëzve e mos bëj gjëra që të turpërojnë". Kjo do të thotë që të bësh më të bukurën, më të mirën. Por nëse nuk turpërohesh para Krijuesit tënd, Zotit të Lartësuar dhe para njerëzve, bëj edhe punë të papëlqyeshme, në kundërshtim me urdhrat e Zotit, do të gjykohesh e ndëshkohesh për to.

Në hadithin e Profetit a.s., të cituar më lart, i është dhënë fuqi e madhe turpit, që është një cilësi morale, një nga virtytet që sundon ndërgjegjen e njeriut, një nga virtytet që nuk lejon të bësh veprime të ndaluara nga ligji. Pra, ihsani, të bësh më të bukurën, më të mirën, në këndvështrimin e thënies profetike, kuptohet: Njeriu që ka turp duhet të mendohet mirë, të flasë mirë, të shohë mirë, të dëgjojë mirë, të punojë mirë, të ushqehet në hallall e të kryejë punë që janë të lejuara (hallall). Ai individ që turpërohet para Zotit të Lartësuar, mendon jetën e pasosur dhe heq dorë nga punët e papëlqyeshme të kësaj bote.

Mendja, arsyeja duhet të drejtohen gjithmonë nga më e bukura, nga më e mira dhe të gjykojë me drejtësi. Në Kur'anin Famëlartë, Zoti i Lartësuar thotë: "Në të vërtetë, Allahu urdhëron drejtësinë, mirësinë dhe ndihmën për të afërmit, si dhe ndalon imoralitetin, veprat e shëmtuara dhe dhunën..."[214]. Në këtë ajet të Kur'anit fisnik, Zoti i Lartësuar urdhëron zbatimin e tre veprimeve dhe ndalimin nga tri punë:

E para: Çdo njeri duhet të respektojë drejtësinë në marrëdhënie me të tjerët dhe të veprojë drejtësisht;

E dyta: Çdo njeri duhet të ndihmojë me fjalë e me vepra në mirësi ata që kanë nevojë;

---

213. Kur'an, El-Ahkaf: 15.
214. Kur'an, En-Nahl: 90.

E treta: Dashuria dhe dhembshuria duhet të jenë pa dallim si për njeriun e afërt në farefisni, ashtu edhe për të tjerët me të cilët nuk ka lidhje gjaku.

Krahas këtyre tre detyrave, Zoti i Lartësuar na porosit:

1. Çdo njeri duhet të karakterizohet nga sjellja korrekte duke u larguar nga ato që nuk pajtohen me moralin e fesë, të cilat quhen të papëlqyeshme në opinionin shoqëror.
2. Çdo njeri të respektojë të drejtat e tjetrit dhe të mos i cenojë ato.
3. Të mos marrë pjesë dhe as të jetë prezent kur cenohen të drejtat e tjetrit.

Të gjitha këto veprime ose mosveprime i nënshtrohen arsyetimit të ligjit, dhuratë e Krijuesit, i cili na porosit që ta pajisim shpirtin me ato virtyte të larta që janë burim lumturie për njeriun.

Profeti a.s., citimin kuranor që bën fjalë për drejtësinë dhe këshillat e nevojshme për këtë, ka urdhëruar të jepet çdo të premte dhe vazhdon edhe sot nga predikuesit fetarë. Nëse këto hadithe që përmbajnë ligjet për drejtësinë do të jepen me korrektësi dhe do të zbatoheshin si duhet nga besimtarët, nuk do të kishim vepra amorale dhe krime.

Legjislacioni për drejtësinë, gati në gjithë vendet e botës përbëhet nga tre kapituj kryesorë:

1. Janë nenet që shpjegojnë moralin që i përket individit, qëllimi i të cilëve është të ndalojë njerëzit nga veprat e liga që cenojnë veten dhe nderin e tjetrit.
2. Janë nenet që kanë për qëllim mbrojtjen e të drejtave të njeriut.
3. Janë nenet që i bëjnë të aplikueshme dhe të detyrueshme për të gjithë.

Në pjesën e dytë të ajetit kuranor për drejtësinë, për të cilin po bëjmë fjalë, dallohen fjalët: "fahsha", "munker" dhe "bag'j".

Koncepti "fahsha" ka të bëjë me ndalimin e sjelljeve të liga të njeriut; "munker" ndalon punët e fëlliqura që ndodhin në shoqëri; "bag'j" ndalon lëvizjet e papëlqyeshme që tronditin qetësinë publike dhe stabilitetin e shoqërisë dhe të shtetit.

Pra kuptohet se një nga cilësitë me të bukura të Kur'anit Famëlartë është se, kur urdhëron "bëj më të mirën", "më të bukurën", tregon gradualisht virtytet nga më e ulëta deri te më e larta; po në këtë mënyrë tregon edhe për të këqijat. Prandaj Ihsani është vendosur në tre themele bazë të fesë islame, qëllimi kryesor i të cilave është të besuarit në Njësinë e Zotin të madhërishëm, që është Një në ekzistencën e Tij dhe në pastrimin e moralit. Nga njerëzit kërkohet harmonia bashkë me rregullin e disiplinën. Tek Ai kërkohet urtësia, mençuria, dashuria dhe drita për të bërë më të bukurën e më të mirën në jetë. Atëherë lind për të kultura e re, dielli i ri, shpirti i ri. Dhimbja e çdo individi do të bëhet dhimbje e shqetësim i gjithë shoqërisë dhe të gjithë do të vrapojmë të shërojmë plagët e njëri-tjetrit. Mirësia dhe bamirësia e njeriut kanë për t'u bërë ligji më i madh dhe më i bukur që do të zbatohet vetëm për fatin e lumturinë njerëzore.

1.1 Bëni atë që është e bukur

Problem i ditës në fenë islame, për besimtarët kudo qofshin, është çështja e etikës, e moralit që lidhet direkt me marrëdhëniet njerëzore. Të bësh të bukurën në këto marrëdhënie, do të thotë të kryesh veprime të moralshme që shprehen në punë, në fjalë dhe në sjelljen e jashtme të njeriut. Për njeriun e moralshëm, të udhëhequr nga ndjenjat e besimit, kërkohet që të bëjë më të bukurën në ndërtimin e veprimtarisë jetësore sipas normave të moralit që përfshin parime, norma e rregulla që përcaktojnë sjelljen e tij në familje e shoqëri. Zoti i Lartësuar në Kur'an thotë: "Ata që bëjnë vepra të mira, do të kenë shpërblim të mirë, madje edhe më tepër!"[215]. Kjo do të thotë që njeriu i pastër që bën më të bukurën është i pajisur me moral dhe pranohet bindshëm nga morali i shoqërisë. Ai merr nga ata vlera të shumëfishuara si njeri. Ndryshe ndodh në raste të veçanta kur njeriu me fjalë jep moralizime, por pa i konkretizuar në vepra praktike. Këtu nuk kemi të bëjmë më ihsanin, bën atë që është e bukur, sepse kemi dobësim të ndjenjës së besimit te ky njeri. Praktika ka treguar se njerëz të tillë kanë kryer veprime të pahijshme morali e deri në përfshirje të akteve kriminale. Duhet në mënyrë të domosdoshme rikthimi në besim të ndërgjegjshëm i njerëzve të tillë, i cili zbut ndërgjegjen dhe i bën të ndjeshëm për t'u larguar nga e gabuara.

Zoti i Lartësuar në Kur'anin Fisnik thotë: "Vërtet, Allahu është me ata që e kanë frikë dhe që janë punëmirë."[216]. Prandaj besimtari duhet të zotërojë sjellje e veprime të bukura, sepse Ligji Hyjnor ka fuqi supreme kundër të keqes, i papajtueshëm me veprat amorale që lidhen me nderin, ndershmërinë e tij etj. Për këtë arsye, në zemrën e gjithsecilit duhet të zërë vend besimi tek Allahu i Madhërishëm, i Cili i sjell natyrshëm me Udhëzimin Hyjnor formimin e koncepteve për të bërë më të bukurën në çdo fushë të aktivitetit të tij jetësor.

Ndërgjegjja e njeriut për më të bukurën gjithmonë duhet të jetë në ngritje që të krijohet një atmosferë e përgjithshme për më të mirën, të bukurën, të jetuarit në tërësinë e forcave të brendshme, që e shtyjnë atë të veprojë, të qëndrojë e të plotësojë jetën e tij sipas parimeve, normave e rregullave të fesë islame. Njeriu që zotëron koncepte të dobëta për të bërë më të bukurën, më të mirën e shkatërron këtë bukuri që inspiron Islami. Atëherë ai është i prirur të kryejë vepra të shëmtuara. Kjo e bën të domosdoshme rikthimin me ndërgjegje të pastër në besimin te Zoti i Madhërishëm, me qëllim që të reagojë ndërgjegjja për të bërë më të bukurën, më të mirën, e cila do të jetë gjithmonë e gatshme për të vepruar. Aty ku mungon ky veprim dhe kjo gatishmëri, dobësohet lufta kundër së keqes, të moralshmes dhe nuk e ka atë fuqi të nevojshme për të gjykuar ashpër të keqen. Ndryshe ndodh me besimtarët e devotshëm, që këshillohen me njëri-tjetrin, ushqejnë ndërgjegjen për veprime të gjalla që shkaktojnë te secili ndjenjën e kënaqësisë, të bukurës dhe të gatishmërisë për të vënë të gjitha forcat për të mirën e të bukurën jo vetëm për vete, por edhe për të tjerët. Zoti i Lartësuar në Kur'anin Famëlartë urdhëron e thotë: "... por bëni të mira; Allahu me të vërtetë i do bamirësit."[217].

---

[215]. Kur'an, Junus: 26.
[216]. Kur'an, En-Nahl: 128.
[217]. Kur'an, El-Bekare: 195.

Njeriu që nuk e demonstron veten, nuk kryen asnjë veprim që kërkon fuqi të ndërgjegjes për të bukurën, është gjithmonë i pafuqishëm, i lëkundur dhe i prirur të shkojë nëpër rrugë jo të drejta. Detyra e çdo besimtari është që të manifestojë konkretisht fuqi të larta shpirtërore të besimit te Zoti i Lartësuar dhe të largojë indiferentizmin, zakonin për të duruar gjestet e këqija që kryejnë të tjerët e shumë cilësi të tjera negative të karakterit që mund të ketë shoku i tij. Sa më e madhe të jetë mungesa e dëshirës për t'u ballafaquar me të keqen, me amoralen, aq më e pafuqishme bëhet apo tregohet forca e vullnetit dhe e këmbënguljes së tij për këto fenomene. Për këtë arsye Allahu i Lartësuar tërheq vëmendjen në Shpalljen Hyjnore, Kur'anin Famëlartë kur thotë: "Kush është besimtar më i mirë se ai që i dorëzohet sinqerisht Allahut, duke qenë bamirës"[218]. Ky mesazh na inspiron të gjithëve që të merremi me edukimin e fëmijëve dhe të tjerëve me besimin te Zoti. Këtu duhet të merren parasysh veçoritë individuale të secilit dhe mosha. Nxitja e tyre për të bërë më të bukurën, më të mirën si punë e vullnetit dhe e mendjes së çdo besimtari, që të kanalizojë fuqitë shpirtërore në këtë drejtim, është shkak për shpërblimin e tyre nga Zoti, siç thotë në Kur'anin Famëlartë: "Allahu do t'i shpërblejë me kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku ata do të qëndrojnë përgjithmonë. Ky është shpërblimi i punëmirëve."[219].

Problem i marrëdhënieve reciproke midis njëri-tjetrit është një nga çështjet më të rëndësishme të etikës e të moralit islam. Baza për formimin dhe edukimin e ndjenjës së të bukurës në etikë e moral është familja dhe pastaj shoqëria ku jeton. Marrëdhëniet familjare dhe ato sociale duhet të udhëhiqen nga ideali më i lartë që ka njeriu në jetë, ai i besimit te Zoti dhe adhurimi ndaj Tij. Nga kjo pikëpamje shoqëria jonë vuan sepse nuk paraqet një unitet në respektimin e ligjeve të fesë. Prirja më tepër drejt individualizmit po inkurajon "unin" e njeriut, "egon" e tij që sjell përçarje midis njerëzve. Interesi material dhe përfitimi i të mirave materiale në rrugë jo të drejtë e deri në prekjen e interesave të tjetrit, ka çuar në konflikte dhe shpesh edhe në akte kriminale. Zoti në Kur'an thotë: "Mjerë ju dhe mjerë ata që ju i adhuroni në vend të Allahut! A nuk arsyetoni?!"[220]. Nga kjo del se që të adhurosh paranë e pronën duke harruar se ne jemi në pronën e Zotit, do të thotë që ne largojmë vëmendjen ndaj kujtimit të Tij dhe sigurisht kjo përbën një turp. Individualizmi po bëhet tipari themelor i sjelljes së njerëzve që përpiqen të grumbullojnë sa më shumë pasuri, kjo edhe duke grabitur pronat e të tjerëve. Jo pak raste kanë përfunduar në akte tragjike madje edhe brenda familjes apo fisit. Duhet të mbajmë gjithmonë parasysh se Zoti në Kur'an thotë: "Besimtarët janë vëllezër të njeri-tjetrit". Kjo do të thotë që bashkësia e njerëzve që krijohet në bazë të marrëdhënieve që kanë njerëzit midis tyre për qëllime të caktuara, bën përpjekje për t'i arritur ato duke pasur udhëheqjen e përbashkët islame si fe dhe besimin në Një Zot. Nëpërmjet veprimeve të përbashkëta për të bukurën dhe të mirën, çdo besimtar formon një qëndrim të caktuar ndaj mjedisit, natyrës, punës së të tjerëve e ndaj vetes. Në këtë proces marrëdhëniesh secili është njëkohësisht subjekt dhe objekt i këtyre marrëdhënieve që ndikohet në edukimin e të bukurës dhe të së mirës. Zoti i Madhërishëm në Kur'anin Famëlartë urdhëron e thotë: "Vërtet, mëshira e Allahut është afër punëmirëve."[221].

Në kontaktet e përditshme, veçanërisht të myslimanëve në xhami, vendosen marrëdhënie besimtarësh me të drejta të barabarta ndërmjet moshave dhe niveleve të ndryshme kulturore. Mirëpo

---

218. Kur'an, En-Nisa: 125.
219. Kur'an, El-Maide: 85.
220. Kur'an, El-Enbija: 67.
221. Kur'an, El-A'raf: 56.

jo rrallëherë edhe këtu paragjykohen individë të veçantë. Kjo do të thotë se personat që paragjykojnë e kanë të sëmurë ndërgjegjen e tyre. Duke pasur parasysh citimin kuranor që "mëshira e Zotit është pranë atyre që bëjnë të bukurën" duhet që çdo besimtar të bëjë të bukurën me fjalë, veprime dhe sjellje dhe nuk duhet të paragjykojë të tjerët, veçanërisht kur ata nuk janë prezent. Profeti Muhamed, paqja e bekimi i Zotit qofshin mbi të, këto raste i ka konsideruar përgojime dhe ka thënë: "Përgojimi është përmendja e dikujt me diçka që, nëse ai do ta dëgjonte, nuk do t'i pëlqente. Nëse ajo e metë që ti i vesh atij gjendet vërtet tek ai, thënia përbën përgojim; nëse e meta nuk gjendet tek ai, atëherë konsiderohet shpifje". Në të tilla raste kemi të bëjmë me cenim të nderit dhe personalitetit të tjetrit. Prandaj besimtarët duhet t'i nënshtrohen procesit të edukimit me ligjet e fesë islame. Sa më i lartë të jetë niveli i përgatitjes së besimtarëve me njohjen e parimeve të Islamit, imanit dhe ihsanit, aq më i ndërgjegjshëm bëhet ai në kuptimin e vlerave që përfaqëson Mesazhi Hyjnor.

1.2 Sinqeriteti

Me ihsanin kuptojmë që çdo njeri duhet të veprojë sikur është në prani të Zotit të Madhërishëm dhe nuk mund të fshihet asgjë nga veprimtaria e tij. Për këtë arsye tërë veprimtaria e njeriut duhet bërë në emër të Zotit. Në Kur'an thuhet: "Allahu e di ç'ka në zemrat tuaja; Allahu është i Gjithëdijshëm dhe i Butë."[222].

Njeriu si qenie sociale është në kontakt të vazhdueshëm me të tjerët duke filluar nga familja, puna e shoqëria. Në këto marrëdhënie karakteri i tij duhet të jetë i pajisur me një virtyt shumë të lartë, që është sinqeriteti. Kjo do të thotë që ai është besnik në fjalë, në vepra dhe në kryerjen e amanetit. Mbi të gjitha ky virtyt është karakteristikë themelore e fesë islame. Kur njeriu pranon Islamin dëshmon se "nuk ka Zot tjetër veç Allahut Një dhe se Muhamedi është i dërguari i Tij". Kush e ruan dhe e mbron këtë sinqeritet, konsiderohet besnik i rrugës së vërtetë të Allahut dhe të dërguarit të Tij. Zoti në Kur'an thotë: "O besimtarë! Frikësojuni Allahut dhe bëhuni me ata që janë të sinqertë (në fjalë dhe në vepra)"[223]. Profeti a.s. thotë: "Natyrës së besimtarit i janë të bindura të gjitha cilësitë, përveç mashtrimit dhe gënjeshtrës". Pra, njeriu, për të ruajtur dinjitetin e tij, duhet të karakterizohet nga sinqeriteti me të cilin fiton kënaqësinë e Zotit të Madhërishëm. Duhet të jetë në unitet mendimi me veprimin, fjala me veprën. Që të thuash se një njeri është i sinqertë, duhet të jesh në gjendje të vërtetosh se atë që ky person mban në brendësi e shfaq jashtë, atë që ndjen e shfaq në praktikë. Për këtë Profeti a.s. thotë: "Mbahuni për sinqeritetin, sepse sinqeriteti të shpie në bamirësi, ndërsa bamirësia të shpie në xhenet. Njeriu që është i sinqertë dhe që synon nga sinqeriteti, do të shkruhet tek Allahu si i sinqertë. Ruajuni nga gënjeshtra, sepse gënjeshtra të shpie në mëkat, ndërsa mëkati në zjarr. Njeriu që gënjen ose që ka prirje për të gënjyer do të shkruhet tek Allahu si gënjeshtar". Prandaj njeriu është urdhëruar që të flasë vetëm të vërtetën, siç thotë Profeti a.s:. "Thuaj të vërtetën, qoftë edhe e hidhur për ty".

Sinqeriteti është tipari themelor që karakterizon fenë islame. Ka edhe njerëz që nuk e zbatojnë, sepse në karakterin e tyre mbizotërojnë cilësi negative. Kështu ndodh me shumë njerëz të

[222]. Kur'an, El-Ahzab:51.
[223]. Kur'an, Et-Teube: 119.

fushave të ndryshme të jetës që reklamojnë si të vërtetë diçka që nuk është e vërtetë. Këta në fenë islame quhen hipokritë, sepse e paraqesin veten në mënyrë false, jo ashtu si janë në të vërtetë. Zoti në Kur'an urdhëron e thotë: "Hipokritët dhe hipokritet janë të ngjashëm me njëri - tjetrin: kërkojnë që të bëhen vepra të këqija e pengojnë të mirat dhe janë dorështrënguar. Ata e kanë harruar Allahun, por edhe Ai i ka harruar ata. Me të vërtetë, hipokritët janë keqbërës. Allahu u ka premtuar hipokritëve, hipokriteve dhe mosbesimtarëve zjarrin e Xhehenemit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë; ai do t'iu mjaftojë atyre! Allahu i ka mallkuar dhe ata do të kenë dënim të vazhdueshëm."[224]. Prandaj çdo punë që bën njeriu duhet të karakterizohet nga sinqeriteti. E vërteta është virtyt hyjnor nga i cili duhet të niset çdo njeri e në veçanti myslimani. E tërë jeta e tij duhet të jetë pasqyrim i fisnikërisë dhe sinqeritetit.

Njeriu është krijuar të jetojë në shoqëri, por duhet të ndërtojë marrëdhënie që në bazë të kenë sinqeritetin e jo hipokrizinë. Profeti a.s. thotë: "Myslimani sillet ndaj myslimanit sikurse tullat e ndërtesës, pjesët e së cilës janë të lidhura mes tyre dhe përbëjnë një tërësi". Të gjithë njerëzit kanë nevojë reciproke për njëri-tjetrin. I pasuri nuk mund të vërë pasurinë e tij pa përdorur fuqi punëtore që të punojnë për të. Edhe punëtorët, nga ana tjetër, kërkojnë punë për të siguruar të ardhura për të mbajtur familjet e tyre. Këtë punë do ta sigurojë tek tregtari, industrialisti, fermeri etj. Për këtë arsye themi se themeli i të ardhurave për të ndërtuar jetën individuale e familjare ndodhet në bashkësi. Tërësia e këtyre marrëdhënieve duhet të karakterizohet nga sinqeriteti dhe jo hipokrizia për t'ia hedhur njëri-tjetrit. Zoti i Lartësuar në Kur'anin Fisnik thotë: "Ndihmojeni njëri-tjetrin në punë të mira dhe në të ruajturit nga të këqijat dhe jo në gjynahe dhe armiqësi! Frikësojuni Allahut, sepse Ai dënon ashpër."[225]. Për këtë arsye sinqeriteti kërkon që të jesh i pastër me njëri-tjetrin, i qartë e i lirë dhe të mos hyjë në mes papastërtia. Njeriu duhet të pastrojë veten dhe të largojë të gjitha nxitjet që të çojnë në hipokrizi, sepse Zoti në Kur'an thotë: "Pa dyshim që hipokritët do të jenë në thellësinë më të madhe të Xhehenemit dhe ti kurrsesi nuk do t'u gjesh atyre ndihmës."[226].

1.3 Sinqeriteti, virtyti më i lartë i profetit Muhamed a.s.

Sinqeriteti është cilësia më e lartë e karakterit të H. Muhamedit, paqja e bekimi i Zotit qofshin mbi të. Ai është krijesa më e përsosur, më e pastër që krijoi Zoti, që e zgjodhi për t'i dërguar njerëzimit Shpalljen Hyjnore si udhëheqëse drejt së vërtetës, të mirës dhe të bukurës, drejt unitetit origjinal, drejt monoteizmit, besimit në një Zot, i cili është i vetëm në Qenien e Tij, i vetëm në cilësitë e Tij dhe i vetëm në veprat e Tij. Ai ngjall dhe ai vdes dhe askush nuk mund t'i kundërvihet gjykimit të Tij. Ky ishte besimi i ri që solli Zoti me të dërguarin e Tij, Muhamedin a.s. për të larguar idhujtarinë. Për këtë arsye Muhamedi zuri vendin më të lartë në historinë botërore. Nga sinqeriteti i tij buronin fjalë të cilat ishin drejtpërsëdrejti zëri i së vërtetës, njerëzit e dëgjonin këtë zë dhe duhet ta dëgjojnë. Si i tillë u tregua besnik në përcjelljen e Mesazhit Hyjnor me sinqeritet e besnikëri të lartë në fjalë, në vepra dhe në kryerjen e amanetit. Në këtë rrugë u tregua më i sinqerti i njerëzve, më bujari, më fisniku, më trimi, më i forti, më durimtari, më seriozi, më i drejti, më i ndershmi dhe më i

[224]. Kur'an, Et-Teube: 67-68.
[225]. Kur'an, El-Maide: 2.
[226]. Kur'an, En-Nisa: 145.

çiltri në fjalë. Ai zbatoi me përpikëri marrëveshjet dhe premtimet, shikonte farefisin, kishte dhembshuri dhe mëshirë, kishte mirësjellje dhe edukatë. Si i tillë ishte krijuar për t'i dhënë botës një drejtim të ri. Ai shprehej: "Mbajuni për sinqeritetin, sepse të shpie në bamirësi, ndërsa bamirësia të shpie në xhenet".

Sinqeriteti i tij e bëri të jetë i durueshëm, me vullnet e gjykim të mprehtë, me gjuhë të ëmbël, me kurajën e pashembullt e të tjera karakteristika të veçanta vetëm për këtë profet të jashtëzakonshëm. I mbështetur te Zoti, arriti të bëjë një revolucion të madh në kombin e tij dhe krahinat përreth, nëpër të cilat krijoi qendrat e mëdha të kulturës dhe qytetërimit islam. Ai u bë heroi i fesë islame, i karakterizuar nga sinqeriteti i lartë që depërtoi thellë në ndjenjat e njerëzve, duke kuptuar veset e liga shoqërore e fetare që gërryenin zemrën dhe helmonin gjakun e pastër njerëzor. Ai erdhi me një recetë shërimi, të perfeksionuar e të pavdekshme në efektin e saj.

Sinqeriteti është tipari themelor që karakterizon fenë islame. Mbi këtë bazë besimtari duhet të ndërtojë rrugën e tij të jetës. Zoti në Kur'an urdhëron e thotë: "E megjithatë, ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me përkushtim të sinqertë"[227]. Pra, në çdo punë që bën njeriu duhet të karakterizohet nga sinqeriteti. E tërë puna e tij duhet të jetë pasqyrim i fisnikërisë dhe sinqeritetit. Në Muhamedin, në trupin dhe intelektin e tij, me diturinë dhe moralin e tij u manifestuan atribute hyjnore që historia njerëzore i ka njohur shumë pak dhe akoma ekziston një hapësirë e gjerë për ta njohur dhe konceptuar, për të përshkruar me hollësi qenien e këtij profeti të madh. Ai predikoi fenë më të përsosur, më të plotë në Islam dhe mbylli njëherë e përgjithmonë vargun e profetëve, duke u bërë diell ndriçues, drejtues, ngushëllues, mëshirues e përgëzues për të gjithë njerëzit. Me ndihmën e Kur'anit të Shenjtë i zbritur nga Zoti, vendosi drejtësi, bashkoi dhe harmonizoi lidhjet ndërnjerëzore. Sinqeriteti i tij bëri që të dhuronte tolerancë si për miq, ashtu edhe për armiq me një butësi të rrallë, i drejtë në gjykime e vendime. Nga mendja dhe logjika e tij shpërthyen burimet e të gjitha llojeve të diturisë që dilnin nga goja e tij me një elokuencë të paparë ndonjëherë, duke prekur zemrat e poetëve dhe dijetarëve më të mëdhenj. Ai citonte fjalët e Allahut ku thuhet: "O besimtarë! Frikësojuni Allahut dhe bëhuni me ata që janë të sinqertë (në fjalë dhe në vepra)!"[228]. Nuk i mungonte asgjë këtij profeti të madh që të udhëhiqte lumturinë njerëzore, që solli në realitet rilindjen e madhe e të pashembullt në histori. Zoti në Kur'an shprehet: "Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun."[229]. Ai ruajti dhe mbrojti Shpalljen Hyjnore me sinqeritet duke u treguar besnik i rrugës së vërtetë të Allahut të Lartësuar.

Me sinqeritetin e tij u bë mbi çdo gjë të lartë dhe më i lartë, mbi çdo send me vlerë dhe më me vlerë, mbi çdo veprim shembullor edhe më shembullor, i krijuar me cilësitë më të plota njerëzore, njeri për njeri, njeri për lartësi e njeri për përsosmëri.

Ai solli përmirësimin e moralit, drejtësinë, sjelljen e mirë shoqërore, virtytin, vlerësimin e diturisë dhe mirësisë, nderimin e dijetarëve, ndihmën e jetimëve, bujarinë, besnikërinë, mëshirën, ruajtjen e nderit e të tjera dispozita që sollën evoluimin e njeriut, gjëra për të cilat ai ka nevojë shumë në jetën e tij.

---

227. Kur'an, El-Bejiine: 5.
228. Kur'an, Et-Teube: 119.
229. Kur'an, El-Ahzab: 21.

I tillë ishte Muhamedi që nuk e shkëputi jetën e tij nga ajo e shoqërisë, sepse ishte i rrethuar nga shumë shtytje e nxitje që kërkojnë patjetër një organizim e kombinim forcash. Në momente të caktuara hidhërimi i tij ishte porsi zjarri që del nga çeliku, i vështirë për t'u nxehur dhe kur nxehej menjëherë ftohej, sepse gjakftohtësia i jepte jo vetëm qetësi të madhe mendore, por më vonë bënte të shkëlqenin mendimet dhe largpamja e tij. Ai nuk krenohej asnjëherë në ecje, por gjithmonë shkonte si i përvuajtur saqë njerëzit kur e shikonin thoshin për të: "Ja ku po shkon El-Emini, i vërteti, i drejti, i besueshmi". Mik besnik e bashkëshort i devotshëm, mendimtar i thellë në misteret e jetës dhe të vdekjes dhe mbi përgjegjësitë e veprave njerëzore që është qëllimi i fundit i jetës së njeriut. Merr përgjegjësinë e reformimit të një kombi dhe më tej për krejt botën, me zemër që digjet nga dashuria për ta ngushëlluar e qetësuar atë. Ai pengohet, por kurrë nuk rrëzohet, torturohet, por kurrë nuk dëshpërohet. Nuk mund të përshkruhen cilësitë e larta morale të profetit Muhamed me të cilat ai lindi dhe u plak, efektet e të cilave kanë përshkruar mbarë shekujt dhe janë vendosur në faqen e pashlyeshme të përjetësisë, prej së cilës bota ka mundur të përfitojë ushqimin e jetës së saj shpirtërore e shoqërore.

I karakterizuar nga sinqeriteti ai e konsideronte veten njeri si gjithë njerëzit, si i larti ashtu edhe i ulëti, si i fuqishmi ashtu edhe i pafuqishmi, si i pasuri ashtu edhe i papasuri, si i dituri ashtu edhe i padituri, si zyrtari ashtu edhe punëtori etj. Të gjithë njerëzit ishin të barabartë para tij dhe preferenca ishte në devotshmëri. Në të gjithë jetën u portretizua si më i sinqerti, më besniku, më i shquari që duhet marrë shembull e model. Gjithë veprimtarinë e shoqërisë njerëzore e lidhi me moralin dhe moralin e lidhi me fenë, me parimin e rëndësishëm: sinqeritet e respekt për urdhrat e Zotit dhe mëshirë e dhembshuri për krijesat e Tij.

Për myslimanët H. Muhamedi është i pavdekshëm, mësimet e tij janë të përjetshme, rron i gjallë në zemrat e qindra miliona njerëzve, përjetësohet në librin e shenjtë, Kur'anin, që është plot dritë, shenjtërohet me historinë e lumnueshme të fazave të ndryshme të jetës së tij dhe me qytetërimin e mrekullueshëm islam që transmetoi e përcolli.

Me këtë rast ju urojmë gjithë vëllezërve dhe motrave myslimane festën përkujtimore të ditëlindjes së profetit islam, që është shpëtimtari ynë i përjetshëm. I lutemi Zotit që për hatër të këtij profeti të madh të derdhë mëshirën e vet mbi të dhe gjithë njerëzimin e në veçanti mbi kombin shqiptar duke na dhuruar paqe e lumturi në mesin tonë pa dallim feje e krahine.

Amin!

1.4 Morali njerëzor është me origjinë hyjnore

Njeriu e ndërton jetën në bazë të ligjeve dhe rregullave të ndërtuara nga arsyeja dhe logjika, të cilat janë dhuratë speciale nga arsyeja absolute e amshuar. Do të thotë që ligjet kanë bazë Hyjnore, sepse çdo gjë në botë udhëhiqet e sundohet nga i Gjithëdituri, i Gjithëfuqishmi, Zoti i madhërishëm. Me dritën e arsyes njeriu ka prirjen e natyrshme për të arritur objektivat në jetë. Ai e shfaq identitetin e tij vetëm nëpërmjet karakterit, moralit dhe natyrës së vet. E për ta drejtuar këtë kërkohet si

domosdoshmëri edhe ekzistenca e një ligji Hyjnor, funksioni i të cilit është për të dalluar të mirën nga e keqja dhe për të shmangur gjykimet kontradiktore të njerëzve. Ligji i dhënë nga Zoti Famëlartë është i vërtetë, i saktë, që vepron edhe në lëvizjet e brendshme, të fshehura thellë në ndërgjegjen e njeriut dhe shërben njëkohësisht si masë parandaluese ndaj veprimeve negative që konsiderohen mëkate. Ky njeri konsiderohet me moral të mirë, është i ndarë nga morali i keq, karakteri i tij bashkohet me moralin e mirë dhe kjo i jep vlerën e duhur si njeri. Pra kriteri më i qëndrueshëm i vlerësimit të tij është pikërisht ky moral i mirë, i cili përfaqësohet me Kur'anin Famëlartë. Ashtu si thuhet në Kur'anin Famëlartë ku shprehet: "Vërtet ti Muhamed je me një shkallë të lartë morali"[230]. Po ashtu zonja Aishe, bashkëshortja e profetit Muhamed, kur u pyet për moralin e tij tha: "A nuk lexoni Kur'anin? Kur'ani ishte morali i tij". Pra burimi i moralit në fenë islame rrjedh nga Kur'ani dhe suneti. Këtu e kanë burimin ligjet teorike dhe praktike që formojnë një sistem të plotë morali, i cili përsos personalitetin e njeriut besimtar. Prandaj edhe profeti Muhamed, paqja e bekimi i Zotit qofshin mbi të, ka thënë: "Ndër besimtarët më të mirë në çështje të besimit, është ai që zotëron moralin më të mirë".

Nga sa u tha del si domosdoshmëri forcimi dhe përmirësimi i gjithanshmes edukative nga kuadrot fetare dhe familjet myslimane për edukimin dhe formimin moral të brezit të ri. Sigurisht ky është një problem shumë i gjerë dhe i ndërlikuar që nuk mund të analizohet në gjithë aspektet e tij vetëm me një shkrim. Do të ndalem vetëm në disa anë shumë të rëndësishme të këtij procesi që janë probleme të mprehta dhe aktuale dhe kanë të bëjnë me formimin e përgjithshëm të brezit të ri.

Në kuadrin e zhvillimeve demokratike, ku mbrohen me ligj liritë dhe të drejtat e njeriut, liria e besimit, e fjalës së lirë etj., në familjen tonë kanë ndodhur ndryshime të rëndësishme si në formë ashtu edhe në përmbajtje. Si rrjedhim edhe funksionet edukative që ushtrohen aty janë një fenomen në zhvillim e sipër. Nuk ka më familje të mëdha patriarkale jo vetëm në qytet, por as në fshat. Po shkohet gjithnjë drejt formimit të familjeve të vogla. Në këto kushte merr vlera të veçanta edukimi i fëmijëve dhe përgjegjësia për këtë bie në radhë të parë mbi prindërit. Ky fakt ka rëndësi të madhe për edukimin moral të fëmijëve dhe kërkon në mënyrë të domosdoshme të rritet niveli arsimor e kulturor i vetë prindërve, të rritet niveli ekonomik i familjes, niveli edukativ i nënës, të rritet koncepti i barazisë midis burrit e gruas etj.

Pra kanë lindur tipare të reja në fizionominë e familjes shqiptare, si jehonë drejtpërsëdrejti e ndryshimeve të mëdha demokratike. Krahas anëve pozitive, kjo ka sjellë edhe probleme e detyra të reja në fushën e edukimit të fëmijëve jo vetëm para familjes, por edhe për shkollën e shoqërinë. Zoti i madhërishëm në Kur'anin fisnik thotë: "Njeriun e kemi porositur të jetë i sjellshëm ndaj prindërve të vet. Nëna e mbart atë me mund dhe me mund e lind. Ai mbartet dhe ushqehet me gji për tridhjetë muaj dhe, kur arrin në moshën e burrërisë e i mbush dyzet vjet, ai thotë: "O Zoti im! Më frymëzo që të të falënderoj për begatitë që Ti më ke dhënë mua dhe prindërve të mi dhe që të bëj vepra të mira, me të cilat Ti do të jesh i kënaqur! Më dhuro pasardhës të mirë! Tek Ty kthehem i penduar dhe Ty të dorëzohem!""[231].

Rëndësi vendimtare, në radhë të parë, ka të kuptuarit drejtë të faktit që edukimi me besimin te Zoti, me edukimin moral nuk bëhet vetëm me fjalë. Ai është një edukim i gjallë dhe aktiv që

[230]. Kur'an, Kalem: 4.
[231]. Kur'an, El-Ahkaf: 15.

realizohet edhe në jetën e përditshme, duke i shoqëruar fëmijët në aktivitete edukative për ndjekjen e praktikave të adhurimit ndaj Zotit. Pra familja dhe çdo gjë që e rrethon fëmijën të shërbejë për edukimin e tij. Për këtë duhet:

Së pari: Të forcojmë punën për krijimin e koncepteve dhe shprehive të shëndosha të sjelljes dhe edukatës qytetare të brezit të ri, udhëhequr nga besimi në Zotin Famëlartë. Ky problem duhet parë që në hapat e para kur fëmija fillon shkollën. Për këtë çështje familjet tona bëjnë punë të pamjaftueshme dhe jo konkrete në aspektin e sjelljes së kulturuar në familje, me shokët në shkollë e jashtë saj. Duhet të na tërheqin vëmendjen ankesat e mjaft qytetarëve për sjelljen dhe qëndrimin e disa fëmijëve në rrugë, përdorimi i një fjalori të pahijshëm, të grindjeve me shokët, me ofendime banale e deri në përdorimin e mjeteve të ndaluara si thika etj. Opinioni i shëndoshë dhe familja duhet të thellohen në analizimin e shkaqeve të këtyre shfaqjeve që i shtyjnë fëmijët të kenë sjellje të tilla e pastaj të mendohet thellë se si mund të shmangen këto fenomene. Të dy qëndrimet ekstreme, si ato të masave të ashpra administrative edhe qëndrimet liberale janë të dëmshme. Këtu duhet sakrifikim i kohës së lirë të prindërve për t'u marrë më shumë me edukimin e fëmijëve dhe kjo kërkon edhe kulturë e arsim. Shembulli i prindit është faktor kryesor në edukimin e fëmijëve, kur ai reflekton mendim të drejtë, të fjalës së vërtetë dhe të sjelljes korrekte me fëmijët e tij dhe me shoqërinë përreth. Në prezencën e fëmijës ai tregohet si një personalitet që udhëhiqet nga e drejta dhe e vërteta që nuk njeh mashtrim dhe gënjeshtër. Ai i zgjedh shokët me të cilët shoqërohet dhe i ofron fëmijës miq e shokë të mirë. Në Kur'an thuhet: "O besimtarë! Frikësojuni Allahut dhe bëhuni me ata që janë të sinqertë (në fjalë dhe në vepra)!"[232]. Tek prindërit dhe fëmijët duhet të zotërojë ai moral që karakterizohet nga e vërteta dhe e sinqerta, nga ndershmëria dhe drejtësia. Mendimi dhe vepra duhet të përbëjnë unitetin e sjelljes, në radhë të parë nga prindërit me qëllim që fëmija të gjejë terrenin e shëndoshë që të përfaqësojë kudo të mirën, të bukurën, të drejtën etj., që burojnë nga tërësia e cilësive morale e shpirtërore, pasuruar nga burimi Hyjnor.

Një prind besimtar edukon një fëmijë besimtar që udhëhiqet në jetë gjithmonë nga arsyeja e shëndoshë dhe sjellja e bukur.

Në praktikën e përditshme shpesh hasen raste nga të rinj e të rritur që sillen në kundërshtim me mendimet e veta. Kjo do të thotë se ata dëmtojnë identitetin e tyre njerëzor dhe nuk shkojnë drejt përsosjes së personalitetit të tyre dhe moralit të bukur. Pikërisht këtu duhet të marrë kthesë besimi i njerëzve të devotshëm, të cilët, duke u mbështetur në udhëzimet hyjnore të Kur'anit Famëlartë dhe traditës së Profetit a.s., të bëhen më të ekuilibruar, më të drejtë në veprime, më besnikë e të ndershëm në marrëdhënie me të tjerët pa dallim gjinor. Në Kur'an thuhet: "Trego në Libër për Ibrahimin! Ai ishte njeri i së vërtetës dhe profet."[233].

Së dyti: Të heqim dorë nga moralizimet formale, nga cektësia dhe puna me hope dhe të gjallërojmë e pasurojmë gjithnjë e më shumë punën për edukimin moral të brezit të ri në familje, të shkëmbejmë mendime për problemet e mprehta aktuale të realitetit. Në përgjithësi puna edukative në familje ka një defekt të madh, sepse ajo bëhet e shkëputur nga gjendja konkrete e reale në terrenin praktik. Sot rinia po i mbush kafenetë e luksit, klubet e natës, kazinotë etj., ku shërbehet alkool, drogë e pije të tjera dehëse nën efektin e të cilave ndodhin përdhunime e krime. Familja shpesh nuk i

[232]. Kur'an, Et-Teube: 119.

[233]. Kur'an, Merjem: 41.

përgjigjet në shkallën e duhur nevojave dhe interesave të fëmijëve të tyre, të problemeve dhe pyetjeve që shtrojnë ata dhe vetë problemeve që ka familja në veçanti. Sot ka probleme sociale shqetësuese që ndeshen në jetën e përditshme dhe kërkojnë trajtim të kujdesshëm nën siglën e moralit islam, që është i vetmi mjet shërimi për plagët që kanë prekur shkatërrimin e familjes, degradimin moral dhe fëmijë të mbetur jetimë e jashtë edukimit, nën ndikimin e traumave që po pëson familja.

Sjellja e shëndoshë e fëmijës gjen zhvillim e rritje vetëm në familje të shëndoshë, që udhëhiqet nga ligjet e moralit islam. Të jesh besimtar i vërtetë do të thotë që fjalët dhe veprat të reflektojnë gjithmonë të vërtetën. Në Kur'an thuhet: "Thuaj: "O Zoti im, më shpjer në një hyrje të kënaqur, më nxirr nga një dalje të kënaqur dhe më dhuro nga Ti fuqi, që do të më ndihmojë!""[234]. Kjo do të thotë që besimtari duhet të jetë njeri i drejtë jo vetëm me pjesëtarët e familjes së tij, por edhe me të tjerët dhe të qëndrojë larg mjediseve që nxisin epshin e pasionin për vepra amorale, si dhe të largojnë fëmijët e tyre nga këto që mund të tronditin apo lëkundin mendimin apo vendimin joshës së tyre.

Pajisja e brezit të ri me moral të shëndoshë do të bënte të mundur që ai të mos dorëzohej para bukurive më joshëse që i dalin përpara duke i bërë pjesë të natyrës së tij, e cila është e moralit të shëndoshë islam.

Së treti: Një drejtim tjetër ku duhet të përqendrohet roli edukativ i familjes, është edhe depërtimi i shpejtë dhe i vazhdueshëm i mjeteve të informacionit dhe komunikimit masiv. Nëpërmjet tyre po forcohet çdo ditë e më shumë ndikimi i jashtëm mbi fëmijët, pasurohet horizonti i tyre politik e kulturor, krijohen mundësi të gjera për të organizuar e ngritur në një nivel më të lartë punën edukative të saj. Kujdesi i prindërve për të shtuar këto mjete është në rritje e sipër. Krahas anëve pozitive që ka përdorimi i këtyre mjeteve, vlen të theksohet se ky proces ka edhe anët e veta negative. Shfrytëzimi dhe vlerësimi pa kriter i këtyre mjeteve, veçanërisht televizionet me filmat dhe emisionet pornografike, interneti dhe lojërat elektronike të fatit, kanë ndikimet e tyre negative dhe shumë të dëmshme për brezin e ri. Jo nga të gjithë prindërit dhe jo gjithnjë i kushtohet kujdes përdorimit kolektiv të mjeteve të ndryshme të kulturës e në veçanti asaj islame që disponon familja. Po çahet perdja e ndershmërisë që ka karakterizuar familjen shqiptare në përgjithësi e atë islame në veçanti. Ndershmëri do të thotë drejtësi dhe zbatim i ligjeve hyjnore për ndërtimin e jetës individuale, familjare e shoqërore, në përdorimin e ushqimeve në pije me fjalë e vepra si dhe gjithë sjelljet që manifeston njeriu në mjedisin ku jeton e punon. Besimtari i pajisur me moralin e bukur islam jeton me moton: "Allahu është Një". Për këtë Zoti Famëlartë në Kur'an urdhëron e thotë: "Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni! Dhe gëzojuni Xhenetit që ju është premtuar."[235]. Kjo i pret besimtarët e devotshëm të pajisur me moralin e bukur të Kur'anit e Sunetit që na mëson Profeti a.s., ata që ecin në rrugën e vërtetë me besim në sjellje të devotshme. Për sa kohë që zemra e besimtarit nuk është e drejtë, edhe besimi i tij nuk është i drejtë. Prandaj çdo besimtar në familje të punojë me fëmijët e tij që t'i kthehen me vetëdije Islamit, dhe të ushqehen me dritën e besimit. Këtë dritë ata do ta gjejnë në literaturën islame, që duhet të jetë prezente në bibliotekat e çdo besimtari.

---

[234]. Kur'an, El-Isra: 80.

[235]. Kur'an, Fussilet: 30.

Libri është një nga mjetet kryesore që ndikon për ta bërë familjen një ambient të kulturuar. Interesi i prindërve besimtarë për ushqimin mendor e shpirtëror si të vetin edhe të fëmijëve të tyre është detyrë e domosdoshme, pasi ata në shkollë ushqehen me libra që mohojnë fenë dhe Allahun e Madhërishëm. Përpjekjet për të lexuar literaturën fetare duhet të shndërrohen në shprehi dhe edukatë në mënyrë që rinia të marrë më shumë edukatë fetare dhe informacione mbi normat e moralit hyjnor islam. Për këtë arsye predikuesit fetarë duhet të shoqërojnë mesazhin fetar me një punë bindëse, edukative, të vazhdueshme e sistematike, që të shtojnë interesin në edukimin e fëmijëve me literaturë të përshtatshme fetare. Ndihma direkte që ata u japin fëmijëve për mbarëvajtjen në shkollë nuk duhet shkëputur nga ushqimi shpirtëror, me biseda interesante mbi besimin te Zoti, mbi mënyrën e sjelljes në çdo mjedis etj. Shembulli i gjallë i prindit ka fuqi të madhe ndihmëse te fëmijët. Zoti në Kur'an urdhëron e thotë: "Prandaj qëndro i patundur në udhën e drejtë, ashtu siç je i urdhëruar."[236]. Kjo nuk ndodh gjithmonë, sepse ka prindër që e kanë lënë në një anë fenë si dhe po shkëputen nga fëmijët në emër të lirive dhe të drejtave që ata kanë. Kështu frekuenca e daljes së prindërve nga shtëpia së bashku me fëmijët është e ndryshme në prindër të ndryshëm dhe për mosha të ndryshme të fëmijëve të tyre. Të dalësh bashkë me fëmijën gjatë kohës së lirë është një rast shumë i volitshëm për të ndikuar mbi ta, për t'i orientuar se çfarë qendrash kulturore të frekuentojnë dhe mënyra se si duhet të sillen kur ata ndeshen me fjalorin e pahijshëm të rrugës. Profeti a.s. ka thënë: "Çdo mëngjes gjymtyrët e njeriut i drejtohen gjuhës dhe i thonë: Kije frikë Zotin në lidhje me ne; nëse ti je e drejtë, edhe ne jemi të drejtë; nëse ti je e shtrembër edhe ne shtrembërohemi". Nuk ka rast më të bukur se sa shembulli i prindit dhe korrigjimi që mund të bëjë ai kur është me fëmijët e tij dhe dëgjon në rrugë të rinj e fëmijë që me fjalët më banale ofendojnë njëri-tjetrin. Vërehet se kjo nuk realizohet gjithmonë dhe nga të gjithë. Prirja e sotme është që fëmijët dhe të rriturit të marrin pjesë në aktivitete të rëndomta pa kontrollin reciprok prind-fëmijë. Shpesh sot vërehet se fëmijët, veçanërisht të rinjtë, nuk kanë dëshirë të ndjekin prindërit në shëtitje ose aktivitete të ndryshme se u "vjen turp", sepse gjoja janë rritur, por në fakt te këta individë ka filluar të nxjerrë kokë mendjemadhësia dhe tendenca e ruajtjes së privatësisë.

Së katërti: Forcimi i disiplinës brenda anëtarëve të familjes në zbatim të detyrave, do të ndikojë në edukimin e brezit të ri me normat e moralit islam. Konkretisht çështja shtrohet që prindërit të rrisin kërkesat ndaj vetes, ndaj punës së tyre për kujdesin ndaj fëmijëve duke shmangur indiferentizmin dhe liberalizmin. Nga ana tjetër, edhe fëmijët duhet të rrisin përgjegjësinë ndaj detyrave të tyre shkollore e jashtëshkollore në sjellje me shokët. Nga besimtarët fillimisht kërkohet që të zbatojnë me përpikëri adhurimin ndaj Zotit Famëlartë dhe të shquhen për moral të lartë në sjellje brenda familjes e jashtë saj. Ky shembull do të ndikojë pozitivisht tek të gjithë anëtarët e familjes. Nuk mund të tregohemi liberalë në zbatimin e detyrave fetare, sepse këto janë të shenjta. Një qëndrim i tillë reflekton indiferentizmin e fëmijëve duke e konsideruar vetëm si detyrë të prindërve e jo të tyren. Feja islame këshillon që çdo besimtar, çdo prind duhet të reagojë jo vetëm ndaj të metave te vetja, por edhe të metat që konstatohen tek të tjerët, tek fëmijët e tij, në bazë të normave të moralit të bukur islam.

Në masën e rinisë pak kohë i kushtohet punës për kryerjen e detyrave shkollore. Më shumë janë të dhënë pas shfrytëzimit të kohës së lirë pa kriter e vlerë si në rrugë, në lokale, në jetën e natës

[236]. Kur'an, Hud: 112.

ku vërehen edhe shfaqje të sjelljes së pakulturuar. Në ambientet publike shpesh ka shkelje të rregullave dhe mungesë respekti për më të mëdhenjtë, konkurrencë në marrëdhëniet me femrat e deri në grindje ku përdoren armë të ftohta e armë zjarri. Nga organet e policisë, kur jepet informacion për publikun për akte të ndryshme kriminale, shpesh thuhet: "Për motive të dobëta". Si mund të konsiderohet veprim i dobët kur 2-3 të rinj të maskuar, me armë dalin e grabisin tjetrin në mes të rrugës, çantat dhe bizhuteritë e grave duke u shkaktuar shpesh edhe vdekjen. Të tjerë rrëmbejnë e përdhunojnë të mitura etj. Këto nuk mund të klasifikohen si veprime të dobëta, por akte kriminale ndaj të cilave duhet të reagohet më forcën e ligjit e të mbahet qëndrim i rreptë duke i vënë para përgjegjësisë edhe prindërit e këtyre të rinjve, të cilët nuk kanë bërë si duhet detyrën e tyre për edukimin e fëmijëve.

Prindërit nuk duhet të pajtohen me këtë qëndrim ndaj këtyre shfaqjeve, të punojnë për forcimin e besimit në Zotin dhe të vendosin marrëdhënie të drejta me fëmijët duke i ndihmuar ata për pastrimin e figurës së tyre morale. Prindër indiferentë ndaj edukimit të fëmijëve me normat e moralit islam, krijojnë te fëmijët vetëm një autoritet fals. Familja duhet t'u presë rrugën që në embrion shfaqjeve të sjelljes negative të fëmijëve si mosbindjes së tyre ndaj prindërve dhe më të mëdhenjve në përgjithësi, të shthurjeve në sjellje dhe amoralë në veprime. Në raste të tilla indiferentizmi i prindërve mund të bëhet po aq i dëmshëm, madje më shumë i dëmshëm se sa mbajtja nën tutelë. Në përgjithësi rinia sot është mbajtur larg ndikimit fetar, të besimit te Zoti dhe urdhrave e udhëzimeve në dobi të tij për ta ruajtur atë të pastër. Në këtë mënyrë ata e ndjejnë veten të lirë nga syri i opinionit shoqëror, i kontrollit të shoqërisë dhe kudo në lokale, në rrugë, në autobusë krijojnë gjeste shumë të ulëta me femra, me vajza të reja, të cilave u ka plasur cipa e turpit, etj. Pra tek të rinjtë konstatohet ndjenja e një epërsie gënjeshtare dhe e vlerësimit të këtyre fenomeneve me mendjelehtësi, sëmundje këto që po depërtojnë pak nga pak në gjakun e tyre dhe nuk mund të marrësh guximin t'u japësh ndonjë këshillë se mund të shijosh tehun e thikës në trupin tënd siç ka ndodhur në jo pak raste. Prindërit paguajnë avokatë për t'i mbrojtur nga dënimi dhe një pjesë prej tyre nuk dënohen se konsiderohen të mitur. Këto probleme nuk analizohen me përgjegjësi për të parë se përse ndodhin, kush mban përgjegjësi? Përse prindërit qëndrojnë indiferent ndaj këtyre fenomeneve? Mos mendojnë se shkelin të drejtat e tyre? A mendojnë se këta fëmijë kanë detyrime edhe ndaj prindërve të tyre? Këto fenomene nuk duhen nënvleftësuar sepse marrin karakter të mprehtë e të rrezikshëm për shoqërinë. Organizimi i veprimtarive edukative fetare, ftesa për besimin te Zoti e kthimin në zbatimin e normave të moralit islam, do të përbënte një kthesë të madhe. Atë që bën feja nuk e bën as ligji. Feja e shoqëron njeriun në çdo çast të jetës deri në cepin më të errët të botës. Kur t'i drejtohemi me vetëdije Zotit Famëlartë edhe sjellja do të shoqërohet me vetëdije dhe e shikon pozitën e tij vlerësuese në mesin e të tjerëve. Zoti në Kur'an urdhëron e thotë: "Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër Tokë dhe, kur të paditurit i sulmojnë me fjalë, ata përgjigjen: "Paqe""[237]. Besimtar i mirë bëhet ai që rrjedh nga një familje e mirë, me prindër besimtarë që i nënshtrohen madhështisë së ligjeve të Krijuesit, reflektojnë një sjellje që vlerësohet nga të tjerët, por në veçanti efekti ndihet te fëmijët e tij. Pra pajisja me moralin Hyjnor është mjeti kryesor që e afron besimtarin me Zotin e tij dhe me njerëzit që e rrethojnë. Kjo përbën shkallën më të lartë të moralit që zotëron besimtari islam.

[237]. Kur'an, El-Furkan: 63.

Së pesti: Edukata morale është një tregues i rëndësishëm që ka të bëjë me bindjet dhe veprimet morale të brezit të ri në marrëdhëniet reciproke, në marrëdhëniet me prindërit, me punën etj. Duhet theksuar se procesin e edukatës morale prindërit e reduktojnë aq shumë sa e kufizojnë vetëm në mënyrën e sjelljes së fëmijëve të tyre në shtëpi e jashtë saj me shokët. Lidhur me këtë duhet mbajtur parasysh se Islami e konsideron moralin të shenjtë që bazohet në mësimet e Profetit Muhamed, paqja e bekimi i Zotit qofshin mbi të, i cili shprehet: "Jam dërguar për të përsosur moralin njerëzor". Kështu themi se morali ka një kuptim shumë më të gjerë dhe përmbledh disa tipare të rëndësishme si: ndershmëria, sinqeriteti, thjeshtësia, guximi dhe optimizmi, respekti ndaj të moshuarve, ndaj grave e vajzave, mbajtja e fjalës së dhënë si dhe vendosmëria për arritjen e objektivave në jetë. Të gjitha këto tipare ndikojnë në formimin e çdo besimtari dhe shfaqin e zhvillojnë natyrshëm personalitetin e tij. Në Kur'anin Fisnik thuhet: "Vetëm njerëzit që kuptojnë ia vënë veshin kësaj. Këta janë ata që i përmbahen besëlidhjes me Allahun dhe nuk e prishin premtimin"[238].

Besnikëria është një cilësi e besimtarit të sinqertë që kanë të përbashkët në ndjenjë, në mendime e në ide. Shfaqja herë pas here tek disa njerëz e ndjenjës së urrejtjes dhe smirës ndaj vëllait mysliman përbën armikun kryesor të besnikërisë. Besimtari nuk e prish moralin e tij me këto cilësi që janë të huaja për të. Në fjalë gjithmonë është i vërtetë, e mban fjalën e dhënë, është besnik në marrëdhënie dhe jo mashtrues e tradhtar. Në Kur'an thuhet: "... dhe e atyre që i plotësojnë premtimet, kur marrin përsipër diçka; e atyre që durojnë në kohë skamjeje, sëmundjeje dhe lufte. Këta janë besimtarët e vërtetë dhe këta janë ata që e kanë frikë Allahun."[239]. Po ashtu në ajet theksohet: "Besa në radhë të parë është cilësi dhe mirësi themelore e profetëve dhe njerëzve të zgjedhur". Prandaj çdo besimtar e në veçanti ai që është prind, këto cilësi të bukura të moralit duhet t'i manifestojë vetë dhe t'ua transmetojë edhe fëmijëve të tij. Me këtë ndjenjë çdo individ fiton besueshmërinë dhe lartësohet si person në familje e shoqëri. Mbi të gjitha familja që po shkon nga dita në ditë drejt tronditjes, duhet të reflektojë që të bëhet e qëndrueshme vetëm me forcimin e ndjenjës së besnikërisë. Aty ku ka humbur ndjenja e besnikërisë pritet të vijë shkatërrimi. Kështu ndodh edhe në një shoqëri, kur anëtarët e saj sillen me dyshim ndaj njëri-tjetrit, nuk do të ketë paqe e qetësi në mes tyre, përkundrazi, konflikte e deri krime.

Theksojmë se besa e besnikëria janë cilësi të larta të moralit njerëzor që ka të bëjë së pari me marrëdhëniet e besimtarit me Allahun e Madhërishëm e pastaj të marrëdhënieve të tij me veten e me njerëzit që e rrethojnë. Këto i mëson njeriu në Kur'anin Famëlartë e sunetin e profetit Muhamed, paqja e bekimi i Zotit qofshi mbi të. Është për të ardhur keq se kemi shfaqje të pabesisë në shoqërinë tonë, që përbëjnë sëmundje të rrezikshme si mashtrim, tradhti, mosmirënjohje etj., që kanë çuar deri në zhvatjen e pasurisë së tjetrit apo eliminimin fizik të shokut siç ndodhi në rastin e fitimit të basteve të futbollit prej 50 000 lekësh nga një person, të cilin e grabitën dhe e vranë, natyrisht duke i marrë edhe lekët e fituara. Profeti a.s. thotë: "I'i përmbahesh fjalës së dhënë në mënyrën më të bukur, është pjesë e imanit (besimit)."

Së fundi edukimi i çdo besimtari me normat e moralit islam, duhet të synojë zhvillimin e aftësive të secilit për të parandaluar sjelljet dhe veprat e pahijshme. Pajisja e besimtarit islam me

[238]. Kur'an, Err-Rra'd: 19-20.
[239]. Kur'an, El-Bekare: 177.

ndjenjën e besimit te Zoti i madhërishëm do të bëjë të mundur formimin e tipareve të shëndosha të moralit islam dhe do ta aftësojë atë të gjykojë e vlerësojë ngjarjet e realitetit që e rrethojnë si në familje edhe në shoqëri. Edukimi me moralin islam është i lidhur me të gjithë komponentët e tjerë të edukatës që përfshin familja e lidhur ngushtë me sistemin e edukimit që bën shkolla. Puna e familjes për edukimin e brezit të ri me normat e moralit islam është e pazëvendësueshme. Epërsia e saj qëndron në faktin se besimtarët islamë janë në kontakt të vazhdueshëm me predikuesit e fesë si dhe me literaturën fetare, duke vënë në zbatim urdhrat e porositë e Kur'anit dhe sunetit të Profetit a.s. Me këtë literaturë duhet të njihet çdo fëmijë që nga mosha 7-vjeçare dhe pastaj tërheqje e tyre në adhurim si familje dhe në kohën e lirë në xhami, do të ngjallë tek ata dashurinë për Krijuesin, Zotin Famëlartë. Prindi besimtar ka mundësi të pajisë fëmijët e tij me ndjenjën e besimit, e cila përbën bazën për një moral të shëndoshë.

Vendosja e një raporti të drejtë e të arsyeshëm ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, veçanërisht gjatë kohës së lirë mendoj se është një problem kyç që ka nevojë të merret në konsideratë nga çdo prind sepse fëmijët janë objekt dhe subjekt i edukimit. Sot po abuzohet me liritë dhe të drejtat që u janë garantuar fëmijëve. Sjellja e tyre në shumë raste lë për të dëshiruar si në marrëdhëniet me prindërit ashtu edhe me moshatarët jashtë shtëpisë. Moszbatimi i porosive të prindërve nuk po vlerësohet dhe pasojat ndihen kur ata arrijnë moshën e adoleshencës dhe rinisë.

Morali islam e konsideron mirësjelljen si fisnikëri të njeriut, që tregohet i edukuar me të tjerët, i butë dhe i ëmbël në të folur, në të ecur, në mjedis, kujdes dhe etikë në sjellje. Etika dhe mirësjellja për myslimanin duhet të përbëjë çelësin e moralit, për t'u bërë të dashur me njëri-tjetrin, të krijojnë një vëllazëri të shëndoshë, ashtu si porosit Allahu i Madhërishëm në Kur'an: "Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër"[240]. I dërguari i Allahut, Muhamedi a.s., ishte shembull i mirësjelljes për njerëzimin, për të cilin thuhet: "Kur dikush e pyeste për diçka, ai e dëgjonte me vëmendje të thellë dhe deri sa i interesuari të largohej, ai nuk largohej dhe nuk e linte vetëm. Kur dikush i shtrëngonte dorën për ta përshëndetur ose kur i zgjaste dorën, ai ia mbante dorën plot respekt, pa e lëshuar deri sa tjetri ta tërhiqte vetë. Nuk i shtrinte këmbët mes shokëve të vet. Kur takonte dikë, ai e përshëndeste vetë i pari. Ata që i vinin për vizitë i mirëpriste, u shtronte rrobën e vet që të uleshin …kurrkujt nuk ia priste fjalën dhe nuk ia linte të folurën në mes. Sipas shprehjes së Enesit r.a. "ai s'ka prekur kënd as me majën e gishtit. Kur zemërohej, kurrë nuk ka ndodhur që të godiste me grusht ndonjë send të fortë". Nga ky shembull duhet të udhëhiqen gjithë besimtarët myslimanë për edukimin me normat e moralit islam, për të parandaluar çdo shfaqje të pahijshme apo amorale. Ngritja e opinionit të shëndoshë islam për problemet e edukimit me tiparet e moralit islam mbetet detyrë e predikuesve dhe besimtarëve myslimanë.

1.5 Funksioni edukativ i familjes

Në shoqërinë e sotme demokratike brendia dhe metodat e edukatës familjare kanë marrë një funksion të ri. Ndryshe nga sa ndodhte më parë, kur edukimi mbështetej në traditën dhe zakonet e familjes dhe përqendrohej kryesisht në të drejtën për të riprodhuar, për mirëqenien ekonomike, për

[240]. Kur'an, El-Huxhurat: 10.

të edukuar etj., sot ka një sistem të tërë arsimor e institucione të tjera që interesohen për edukimin e brezit të ri. Tani në marrëdhëniet familjare nuk kemi pushtetin absolut të burrit, që ishte tipari karakteristik i familjes patriarkale me pozitën e nënshtruar të gruas dhe të fëmijëve në gjirin e familjes.

Me krijimin e familjes së re kanë ndryshuar edhe motivet e edukatës dhe po futen element të rinj të normave e rregullave të sjelljes, si dhe po bëhen përpjekje, sado të vogla, për të shpjeguar fenomenet më të thjeshta të natyrës, të njeriut dhe të shoqërisë. Kujdesi i prindërve për anën mësimore-edukative e kulturore të fëmijëve ka ardhur gjithnjë në rritje si rezultat edhe i mirëqenies ekonomike. Teknologjia e re moderne dhe mjetet e sofistikuara të informimit masiv kanë sjellë ndryshime të mëdha në botëkuptimin e prindërve, por edhe të fëmijëve. Televizioni, kompjuteri, interneti, facebook-u etj., po përdoren gjerësisht nga fëmijët. Mendoj se në këto kushte, krahas anëve pozitive të padiskutueshme, manifestohen edhe fenomene negative, të cilat duhet të merren në konsideratë nga ana e prindërve. Kjo ka të bëjë me përcaktimin dhe zbatimin e një regjimi korrekt ditor si nga ana e nxënësve, ashtu edhe e prindërve. Kjo çështje lidhet me kuptimin e drejtë që duhet të kenë vetë prindërit në kujdesin për fëmijët me dëshirën dhe rregullin për t'iu përkushtuar studimit individual në përgatitjen ditore për shkollë. Theksojmë se te një fëmijë që është bërë shprehi regjimi ditor, pas shkollës pushon me orar, luan me orar, merret me mjetet e informimit me orar, përgatit detyrat e shkollës me orar, do të sjellë një zhvillim normal, me shëndet të mirë, rezistent ndaj sëmundjeve etj. Te këta fëmijë shihen rezultate të larta në mësime, por njëkohësisht reflektojnë sjellje shembullore me të tjerët dhe shumë aktiv në jetën shoqërore.

Për të rritur dhe edukuar fëmijë të tillë, nga prindërit kërkohet plotësimi i kushteve minimale për studim, qetësinë, orarin etj., dhe pastaj duhet organizuar edhe kontrolli dhe ndihma e prindërve për zbatimin e këtij regjimi ditor. Prindërit duhet të këmbëngulin në këtë drejtim derisa fëmijët të fitojnë bindjen, dëshirën dhe vullnetin për të zbatuar me përpikëri të regjimit të caktuar. Prindërit duhet të ndjekin në mënyrë sistematike ecurinë e fëmijës në shkollë, me qëllim që të eliminojnë vështirësitë që ndesh fëmija në lëndë të veçanta që në fazën e parë.

Çështja e edukimit të fëmijëve nuk mjafton vetëm me kujdesin për ecurinë në shkollë, por edhe në aktivizimin e tyre për kryerjen e disa detyrave në nivel personal si kujdesi për mirëmbajtjen e veshjes, mënyra e të ushqyerit, si dhe në shërbime të tjera të vogla. Pra duhet të ngulitet dëshira për të kryer punë të vogla dhe jo çdo gjë t'u serviret e gatshme fëmijëve. Gjatë shërbimeve që u jep familja fëmijëve nuk duhet bërë dallim në punë ndërmjet djemve dhe vajzave. Për shembull, për larjen e enëve apo pastrimin e shtëpisë, hekurosja e rrobave etj., janë punë vetëm për vajza dhe për djalin është turp të merret me këto lloj punësh. Gjithashtu vajzat duhet të rrinë në shtëpi, ndërsa djemtë duhet të dalin e të jenë më të lirshëm. Koncepte të tilla i kemi edhe sot te bashkëshortë të veçantë kur vërehet se burri, pasi vjen nga puna, shtrihet e pushon ose del shëtitje me shokët, kurse gruaja mbyllet në shtëpi dhe merret me punët e shtëpisë si pastrim i shtëpisë, gatim, larje rrobash etj. Kjo është një mbingarkesë për gruan dhe nuk siguron barazinë e të drejtave midis tyre. Prandaj prindërit nuk duhet të bëjnë dallim as me fëmijët e tyre në kryerjen e punëve të shtëpisë.

Çështja e edukimit të fëmijëve është shumë komplekse, që përmbledh disa anë.

Një kujdes i veçantë duhet treguar në familjet ku ka më shumë se dy fëmijë, të cilët grinden me njëri-tjetrin. Këta jo vetëm që prishin qetësinë në familje, por edhe ndikojnë për keq në edukimin

e tyre duke u bërë nervozë, grindavecë, frikacakë, servilë etj. Lind pyetja: Pse ndodhin shpesh grindjet midis fëmijëve? Shkaku është se shpesh gjejmë fëmijë kapriçozë, me shfaqje të egoizmit, të kokëfortësisë, etj. Ka edhe raste të tjera,veçanërisht në familjet ku jetojnë edhe gjyshërit, të cilët janë të ndjeshëm dhe i përkëdhelin më shumë se duhet nipërit e tyre dhe shpesh nuk bien në emërues të përbashkët as me prindërit e fëmijës.

Gjithashtu fëmijët në familje duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë. Nuk mundet që njërin fëmijë ta përkëdhelësh më shumë ose ta lavdërosh me shumë dhe tjetrin ta shash, pasi kjo krijon xhelozi te fëmijët dhe ka ndikim shumë negativ në edukimin e tyre. Ajo që dëmton më shumë dhe lë gjurmë të thellë te fëmijët janë marrëdhëniet midis prindërve në familje. Grindjet midis prindërve, dhunimi i nënës nga ana e babait etj. jo vetëm traumatizojnë fëmijët, por luajnë rol shumë negativ edhe në krijimin e personalitetit dhe karakterit të tyre. Në të tilla raste bie dashuria e fëmijëve për prindërit dhe këto sjellin një sërë pasojash që formojnë cilësi negative te fëmija. Ajo që do të përgatiste kushtet më të mira edukative në një familje, pa shkaktuar shqetësime, do të ishte një familje e shëndoshë islame, që e ndërton jetën dhe edukatën mbi bazën e besimit te Zoti, i Cili e konsideron familjen dhe edukatën të shenjta.

Prindërit besimtarë do të respektonin njëri-tjetrin, do të falënderonin dhe adhuronin Krijuesin e tyre që u dhuroi fëmijë, të cilët kanë të drejtë të jetojnë dhe edukohen në frymën e këtij besimi. Edukimi fetar i fëmijëve përcaktohet nga disa faktorë:

Së pari, ata duhet të pajisen me kulturën e nevojshme fetare mbi bazën e së cilës të mbështeten edhe fëmijët e tyre. Pra kultura fetare merret me fëmijë dhe pastaj prindërit i marrin e i shoqërojnë në xhami ku dëgjojnë edhe këshilla nga predikuesit fetarë. Prindërit duhet të heqin pengesat që u servirin fëmijëve se nuk duhet të edukohen apo t'u transmetohen fëmijëve elemente të besimit fetar, por përkundrazi, të gjejnë mënyrën për furnizimin e tyre me literaturën fetare sipas moshës. Kur bëhet fjalë për organizimin e riteve, ceremonive e festave në mënyrë të hapur, duhet të marrin pjesë edhe fëmijët, pasi ndikimi i këtyre ngjarjeve në ndërgjegjen e fëmijëve lë mbresa të thella.

Nëpërmjet këshillave të prindërve dhe të ndjekjes së shembullit të tyre, fëmijët fitojnë mjaft elemente të mira të mirësjelljes si në respektin ndaj prindërve, gjyshërve, të moshuarve, më të rriturve, si dhe disa parime morale fetare; si të duan njëri-tjetrin, të ndihmojnë të varfrit, jetimët, mëshirën ndaj tyre etj. Po kështu pajisja me moralin e bukur i ndalon fëmijët të merren me thashetheme, me përgjime e shpifje, që dënohen edhe moralisht nga populli, por që ligji nuk merret me ta. Fëmijët nuk duhet të dëgjojnë nga prindërit e tyre të merren me paragjykimin e të tjerëve për sjellje e moral dhe në nder. Shembulli i keq i prindërve do të ndikojë në edukimin keq të fëmijëve. Zoti i Madhërishëm në Kur'anin Famëlartë urdhëron e thotë: "O ju që keni besuar! Asnjë burrë prej jush të mos tallet me burra të tjerë, se këta mund të jenë më të mirë se ai. Gjithashtu, asnjë grua të mos tallet me gra të tjera, se këto mund të jenë më të mira se ajo. Mos e nënçmoni dhe mos e qesëndisni njëritjetrin me nofka (të këqija)! Sa e shëmtuar është të thirresh me emër të keq pas (pranimit të) besimit! Ata që nuk pendohen, janë vërtet keqbërës. O ju që keni besuar! Mënjanoni shumë dyshime, se, vërtet, disa dyshime janë gjynah. Mos e spiunoni dhe mos e përgojoni njëri-tjetrin!"[241]. Po ashtu thuhet: "Mos shko pas diçkaje për të cilën nuk ke dijeni. Vërtet, dëgjimi, shikimi

[241]. Kur'an, El-Huxhuratë: 11-12.

dhe zemra, të gjithë këta do të merren në përgjegjësi."[242]. Parashikimi i të ligave për njëri-tjetrin është burim i shumë të këqijave, prandaj duhet edukuar çdo besimtar në familjen e tij që të ushqejë për tjetrin vetëm dashuri dhe respekt e të shprehë konsiderata të mira. Ashtu siç thuhet në Kur'an ku shprehet: "Kur e dëgjuat këtë përgojim, përse besimtarët dhe besimtaret nuk menduan mirë për njëri-tjetrin dhe të thoshin: "Kjo është shpifje e qartë"?!"[243].

Në kushtet e sotme familja e shoqëria duan t'i dënojnë me ashpërsi veprime të tilla që brezi i ri të rritet i pastër e me cilësi të larta morale, sinqeritetin, besnikërinë, bujarinë, ndershmërinë e mbi të gjitha besimin te Zoti dhe dashurinë për atdheun dhe prindërit. Zoti i Madhërishëm në Kur'anin Famëlartë urdhëron e thotë: "Zoti yt ka urdhëruar, që të mos adhuroni askënd tjetër përveç Atij dhe, që të silleni mirë me prindërit. Nëse njëri prej tyre ose të dy arrijnë pleqërinë te ti, mos u thuaj atyre as "uh!", mos i kundërshto, por drejtoju atyre me fjalë respekti. "[244]. Në shenjë bamirësie, shtrije përulësisht dorën ndaj tyre dhe thuaj: "O Zoti im, mëshiroji ata, ashtu siç më kanë rritur, kur unë isha i vogël"[245]. Kjo do të thotë që prindi nuk tregohet besnik me prindërit e tij edhe fëmija nuk do të ketë respekt ndaj prindërve të tij. Fatkeqësisht sot shumë prindër kanë mbetur pa kujdesin e fëmijëve e janë strehuar në "Shtëpitë e të moshuarve" nën kujdesin social. Familja islame duhet të jetë e shëndoshë, si themeli bazë i shoqërisë që është e lidhur me dashurinë, dhembshurinë, besnikërinë e sinqeritetin e ndërsjellë me njëri-tjetrin. Divorcet e shumta sot në shoqërinë tonë po dëmtojnë shumë edukimin e fëmijëve që mbeten pa mbështetjen e njërit ose të dy prindërve. Për këtë arsye profeti Muhamed, paqja e bekimi i Zotit qofshin mbi të, tërheq vëmendjen teksa thotë: "Marrëveshja më e rëndësishme, kushtet e së cilës duhet të përmbushen pikë për pikë, është marrëveshja e martesës e lidhur me bashkëshorten tuaj". Në Islam familja nuk përfaqëson vetëm lidhjen mes individëve që krijojnë bazën e saj, por edhe një mjedis social që merret si shembull për ndërtimin e shoqërisë. Pra ajo është kudhra e parë e edukatës, që promovon vlera të shëndosha për shoqërinë. Në brendinë e edukatës familjare islame, futen parime të shëndosha të moralit që mëshirojnë në vetvete një besim të sinqertë te Zoti e zbatimi i ligjeve të tij në Kur'anin Fisnik e sunetin e Profetit a.s.

Këto parime të rëndësishme mëshirojnë në vetvete respektimin e plotë të prindërve nga ana e fëmijëve, por njëkohësisht edhe përgjegjësinë e tyre për edukimin e fëmijëve. Një edukatë e tillë lë gjurmë të thella në rritjen e autoritetit të prindërve si edukatorë, por edhe respektimin e personalitetit të fëmijëve dhe tërë brezit të ri. Edukimi i brezit të ri me të drejta të barabarta ndërmjet djemve dhe vajzave siç thotë edhe Profeti a.s. se: "Dituria është detyrë për çdo mysliman e myslimane". Do të thotë që të parandalojë në të ardhmen patriarkalizmin që synon që në fëmijëri edukimin e djalit me tiparet e sundimit, të mburrjes, të kapadaillëkut etj., ndërsa te vajzat tiparet e nënshtrimit të plotë, të përuljes e të heshtjes para burrit. Edhe sot aty këtu vërehen koncepte patriarkale që burojnë nga kjo pabarazi dhe kemi fenomene të dhunimit të grave nga burrat e deri në sakrifikimin fizik të tyre.

Sot shoqëria dhe familja shqiptare dënon me ashpërsi këto fenomene apo veprime të ulëta të dhunës familjare, si dhe veprimet e tjera të kësaj natyre. Por zakoni i gjakmarrjes, mbeturinë e rendit

---

242. Kur'an, El-Isra: 36.
243. Kur'an, En-Nur: 12.
244. Kur'an, El-Isra: 23.
245. Kur'an, El-Isra: 24.

fisnor patriarkal të traditës komunare, po e gërryen familjen shqiptare që ka lënë fëmijë të ngujuar, pa ushqim, pa edukim dhe arsim, që presin fatin e tyre dhe rrezikohen nga dita në ditë.

Në shoqërinë demokratike në të cilën jetojmë, ku liritë dhe të drejtat e njeriut janë të garantuara me ligj, duhet të marrin një përmbajtje të re cilësi të pozitive të shqiptarit si besa, burrëria, mikpritja etj., duke u mëshiruar në ndjenjën e shëndoshë të besimit te Zoti, duhet të evitojmë vëllavrasjen në dobi të unitetit moral e fetar. Profeti Muhamed, paqja e bekimi i Zotit qofshin mbi të, ka thënë: "Mësoni të ruani e të forconi marrëdhëniet familjare e farefisnore, sepse kjo sjell dashuri mes të afërmve, shtim të pasurisë dhe zgjatje të jetës". Forcimi i marrëdhënieve familjare dhe farefisnore parandalon vëllavrasjen e për rrjedhojë gjakmarrjen. Por për ata që e përjetojnë sot, ftesa për forcimin e vetëdijes së besimit te Zoti dhe afrimin në adhurim e lutje tek Ai që na ka dhuruar jetën, bën të mundur që edhe ata të falin jetë njerëzish për të shpëtuar brezin e ri që të rritet i qetë, i lirë dhe i lumtur, për të shijuar edhe ata të mirat e kësaj bote.

Së fundmi, familja, si pjesë të edukimit të fëmijës, duhet të punojë për arritjen e përhapjes së fizionomisë morale të tyre, që përfshin edhe komponentë të sferës emocionale që lidhen së pari me besimin te Zoti i Madhërishëm e pastaj të respektit, të modestisë, të nderit dhe turpit, të dinjitetit personal dhe të dashurisë për atdheun.

4

Sheriati

1. Sheriati- Legjislacioni Islam

Sheriati apo legjislacioni islam përmbledh shumë dispozita, të cilat myslimanët janë të detyruar t'i respektojnë në jetën e përditshme. Burimi i këtyre dispozitave është në Kur'anin Famëlartë dhe në hadithin e profetit Muhamed, paqja e bekimi i Zotit qofshin mbi të. Ai i ka nxjerrë nga Kur'ani dhe i ka zbatuar në praktikë. Kjo konsiderohet edhe si traditë profetike.

Këtu do të ndalemi shkurtimisht në klasifikimin e dispozitave të sheriatit islam, që kanë të bëjnë kryesisht me tre elemente bazë të fesë islame për të cilat folëm më lart: Islami, Imani dhe Ihsani. Këto detyra janë për myslimanët e myslimanet që kanë mbushur moshën e pjekurisë dhe gëzojnë shëndet të mirë mendor e fizik. Ato janë:

1. Farzi - detyrimi: Myslimanët e myslimanet janë të urdhëruar të kryejnë: të falurit e namazit, agjërimin e ramazanit, dhënien e zekatit mbi pasurinë, kryerjen e haxhit një herë në jetë, për ata që i plotësojnë kushtet financiare, etj.

Kemi dy lloj farzesh: Farzi ajn - detyrë e domosdoshme për ata që u fol më sipër dhe Farzi kifaje, i cili nëse kryhet nga një grup myslimanësh, për të tjerët nuk është detyrë të përsëritet. Kjo ndodh me rastin e faljes së namazit të një xhenazeje (të vdekuri) nga një pjesë e pjesëmarrësve dhe shkarkohen të tjerët.

2. Vaxhib - detyrë: Është një detyrë, por jo urdhër i prerë si në rastin e farzit. Në këtë grup futen adhurime si: Falja e namazit të vitrit, falja e namazit të dy bajrameve, dhënia e sadakasë së fitrit, lëmosha dhe prerja e kurbaneve.

3. Suneti - Praktika e profetit Muhamed, paqja e bekimi Zotit qofshin mbi të. Këtu përfshihen veprimet në falje si: Në faljen e pesë kohëve shtohen edhe falje të tjera nga dy rekatë deri në katër rekatë që i ka praktikuar Profeti a.s. e këto konsiderohen "sunete" ose praktika e të dërguarit të Allahut të Lartësuar. Edhe sunetet ndahen në dy kategori: Suneti Muekede (i fortë) si falja e sabahut, e drekës, e akshamit, thirrja e ezanit, i ikametit etj. Këtë praktikë nuk e ka lënë asnjëherë Profeti a.s., ndërsa suneti gajri muekede (jo i fortë), është praktikuar nga Profeti a.s. në faljen e ikindisë dhe jacisë, por nuk i ka falur në vazhdimësi.

4. Mustehab - të pëlqyeshme për t'u punuar e vepruar, sepse edhe Profeti a.s. i ka kryer këto veprime në jetën e tij si në adhurim e në falje namazi të quajtura "nafile" dhe punë të tjera në mbrojtjen e shëndetit.

5. Mubah - të lejuara, por që nuk kanë masë të përcaktuar ndalimi ose lejimi, veçse konsiderohen vepra të dobishme për njeriun, si: respektimi i regjimit ditor me punë e pushime, argëtime etj.

6. Haram - të ndaluara: Janë ato vepra që Zoti i Lartësuar në Kur'anin Famëlartë i ka cilësuar si të dëmshme e të rrezikshme për jetën e njeriut dhe ka dhënë urdhër të prerë që të mos veprohen, si: bixhozi, alkooli, droga, prostitucioni, vjedhja, grabitja, vrasja, etj.

7. Mekruh - të papëlqyeshme: Në këtë kategori futen veprime si: moslarja e duarve para dhe pas ngrënies, pirja e duhanit, mosthirrja e ezanit dhe ikametit, etj.

8. Mufsid - vepra që prishin veprat fetare si të qeshurit në namaz, ngrënia në muajin e agjërimit etj.

Të gjitha ligjet dhe rregullat që janë vendosur në Shpalljen Hyjnore, Kur'anin Famëlartë si dhe interpretimet e bëra nga profeti Muhamed, që e përçoi këtë shpallje te njerëzit, janë përcaktuar si nene kushtetuese, të cilat duhet të zbatohen nga besimtarët myslimanë. Këto janë sanksionuar në ligje të përkthyera dhe në sheriatin islam, që shërben si kodi etik për myslimanët. Ky ka dallim me kodin penal e civil, pasi ka një shtrirje më të gjerë në veprimtarinë jetësore të njeriut. Në të përfshihen urdhra e ndalesa kategorike, thyerja e të cilave ndëshkohet me penalizime të rënda. Këto shtrihen edhe në fushën e ibadetit ose adhurimit ndaj Zotit si namazi, agjërimi etj. Dallimi qëndron se ato ndalesa që penalizohen në veprimtarinë e njeriut janë vrasja, prostitucioni, droga, konsumimi i pijeve dehëse etj., që penalizohen gjatë jetës, ndërsa për të tjerat do të japë llogari përpara Krijuesit të tij në Ditën e Ringjalljes. Në Kur'an thuhet: "Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit, për të shpresuar mëshirën (e Allahut)."[246].

1.1 Kur'ani dhe Suneti

Kur'ani ose Shpallja Hyjnore iu dorëzua Muhamedit a.s. për t'ia përcjellë njerëzimit. Në të përmblidhen urdhra e udhëzime, ndalime e lejime që nga mënyra e adhurimit deri te veprimtaria praktike e njeriut në ndërtimin e jetës dhe marrëdhëniet në familje e shoqëri. Pra është një mënyrë jetese e myslimanit e shprehur në ligjet e fesë islame, që e kanë burimin nga Kur'ani. Ky është i lidhur ngushtë me zbatimin në praktikë nga profeti Muhamed, që është suneti i tij. Si Kur'ani ashtu edhe suneti janë të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin, sepse i dërguari i Allahut të Lartësuar, Muhamedit a.s. vuri në jetë atë që thotë Kur'ani dhe tregoi praktikisht se si duhen zbatuar nga besimtarët.

Feja islame që praktikoi profeti Muhamed është model për t'u zbatuar nga myslimanët, t'i binden dhe nënshtrohen Mesazhit Hyjnor me vetëdije të plotë. Nuk mund të konsiderohesh mysliman në qoftë se nuk zbaton ligjet e Islamit, Kur'anin dhe Sunetin. Siguron bazën e edukatës islame për të jetuar sipas udhëzimeve të Mesazhit Hyjnor.

Me Shpalljen Hyjnore, njerëzit janë të ftuar të besojnë në Një Zot, në të vërtetën, të mirën, të drejtën. I dërguari i Allahut, Muhamedi a.s., u kumtoi njerëzve Kur'anin, Fjalën e Zotit, që përmban udhëzime shumë të rëndësishme, me synimin që të vendosë themelet e jetës së individit, familjes dhe shoqërisë njerëzore nga fillimi deri në mbarim të kësaj bote. Në tërë Kur'anin, në çdo fjalë të tij, tregohet ekzistenca e Zotit dhe në mënyrë direkte ose indirekte, bëhet fjalë për Të. Prandaj H. Muhamedi e interpretoi dhe praktikoi që njerëzit të kuptonin thellë pastërtinë e veprimeve e të motiveve, për të depërtuar në domethënien e çdo fjale e fjalie në tërë Kur'anin, për aftësimin e

[246]. Kur'an, Al Imran:132.

përgatitjes së shpirtit, që të ketë ndjenjë, pikëpamje e përvojë të njëjtë me atë që dëshmon e shpall Kur'ani. Me këtë vërtetojmë se Islami është Kur'ani dhe Kur'ani është Islami.

Kur'ani sqarohet nga mësimi i pastër, suneti i të dërguarit, të cilin e vërtetoi engjëlli Xhibril. Omer ibn El-Hattabi tregon: "Një ditë kur ishim me të dërguarin e Zotit, na u afrua një burrë me veshje shumë të bardhë e flokë shumë të zinj. Asnjë shenjë udhëtimi nuk dukej të kishte dhe asnjeri nuk e njihte. Pasi u ul përballë Profetit, duke mbështetur gjunjët pas të tijve dhe duke ia vënë duart mbi kofshët e tij, tha: "O Muhamed, më fol për Islamin (nënshtrimin)". Ai u përgjigj: "Islami (nënshtrimi) nënkupton që njeriu duhet të dëshmojë se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguari i Tij, të kryejë faljen (namazin), të paguajë taksën e dëlirimit (zekatin), të agjërojë gjatë Ramazanit dhe të bëjë Haxhin në shtëpinë e shenjtë (Mekë), nëse është i aftë të shkojë në të". Burri tha: "Ke thënë të vërtetën". Ne u habitëm që ai e pyeste dhe pastaj thoshte se kishte thënë të vërtetën. Ai tha: "Tani më fol për besimin(imanin)". Ai u përgjigj: "Besimi (imani) nënkupton që njeriu ka besim te Zoti, engjëjt e Tij, librat e Tij, lajmëtarët (të dërguarit) e Tij dhe dita e fundit dhe që njeriu ka besim në përcaktimin e të dyjave, të së keqes së tij dhe të mirës së tij". Burri i panjohur, pasi vuri re se kishte thënë të vërtetën, menjëherë tha: "Tani më fol lidhur me bërjen e të bukurës (ihsanin)". I dërguari u përgjigj: "Bërja e së bukurës do të thotë që njeriu të adhurojë Zotin sikur ta shihte, sepse, edhe nëse ai nuk e shikon Atë, e shikon Ai vetë".

Atëhere burri tha: "Më fol për vaktin (kiametin)".

Profeti u përgjigj: "I pyeturi nuk di më shumë se sa pyetësi".

Atëhere burri u largua.

Pasi kishte pritur një kohë të gjatë, Profeti më tha: O Omer, a e di kush ishte ai që pyeste?

Unë iu përgjigja: "Zoti dhe i dërguari i Tij e dinë më mirë".

Ai tha: "Ishte Xhibrili. Erdhi t'ju mësonte fenë tuaj".

Pra, feja islame përmban tre elemente bazë në strukturën e ndërtimit të saj, që janë: Islami, Imani dhe Ihsani.

Këto i praktikoi vetë H. Muhamedi, ua mësoi njerëzve, e përcolli familja e tij, shokët e tij të nderuar dhe mbarë myslimanët e botës. Këto na i la trashëgim dhe kanë kaluar shekuj e do të kalojnë të tjerë, por ato deri në ditën e fundit, do të mbeten të pandryshuara.

Myslimanët shqiptarë duhet ta studiojnë Kur'anin dhe sunetin e profetit Muhamed për të kuptuar rrugën që duhet të ndjekin, si dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me arsimin e kulturën e gjerë shkencore që të çon drejt civilizimit islam. Në këtë mënyrë do të vendosim fenë islame në vendin që meriton si paraprijëse e të gjitha niveleve kulturore e civilizuese. Nuk është e mjaftueshme që Islami të reduktohet vetëm në sjelljen personale të çdo besimtari, apo në aspekte formale të justifikueshme që nuk bëhen pjesë e shoqërisë. Islami është themeli i jetës dhe obligim i çdo besimtari t'i përmbahet fesë së tij, prandaj duhet ndjekur tradita profetike dhe suneti i tij. Të studiohen e kuptohen drejt nga një këndvështrim bashkëkohor për të njohur qëllimet dhe pikësynimet, për të sqaruar rregullat e përgjithshme të Islamit dhe për të vendosur programin e domosdoshëm me qëllim që Islami t'u përgjigjet sfidave të kohës.

Së pari ky studim të përfshijë jetën e lavdishme të Profetit të Islamit, që pasqyron mëshirimi shkencor dhe aktual në metodën që duhet ndjekur.

Teologu i mirënjohur, H. Ibrahim Dalliu në veprën e tij "Udha muhamedane" shprehet: "Nuk bëhet ndryshe veçse me ndjekjen e vulës së profetëve. Profetit të fundit Muhamedit, që është i madhi ynë dhe i madhi i të parëve dhe i të mbrapmëve në besim, në fjalë, në moral dhe në vepra". Në këtë mënyrë vjen të kuptuarit qartë të sunetit, njohja e qëllimeve dhe synimeve profetike të tij.

Dijetari bashkëkohor, akademiku Jusuf Kardavi, tërheq vërejtjen në veprën e tij "Të bashkëveprojmë me sunetin", kur shprehet: "Ka disa neglizhues që duan të hyjnë dhe flasin për Allahun e pejgamberin e Tij, atë që nuk e dinë". Prandaj duhet ta ruajmë të pastër hadithin e profetit a.s., të mos zmadhojmë gjërat e as të mos i deformojmë ato gjoja në emër të ndjekjes së rrugës së tij.

Suneti i Profetit është interpretim praktik i Kur'anit dhe zbatimi real i Islamit. Zoti në Kur'an urdhëron e thotë: "O ithtarët e Librit! Juve ju erdhi i Dërguari Ynë, i cili ju shpjegon gjëra nga ato që i keni fshehur ju prej Librave (Teuratit dhe Ungjillit) dhe ju fal shumë. Juve ju erdhi prej Allahut dritë (i Dërguari) dhe Libër i qartë (Kur'ani), me të cilin Allahu i drejton ata që ndjekin pëlqimin e Tij, në rrugën e shpëtimit, i nxjerr nga errësira në dritë me lejen dhe vullnetin e Vet dhe i shpie në rrugën e drejtë."[247]. Këtë udhë të drejtë e praktikoi dhe e ndoqi me saktësi H. Muhamedi e na e la trashëgim në breza, sepse përmbledh tërë jetën e njeriut nga lindja deri në vdekje si dhe lidhjen e ngushtë me Zotin e tij. Në Kur'an Zoti i Lartësuar thotë: "Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut."[248]. Ndërsa H. Muhamedi në një hadith shprehet: "Më e dobishmja fjalë është libri i Allahut dhe më e dobishmja sjellje është sjellja e Muhamedit dhe më e keqja e punëve është ajo që shpif pas meje, se çdo punë e shpifur është bidat i keq dhe çdo bidat është i ndaluar, jashtë rrugës së fesë". Kjo na detyron ne myslimanëve që të kuptojmë mirë udhën jetësore që përshkoi Profeti ynë a.s. për të qenë korrekt me ligjet juridike, morale, edukative si individ në familje e shoqëri. Jeta e H. Muhamedit është një objekt i ndriçuar në të cilin janë skalitur ligjet e fesë islame. Ai ishte mësues, këshillues dhe edukator i shkëlqyeshëm. Të ndjekim sunetin e H. Muhamedit, sepse natyra dhe karakteri i tij janë aq të pastra sa që ai në çdo çështje është i vërtetë, i drejtpërdrejtë dhe fisnik. Gjithmonë ka frymëzuar virtyte të larta në drejtësi, i zbatonte vetë e i predikonte tek të tjerët. Gjithë jetën e tij është në harmoni me Islamin. As fjala as vepra nuk janë nxitur nga interesi personal. Ai ka vuajtur për të mirën e të tjerëve, por asnjëherë nuk i ka bërë të tjerët të vuajnë për të. Personaliteti i tij është forma më e lartësuar e qenies njerëzore. Si i dërguar i Allahut duhet ndjekur udha e tij, fjalët e tij duhen pranuar dhe duhet t'u bindemi urdhrave dhe udhëzimeve të tij. Mosbindja ndaj tij është mosbindje ndaj Allahut dhe kjo patjetër të çon në degjenerim e shkatërrim. Këtë po e provon edhe shoqëria jonë, ku është dobësuar besimi ndaj Zotit dhe ka depërtuar droga, prostitucioni, trafikimi, krimi e korrupsioni etj. Të gjitha këto lidhen me forcën e besimit. T'i kthehemi besimit dhe me kurajë do të kapërcehen të gjitha veset negative. Duhet gjetur rruga e shpëtimit dhe këtë e gjen në mësimet e profetit Muhamed. Aty gjen jehonën e shpirtit të tij dhe duke zbuluar profetin, zbulon vetveten. Në Kur'an thuhet: "Ne i çuam të dërguarit Tanë me prova të qarta dhe bashkë me ta zbritëm Librat (e shenjtë) dhe peshoren (e drejtësisë): që njerëzit të veprojnë drejt."[249]. Për këtë duhet pranuar Profeti a.s. dhe të ndjekin gjurmët e tij. Vetëm kjo është rruga e shpëtimit, sepse jeta e tij paraqet moralin e Kur'anit, që e trupëzoi atë në realitetin islam. Prandaj edhe Zoti i lartësuar në

---

247. Kur'an, El-Maide: 15-16.
248. Kur'an, En-Nisa: 80.
249. Kur'an, El-Hadid: 25.

Kur'an thotë: "Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm"[250]. Në realitetin e sotëm ndeshemi edhe me shkelje të ligjeve islame gjë që tregon shthurje dhe krizë të ndërgjegjes, që vjen nga mungesa e besimit të shëndoshë te Zoti i madhërishëm. Për këtë ai na tërheq vëmendjen në Kur'an ku thotë: "O njerëz, ju ka ardhur këshillë (Kurani) nga Zoti juaj, shërim për zemrat tuaja, udhëzim dhe mëshirë për besimtarët."[251]. Për këtë arsye suneti jo vetëm që shpjegon Kur'anin, por nuk ndahet prej tij. Ai është burim i ligjeve islame për adhurimin, për marrëdhëniet ndërnjerëzore, për familjen, shoqërinë e shtetin. Kur'ani është shpirti i ekzistencës së Islamit dhe themeli i tij, është kushtetuta origjinale ku të gjitha ligjet kanë origjinën e tyre. Profeti a.s. ka qenë shpjegues i kësaj kushtetute, sqarues i saj dhe në të njëjtën kohë e praktikoi për njerëzit që të ndjekin rrugën e tij. Ky është Islami i vërtetë, një besim integrues në shoqëri. Ky hap horizonte të reja për jetën, natyrën, botën si dhe kohën dhe historinë. Mbi këtë bazë njeriu duhet të parashikojë ndërtimin e jetës që sjell lumturi e jo mjerim.

Jeta e njeriut është një luftë pa mbarim. Do të luftojë me vështirësitë e veta, të shokëve, do të luftojë me konkurrentët që do t'ia pengojnë lumturinë që ia pengojnë misionin e tij të pastër. Do të luftojë me pleqërinë e së fundi me kërcënimet që i bëhen jetës së tij, por as kjo nuk është në dorën e tij deri sa vjen një ditë e shuhet si qiri, ndahet nga kjo botë lëndore, provizore për t'u paraqitur tek Audienca Hyjnore.

Prandaj e ka detyrë ta njohë si Krijues të tij dhe të njohë detyrimet që ka ndaj Tij, sepse jeton në pronën e Tij.

O Zoti ynë! Mëshirues i mëshiruesve!

Na bëj të mundur që të ndjekim sunetin e H. Muhamedit a.s. dhe imamin tonë në ditën e ringjalljes.

1.2 Mëkati, format e tij

Sipas botëkuptimit të fesë islame, njeriu është krijuar me natyrë të pastër, pa vese dhe nuk trashëgon mëkatet e të parëve të tij. Ai është i pajisur me veti morale që i japin mundësi të dallojë të vërtetën nga e pavërteta, të kryejë vepra të mira, të pëlqyeshme nga Zoti xh.sh. dhe jo vepra të liga e të papëlqyeshme nga Zoti i tij. Me pak fjalë, ajo që bën njeriu pas lindjes së tij është rezultat i ndikimit të jashtëm, i familjes dhe shoqërisë. Pikërisht këtu formohet personaliteti i njeriut të ardhshëm dhe karakteri i tij. Zoti i ka dhënë njeriut lirinë për të zgjedhur rrugën e drejtë, për të kryer sjellje e vepra në përputhje me normat e fesë islame. Kjo liri e ngarkon atë edhe me përgjegjësi kur ai largohet nga e vërteta, i nxitur nga lakmia e pasionit, e çon atë në ligësi, prirur nga një krenari e paligjshme, një vetëpëlqim i tepruar që e çon njeriun drejt përdorimit të gjithë formave të padrejtësisë. Pra në trupin e njeriut zhvillohet një luftë midis pozitives dhe negatives. Në këtë luftë ka raste që fiton e keqja, sepse njeriu e ka të pamundur nga vetë natyra e tij të mos bëjë gabime, sepse vetëm Allahu është i pagabueshëm. Për këtë profeti ynë H. Muhamedi a.s. ka thënë: "Të gjithë

[250]. Kur'an, El-Ahzab: 21.
[251]. Kur'an, Junus: 57.

ju gaboni, por më i miri gabues nga besimtarët është ai që pendohet". Duke u nisur nga thënia e Profetit islam, bazuar edhe në shumë ajete të Kur'anit, Islami e ndan mëkatin në dy kategori të mëdha:

E para: janë mëkatet që bëhen kundër drejtësisë së Allahut;

E dyta: janë mëkatet që bëhen ndaj të drejtave të të tjerëve.

Vetë mëkati është një akt, është një mendim apo dëshirë që vihet në zbatim me qëllim, refuzon ligjin e Allahut, shkel të drejtat e Zotit apo të njeriut dhe i bën dëm trupit dhe shpirtit. Ky mëkat mund të përsëritet vazhdimisht ose mund të shmanget.

Feja islame është besim i patundur i njeriut besimtar, i cili beson në mënyrë të plotë ligjet dhe udhëzimet e Zotit, si dhe rregullat hyjnore të shpërblimit e të dënimit.

Nga pikëpamja e fesë islame dhe besimit të tyre, njerëzit i klasifikojmë:

1. Në njerëz që kanë besim të patundur te Zoti xh.sh., i binden ligjeve e dispozitave të Tij që ka dërguar për ta dhe bëjnë çdo gjë në pëlqim po me ato ligje.

2. Njerëzit që mohojnë ekzistencën e Zotit quhen qafirë (mohues).

3. Njerëzit që janë besimtarë, por bëjnë punë të papëlqyeshme, shkelin ligjet e Allahut, bëhen fajtorë dhe për këtë meritojnë dënim.

Pikërisht kjo është edhe pjesa më delikate në klasifikimin e mëkateve të njeriut besimtar. Zoti në Kur'an urdhëron e thotë: "Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin: (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun."[252]. Nga ky ajet kuptohet se njeriu ka kapacitet e potencial për të kryer vepra të mira. Në qoftë se ai me vullnetin e tij të lirë zgjedh aktualizimin e potencialit për mëkate, në vend të veprave të mira, do të shtojë elemente të rinj, jashtë natyrës së tij të pastër njerëzore. Pikërisht për këtë element të jashtëm që i shtohet natyrës së tij, do të jetë vetë përgjegjës.

Besimi i saktë në Zotin xh.sh. është themeli bazë i ndërtimit të jetës, që e mban atë të pastër nga të gjitha veset e liga, duke e bërë të ndërgjegjshëm për detyrat, të drejtat dhe liritë e tij, sipas normave të fesë islame. Mirëpo në trupin e njeriut, shpirti i tij dhe epshet janë gjithmonë në luftë me njëri-tjetrin. Shpirti në esencën e tij kërkon nderim, lartësim dhe dëshiron virtytet e larta, ndërsa epshet e pasionet vazhdojnë me prirjet natyrore dhe në ambicie, pëlqen atë që të largon nga e mira dhe të çon nga e keqja.

Çdo njeri do të gjejë veten e tij ndërmjet këtyre dy forcave të kundërta, por ai që kërkon të plotësohet dhe të gjykojë drejt, ka nevojë që të ketë një fuqi që ta çmojë atë që është e mirë dhe atë që është e keqe dhe të ketë një mendim të patundur. Udhëheqje e pagabueshme këtu është ligji dhe vullneti i Zotit. Në qoftë se besimtari mbështetet me ndërgjegje në udhëzimin hyjnor, egoizmi i tij nuk mund të bëjë ndonjë marrëzi dhe në këtë mënyrë nuk mund të bëjë asnjë mëkat. Përkundrazi, ai që ndjek dëshirat trupore, do të bëjë mëkate, do të abuzojë mbi vullnetin dhe fuqinë e tij e kjo pa dyshim është mëkat ose gjynah.

Besimtari që e pastron veten e tij në punë të mira vetëm për hir të Zotit, meriton shpërblime do ta marrë atë, në rast të kundërt do të qortohet. Pra janë porositë e shpirtit ato që kanë për qëllim shërimin shpirtëror, i japin forcë e supremaci zemrës dhe ndërgjegjes të ndjekin ligjet e fesë islame.

[252] Kur'an, Al 'Imran: 110.

Islami është Fjala e Zotit dhe Fjala e Zotit është gjithmonë më e lartë. Ajo ndiqet e nuk të ndjek pas, dominon e nuk dominohet. Njeriu nuk duhet të imitojë për të gjitha problemet e jetës, të sakta ose të gabuara qofshin ato, sepse imituesi nuk është i sigurt në atë që imiton. Nga ana tjetër, imituesi zhduk rëndësinë e intelektit të njeriut, i cili është krijuar për të drejtuar atë nga e vërteta. Imam Aliu r.a. ka thënë: "Mos e njih të vërtetën me burrëri, sepse e vërteta i njeh bijtë e saj". Zoti xh.sh. që i dhuroi njeriut fenë islame, i dha një dritë të shkëlqyeshme për të ndriçuar rrugën nga errësira.

Qëllimi i fesë islame për mbrojtjen e njeriut nga mëkatet (gjynahet), është pjesë e rëndësishme e amanetit të madh, të cilin refuzuan ta mbartnin qiejt dhe toka, por jo njeriu. Këtë amanet hyjnor Zoti xh.sh. ia dërgoi njeriut edhe si përgjegjës i hilafetit, zëvendësit të Tij në Tokë. Mbi bazën e kësaj përgjegjësie, njeriu do të shpërblehet dhe njëkohësisht për gabimet, do të ndëshkohet, sepse i është dhuruar mendja, logjika dhe vullneti i lirë. Nga ana tjetër, duhet njohur njeriu me mëkatin apo gjynahun. Ai krijon themelin bazë për vepra të mira, të mënjanohet nga vështirësitë, të mbrohet nga korrupsioni dhe nga interesat e tij individuale, familjare e shoqërore, duke mbrojtur llojin e tij si krijesën më të përsosur.

Kjo fe është mëshirë hyjnore për njerëzimin, ashtu si thotë Zoti xh.sh. në Kur'anin Famëlartë: "Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty (o Muhamed), veçse si mëshirë për botët."[253]. Ndërsa vetë Profeti a.s. thotë: "Unë u dërgova si mëshirë e dhuruar". Si nga ajeti kuranor edhe nga hadithi i Profetit a.s., në bazë të mëshirës së dhuruar, Zoti xh.sh. e ka larguar fanatizmin dhe ekstremizmin në drejtim të së mirës për të lejuar diçka, apo për ta ndaluar atë. Për këtë Zoti xh.sh. në Kur'an urdhëron e thotë: "... ndërsa mëshira Ime përfshin çdo gjë. Atë do t'ua jap atyre që ruhen nga gjynahet e japin zeqatin, atyre që u besojnë shpalljeve Tona"[254]. "Thuaj: "Me të vërtetë, Zoti im ka ndaluar vetëm punët e pahijshme, qofshin të hapëta ose të fshehta dhe gjynahet, dhunimin pa të drejtë, t'i shoqërohet Allahut (në adhurim) diçka, për të cilën nuk ju ka dhënë kurrfarë të drejte dhe të thoni për Allahun atë që nuk e dini."[255].

Nga ajeti kuptohet se Zoti xh.sh. krijoi për njeriun të gjitha të mirat dhe ia lejoi atij duke ndaluar vetëm ato sende që janë caktuar nga Kur'ani ose ligjvënësi. Por kemi edhe zakone ose vepra që njerëzit janë mësuar t'i përdorin në jetën praktike e janë pozitive. Këto nuk janë të ndaluara, janë të dobishme, lejohen të përdoren. Ashtu si thuhet në Kur'an: "Thuaj: "Çfarë mendoni ju për ushqimin që jua ka zbritur Allahu, një pjesë të të cilit e bëni të ndaluar e një pjesë tjetër të lejuar?" Thuaj: "A ju ka lejuar Allahu për këtë apo po shpifni gënjeshtra për Allahun?""[256].

Në bazë të ajetit kuptohet fare qartë se zakonet e nevojshme në jetën e njeriut si të ushqyerit, të ngrënët, të pirët, veshmbathja janë të rregulluara me norma të mira. Çdo gjë që është e mirë dhe e domosdoshme lejohet, ndërsa ajo që është e dëmshme nuk preferohet dhe është e padobishme.

Meqenëse Zoti xh.sh. është Krijues edhe i njeriut si qenia më e përsosur, i dhuroi edhe të mira të panumërta, ka të drejta absolute që t'i lejojë apo ndalojë atë që dëshiron Ai me vullnetin e tij. Ndërsa njeriu nuk ka asnjë të drejtë të kundërshtojë atë që ka ndaluar dhe konsiderohet mëkat, sepse qëllimi final i Allahut është të mbrojë interesin e njeriut. Zoti xh.sh. ka lejuar vetëm të mirën që është

---

253. Kur'an, El-Enbija: 107.
254. Kur'an, El-A'raf: 156.
255. Kur'an, El-A'raf: 33.
256. Kur'an, Junus: 59.

e dobishme për njeriun dhe ka ndaluar të përdorë atë që është e dëmshme dhe në rast se njeriu nuk merr në konsideratë ligjet e Zotit bëhet mëkatar. Për këtë Zoti xh.sh. në Kur'an thotë: "Të pyesin ty ç'është e lejueshme që të hanë. Thuaju (o Muhamed): "Ju lejohet juve çdo gjë që është e dëlirë"".[257]

Parimet e fesë islame i kanë hapur horizonte të gjera njeriut, duke mos e ngarkuar me përgjegjësi të rënda, gjithmonë i ka ofruar mirësi, udhëzim e mëshirë. Gjithashtu kur ai i ka ndaluar diçka njeriut, i ndalon edhe mjetet që të çojnë në mëkat, për marrjen e masave preventive për parandalimin e tyre, me parimin: "Ajo që të çon në gjënë e ndaluar (mëkat), konsiderohet e ndaluar apo mëkat".

Njeriu jeton në familje e shoqëri prandaj ka nevojë për të tjerët, për të bashkëpunuar në zgjidhjen e problemeve jetësore. Por cilat janë kufijtë e lejueshëm që nuk e ngarkojnë njeriun me mëkate apo gjynahe? Natyrisht, gama e problemeve është shumë e gjerë, por ne do të ndalemi në problemet kryesore që konsiderohen mëkate ndaj vetes dhe të tjerëve:

1. Konsiderohet mëkat përdorimi i pijeve dehëse dhe intoksikantët. Pa u ndalur në dëmin e tyre psikik e fizik të njeriut, dëmi i tyre është më i gjerë duke u bërë rrezik për familjen e shoqërinë, për mirëqenien e tyre shpirtërore, morale e materiale. Çdo gjë që deh konsiderohet alkool, pa marrë parasysh substancën nga e cila është prodhuar. Profeti a.s. ka thënë: "Çdo pije dehëse është alkool dhe çdo alkool është i ndaluar". Prandaj, sipas fesë islame, konsiderohet mëkat përdorimi i çdo pije dehëse. Jo vetëm kaq, por edhe prodhimi, tregtimi, eksportimi dhe puna që bëhet duke e shërbyer ndaj klientëve, konsiderohen mëkate dhe ndalohen nga ligji islam. Pejgamberin a.s. e kanë pyetur: "A mund të përdoret alkooli për ilaç?" Ai është përgjigjur: "Ai nuk është shërim, por sëmundje".

Po kështu janë të ndaluara dhe konsiderohen mëkate përdorimi i narkotikëve si hashashi, kokaina, opiumi etj., të cilat ndikojnë në shkatërrimin e shëndetit të individit, mpijnë nervat, sjell dobësimin psikik, dobëson vullnetin, i bën njerëzit të papërgjegjshëm dhe sjell shkatërrim moral. Ky individ bëhet i pavlefshëm për shoqërinë, qoftë mashkull apo femër.

2. Konsiderohet mëkat për femrën që përdor veshje të tejdukshme, ekspozon lakuriqësinë e trupit të saj, me barkun jashtë, me pjesët e sipërme e të poshtme të trupit të pa mbuluara e të gjitha këto në emër të modernizimit dhe lirisë së individit. Po ashtu bëjnë mëkat ata që prodhojnë fotografi me femra lakuriq ose gjysmë lakuriq dhe ekspozimin e tyre në faqet e revistave, gazetave, nëpër muret e ndërtesave etj. Veçanërisht të dëmshme konsiderohen programet pornografike që publikohen në mediat vizive e veçanërisht në televizion dhe internet.

3. Konsiderohet mëkat i madh për femrën që merret me profesionin e prostitucionit si dhe ata që merren me organizimin dhe administrimin e aktiviteteve të tilla. Po ashtu konsiderohen mëkate edhe forma të tjera të shthurjes morale si marrëdhëniet e lira seksuale midis të rinjve që çojnë në degradimin e njeriut duke e ulur personalitetin e tij dhe duke e rrezikuar jetën e tyre nga sëmundjet ngjitëse vdekjeprurëse.

Feja islame dënon rëndë dhe tërheq vërejtjen për parandalimin e marrëdhënieve të lira seksuale sepse shkakton edhe krime të lindjes, devijime familjare, shkatërrim të lidhjeve familjare, divorce, mbizotërim të epsheve dhe shkatërrim të moralit njerëzor. Zoti xh.sh. në Kur'an thotë:

[257]. Kur'an, El-Maide: 4.

“Dhe mos iu afroni imoralitetit, sepse vërtet ai është vepër e shëmtuar dhe është një rrugë shumë e keqe"[258].

Feja islame duke i ndaluar këto merr masa parandaluese për të penguar të gjitha mënyrat dhe format që të çojnë në mëkate apo shkatërrim total të njeriut pa dallim seksi. Ndalon si për mashkullin edhe për femrën të nxisin epshet e shfrenuara duke ndërmarrë masa parandaluese. Për përdoruesit do të ketë edhe masa ndëshkuese, ashtu siç thotë profeti ynë, H. Muhamedi a.s.: "Në zjarr do të hyjnë gratë lakuriqe, ato që veshin veshje të tejdukshme dhe provokative, nuk do të hyjnë në xhenet dhe nuk do të shijojnë aromën e tij".

4. Konsiderohet mëkat i madh homoseksualiteti. Ky akt pervers kundërshton rendin natyror të ligjvënësit, kompromenton seksualitetin e njeriut dhe konsiderohet krim kundër të drejtave të femrave. Përhapja e kësaj dukurie të fëlliqur në shoqëri shkatërron jetën e saj duke i shndërruar njerëzit në robër të degjeneruar moralisht.

5. Mëkat i madh konsiderohet mosrespektimi i prindërve. Respektimi i prindërve duhet bërë me sinqeritet të plotë dhe me punë të mira. Zoti xh.sh. në Kur’an urdhëron e thotë: "Njeriun e kemi porositur të jetë i sjellshëm ndaj prindërve të vet. Nëna e mbart atë me mund dhe me mund e lind."[259]. Ndërsa Profeti a.s., kur dikush e pyeti se kush e meriton më shumë shoqërimin e tij, tha: "Nëna jote, duke e përsëritur tre herë radhazi dhe të katërtën herë ka përmendur babain". Profeti a.s. e konsideron mëkat të madh mosrespektimin e prindërve, duke e radhitur menjëherë pas shirkut. Ai u është drejtuar shokëve të tij dhe ka thënë: "A t'ju informoj për tri gjëra që janë mëkate të mëdha? Po, - i thanë. Ai u tha: "Shirkun në Zotin e madhërishëm, mosrespektimi i prindërve, gënjeshtra e dëshmia e rreme".

Veçanërisht duhet kujdesur për prindërit, kur ata arrijnë në moshën e pleqërisë. Për këtë Zoti xh.sh. në Kur’an thotë: "Zoti yt ka urdhëruar, që të mos adhuroni askënd tjetër përveç Atij dhe, që të silleni mirë me prindërit. Nëse njëri prej tyre ose të dy arrijnë pleqërinë te ti, mos u thuaj atyre as “uh!”, mos i kundërshto, por drejtoju atyre me fjalë respekti. Lësho para tyre krahët e përuljes prej mëshirës dhe thuaj: “O Zoti im, mëshiroji ata, ashtu siç më kanë rritur, kur unë isha i vogël!”"[260].

Edhe të ofendosh prindërit është mëkat i madh. Kjo ndodh shpesh te ne që dëgjojmë të shahen të vegjël e të rinj, por edhe të moshuar me fjalë nga më të ulëtat e banale, duke ulur dinjitetin dhe personalitetin e tyre. Kur e pyetën Profetin a.s. se si mundet që njeriu të ofendojë e mallkojë prindërit e tij, ai u përgjigj: "Ai ofendon ose shan prindërit e ndokujt tjetër dhe tjetri ofendon e shan prindërit e tij dhe ai ofendon nënën e dikujt tjetër e tjetri ofendon nënën e tij".

6. Është mëkat të merresh me parashikime fati ose falle. Janë mëkatarë edhe ata që shkojnë për të parë fatin e tyre te këta fallxhorë. Ai që pretendon se shëron dhe njeh fshehtësinë e vërtetë, mashtron Zotin, të vërtetën dhe njerëzit. Askush, as engjëjt, as xhindet nuk e dinë të vërtetën. Zoti xh.sh. në Kur’an urdhëron e thotë: "Thuaj: “Askush, përveç Allahut, në qiell apo në Tokë, nuk i di të fshehtat…”"[261]. Ndërsa Pejgamberi a.s. ka thënë: "Kush shkon te fallxhori dhe u beson fjalëve të tij, bën kufër në atë që i është shpallur Muhamedit a.s.".

---

258. Kur’an, El-Isra: 32.
259. Kur’an, El-Ahkaf: 15.
260. Kur’an, El-Isra: 23-24.
261. Kur’an, En-Neml: 65.

7. Është mëkat të merresh me tregti të pandershme, të mashtrosh ose të shfrytëzosh dhe në mënyrë të veçantë është mëkat të merresh me prodhim dhe tregtim të pijeve alkoolike, narkotikëve dhe prodhimeve të tjera të këtij lloji. Profeti a.s. u është drejtuar tregtarëve me këto fjalë: "Tregtarët do të ringjallen Ditën e Kiametit të pamoralshëm, me përjashtim të atyre që i frikësohen Zotit, bëjnë mirë dhe janë të sinqertë" dhe më poshtë vazhdon: "O tregtarë, kini kujdes e mos gënjeni". Sot ka shumë tregtarë që mashtrojnë me mallin e tyre si p.sh. me mjaltin, me vajin e ullirit etj., duke bërë lloj-lloj përzierjesh. Mashtrimi shkakton amoralitetin dhe amoraliteti të çon në zjarrin e xhehenemit. Po ashtu janë mëkatarë të mëdhenj ata që betohen në tregti për mallin që shesin duke bërë një betim të gënjeshtërt se "është mall i mirë", kur e dinë se malli i tyre nuk është i mirë etj. Profeti a.s. për këta persona ka thënë: "Zoti nuk do të shikojë në Ditën e Kiametit tre persona, nuk do t'i pastrojë nga mëkati dhe do t'u japë dënim të hidhur: njëri prej tyre është tregtari që shet me betim të rrejshëm".

Gjithashtu është mëkatar ai që mashtron në matje, në peshore etj. Zoti xh.sh. lidhur me këta mashtrues në Kur'an urdhëron e thotë: "Kryejeni drejt matjen dhe peshimin"[262]. "Mjerë për ata që hanë në peshë (dhe matje), që, kur masin për veten, e marrin masën të plotë, ndërsa, kur u masin të tjerëve me litër ose me kandar, ua pakësojnë. A nuk mendojnë ata se do të ringjallen në një Ditë të madhe, Ditën, kur të gjithë njerëzit do të dalin para Zotit të botëve?!"[263].

Në ditën kur njerëzit kanë për të dalë para Zotit të botëve do të japin llogari për ato që kanë bërë, ashtu si thotë Zoti xh.sh. në Kur'an: "Sigurisht, Ne i ringjallim të vdekurit dhe shënojmë veprat që kanë bërë dhe gjurmët e (punëve të) tyre. Ne e kemi llogaritur çdo gjë në një Libër të qartë."[264]. Ky ajet qorton besimtarët që harrojnë ose mohojnë ringjalljen në ditën e llogarisë dhe se çdo gjë merr fund me vdekjen. Zoti xh.sh. e përsërit veten e Tij me këtë ajet tri herë, kur thotë: "Vetëm Ne" e ngjallim të vdekurin, me qëllim që të forcohet besimi në ndërgjegjen e njerëzve dhe nga ana tjetër të tmerrojë shpirtin e mohuesve që mendojnë se nuk do të ngjallen për të dhënë llogari.

8. Konsiderohet mëkat shtimi i pasurisë nëpërmjet kamatës, me shumicë ose pakicë. Zoti xh.sh. në Kur'an urdhëron e thotë: "O ju që keni besuar! Ta keni frikë Allahun dhe hiqni dorë nga kamata, nëse jeni besimtarë të vërtetë. Nëse nuk e bëni këtë, atëherë iu është shpallur luftë nga Allahu dhe i Dërguari i Tij.."[265]. Profeti a.s. i ka shpallur luftë të hapur kamatës dhe atyre që merren me kamatë duke treguar për pasojat shkatërrimtare që i sjell shoqërisë. Ai thotë: "Kur të përhapen kamata dhe liritë seksuale në shoqëri, vetë e lejojnë dënimin nga Zoti". Me ndalimin e kamatës feja islame mbron interesat e njerëzve, moralin dhe pasurinë e tyre. Nga ana tjetër kamata i largon njerëzit nga puna. Mallkohen nga Zoti xh.sh. marrësi i kamatës që ka dhënë hua një shumë të caktuar financiare me kusht që t'i kthehet në një shumë më të madhe. Po ashtu edhe ai që e paguan kamatën bën mëkat.

9. Është mëkatar ai që luan bixhoz. Feja islame bixhozin e barazon me alkoolin dhe e konsideron rrezik për vetë personin, por edhe për shoqërinë. Profeti a.s. ka thënë: "Kush i thotë shokut të vet "eja të luajmë bixhoz", duhet të japë sadaka". Bixhozi e degjeneron njeriun dhe e largon atë nga të gjitha detyrat që ka ndaj Zotit, familjes e shoqërisë. Bixhozi e bën njeriun të shesë fenë e tij, nderin e tij e të familjes, madje shkon deri edhe në shitjen e interesave të atdheut të tij.

---

262. Kur'an, El-En'am: 152.
263. Kur'an, El-Mutaffifin: 1-6.
264. Kur'an, Jasin: 12.
265. Kur'an, El-Bekare: 278-279.

Zoti xh.sh. në Kur'an urdhëron e thotë: "O besimtarë! Me të vërtetë, pijet alkoolike, bixhozi, idhujt dhe shigjetat e fallit janë vepra të ndyta nga punët e djallit. Prandaj, largohuni nga këto, me qëllim që të shpëtoni! Vërtet, djalli me pije alkoolike dhe me bixhoz kërkon që të fusë midis jush armiqësi e urrejtje dhe t'ju shmangë nga të kujtuarit e Allahut dhe kryerja e namazit. Prandaj, a po hiqni dorë?"[266]

10. Konsiderohet mëkatar personi që cenon të drejtat e tjetrit dhe prish vëllazërimin midis myslimanëve. Shkalla e mëkatit të njeriut është e ndryshme dhe varet nga shkalla e dëmit material e moral që sjell. Zoti xh.sh. në Kur'an urdhëron e thotë: "Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër, andaj pajtojini vëllezërit tuaj midis tyre dhe kijeni frikë Allahun, në mënyrë që ju të mëshiroheni."[267]. Në mënyrë të veçantë vëllazërimin e bën lidhja fetare. Ajo i afron besimtarët, i bën të njihen me njëri-tjetrin, të bashkohen e të mos ndahen, të jenë të sinqertë në mes tyre. Ai që i prish këto marrëdhënie me fjalë, me sjellje apo diçka tjetër është mëkatar. Profeti ynë a.s. ka thënë: "Mos e urreni njëri-tjetrin, mos e përgojoni njëri-tjetrin dhe mos kini zili ndaj njëri-tjetrit, por bëhuni robër të Zotit dhe vëllezër (për hir të Tij".

11. Konsiderohet mëkat të spiunosh ose të hedhësh dyshime për tjetrin. Feja islame kërkon pastërti shpirtërore dhe besim reciprok midis njëri-tjetrit. Për këtë Zoti xh.sh. në Kur'an urdhëron e thotë: "O ju që keni besuar! Mënjanoni shumë dyshime, se, vërtet, disa dyshime janë gjynah."[268] Myslimanit nuk i lejohet të dyshojë për vëllain e tij mysliman në qoftë se nuk ka argumente. Profeti a.s. thotë: "Kini kujdes nga dyshimi! Dyshimi është biseda më e rrejshme". Dyshimi të çon në spiunim. Vetë dyshimi është formë e brendshme kurse spiunimi është forma e jashtme. Përcjellja e fshehtësive të tjetrit është mëkat. Myslimani e ka për detyrë të këshillojë myslimanin për ta drejtuar në rrugë të drejtë dhe t'ia mbulojë turpësitë. Pejgamberi a.s. në një hytbe i është drejtuar xhematit me këto fjalë: "O njerëz që kini besuar me gojë e jo me zemër! Mos i dëmtoni myslimanët dhe mos spiunoni fshehtësitë e tyre! Zoti do t'i përcjellë fshehtësitë e atij që i përcjell fshehtësitë e vëllait të vet. Kujt ia përcjell Zoti fshehtësirat, do ta turpërojë qoftë edhe brenda shtëpisë së tij".

12. Konsiderohet mëkat i madh afër kufrit krimi i vrasjes. Sipas fesë islame, jeta e njeriut është e shenjtë dhe mbron shenjtërinë e shpirtit. Zoti xh.sh. në Kur'an urdhëron e thotë: "Prandaj Ne i urdhëruam bijtë e Izraelit se kush vret ndokënd, që s'ka vrarë njeri ose që nuk ka bërë çrregullime në Tokë, është sikur të ketë vrarë të gjithë njerëzit. Dhe, nëse dikush shpëton një jetë, është sikur të ketë shpëtuar jetën e krejt njerëzve."[269]. Edhe nga ajeti kuptohet se feja islame e trajton gjithë gjininë njerëzore si një familje dhe armiqësia kundër një anëtari të saj, konsiderohet armiqësi kundër gjithë gjinisë njerëzore. Profeti a.s. ka thënë: "Përfundimi i botës është më i lehtë për Zotin se vrasja e një myslimani", kurse në një hadith tjetër thuhet: "Zoti mund të falë çdo mëkat, përveç njeriut që vdes idhujtar ose njeriut që e vret qëllimisht besimtarin!" Jeta nuk është pronë e njeriut, sepse ai nuk është krijuesi i saj, nuk është as organ dhe as qelizë e tij. Zoti ia ka dhënë dhuratë atij dhe nuk lejohet ta pakësojë atë. Në fenë islame ekzistojnë mëkate të mëdha e mëkate të vogla, ashtu siç ekzistojnë mëkate kundër Zotit dhe mëkate kundër njeriut. Të gjitha mëkatet kundër Zotit, përveç njërit prej tyre, falen në qoftë se mëkatari kërkon falje në mënyrë të sinqertë. Zoti nuk fal

---

266. Kur'an, El-Maide: 90-91.
267. Kur'an, El-Huxhurat: 10.
268. Kur'an, El-Huxhurat: 12.
269. Kur'an, El-Maide: 32.

mëkatin e shirkut, të bërit shok Zotit, ashtu si thuhet në Kur'an: "Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Atij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë."[270]. Mëkatet kundër të tjerëve falen vetëm atëherë kur i dëmtuari fal mëkatarin ose kur zbatohen ligjet në mënyrë të rregullt. Mëkatet që u radhitën në këtë shkrim nuk i përfshijnë të gjitha, por u theksuan ato me të cilat shoqëria jonë është molepsur më shumë dhe janë shkelje flagrante ndaj ligjeve të Allahut që kërkohen me qëllim e vetëdije.

Si besimtar, duke u njohur me këto mëkate të mëdha, që shkojnë edhe afër krimit e deri në kryerjen e tij, duhet të marrim masa parandaluese. Vetëm duke u kthyer në dritën e besimit të Zotit xh.sh. me bindje e ndërgjegje të pastër për dëmet shkatërrimtare që i sjellin njeriut bërja e këtyre mëkateve, do të realizojmë kthesën aq të pritshme dhe të domosdoshme. Nuk ekziston asnjë mënyrë tjetër për të përfituar faljen nga Zoti xh.sh., veçse t'i drejtohemi drejtpërsëdrejti Atij e t'i shprehim pendim të sinqertë, sepse Ai i di të gjitha gjërat e nuk mund t'i fshihet asgjë.

I lutemi Zotit të na falë mëkatet tona dhe amanetin që na ka dërguar, t'ia dorëzojmë të pastër, për të përfituar nga mëshira e Tij nesër në Ahiret.

Amin!

1.3 Teube-ja (Pendimi)

Zoti në Kur'an urdhëron e thotë: "Të gjithë ju, o besimtarë, kthehuni tek Allahu të penduar, që të arrini shpëtimin!"[271].

Duhet ta dijë çdo besimtar se mëkatet e kanë fundin e keq, në qoftë se e keqja na gëzon kur e bëjmë atë, të dëmton pasoja e saj. Prandaj ai që dëshiron të jetë i mirë me Allahun, le t'i lutet Atij. Çdo besimtar duhet të mendojë për mëkatin që ka bërë, veçanërisht për turpin që do të ndiejë nesër kur të paraqitet te Zoti i tij i Plotfuqishëm.

Si shtyhet njeriu në mëkate?

Disa nga shkaqet që e shtyjnë njeriun drejt mëkateve janë:

1. Dija është dritë e dhuruar nga Allahu në zemrën e njeriut, kurse mëkati është errësirë. Kur njeriu humbet dijen dhe bie në mëkat është si të kalojë nga drita në errësirë.

2. Pakësimi i rrezikut është shkak që e shtyn njeriun të gënjehet nga kjo botë materiale.

3. Vetmia shpirtërore e njeriut duke u larguar nga rruga e Zotit.

4. Mëkati sjell mëkate të tjera, kur njeriu qëndron me njerëz në kryerjen e mëkateve dhe ai tërhiqet pas tyre.

5. Mëkatari i bën shprehi e zakon mëkatet e tij dhe e dëmton zemrën, ndërgjegjen e tij.

6. Mëkati ia errëson zemrën, dobëson turpin, i pakëson ushqimin dhe bëhet i urryer tek të tjerët.

Pendimi për t'u larguar nga mëkatet është pastrim i zemrës së njeriut dhe afrim tek Allahu xh.sh.

---

[270]. Kur'an, En-Nisa: 116.

[271]. Kur'an, En-Nur: 31.

Tregohet se: "Një idhujtar erdhi te Profeti a.s. dhe e pyeti: - A më fal Zoti nëse pendohem? Ai iu përgjigj me ajetin e Kur'anit ku thuhet: "(që ju porosis) të kërkoni falje nga Zoti juaj e të ktheheni tek Ai me pendesë. Ai do t'ju japë të shijoni kënaqësi të bukura deri në afatin e caktuar dhe do t'i japë çdo të miri shpërblimin e merituar. E, nëse ktheni shpinën, unë i frikësohem dënimit tuaj në Ditën e Madhe."[272].

Pra sado të mëdha të jenë mëkatet, sado të shumta të jenë ato, rrëzohen e likuidohen, harrohen, fshihen nga regjistri i çdo personi, në qoftë se ai kthehet me të vërtetë, me zemër e vepra, nga Zoti xh.sh.

- Në qoftë se mëkatari, mëkatet e tij i bën vetëm ndaj Allahut xh.sh., vendimi ka tre kushte:

1. Të ndërpresë menjëherë mëkatet;
2. Të pendohet me zemër të pastër;
3. Të mos e përsërisë më atë mëkat.

Në qoftë se mungon njëri nga këto kushte, mëkati nuk shlyhet dhe pendimi është i pavlefshëm.

Në qoftë se mëkati bëhet karshi njeriut tjetër, kërkon dhe një kusht shtesë. Për shembull, borxhliu duhet të shlyejë borxhin që ka. Ai që është dënuar, për shkak se ka dëmtuar një tjetër, duhet t'i kërkojë falje personit të dëmtuar. Po kështu edhe në rast ofendimi ndaj një tjetri, ofenduesi duhet t'i kërkojë falje personit të ofenduar. Pra, pendimi duhet bërë për të gjitha mëkatet, sepse po të bëhet i veçantë, vetëm për një mëkat të caktuar, nuk ka vlerë për të tjerat. Zoti në Kur'an thotë: "O ju, që keni besuar! Kthehuni tek Allahu me një pendim të sinqertë"[273].

- Ebu Hurejre r.a. thotë se e ka dëgjuar të dërguarin e Allahut të thotë: "Pasha Allahun, unë i drejtohem me pendim e kërkim falje Allahut për mëshirë dhe falje më tepër se 70 herë në ditë"[274].

Pra, kthimi i besimtarit me besim te Zoti, me zemër të pastër, e ndihmon atë t'i falen mëkatet, sido e kudo që të jenë, të gjitha me pendim të vërtetë sipas kushteve që u përmendën më lartë.

Të dashur besimtarë!

Duhet të shpëtojmë me pendim tek Allahu, sepse fundi i jetës mund të na trokasë në çdo çast. Nesër pendimi nuk ka vlerë. Besimtari të kërkojë falje sa është gjallë në këtë jetë, që të jetë i çliruar nga mëkatet. Pastaj përpara Zotit ai do të ketë kënaqësi të pafund, rini pa fund, gëzim pa fund në jetën pa vdekje. Gëzimi më i madh do të jetë për besimtarin kur të shohë bukurinë e Zotit xh.sh.

Qofshim edhe ne me fëmijët tanë, me prindërit tanë, me të gjithë myslimanët prej atyre. Amin!

Njeriun e nxit në mëkate djalli i mallkuar dhe kur e realizon këtë qëllim, ia shkëput lidhjen me Allahun xh.sh. me synim që të bëjë sa më shumë shokë nesër në ahiret, kur të shkojë në xhehenem.

Profeti a.s. ka thënë: "Zoti nuk shikon tek ju pamjet tuaja, fytyrat tuaja, por zemrat dhe punët tuaja". Këtu ndryshon besimtari me hipokritin. Besimtari dëshmon njësinë e Zotit, por zemrën nuk e ka të fortë dhe nuk i reziston mëkatit, megjithatë ai shpreson te Zoti me lutje e pendim, sepse Allahu

---

272. Kur'an, Hud: 3.
273. Kur'an, Et-Tahrijm: 8.
274. Buhariu.

nuk e do mëkatin dhe e fal atë. Ebu Abdurrahman Abdulla ibn Umer ibn El Hattabi tregon se Pejgamberi a.s. ka thënë: "Vërtet Allahu i plotfuqishëm pranon pendimin e robit të Vet deri në frymën e tij të fundit". Zoti xh.sh. e dërgoi Profetin Muhamed t'u thotë njerëzve: "Mos adhuroni tjetër veç Allahut, të kërkoni falje për mëkatet dhe të pendoheni për punët e këqija, kurse Ai do t'ju japë mundësi për jetë të mirë dhe shpërblim. Të mos mashtrohet kush duke menduar se mund t'i fshehë diçka Zotit xh.sh. Ai di gjithçka". Ai e krijoi njeriun për ta provuar, për të dalluar të mirën nga e keqja dhe mbi bazën e arsyes do ta shpërblejë ose dëmtojë atë. Zoti xh.sh. në Kur'an urdhëron e thotë: "Megjithatë, nëse ata pendohen, falin namazin dhe japin zeqatin, atëherë janë vëllezërit tuaj në fe."[275].

Besimtari i vërtetë duhet t'i mbështetet Allahut me falje e lutje, sepse nga kjo ai do të ketë vetëm fitim, duhet t'i ruhet mëkatit më tepër se bishës së egër, pasi feja e Zotit xh.sh. është mbi çdo fuqi. Pra sa të jemi gjallë le të bëjmë teube, të kërkojmë falje me zemër e gojë, që kur të na afrohet vdekja, të jemi të përgatitur për mëshirën e Zotit xh.sh.. Jahja Raziu thotë r.a: "Lum ai që lë këtë jetë, para se jeta ta lërë atë, ndërton varrin para se të hyjë në të dhe fiton pëlqimin e Zotit para se të dalë përpara Tij". Toka thotë:"O biri i Ademit! Sot po ecën përmbi mua, nesër do të jesh në barkun tim. Biri i Ademit, sot gëzohesh me të këqijat, nesër do të dëshpërohesh kur të biesh në barkun tim. Biri i Ademit, sot ke me ngrënë shumë lloje ushqimesh se je mbi mua, nesër do të të hanë krimbat, kur të vish në barkun tim. Biri i Ademit, bën mëkat mbi mua, nesër do të pësosh gazepin në barkun tim".

Profeti a.s. thotë: "Çdo fëmijë i Ademit gabon. Më i miri ndër ata, është ai që ben teube e kthehet tek Zoti xh.sh.".

Më e mira është pendimi menjëherë pas mëkatit, qoftë me dashje ose pa dashje, sepse kjo zemër është e lidhur mirë me Zotin xh.sh., por ajo zemër u dobësua një çast nga harresa apo epshi i fortë.

Një herë vjen një djalë te Ibrahim bin Ed'hemi dhe iu ankua se po bënte gjithnjë mëkate dhe nuk po mundej të largohej prej tyre.

Ibrahimi i tha: Në qoftë se pranon prej meje disa këshilla, mos u frikëso nga askush.

Mirë, - tha djali, - m'i trego ato!

E para: Ai tha: - Në qoftë se do të bësh mëkate para Zotit xh.sh., atëherë mos ha ushqimin e Tij.

Djali tha: - Çfarë të ha, kur dihet se gjithësia është e Tij?

Atëherë Ibrahimi tha: - A është e bukur të veprosh kundër kënaqësisë e të hash ushqimin e Tij?

Djali tha: - Jo.

E dyta: Në qoftë se do të bësh mëkate para Zotit xh.sh., atëherë dil jashtë pronës së Tij.

Djali tha: - Kjo është më e rëndë se e para.

Ibrahimi tha: - A është e mirë të kundërshtosh kërkesat e Tij, kur ti banon në pronën e Tij dhe ha ushqimin e Tij?

Jo, - tha ai.

E treta: Ibrahimi tha: - Në qoftë se do të bësh një gjë që nuk i pëlqen Zotit xh.sh., kërko një vend të fshehtë, ku nuk të sheh Ai.

---

[275] Kur'an, Et-Teube: 11.

Djali tha: - Nuk bëhet, pasi Zoti xh.sh. sheh, ndjen dhe di gjithçka e kudo.

Atëherë Ibrahimi tha: - A është mirë të bësh punë që nuk i pëlqen Zotit xh.sh. duke qenë në praninë e Tij, ha ushqimin e Tij, kur Ai sheh, ndjen dhe di gjithçka.

I riu tha: - Jo.

E katërta: - Kur të vijë engjëlli të të marrë shpirtin, thuaji atij: "Më prit pak të bëj teube e ndonjë punë të mirë."

I riu tha: - Engjëlli nuk e pranon atë kërkesë.

Ibrahimi i tha: - Në qoftë se nuk mund të shtysh engjëllin që të merr shpirtin, si pret të shpëtosh nesër?.

E pesta: - Në qoftë se të vijnë engjëjt kur të ringjallesh të të marrin për në zjarrin e xhehenemit, mos shko!.

Ai u përgjigj: - Kjo nuk është e mundur!

Atëherë si shpreson të shpëtosh në jetën e ardhshme? - i tha Ibrahimi.

Djali tha: - Këto këshilla më mjaftojnë. Unë bëj teube, pendim të vërtetë e i lutem Zotit xh.sh. të më falë të metat e gjynahet që kam bërë përpara.

Gjatë kohës kur jetonte Profeti a.s., një i ri me emrin Malik, i biri i Dinarit, u martua e lindi një vajzë që e deshi shumë, por kur pinte alkool, ajo me lodrat e saj, ia derdhte. Megjithatë ai vazhdonte të pinte. Një ditë, papritur i vdiq vajza e vogël. U mërzit shumë, por nuk mund ta sillte dot në jetë. Një natë, në gjysmën e muajit shaban, si zakonisht, piu dhe fjeti dhe në gjumë pa një ëndërr të çuditshme: "Iu bë sikur erdhi dita e kiametit, u ringjallën njerëzit dhe ky vetë bashkë me ta. Nuk dinte nga të shkonte. Dëgjoi një zë të tmerrshëm nga pas. Ktheu kokën dhe sheh një kuçedër të madhe e të zezë, me gojë të hapur që ishte sulur drejt tij. Ai nisi të vrapojë, por ajo e ndiqte nga pas. Ai tha: "Rrugës takova një plak të dobët, me mjekër të bardhë e të pastër. E përshëndeta dhe i kërkova të më mbrojë nga kjo kuçedër. Ai më tha: -Nuk mundem, jam i dobët, por ec më shpejt se ndoshta gjen ndonjë tjetër që mund të të shpëtojë.

Vrapova deri sa përfundova në majë të një mali, por ana tjetër e malit kishte zjarr. Kthej kokën dhe pashë se ajo më ndiqte. Desha të hidhem në zjarr, por në këtë moment dëgjoj një zë: "Largohu nga zjarri, nuk je për të". Kthehem dhe marr vrapin në krahun tjetër. Përsëri më del përpara ai plaku me mjekër të bardhë dhe iu luta të më shpëtojë. Ai më tha: "Shko tek ai mali se aty ndodhen amanetet e myslimanëve. Në qoftë se ke ndonjë aty, ai do të të ndihmojë". Kur arrita atje, pashë një mal të rrumbullakët prej argjendi. Në të ishin dritaret me perde e secila ishte prej floriri. Iu solla rrotull me vrap derisa kuçedra më afrohet shumë. Në këtë çast dëgjoj disa engjëj që po thërrisnin: "O banorë të këtij mali, hapni dritaret e shikoni se ndoshta ky njeri i mjerë ka ndonjë amanet tek ju. Dolën shumë fëmijë dhe njëri nga ata thirri: "Ej, shikoni sa afër i ka shkuar armiku atij njeriu". Në atë çast shoh vajzën time e cila thirri duke qarë: "Betohem, ky është babai im!" Në çast kërcen nga dritarja dhe erdhi pranë meje, më kapi për dore dhe me dorën e djathtë largon kuçedrën. Më mori brenda, më caktoi një vend dhe u ul në prehrin tim. Ajo m'u drejtua: "O baba, a nuk ka ardhur koha që besimtarëve t'ju zbuten zemrat dhe të kthehen te Zoti xh.sh.?" Lotova dhe i thashë: "O vajza ime, çfarë bëni ju këtu?" Ajo tha: "Ne lexojmë Kur'anin". Atëherë - i thashë, - më trego se ç'është ajo kuçedër që deshi të më hante? Ato janë punët e këqija, prandaj donte të të hidhte në zjarr". Po ai plaku me mjekër të bardhë? - i thashë. Ajo u përgjigj: "Janë punët e mira që ke bërë, por

të pakta dhe nuk kishe mundësi të shpëtoje. "Në fund - tregon ai, - pyeta vajzën se çfarë bënin ata këtu?, - dhe ajo tha: "Ne jemi fëmijët e besimtarëve, banojmë këtu deri sa të vijë dita e kiametit, ju presim juve që të vini dhe të lutemi e ndërmjetësojmë tek Allahu xh.sh. për t'ju futur edhe juve ne xhenet."

Në fund, Maliku tha: "U çova nga gjumi me një frikë të tmerrshme, i theva të gjitha shishet e alkoolit dhe bëra një teube-pendim të vërtetë tek Allahu xh.sh. dhe për këtë u bë shkak ëndrra që pashë.

Të dashur besimtarë!

Njeriu ka dobësitë e veta, ka elemente të së mirës dhe të së keqes, por ndjenjat fisnike e shtyjnë atë në vepra të mira e të kujtojë Zotin, t'i lutet Atij për ndonjë mëkat që mund të ketë bërë. Zoti xh.sh. në Kur'an urdhëron e thotë: "Nxitoni drejt faljes së gjynaheve nga Zoti juaj dhe Xhenetit, hapësira e të cilit është sa qiejt e Toka dhe që është përgatitur për të devotshmit, të cilët japin lëmoshë edhe kur janë në mirëqenie, edhe kur janë në vështirësi, e mposhtin zemërimin dhe ua falin fajet njerëzve. Allahu i do bamirësit."[276]

Pendimi tek Allahu me zemër të pastër është shpresa për faljen e mëkateve, duke iu drejtuar vetëm Atij drejtpërsëdrejti, pa asnjë ndërmjetës tjetër. Profeti a.s. ka thënë: "Dashuria e Allahut ndaj krijesave të Tij është 100 herë më e madhe se dashuria e nënës për fëmijën e saj". Ndërsa në një hadith kudsij thuhet: "Kush do të mund të më afrohet një pëllëmbë, Unë i afrohem atij një bërryl, kush më afrohet një bërryl, Unë i afrohem një pash; e kush më afrohet në ecje, Unë i vrapoj në takim". Zoti xh.sh. në Kur'an thotë: "sepse veprat e mira i shlyejnë veprat e këqija"[277]. Zoti xh.sh. nëpërmjet Kur'anit tregon se besimi në natyrën e njeriut qëndron në mendjen e shëndoshë të tij. Ashtu si thotë në Kur'an ku shprehet: "Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin: (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun."[278]. Prandaj njeriu,veçanërisht myslimani, duhet të kthejë fytyrën nga e mira, nga Allahu xh.sh., t'i afrohet me pendim përpara se t'i vijë fundi i jetës së tij. Zoti xh.sh. thotë: "Çdo shpirt do ta shijojë vdekjen"[279].

O ti mëkatar, që je zhytur në këtë botë të përkohshme, që ke braktisur Islamin për jetën e kësaj bote, që e ke harruar adhurimin ndaj Zotit, nuk zbaton ligjet e Tij dhe nuk merr mësim nga fundi që të pret! Largoju mëkateve të kësaj bote. Mos mendo vetëm për kënaqësinë e kësaj bote, por mendo edhe për Ahiretin. Ti ke parë shumë dhe do të shohësh edhe më shumë. Puna nuk mbaron këtu. Jeta e vërtetë fillon pas vdekjes. Tani ti je duke fjetur dhe këto që sheh nuk janë gjë tjetër veçse një ëndërr. Vetëm se duhet të kesh parasysh se nuk je përgjegjës për ato që bën në ëndërr, por për ato vepra që ke kryer në jetën e kësaj bote. Së shpejti do të zgjohesh. I dërguari i Allahut thotë se të gjithë njerëzit që vdesin në gjumë do të zgjohen.

O Zoti ynë!

Na zgjo para se të vdesim. Na jep ne sy për të parë dhe për të nxjerrë mësim. Na bëj ne të turpshëm dhe na dhuro një gjuhë të pastër. Na jep kënaqësi kur të bindemi Ty dhe na bëj ne nga robërit e Tu. Na bëj ne të lumtur me bindjen ndaj Teje dhe pastroje moralin tonë të keq me moralin

---

276. Kur'an, Al 'Imran: 133-134.
277. Kur'an, Hud: 114.
278. Kur'an, Al 'Imran: 110.
279. Kur'an, Al 'Imran: 185.

e Kur'anit. Na mundëso që të fitojmë ndërmjetësimin e Muhamedit a.s. Na mbro nga të këqijat e nefsit tonë.

Na bëj ne nga adhuruesit e Tu që kërkojmë kënaqësinë Tënde duke të përmendur Ty.

Merr shpirtin tonë si myslimanë dhe na bëj ne nga të sinqertët.

Na bëj ne të sigurt ndaj dhimbjes së vdekjes kur Azraili të marrë shpirtin tonë.

Na mundëso që fjala e fundit të jetë shehadeti, dëshmia në Zotin xh.sh.!

Kur të na vijë vdekja, kur të gjitha organet e trupit tonë të ndahen nga njëri-tjetri dhe kur doktorët të heqin shpresën prej nesh, hiqe perden nga sytë tanë, na dërgo engjëjt për gëzim, na trego vendin tonë në xhenet, na bëj ne nga të shpëtuarit dhe na largo nga zjarri i xhehenemit!

Ndriçoje varrin tonë dhe lumturoje shpirtin tonë duke parë të dashurit që kemi. Punët tona të mira bëji bashkudhëtare në varr. Na bëj ne nga ata që të fitojmë mirësitë e Tua!.

Na bashko me të dashurin Tënd, Muhamedin a.s. në xhenet. Mos na ndaj prej tij. Na fut në mirësinë Tënde në xhenet e të shohim bukurinë e fytyrës Tënde!

Mos na gjyko me drejtësinë Tënde, por me faljen tënde dhe me bujarinë Tënde. Na bëj që të fitojmë si jetën e kësaj bote, ashtu edhe të botës tjetër!.

Na fal dhe na mëshiro, mëshiroji ata që kanë vdekur dhe jepu paqe e lumturi atyre që janë gjallë prej nesh.

Largoji të këqijat tona, na mundëso që të bëjmë punë të mira dhe na furnizo me begatinë Tënde!.

Të keqen mos na e bëj të bukur dhe të bukurën mos na e bëj të keqe!.

Jepi begati tokës tonë, jepu paqe gjithë shqiptarëve. Udhëzoi në rrugë të drejtë ata që i besojnë mësimet e Tua dhe bëji të pranueshme pendimet tona!.

Amin!

PËRMBAJTJA

faqe

HYRJE……..

KAPITULLI 1
ISLAMI ËSHTË I NDËRTUAR NË PESË SHTYLLA …….

1. *Dëshmia ose shehadeti* ……..
1.1 Ç'është Islami?.....
1.2 Njeriu lind me natyrë islame…….
1.3 Islami fe universale ……
1.4 Islami rrezaton dije e kulturë ……..
1.5 Edukimi i brezit të ri me Islamin ……
1.6 Të ndjekim Islamin ……

2. Të falurit e namazit ……..
2.1 Ritet fetare – adhurimi ……
2.2 Xhamitë – vende të shenjta adhurimi ……..
2.3 Virtytet e namazit …….
2.4 Veprimtari praktike: Si merret abdesi, si falet namazi, si falet namazi i xhumasë, si falet namazi i Bajramit, si falet namazi i xhenazes, si falet namazi i teravisë ……

3. *Agjërimi i Ramazanit* …….
3.1 Muaji agjërimit, faktor i rëndësishëm për përsosjen e moralit të agjëruesit ……
3.2 Kush nuk duhet të agjërojë…….
3.3 Vlerat e agjërimit në edukimin e vullnetit e të karakterit…….….
3.4 Nata e Kadrit ……

4. *Dhënia e Zekatit* ……
4.1 Shpërblimi dhe dhënia llogari në lidhje me detyrën e zekatit ……
4.2 Dispozitat e legjislacionit islam për zekatin ……
4.3 Qëllimi dhe kujt i takon zekati …….
4.4 Renditja e dhënies së zekatit ……..
4.5 Kujt nuk i takon zekati …….
4.6 Përqindja dhe lloji i pasurisë që i nënshtrohet zekatit ……..
4.7 Ç'është Nisabi? ……..
4.8 Objekti i Zekatit ……
4.9 Ari dhe argjendi …….
4.10 Stolitë ……..
4.11 Malli tregtar …….

4.12 Kërkesat ……..
4.13 Zekati për bagëtinë ……..
4.14 Prodhimet bujqësore …….
4.15 Sadekatu -l -Fitri ……..

5. *Kryerja e Haxhit njëherë në jetë* ……..
5.1 Domethënia e Haxhit ……
5.2 Vlerat shpirtërore të Haxhit ……

KAPITULLI 2
KUSHTET E IMAMIT …….

1. *Të besuarit në Zotin e madhërishëm* ……..
1.1 Zoti ekziston ……
1.2 Zoti është fuqiplotë ……...
1.3 Ç'është imani? ……..
1.4 Besimi në dritën e Kur'anit …….
1.5 Besimi, themeli i jetës ……..
1.6 Besimi pa vepra e praktikë e humb gjallërinë dhe fuqinë motivuese të tij …….
1.7 Trupi i njeriut, argument i ekzistencës së Krijuesit ……

2. *Të besuarit në Meleket (Engjëjt) e Zotit* ……..
2.1 Engjëjt – lajmëtarë të padiskutueshëm të Zotit të lartësuar …….

3. *Të besuarit në librat e Zotit*…….
3.1 Librat e Zotit – Shpallje Hyjnore …….
3.2 Kur'ani, baza e besimit islam …….
3.3 Kur'ani Mrekulli ……
3.4 Kur'ani, kushtetuta më e mirë në jetë …….
3.5 Filozofia e Kur'anit ……...

4. *Të besuarit në të dërguarit e Zotit* ……
4.1 Të dërguarit e Zotit ……
4.2 Besimi në pejgamberët ……..
4.3 Madhështia e Muhamedit a.s. ……..
4.4 H. Muhamedi profet reformator i kohërave ……

5. *Besimi në ditën e gjykimit* …….
5.1 Ç'është vdekja? ……..
5.2 Varri ……..
5.3 Ringjallja ……..
5.4 Dita e llogarisë …….

5.5 Parajsa – Xheneti …….
5.6 Ferri – Xhehenemi …….
5.7 Jeta e pasosur ……
5.8 Ç'është shpirti i njeriut?……..…….

6. *Të besuarit në caktimin e Zotit* …….

KAPITULLI 3
IHSAMI ……
1. *Ihsami – Bërja e asaj që është e bukur* ……..
1.1 Bëni atë që është e bukur …….
1.2 Sinqeriteti ……
1.3 Sinqeriteti – virtyti më i lartë i profetit Muhamed ……..
1.4 Morali njerëzor është me origjinë hyjnore …….
1.5 Funksionimi edukativ i familjes …….

KAPITULLI 4
SHERIATI ……
1 *Sheriati legjislacioni islam* ……
1.1 Kur'ani dhe Suneti …….
1.2 Mëkati dhe format e tij ……..……..
1.3 Teube – Pendimi ……..

LITERATURA

1. Hafiz Dalliu — Ajka e Kuptimeve të Kur'ani Qerimit, fq. 4, 22, 25, 33, 35, 37, 40, 41, 42, 45, 46, 54, 59, 62, 63, 65, 67, 74, 75, 83, 84, 86, 120, 125, 130, 140, 143, 160, 175, 178
2. Hafiz Dalliu — Patriotizma në Tiranë
3. Muhamed Gazali — Feja jonë
4. Sajmir Bulku — Sekretet e mjekësisë në Kur'an
5. Kurani i madhërishëm Qytetërimit Islam. — Prof. Hasan I. Nahi, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i